

FORMA E NAMAZIT E TË DËRGUARIT

[sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]

E PËRSHKRUAR PREJ FILLIMIT DERI NË FUND, SIKUR TË ISHIT DUKE E PARË

Shejh Muhamed Nasirudin el-Albani

Hyrje.....	4
Metodologjia e këtij libri.....	7
Thëniet e Imamëve në lidhje me pasimin e Sunetit dhe me mospërfilljen e pikëpamjeve të tyre që kundërshtojnë atë.....	9
1) Ebu Hanifja (rahimehull-llah)	9
2) Malik ibn Enesi (rahimetull-llah).....	11
3) Shafiu (rahimehull-llah).....	12
4) Ahmed ibn Hanbeli (rahimetull-llah)	15
Braktisja e pikëpamjeve të imamëve nga ana e pasuesve të tyre, nëse ato janë në kundërshtim me Sunnetin.....	18
Përgjigje mëdyshjeve	20
Dilema e parë:	20
Dilema e dytë:	22
Dilema e tretë:	27
Dilema e katërt:.....	29
Të drejtuarit kah Qabja	32
Qëndrimi në këmbë gjatë namazit.....	35
Namazi i personit të sëmurë në pozitë të ulur	35
Namazi në anije	36
Ulja dhe qëndrimi në këmbë në namazin e natës (<i>Tehexhahud</i>)	37
Namazi me këpucë të mbathura dhe urdhri për të bërë kështu	37
Namazi në Minber.....	38
Sutra dhe Obligimi për të.....	39
Çka e prish namazin	41
Ndalimi i faljes në drejtim të varrit.....	41
Tekbiri	42
Ngritja e duarve.....	44
Vendosja e dorës së djathtë mbi dorën e majtë dhe urdhërimi për këtë.....	44
Vendosja e duarve në gjoks	44
Shikimi në vendin e sexhdes dhe përulësia.....	45
Lutjet e hapjes (Duatë).....	48
Këndimi	53

Këndimi i ajeteve një nga një	53
Domosdoshmëria e El-Fatiha-së dhe rëndësia e saj	54
Shfuqizimi i këndimit pas imami në namazet me zë	56
Detyrimi për të kënduar në namazet pa zë	57
Amini dhe thënia e tij me zë nga imami	57
Këndimi pas El-Fatiha-së	58
Kombinimi i sureve të ngjashme dhe i të tjerave në një rekat	60
Lejimi i këndimit të vetëm El-Fatiha-së	61
Këndimi më zë dhe në heshtje në pesë namazet dhe në namazet tjera.....	62
Këndimi me zë dhe në heshtje në namazin e natës (<i>Tehexhahud</i>)	62
Çka këndonte ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në namaze të ndryshme.....	63
1- Namazi i Sabahut	63
Këndimi në namazin sunnet para sabahut	65
2- Namazi i Drekës	66
Këndimi i ajeteve pas El-Fatiha-së në dy rekatet e fundit.....	66
Domosdoshmëria e leximit të Fatiha-së në çdo rekat	67
3- Namazi i Ikindisë	67
4- Namazi i Akshamit	68
Këndimi në namazin sunnet pas Akshamit	68
5- Namazi i Jacisë	68
6- Namazi i natës	69
7- Namazi i Vitrit	72
8- Namazi i xhumasë	73
9- Namazi i Bajramit	73
10- Namazi i xhenazes	74
<i>Tertili</i> (Këndimi me tone të ngadalshme ritmike) dhe Zbukurimi i zërit gjatë këndimit.....	75
Përmirësimi i Imami	77
Kërkimi i strehimit dhe pështyerja lehtas gjatë namazit me qëllim të sprapsjes së tundimit	77
Rukuja (përkulja).....	78
Përshkrimi i përkuljes.....	78
Obligimi i qetësimit në ruku	79
Dhikret e rukunë	80
Zgjatja e Rukusë.....	82
Ndalimi i këndimit të Kur'anit në Ruku	83
Të drejtuarit pas rukusë dhe çka duhet thënë atëherë.....	83
Zgjatja e këtij qëndrimi dhe obligimi për t'u qetësuar në të	87
Sexhdja	89
Rënia në sexhde me duar	89

Përshkrimi i Sexhdes.....	90
Obligimi për t'u qetësuar në sexhde.....	92
Dhikret e Sexhdes.....	93
Ndalimi i këndimit të Kur'anit në Sexhde.....	95
Zgjatja e sexhdes.....	96
Rëndësia e sexhdes.....	96
Sexhdja në tokë dhe në shtrojë (hasër).....	97
Ngritja nga sexhdja.....	98
Ulja <i>muftarishen</i> ndërmjet dy sexhdeve.....	98
<i>Ik'a</i> ndërmjet dy sexhdeve.....	99
Obligimi për t'u qetësuar ndërmjet dy sexhdeve.....	99
Zgjatja e uljes ndërmjet dy sexhdeve.....	99
Dhikret ndërmjet dy sexhdeve.....	99
Sexhdja e dytë.....	100
Ulja e pushimit.....	101
Mbështetja në duar gjatë ngritjes për në rekatin tjetër.....	101
Rekati i dytë.....	101
Obligimi i këndimit të sures El-Fatiha në çdo rekat.....	101
Teshehudi i parë.....	103
Lëvizja e gishtit në <i>teshehhud</i>	103
Obligimi i <i>teshehhudit</i> të parë dhe vlefshmëria e të luturit gjatë tij.....	105
Llojet e teshehudeve.....	105
<i>Es-Salah 'ala En-nebijj</i> (Dërgimi i <i>Salavateve</i> mbi të Dërguarin) - Vendi dhe mënyra e dërgimit.....	109
Dobi të rëndësishme lidhur me dërgimin e <i>salavateve</i> mbi të Dërguarin e ummetit.....	111
Duaja në <i>teshehhudin</i> e parë.....	120
Ngritja në rekatin e tretë e pastaj në të katërtin.....	122
<i>Kunuti</i> në pesë namazet për shkak të ndonjë fatkeqësie.....	123
<i>Kunuti</i> në namazin e vitrit.....	123
Obligimi i këtij <i>teshehudi</i>	125
Obligimi i dërgimit të <i>salavateve</i> mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel- lem] në këtë <i>teshehud</i>	125
Obligimi për të kërkuar strehim nga katër gjëra para bërjes së duasë.....	126
Duaja para Selamit dhe llojet e ndryshme të saj.....	127
<i>Teslimi</i> (përshëndetja e paqes).....	131
Obligimi i <i>teslimit</i>	132
SHTOJCË.....	133
SHTOJCA 1.....	134
SHTOJCA 2.....	140

SHTOJCA 3.....	141
SHTOJCA 4.....	142
SHTOJCA 5.....	144
SHTOJCA 6.....	147
SHTOJCA 7.....	150
SHTOJCA 8.....	151

Hyrje

Lavdërimi i goftë All-llahut, i Cili ua bëri Namazin detyrim robërve të tij dhe i urdhëroi që ta zbatojnë dhe ta kryejnë si duhet; i Cili e lidhi suksesin dhe lumturinë me përvetësimin në namaz; i Cili e bëri kriter dallimi mes kufrit dhe imanit; dhe i Cili e bëri pengimtar nga veprat e turpshme dhe të këqija.

Paqja dhe salavatet qofshin me të Dërguarin, Muhammedin, të cilit iu ishin drejtuar Fjalët e Lartësuarit:

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ

“Dhe ne ta zbritëm ty shpalljen, që ti t’ua komentosh njerëzve se çka u është zbritur atyre”¹,

dhe i cili plotësisht e përmbushi këtë detyrë. Namazi ka qenë një ndër gjërat më të rëndësishme të cilën ai ua shpjegoi njerëzve, gojarisht dhe praktikisht, madje edhe duke u falur në minber njëherë, duke qëndruar në këmbë, duke bërë ruku dhe duke bërë sexhde dhe pastaj duke u thënë:

((إِنَّمَا صَنَعْتُ هَذَا لِتَأْتُمُوا بِي وَلِتَعْلَمُوا صَلَاتِي))

“Unë e bëra këtë që ju të më përcillni mua dhe ta mësoni namazin tim”².

Ai na ka detyruar që ta përcjellim namazin e tij, duke thënë:

((صَلُّوا كَمَا رَأَيْتُمُونِي أُصَلِّي))

“Faluni ashtu siç më keni parë mua duke u falur”³.

¹ En-Nahl: 44

² Buhariu dhe Muslimi - më vonë pason në tërësi.

³ Buhariu, Muslimi dhe Ahmedi. Shih “Irvaul Galil” nr.213

Ai, po ashtu, e përgëzoi atë që falet si ai se do të ketë marrëveshje të shenjtë me All-lahun se do të hyjë në xhennet, duke thënë:

“Janë pesë namaze të cilat All-llahu i Gjithëfuqishëm dhe i Lartësuar i ka bërë të detyrueshme. Ai i cili merr abdes siç duhet, i fal ato në kohët e tyre dhe është i plotë në rukutë, në sexhdet dhe në përlulësi, ai ka garanci nga All-llahu se do ta falë atë; ai i cili nuk vepron kështu, nuk ka garanci nga All-llahu: nëse do, Ai e fal, e nëse do, Ai e ndëshkon”.⁴

Paqja dhe salavatet qofshin gjithashtu mbi familjen e tij dhe mbi shokët e tij të devotshëm dhe të dëlirë, të cilët na e përcollën neve adhurimin, namazin, fjalët dhe veprat e tij [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe të cilët bënë që këto dhe vetëm këto të jenë një medhheb dhe shëmbëlltyrë që duhet pasuar, dhe po ashtu mbi ata të cilët pasojnë hapat e tyre dhe ecin rrugës së tyre, deri në Ditën e Gjykimit.

Kur e kreu leximin e “Kapitullit (Librit) të Namazit” në “Et-Tergib vet-Terhib” nga El-Hafidh El-Mundhiri (rahimehull-llah), dhe të mësuarit e tij vëllezërve tanë selefij para katër vitesh, na u bë e qartë të gjithëve pozita e rëndësishme e namazit në Islam, si dhe shpërblimi, mëshira dhe respekti që i pret ata të cilët e zbatojnë dhe e kryejnë si duhet; dhe se tërë kjo ndryshon varësisht nga afërsia me namazin e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Është kjo për çka ai bën me dije në thënien e tij:

“Me të vërtetë, rob i fal një namaz nga i cili nuk i shkruhet asgjë, përveçse një e dhjeta, e nënta, e teta, e shtata, e gjashta, e pesta, e katërta, e treta, ose gjysma e tij”.⁵

Prandaj, ua tërhoqa vërejtjen vëllezërve se nuk është e mundur ta kryejmë namazin si duhet e as t’i afrohemi atij përderisa nuk i dimë formën e detajizuar të namazit të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], duke i përfshirë gjërat thelbësore, mënyrat, format, lutjet (duatë) dhe përkujtimet (*dhikret*) e tij, dhe kur të mundohemi që këtë dije ta zbatojmë në praktikë me kujdes, vetëm atëherë mund të shpresojmë që namazi ynë do të na ndalojë nga veprat e turpshme e të këqija, dhe se shpërblimi dhe bekimi i përmendur në transmetime do të shkruhet për ne.

Megjithatë, njohja në detaje e të gjitha këtyre aspekteve të namazit ka pak gjasa të arrihet nga shumica e njerëzve sot, madje edhe nga shumë dijetarë, për shkak të kufizimit të tyre në medhhebe të veçanta. Por, siç e di çdokush që merret me përmbledhjen dhe studimin e Sunnetit të pastër, në çdo medhheb gjenden sunnete që nuk hasen në medhhebet e tjera. Përveç kësaj, në çdo medhheb hasim vepra dhe thënie që nuk mund

⁴ Maliku, Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Hibbani. Hadith *sahih*, i shpallur *sahih* nga disa Imamë. E kam dhënë *tahrixhin* e tij në *Sahih Ebi Davud* (451, 1276).

⁵ *Sahih* - I mbledhur nga Ibn El-Mubareku në *Ez-Zuhd* (10/21/1-2), nga Ebu Davudi dhe Nesaiu, me *sened* të mirë; e kam dhënë *Tahrixhin* e tij në *Sahih Ebi Davud* (761).

të përcillen në mënyrë autentike deri te i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Kjo që thamë, më së shumti gjendet në librat e dijetarëve të mëvonshëm.⁶ Shumë *rivajete* ata me këmbëngulësi ia veshin të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]!⁷ Kjo është arsyeja

⁶ Dijetari i mirënjohur i shkollës hanefite Ebul-Hasenat el-Laknevi thotë në “En-Nafi’ El-Kebir Limen Jutali El-Xhami Es-Sagir” (f.122-3), pas klasifikimit të librave të fikhut hanefij dhe pas sqarimit se cilat prej tyre janë të besueshme e cilat s’janë:

“E gjithë ajo që thamë për shkallët relative të këtyre përmbledhjeve ka të bëjë me çështjet e fikhut të shtjelluara në to. Megjithatë, sa i përket përmbajtjes së tyre të haditheve të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], atëherë nuk vlen, sepse shumë libra në të cilët ajka e fukahasë mbështetet janë plot me hadithe të shpikura, e të mos flasim për vendimet e dijetarëve. Është e qartë nga analizat e zgjeruara që, edhe pse autorët e tyre ishin kompetentë, ata qenë të pakujdesshëm në citimet e transmetimeve.”

Një prej këtyre haditheve të rreme, të shpikura, të cilat gjenden në disa prej librave më të mirë, është: “Ai i cili fal namazet e detyrueshme në të premtën e fundit të Ramazanit, kjo do të jetë për të kompensim për çdo namaz të pafalur gjatë jetës së tij deri në moshën 70 vjeçare”! Laknevi (rahimehull-llah) thotë në *El-Athar el-Merfu’ah fil-Ahbar el-Mevdu’ah* (f.315), pas transmetimit të këtij hadithi:

“Ali el-Kariu thotë në *El-Mevdu’at es-Sugra* dhe *el-Kubra*-në e tij: “Kjo është plotësisht e pavërtetë dhe e kundërshton *ixhmanë* (njëzëshmëria e mendimeve) se një akt i adhurimit nuk mund t’i kompensojë të tjerat që kanë mbetur pa u kryer me vite të tëra”. Prandaj, nuk ka arsye që ta citojmë autorin e *En-Nihaje*-së e as komentuesit e tjerë në *El-Hidajeh*, sepse ata as nuk janë dijetarë të Hadithit e as që ia referojnë këtë hadith ndonjërit prej përmbledhësve të Hadithit.”

Shevkani, po ashtu, përmend këtë hadith në *El-Fevaid el-Mexhmu’ah fil-Ehadith el-Mevdu’ah* me fjalë të ngjashme dhe pastaj thotë (fq.54):

“Ky është padyshim i shpikur. Unë, bile, nuk mund ta gjej në asnjë përmbledhje të haditheve të shpikura. Megjithatë, u bë i popullarizuar në mesin e studentëve të fikhut në qytetin Sana në kohën tonë dhe shumica prej tyre filluan të vepronin me këtë hadith. Nuk e di se kush e shpiku për ta - All-llahu i poshtëroftë gënjeshtarët.”

Laknevi thotë më tutje:

“Që të vendoset se ky hadith, i cili haset në librat e ritualeve dhe të duave, është i shpikur, kam përpiluar një ese të shkurtër me argument transmetues dhe intelektual, të quajtur “Largimi i Vëllazërisë nga Shpifja e së Premtes së Fundit të Ramazanit”, në të cilën kam mbushur zbrazëtira, që të ndriçohen mendjet dhe veshët prej thashethemeve, pra, konsultojeni për vlerën e saj në këtë temë dhe për kualitetin e lartë.”

Prania e haditheve të ngjashme të shpikura në librat e fikhut, shkatërron besueshmërinë e haditheve të tjera, të cilat nuk i citojnë prej librave të besueshëm të Hadithit. Fjalët e dijetarit të mirënjohur të shkollës hanefite Ali el-Kariut aludojnë në këtë:

“Muslimani duhet ta marrë hadithin prej njerëzve që janë ekspertë në atë lëmi, siç thotë një fjalë e vjetër arabe: “Populli i Mekës i njeh më së miri rrugët malore të saj” dhe “I zoti i shtëpisë e di më së miri se çfarë ka në të.”

⁷ Fjalët e Imam Neveviut (rahimehull-llah) në *El-Mexhmu Sherh al-Muhadhdhhab* (1/60) mund të përmbledhen si vijon:

“Dijetarët hulumtues të Njerëzve të Hadithit dhe të tjerët thonë që, nëse hadithi është i dobët, nuk do të thuhet për të, “I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka thënë/ka bërë/ka urdhëruar/ka ndaluar...” ose çfarëdo fraze tjetër që emëron siguri. Por, në vend të kësaj, do të thuhet, “transmetohet se /citohet tregohet nga ai...” ose fraza të tjera që sugjerojnë pasiguri. Thonë se frazat e sigurisë janë për hadithet *sahih* dhe *hasen*, dhe se frazat pasigurisë vlejnë për çdo gjë tjetër. Sepse frazat që emërtojnë siguri, nënkuptojnë se ajo që vijon, është autentike, prandaj mund të përdoren vetëm në rast të asaj çka është autentike; përndryshe, si pasojë, dikush do të mund të gënjente ndaj tij [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Kjo praktikë injorohet nga shumica e fukahasë së kohës sonë, madje nga shumica e dijetarëve të çfarëdo disipline, përveç nga muhaddithët e shkathët. Kjo është një pakujdesi neveritëse, sepse ata shpesh thonë për një hadith *sahih*,

pse dijetarët e hadithit - All-llahu i shpërbleftë - kanë punuar libra të *Tahririxhit* rreth librave të njohur të dijetarëve të mëvonshëm, duke e shpjeguar shkallën e çdo hadithi të dhënë në të: se a është autentik, i dobët apo i shpikur. Shembuj të këtyre librave të *Tahririxhit* janë: “El-Inaje fi Ma’rife Ahadith el-Hidaje” dhe “Et-Turuk vel-Vesail fi Tuhrixh Ehadith Thelasatid-Dalail” nga Abdul-Kadir ibn Muhammed El-Kurejshi El-Hanefi; “Nasb er-Rajeh li Ahadith el-Hidaje” nga Hafidh Zejlai dhe versioni i tij i shkurtuar “ed-Diraje”, nga Hafidh Ibn Haxhr el-Askalani, i cili po ashtu ka shkruar “Talkhis el-Habir fi Takhrixh Ahadith er-Raafi’i el-Kabir”. Ka edhe shumë të tjerë përmendja e të cilëve vetëm do të na e zgjaste këtë diskutim.⁸

Them: Pasi që njohja e këtyre gjërave në detaje është e pamundur për shumicën e njerëzve, ua shkrova këtë libër që të mësojmë formën e namazit të Pejgamberit sipas udhëzimit të tij të udhëzohen, duke shpresuar prej All-llahut atë që ua ka premtuar në gjuhë të Pejgamberit të vet. Kush thërret në udhëzim, ka shpërblim sikur ata që e pasojnë, duke mos u pakësuar aspak nga shpërblimi i tyre...”. (Transmeton Muslimi. Shih “Zinxhiri i haditheve të vërteta” nr: 863.)

Metodologjia e këtij libri

Pasi qëllimi i këtij libri është të bartë udhëzimin e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] lidhur me namazin, ishte e natyrshme se nuk do ta kufizoja veten në një medhheb të caktuar, për arsyet që përmendëm më parë. Prandaj, kam dhënë vetëm atë që në mënyrë autentike është dëshmuar prej tij [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], siç edhe ka qenë gjithmonë drejtimi i dijetarëve të hadithit,⁹ si i të mëhershmeve, ashtu edhe i të mëvonshëmve¹⁰, siç flet kjo thënie e bukur:

“transmetohet nga ai se...” dhe për atë *daif* “ai tha” dhe “kështu dhe kështu transmetohet...” dhe kjo është larg prej së vërtetës”.

⁸ Shënime të botuesit: Gjithashtu, në këtë kategori janë veprat e mësuesit tonë, autorit të “Irvaa el-Ghalil fi takhrixh Menar es-Sabil” në tetë vëllime, dhe të “Ghajeh el-Meram fi Takhrixh Ahadith el-Halaal vel-Haraam”, që është një *tahririxh* i haditheve të gjetura në librin “Hallalli dhe Harami në Islam”, të Dr. Jusuf El-Kardavit (i cili përmban shumë hadithe *daife*).

⁹ Abdul-Haxhixh (Ebul-Hasenat) El-Laknevi thotë në *Imam el-Kalem fima jata'allak bil-Kira'ah Khalf el-imaam* (f. 156), siç vijon:

“Kushdo që zhytet në oqeanet e fikhut dhe në bazat e jurisprudencës, mendjehapur dhe pa paragjykim, do të shohë me siguri se në shumicën e çështjeve kryesore dhe anësore, në të cilat dijetarët janë ndarë në mendime, medhhebi i dijetarëve të hadithit është më i paluhatshmi ndër medhhebet e tjera. Sa herë depërtoj nëpër degët e mendimeve të ndryshme, vij në përfundim se pikëpamjet e muhaddithëve i janë më së afërmi drejtësisë - shpërblimi i tyre është tek All-llahu dhe Ai do t'i falënderojë. Si mund të jetë ndryshe, kur ata janë trashëgimtarët e vërtetë të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe përfaqësues të sinqertë të ligjit të tij, All-llahu na përfshiftë në grupin e tyre dhe na bëftë prej atyre që vdesin duke i dashur ato.

¹⁰ Dijetari i mirënjohur i shkollës shafite Subkiu thotë në *el-Fetava* (1/148):

“Çështja më e rëndësishme e muslimanëve është namazi, për të cilin çdo musliman duhet të kujdeset dhe të sigurojë zbatimin e tij dhe t'i përforcojë elementet thelbësore të tij. Lidhur me

“Njerëzit e Hadithit janë Njerëzit e të Dërguarit, edhe pse nuk e shoqërojnë atë, ata janë me të në çdo moment.”¹¹

Kështu, ky libër, me dëshirën e All-llahut, do të përmbledhë tërë atë që është e shpërndarë në librat e Hadithit dhe të fikhut, pa marrë parasysh dallimet mes medhhebeve. Mirëpo, ky ka të bëjë me temën tonë, kështu që përfundimet e sakta në këtë libër nuk do të mund të gjenden ashtu të plota në asnjë libër dhe në asnjë medhheb. Prandaj, ata të cilët veprojnë sipas tij, me dëshirën e All-llahut, do të bëhen në mesin e atyre që All-llahu i ka udhëzuar:

فَهَدَى اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا لِمَا اخْتَلَفُوا فِيهِ مِنَ الْحَقِّ بِإِذْنِهِ وَاللَّهُ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ (213)

“Allahu i udhëzoi besimtarët që ta kuptojnë të vërtetën në çështjet të cilat të tjerët nuk pajtoheshin. All-llahu e udhëzon në rrugën e drejtë kë të dojë.”¹²

Kur i përvetësova këto parime, d.m.th. t’i përmbahem Sunnetit autentik dhe t’i zbatoj në këtë libër, si dhe në të tjerët, e dita se, me siguri, kjo nuk do të kënaqte çdo grup njerëzish a sekt. Në të vërtetë, kjo do të rezultonte që disa, në mos shumica e tyre, të më fyejnë me gjuhën e tyre ose të më kritikojnë me lapsat e tyre. Kjo nuk më brengos, sepse unë, gjithashtu, e di se t’i kënaqësh të gjithë është nocion i paarritshëm dhe **“Ai i cili e hidhëron All-llahun duke i kënaqur të tjerët, All-llahu do ta lërë atë në mëshirën e njerëzve”**, siç ka thënë i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].¹³ All-llahu e shpërbleftë autorin e vargjeve që pasojnë:

Kurrë nuk do të mund t’u shpëtoj fyerjeve,
Edhe sikur të isha brenda në shpellë, në malet shkëmbore;
Ngase askush nuk mund të shpëtojë nga njerëzit i palënduar,
Edhe po që se fshihet pas krahëve të shqiponjës

Mua më mjafton besimi që kjo është rruga më e drejtë, të cilën All-llahu i ka urdhëruar besimtarët ta ndjekin, të cilën i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], Zotëriu i të

namazin ka çështje për të cilat ekziston njëzëshmëria, ku nuk mund t’i iket së vërtetës, dhe çështje të tjera në të cilat dijetarët janë ndarë në mendime. Qasja korrekte është ose të mënjanohej kundërshtimet, nëse është e mundur, ose të shikohet se ç’është e dëshmuar në mënyrë autentike nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe t’i përmbahemi asaj. Kur ndokush e bën këtë, namazi i tij do të jetë korrekt dhe i drejtë, dhe i përfshirë në fjalët e All-llahut të Lartësuar: **“Kushdo që shpreson ta takojë Zotin e tij, le të punojë si duhet vepra të mira.”** (El-Kehf, 18: 110)

Unë them: Qasja e fundit është superiore, bile e obligueshme, sepse shqyrtimi i parë, duke qenë edhe i pamundshëm në shumë çështje, nuk i përmbahet urdhërit të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]:

“Faluni ashtu siç më keni parë mua duke u falur”, por në vend të kësaj shpie tek ajo që namazi i njërit të jetë qartazi i ndryshëm me të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

¹¹ Nga poezia e Hasan ibn Muhammed en-Neseviut, sikurse transmetohet nga Hafiz Dija ed-din el-Makdisi në artikullin për ekselencën e Hadithit dhe Njerëzve të tij.

¹² Bekare: 2: 213

¹³ Tirmidhiu, Kudaliu, Ibn Bushrani dhe të tjerët.

Dërguarve, e ka shpjeguar. Kjo është rruga të cilën e kanë trasuar Paraardhësit e Devotshëm (*selefus-salih*): sahabët, trashëgimtarët e tyre dhe ata pas tyre, duke përfshirë edhe katër Imamët, medhhebeve të të cilëve shumica e muslimanëve sot u përkasin. Të gjithë ata janë pajtuar për domosdoshmërinë e pasimit të Sunetit dhe të referimit në të, për mospërfilljen e çdo mendimi që është në kundërshtim me të, pa marrë parasysh pozitën e lartë të proklamuesit të atij mendimi, sepse statusi i Lajmëtarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është shumë më i madh dhe rruga e udhëzimit të tij më e drejtë. Andaj, kam ecur hapave të tyre dhe kam zbatuar urdhërat e tyre për tu kapur për hadithe, edhe nëse kjo kundërshton pikëpamjet e tyre. Këta urdhëra të tyre kanë pasur ndikim tejet të madh në mua, në ndjekjen time të kësaj rruge të drejtë dhe në refuzimin tim të *taklidit* (pasimit verbërisht).

E lus All-llahun e Lartësuar t'i shpërblejë ata pa masë.

Thëniet e Imamëve në lidhje me pasimin e Sunetit dhe me mospërfilljen e pikëpamjeve të tyre që kundërshtojnë atë

Do të ishte e dobishme t'i japim disa thënie këtu, se ndoshta kjo do t'i rikujtojë dhe do t'i këshillojë ata që pasojnë mendimin e Imamëve verbërisht¹⁴ - madje të atyre që janë në shkallë më të ulët se Imamët -, duke ngulmuar në medhhebet ose pikëpamjet e tyre, sikur këto të kishin zbritur nga qielli! Por, All-llahu, i Gjithëfuqishmi dhe i Lartësuari thotë:

اتَّبِعُوا مَا أُنْزِلَ إِلَيْكُم مِّن رَّبِّكُمْ وَلَا تَتَّبِعُوا مِن دُونِهِ أَوْلِيَاءَ قَلِيلًا مَّا تَذَكَّرُونَ

“Përcillni (o njerëz!) Shpalljen të dërguar nga Zoti juaj dhe mos merrni dikë tjetër për mbrojtës dhe shokë pos Atij. Pak ka prej jush që rikujtojnë këshillën.”¹⁵

1) Ebu Hanifja (rahimehull-llah)

I pari prej tyre është Imami Ebu Hanife en-Nu'man ibn Thabit (rahimehull-llah), shokët e të cilit kanë përcjellë nga ai thënie të ndryshme dhe shprehje të shumta, të gjitha këto shpënë në një gjë, e kjo është domosdoshmëria për të pranuar Hadithin dhe për të hequr dorë nga ndjekja e mendimit të imamëve që e kundërshtojnë atë:

¹⁴ Kjo është formë e *taklidit* (pasim verbazi), të cilit i referohet Imam Tahaviu:

“Vetëm kush është i marrë ose konformist pason verbërisht ndonjë mendim” - cituar nga dijetari i mirënjohur i shkollës hanefite Ibn Abidini në *Rasm el-Mufti* (vëllimi 1, f.32, nga përmbledhja e eseve të tij).

¹⁵ El-A'raf, 7: 3

1. "Nëse vërtetohet se një hadith është *sahih*, atëherë ai është medhhebi im."¹⁶
2. "Nuk i lejohet askujt që t'i pranojë pikëpamjet tona, nëse nuk e di se ku i kemi marrë ato"¹⁷

Në një transmetim, "Është e ndaluar për dikë që nuk e njeh argumentin tim të sjellë gjykime duke u bazuar në fjalët e mia."

Një transmetim tjetër shton, "Sepse ne jemi njerëz: e themi një gjë një ditë dhe e tërheqim atë ditën tjetër".

E në një anë tjetër, "Mjerë për ty, o Jakub!¹⁸ Mos shkruaj çdo gjë që dëgjon prej meje, se ndodh që ta mbaj një mendim sot dhe ta hedh poshtë të nesërmen, ose të mbaj një mendim nesër e ta hedh poshtë pasnesër."¹⁹

¹⁶ Ibn Abidini në *el-Hashije* (1/63) dhe në esenë e tij *Rasm el-Muftie* (1/4 nga përmbledhja e eseve të Ibn Abidinit), shejh Salih el-Fulani në *Ikaz el-Himam* (f.62) dhe të tjerët. Ibn Abidini ka cituar nga *Sharh el-Hidaje* e Ibn el-Shahne el-Kebirit, mësuesit të Ibn el-Humamit, këtë:

"Kur një hadith që është në kundërshtim me medhhebin vërtetohet se është *sahih*, atëherë njëri duhet të veprojë sipas tij dhe ta bëjë atë medhheb të tij. Të vepruarit me hadith nuk do të zhvleftësojë të qenët e tij hanefi, ngase është transmetuar në mënyrë të sigurt se Ebu Hanifja ka thënë: "Kur për një hadith vërtetohet se është *sahih*, atëherë ai është medhhebi im", dhe kjo është transmetuar prej Imam Ibn Abdul-Berrit nga Ebu Hanifja dhe imamët e tjerë."

Kjo është pjesë e diturisë së plotë dhe e devotshmërisë së Imamëve, sepse ata, duke e thënë këtë, kanë bërë me dije se nuk kanë qenë të udhëzuar në tërësi në Sunet, dhe Imam Shafiu e ka qartësuar këtë plotësisht (shih më vonë). Ka ndodhur që ata ta kundërshtojnë ndonjë sunet, sepse nuk kishin dijeni për të. Prandaj, ata na kanë urdhëruar që t'i përmbahemi Sunetit dhe ta konsiderojmë atë si pjesë të medhhebit të tyre. All-llahu i mëshiroftë ata të gjithë.

¹⁷ Ibn Abdul-Berri në *el-Intikaa fi Fedail eth-Thelatheh El-Eim-meh El-Fukaha* (f.145), Ibn El-Kajimi në *I'lam Al-Muki'in* (2/309), Ibn Abidini në fusnotat e tij mbi *el-Bahr er-Ra'ik* (6/293) dhe në *Rasm el-Mufti* (f.29, 32) dhe Sha'rani në *el-Mizan* (1/55) me transmetimin e dytë. Transmetimi i fundit është përmbledhur nga Abbas ed-Devri në *et-Tarik* nga Ibn Meini (2/77/1) me *sened sahih* nën autoritetin e Zaferit, nxënësit të Imam Ebu Hanifes. Transmetime të ngjashme ekzistojnë nën autoritetin e shokëve të Ebu Hanifes: Zaferit, Ebu Jusufit dhe Afijeh ibn Jezidit; *Ikaz* (f.52). Ibn El-Kajimi fuqishëm vërteton autenticitetin e tij nën autoritetin e Ebu Jusufit në *I'lam al-Muki'in* (2/344). Shtojca në transmetimin e dytë u referohet nga editori i *Ikazit* (f.65) Ibn Abdul-Berrit, Ibn El-Kajimit dhe të tjerëve.

Nëse kjo është ajo që thonë për dikë që nuk e njeh argumentin e tyre, çfarë do të ishte reagimi ndaj atij që e di se argumenti kundërshton thënie e tyre, por prapëseprapë merr vendime në kundërshtim me argumentin?! Prandaj, mendoni rreth kësaj thënieje, sepse kjo mjafton që të thejë ndjekjen verbazi të mendimit. Kjo është arsyeja pse njëri prej dijetarëve *mukal-lidë*, kur kritikova sjelljen e tij të një vendimi duke përdorur fjalët e Ebu Hanifes pa njohur argumentin, refuzoi të besonte se kjo është thënie e Ebu Hanifes!

¹⁸ Ebu Jusufi (rahimehull-llahu), student i dalluar i Ebu Hanifes.

¹⁹ Kjo ishte ngase Imami shpesh i bazonte pikëpamjet e veta në *Kijas* (Analogji), pas së cilës do t'i shfaqej një analogji më e fortë, ose ndonjë hadith i të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] do t'i mbërrinte atij, kështu që ai do ta pranonte atë dhe do ta hidhte poshtë mendimin e dhënë më parë. Fjalët e Sha'ranit në *el-Mizan* (1/62) janë përmbledhur kështu:

"Është bindje jona si dhe e çdo hulumtuesi për Imam Ebu Hanifen [radijall-llahu anhu] se, sikur të kishte jetuar ai deri në regjistrimin e Sheriatit dhe në udhëtimet e Ruajtësve të Hadithit nëpër qytete dhe skaje të ndryshme me qëllim të përmbledhjes dhe të përvetësimit të tij, ai do ta kishte pranuar atë dhe do t'i kishte shpërfillur analogjitë e bëra më parë. Dhe sasia e *Kijasit* në medhhebin

3. “Kur them diç që kundërshton librin e All-llahut të Lartësuar ose atë që është transmetuar nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], atëherë mos e përfillni fjalën time”.²⁰

2) Malik ibn Enesi (rahimetull-llah)

Sa i përket Imamit Malik ibn Enes, ai ka thënë:

1. “Vërtet, unë jam vetëm një i vdekshëm. Bëj gabime (nganjëherë) dhe kam të drejtë (nganjëherë). Prandaj, vështroni mendimet e mia: gjithë atë që pajtohet me Librin dhe Sunetin, pranojeni; gjithë atë që nuk pajtohet me Librin dhe Sunetin, mos e përfillni.”²¹

e tij do të kishte qenë e pakët sikurse në medhhebet e tjera. Por, pasi që argumentet e Sheriatit qenë shpërndarë nga Trashëgimtarët dhe pasardhësit e tyre dhe nuk qenë përmbledhur gjatë jetës së tij, që e pashmangshme që të këtë shumë *kijas* në medhhebin e tij, në krahasim më të imamëve të tjerë. Dijetarët e mëvonshëm ndërmorën udhëtime për të gjetur dhe për të përmbledhur hadithe në qytete të ndryshme dhe i shënuan ato. Kështu, disa hadithe të Sheriatit i shpjegojnë të tjerat. Kjo, pra, është arsyeja për sasinë e madhe të *kijasit* në këtë medhhebe, derisa në medhhebet e tjera është më e paktë.”

Ebul-Hasenat el-Laknevi ka cituar fjalët e tij në tërësi në *en-Nafi' el-Kebir* (f.135), duke e shqyrtuar dhe duke u zgjeruar më shumë rreth kësaj në fusnotat e tij. Prandaj, kush dëshiron të konsultohet, le ta bëjë aty.

Pasi kjo është arsyeja pse Ebu Hanifja nganjëherë pa qëllim ka kundërshtuar hadithin autentik - dhe kjo është plotësisht arsye e pranueshme, sepse All-llahu nuk e ngarkon askë përtej mundësive të tij -, nuk është e lejuar ta fyejmë për këtë, siç kanë vepruar disa injorantë. Në të vërtetë, është e obligueshme që ta respektojmë, sepse ai është njëri nga imamët e muslimanëve, nëpërmjet të cilëve ky Din është ruajtur dhe na është dorëzuar neve, me të gjitha degët e tij. Dhe, po ashtu, sepse ai është i shpërblyer në cilindo rast, qoftë kur gabon, qoftë kur ia qëllon. Dhe ithtarëve të tij nuk u lejohet të vazhdojnë ndjekjen e deklaratave të tij që kundërshtojnë hadithet autentike, ngase ato deklarata përfundimisht nuk i përkasin medhhebit të tij, siç tregon thënia e mësipërme. Sepse këto janë dy ekstreme dhe e vërteta qëndron në mes. “Zoti ynë! Falna ne dhe vëllezërit tanë që besuan para nesh; dhe mos lë në zemrat tona urrejtje kundër atyre që besuan. Zoti ynë! Ti, me të vërtetë, je plot mirësi, Mëshirues.” (El-Hashr, 59: 10)

²⁰ El-Fulani në *Ikaz el-Himam* (f.50) duke e gjurmuar deri te Imam Muhammedi, dhe pastaj duke thënë:

“Kjo nuk ka të bëjë me muxhtehidin, sepse ai, sidokudo, nuk është i lidhur me pikëpamjet e tyre, por ka të bëjë me *muka-lidin*.”

Sharani u zgjerua rreth kësaj në *el-Mizan* (1/26):

“Nëse thuhet: ‘Ç’duhet të bëj me hadithet që imami im nuk i ka përdorur, por kanë dalë të vërteta pas vdekjes së tij?’, përgjigjja më e mirë do të ishte: ‘Të veprosh me to, ngase po të kishte parë imami yt se janë autentike, do të të kishte udhëzuar ty që të punosh me to, sepse të gjithë Imamët kanë qenë robër në dorën e Sheriatit.’ Ai i cili vepron kështu, ka kapur të mirën me të dy duart e tij, ndërsa ai i cili thotë: ‘Nuk do të veproj me hadith, përderisa Imami ynë nuk ka bërë një gjë të tillë’, ai nuk do të shfrytëzojë një dobi të madhe, siç është rasti me shumë pasues të Imamëve të medhhebeve. Do të ishte më mirë për ta sikur të vepronin në çdo hadith të shpallur autentik pas kohës së Imamit, duke zbatuar kështu dëshirën e Imamëve, sepse është bindje e thellë jona se, po të kishin jetuar më shumë dhe të kishin hasur se ato hadithe janë gjetur pas kohës së tyre janë autentike, atëherë do t’i kishin pranuar definitivisht dhe do të kishin vepruar në përshtatje me to, duke shpërfillur çdo analogji që kanë bërë më parë dhe cilëndo pikëpamje që kanë pasur më herët..”

²¹ Ibn Abdul-Berri në *Xhami' Bejan el-'Ilm* (2/32), Ibn Hazmi duke cituar prej tij në *Usul el-Ahkam* (6/149), dhe kësisoj el-Fulani (f.72).

2. “Secilit pas të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] do t’i refuzohen dhe do t’i pranohen thëniet e tij, por jo edhe të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].”²²

3. Ibn Vehbiu ka thënë:

“Kam dëgjuar që, kur Maliku është pyetur për pastrimin midis gishtërinjve të këmbëve gjatë abdesit, ai tha: ‘Njerëzit nuk janë të detyruar ta bëjnë këtë.’ Nuk iu afrova, derisa turma u pakësua e atëherë i thashë: ‘Ne dimë një sunet në lidhje me këtë.’ Ai tha: ‘E çfarë është ai?’ Unë i thashë: ‘Na kanë rrëfyer Lejth ibn Sa’di, Ibn Lehi’a dhe Amër ibn el-Harithi nga Jezid ibn Amër el-Me’afiriu, e ky nga Abdurr-Rahman el-Hubuliu, ky nga el-Mustevrid ibn Shaddad el-Kurashiu, i cili ka thënë: ‘Kam parë të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] duke fërkuar me gishtin e tij të vogël mes gishtërinjve të këmbëve të tij.’ Ai tha: ‘Ky hadith është i mirë. Nuk kam dëgjuar për të fare, deri më tash.’ Pas kësaj, e dëgjova duke u pyetur për të njëjtën gjë e ai urdhëronte fërkimin mes gishtërinjve të këmbëve.”²³

3) Shafiu (rahimehull-llah)

Sa i përket Imam Shafiut, citimet nga ai janë më të shumtat dhe më të bukurat²⁴ ndërsa pasuesit e tij qenë më të mirët në ndjekjen e tyre:

1. “Sunetet e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] sikurse që mbërrijnë, ashtu edhe i ikin secilit prej nesh. Prandaj, sa herë që e them një mendim ose

²² Kjo është mirë e njohur në mesin e dijetarëve të mëvonshëm si thënie e Malikut. Ibn Abdul-Hadi e ka shpallur atë *sahih* në *Irshad es-Salik* (227/1). Ibn Abdul-Berri në *Xhami’ Bejan el-’Ilm* (2/91) dhe Ibn Hazmi në *Usul el-Akham* (6/145, 179) e ka transmetuar si thënie të el-Hakam Ibn Utejbet dhe të Muxhahidit. Taki ed-Din es-Subkiu e ka dhënë atë, i mahnitur me bukurinë e saj, në *el-Fetava* (1/148), si thënie të Ibn Abasit dhe pastaj ka thënë:

“Këto fjalë janë fillimisht të Ibn Abasit dhe të Muxhahidit, prej të cilëve Maliku [radijall-llahu anhu] i mori dhe u bë i famshëm për to. Duket se Imam Ahmedi e mori pastaj këtë thënie prej tyre, siç ka thënë Ebu Davudi në *Mesa’ilin* e Imam Ahmedit (f.276): ‘Kam dëgjuar Ahmedin duke thënë: ‘Çdokush pranohet dhe refuzohet për mendimet e veta, me përjashtim të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]’”.

²³ Nga Parathënia në *el-Xherh vet-Ta’dil* të Ibn Ebi Hatimin, fq.31-2.

²⁴ Ibn Hazmi thotë në *Usul el-Akham* (6/118):

“Me të vërtetë, të gjithë fukahatë, mendimet e të cilëve pasohen, kundërshtojnë *taklidin* dhe ndalonin shokët e tyre nga ndjekja e mendimit të tyre verbazi. Më i ashpri prej tyre në këtë aspekt ka qenë Shafiu (rahimehull-llah), ngase ai vazhdimisht ka theksuar më shumë se çdokush tjetër që të pasohen transmetimet autentike dhe të pranohet çdo gjë që është e dëshmuar. Ai po kështu e ka shfajësuar veten nga të qenët kryekëput i ndjekur, dhe këtë ua publikoi atyre që i kishte përreth. I bëftë kjo dobi para All-llahu dhe i takoftë shpërblimi i madh, sepse ai ishte shkak i një mirësie të madhe.”

formuloj ndonjë parim në kundërshtim me atë që ekziston nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], atëherë pikëpamje e saktë është ajo çka i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka thënë, dhe ajo është pikëpamje imja.”²⁵

2. “Muslimanët janë pajtuar njëzëri që, nëse një sunet i të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i është qartësuar dikujt, nuk është e lejuar për të që ta lë atë për fjalët e ndokujt tjetër.”²⁶
3. “Nëse gjeni në shkrimet e mia diçka në kundërshtim me Sunetin e të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], atëherë flitni duke u bazuar në Sunetin e të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe lini atë që unë kam thënë.”
4. Në një transmetim thuhet: “... atëherë pasojeni atë (Sunetin) dhe mos shikoni në thënie e askujt.”²⁷
5. “Nëse vërtetohet se një hadith është *sahih*, atëherë ai është medh-hebi im.”²⁸

²⁵ Përmbledhur nga Hakimi me *sened* deri te Shafi, si në *Tarih Dimeshk* të Ibn Asakirit (15/1/3), në *I'lam el-Muki'in* (2/363, 364) dhe në *Ikaz* (f.100).

²⁶ Ibn el-Kajjimi (2/361) dhe Fulani (f.68).

²⁷ Haraviu në *Dhamm el-Kelam* (3/47/1). Hatibi në *el-Ihtixhaxh bi esh-Shafi'i* (8/2). Ibn Asakiri (15/9/10), Neveviu në *el-Mexhmu'* (1/63). Ibn el-Kajjimi (2/361) dhe Fulani (f.100). Transmetimi i dytë nga *Hilijeh el-Evlija* e Ebu Nuajmit.

²⁸ Neneviu në *el-Mexhmu'* (1/63), Sharani (1/57), duke i dhënë burimet si Hakimi dhe Bejhekiu dhe Fulani (f.107). Sharani ka thënë: “Ibn Hazmi ka thënë: ‘Përkatësisht... i shpallur *sahih* nga ai a nga çdo imam tjetër’.” Fjalët e tij të dhëna më poshtë vërtetojmë këtë kuptim. Neveviu thotë:

“Shokët tanë kanë vepruar në përputhje me këtë në çështjen e *tethvibit* (thirrja për namaz pas ezanit), të kushteve të heqjes së ihramit, për shkak të sëmundjes, dhe në çështjet e tjera të njohura mirë në librat e medhhebit. Në mesin e shokëve tanë, për të cilët transmetohet se kanë miratuar gjykime në bazë të hadithit (e jo të fjalës së Shafiut), janë Ebu Jakub el-Buveti dhe Ebul-Kasim ed-Darikui. Prej shokëve tanë muhaddithë, Imam Ebu Bekr El-Bejhekiu dhe të tjerë aplikuan këtë qasje. Shumë nga shokët tanë të hershëm, nëse janë ndeshur me ndonjë çështje, për të cilën ka ekzistuar hadithi dhe medhhebi Shafi ka qenë në kundërshtim me të, vepronin në përputhje me hadithin dhe merrnin vendime duke u bazuar në të, duke thënë: ‘Medhhebi i Shafiut është çdo gjë që pajtohet me hadithin.’ Shejh Ebu Amri (Ibn Es-Salah) thotë: ‘Kushdo që nga mesi i Shafive gjente një hadith në kundërshtim me medhhebin e tij, ai shikonte se a i ka përmbushur kushtet e *ixhtihadit* në përgjithësi apo për atë temë të caktuar a çështje, në të cilin rast do të ishte i lirë të vepronte në përputhje me hadithin; nëse jo, do të ishte vështirë të arsyetojë kundërshtimin e hadithit pas analizave të mëtutjeshme dhe nuk do të ishte në gjendje të gjejë një arsyetim bindës për kundërshtimin e hadithit. Për këtë shkak, do të mbetej të veprojë në përshtatje me hadithin, nëse ndonjë prej imamëve të pavarur, krahas Shafiut, ka vepruar me të. Dhe kjo do të ishte arsyetim për lënien e medhhebit të Imami të tij në atë çështje.’ Çka ka thënë ai (Ebu Amri) është e saktë dhe e zbatuar. All-llahu e di më së miri.”

Është një mundësi tjetër, të cilën Ibn es-Salahu ka harruar ta cekë: çka do të bënte njeriu, nëse nuk do të gjente askënd duke vepruar me hadithin? Këtu është përgjigjur Teki ud-Din es-Subkiu në artikullin e tij Kuptimi i thënies së Shafiut:

“Kur një hadith vërtetohet se është *sahih*, atëherë ai është medhhebi im” (fq.102, vëllimi 3): “Sipas mendimit tim, gjëja më e mirë është ta pasojë hadithin. Personi duhet ta parafytyrojë veten e tij

6. “Ju²⁹ keni më shumë se unë njohuri për Hadithin dhe transmetuesit, prandaj, kur një hadith është *sahih*, më informoni për të, qoftë ai nga Kufa, Basra a Siria, që ta marrë atë pikëpamje të hadithit përderisa ai është i vërtetë.”³⁰
7. “Në çdo çështje për të cilën Ithtarët e Hadithit gjejnë një transmetim nga i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] të jetë *sahih*, i cili është në kundërshtim me atë që unë kam thënë, atëherë unë tërhiqem nga mendimi im, qoftë gjatë jetës sime, qoftë pas vdekjes.”³¹
8. “Nëse më shihni duke thënë diçka dhe në kundërshtim me të është transmetimi autentik nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], atëherë ta dini se më ka lënë mendja.”³²
9. “Për çdo gjë që them, nëse ekziston diçka autentike nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e kundërt me fjalët e mia, atëherë hadithi i të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] vjen në rend të parë, prandaj mos e pasoni mendimin tim.”³³

para të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], sikur është duke e dëgjuar në atë çast prej tij. A do të kishte arsytim për të vonuar veprimin me të? Jo, pasha All-llahun... dhe çdokush bart përgjegjësinë në përputhje me dijeninë e tij.”

Pjesa tjetër e këtij diskutimi është dhënë dhe është analizuar në *I'lam el-Muvaki'in* (2/302, 307) dhe në librin e el-Fulanit (titulli i plotë: *Ikadh Himam ulul-Absar, lil-Iktida' bi Sejjid el-Muhaxhirin ve-Ensar, ve Tahdhiruhum 'an el-Ibtidaa' esh-Shaa'i' fil-Kura vel-Amsar, min Taklid el-Madhahib ma'al-Hamijeh vel-Asebijeh bejne el-Fukaha' el-A'sar* (Zgjuarja e mendjeve të tyre që mendojnë për të pasuar Prijësin e Emigrantëve dhe të Ndihmëtarëve, dhe tërheqja e vërejtjes atyre për përhapjen e risive në mesin e juristëve bashkëkohorë nëpër qytete, për ndjekjen e medhhebeve në fanatizëm dhe konformizëm). Ky është libër unik në këtë fushë, të cilin çdo dashamir i së vërtetës duhet ta studiojë me kujdes dhe mendjethëllësi.

²⁹ Duke iu drejtuar Ahmed Ibn Hanbelit (rahimehull-llah).

³⁰ Përmbledhur nga Ibn Ebi Hatimi në *Adab es-Shafi'i* (fq. 94-5), nga Ebu Nu'aimi në *Hiljetul-Evlija* (9/106), nga el-Hatibi në *el-Ihtixhaxh bish-Shafi'i* (8/1) dhe nga ai Ibn Asakiri (15/9/1), Ibn Abdul-Berri në *el-Intika* (fq. 75), Ibn El-Xhevziu në *Menakib el-Imam Ahmed* (fq. 499) dhe Haraviu (2/47/2) me tri rrugë nga Abdull-llah Ibn Ahmed Ibn Hanbeli, e ky nga i ati i tij, se Shafi'u i ka thënë atij: ...etj., kështu që është i vërtetë në autoritetin e Shafiut. Për këtë shkak, Ibn el-Kajjimi ia atribuoi përfundimisht atij në *I'lam* (2/325), siç ka vepruar Fulani në *Ikadh* (fq.152) dhe atëherë tha:

“Bejhekiu ka thënë: Për këtë shkak, Shafi'u ka përdorur hadithin aq shumë sepse ka mbledhur dijeni (njohuri) nga njerëzit e Hixhazit, Sirisë, Jemenit dhe Irakut dhe ka pranuar gjithë atë që dilte të jetë autentike, pa anuar dhe pa shikuar në atë që ai ka konsideruar jashtë medhhebit të vendit të tij, kur e vërteta ishte e qartë tjetërkund. Disa prej tyre para tij e kufizonin veten në atë çka kanë gjetur në medhhebet e vendeve të tyre, pa u përpjekur për të vërtetuar autenticitetin e saj që e kundërshtonte atë. All-llahu na mëshiroftë të gjithëve.”

³¹ Ebu Nu'aimi (9/107), Haraviu (47/1), Ibn el-Kajjimi në *I'lam al-Muveki'in* (2/363) dhe Fulani (f.104)

³² Ibn Ebi Hatimi në *el-Adab* (f.93), Abdul-Kasim Semerkandi në *el-Amali*, si dhe në seleksionimin prej tij nga Ebu Hafs el-Mu' addabi (234/1), Ebu Nu'aimi (9/106) dhe Ibn Asakiri (15/10/1) me *sened sahih*.

³³ Ibn Ebi Hatimi, Ebu Nu'aimi dhe Ibn Asakiri (15/9/2)

10. “Çdo hadith nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është gjithashtu pikëpamje imja, edhe nëse ju nuk e dëgjoni atë nga unë.”³⁴

4) Ahmed ibn Hanbeli (rahimetull-llah)

Sa i përket Imam Ahmedit, ai ka qenë më i shquari në mesin e Imamëve në përmbledhjen e Sunnetit, duke iu përmbajtur atij aq shumë, saqë “ai madje nuk pëlqente të shkruhej libri që do të përmbante deduksione dhe mendime”.³⁵ Për këtë shkak, ai ka thënë:

1. “Mos e pasoni as mendimin tim, as atë të Malikut, as të Shafiut, as të Evzaiut, e as të Thevriut, por merrni nga kanë marrë ata.”³⁶

Në një transmetim: “Mos kopjo Dinin tënd nga asnjëri prej këtyre, por çdo gjë që vjen nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe Shokët e tij, merreni atë, e pastaj nga Trashëgimtarët e tyre, ku njeriu mund të zgjedhë.”

Njëherë ai ka thënë: “Ndjekja³⁷ nënkupton që njeriu të pasojë atë që ka ardhur nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe nga Shokët e tij, pas Trashëgimtarëve ai ka zgjedhje.”³⁸

2. “Mendimi i Evzaiut, mendimi i Malikut, mendimi i Ebu Hanifes, të gjitha këto janë mendime dhe janë të barasvlershme në sytë e mi. Megjithatë, argumenti është në transmetime (nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe Shokët e tij).”³⁹
3. “Kushdo që refuzon një hadith të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ai është buzë shkatërrimit.”⁴⁰

³⁴ Ibn Ebi Hatimi (f.93-4)

³⁵ Ibn el-Xhevziu në *el-Menakib* (f.192)

³⁶ Fulani (f.1130 dhe Ibn el-Kajjimi në *I'lam* (2/302)

³⁷ Ar.: *ittiba*: “Këto janë thëniet e qarta, të dëlira të imamëve (All-llahu i Lartësuar qoftë i kënaqur me ta lidhur me pasimin e hadithit dhe me ndalimin nga ndjekja e mendimeve të tyre pa argument të qartë, prandaj vetëm mendimi dhe interpretimi është i papranueshëm.

Kështu, kushdo që do t'i përmbahej cilitdo sunet që është dëshmuar i vërtetë, edhe nëse kundërshton disa nga thëniet e Imamëve, nuk do të binte ndesh me medhhebet e tyre e as që do të shmangej nga rruga e tyre. Përkundrazi, një person i tillë do t'i pasonte të gjithë ata dhe do të kapej për litarin më të sigurt që kurrë nuk këputet. Derisa ky nuk do të ishte rasti me atë që ka lënë ndonjë sunet autentik vetëm se kundërshton mendimet e tyre. Madje, një person i tillë do të ishte i padëgjueshëm ndaj tyre dhe në kundërshtim me thëniet e mësipërme të tyre, përderisa All-llahu thotë: “Por jo, pasha Zotin tënd, nuk do të jenë besimtarë”

³⁸ Ebu Davudi në *Mesa'il* të Imam Ahmedit (fq.276-7).

³⁹ Ibn Abdul Berri në *Xhaami' Bejan el-Ilm* (2/149).

⁴⁰ Ibn el-Xhevziu (fq.182)

Këto janë thëniet e Imamëve - All-llahu [subhanehu ve teala] qoftë i kënaqur prej tyre - që urdhërojnë të kapemi për Hadith dhe na ndalojnë nga imitimi i tyre pa argument, dhe janë aq të qarta, saqë s'kanë nevojë për polemika dhe komentime të ndryshme.

Andaj, ai që kapet për çdo sunet, edhe pse ndoshta janë në kundërshtim me thëniet e Imamëve, nuk bie ndesh me medhhebin e tyre e as që del nga metoda e tyre, por është pasues i tyre, i kapur për litarin më të fortë, i cili kurrë nuk këputet. Kurse nuk është kështu situata me atë që e len pas shpinës veprimin me sunet vetëm e vetëm pse bie ndesh me thëniet e tyre. I këtilli, me këtë gjest, tregon mosrespekt ndaj tyre dhe kundërshton thëniet e tyre që i përmendëm pak më parë, kurse All-llahu [subhanehu ve teala] thotë:

فَلَا وَرَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ حَتَّى يُحَكِّمُوكَ فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ لَا يَجِدُوا فِي أَنْفُسِهِمْ حَرَجًا مِمَّا قَضَيْتَ وَيُسَلِّمُوا تَسْلِيمًا (65)

“Nuk janë besimtarë të vërtetë, përderisa të të bëjnë gjykatës në të gjitha mospajtimet e tyre dhe të mos lënë asnjë kundërshtim në zemrat e tyre ndaj vendimeve tua dhe t’i pranojnë ato me bindje të plotë.”⁴¹

Ai po kështu thotë:

فَلْيَحْذَرِ الَّذِينَ يُخَالِفُونَ عَنْ أَمْرِهِ أَنْ تُصِيبَهُمْ فِتْنَةٌ أَوْ يُصِيبَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ (63)

“Le të ruhen ata të cilët kundërshtojnë urdhrat e të Dërguarit se mos u vjen ndonjë shenjë ose ndonjë dënim i hidhur mbi ta.”⁴²

Hafidh Ibn Rexheb el-Hanbeli (rahimehull-llah) thotë:

“Prandaj, është obligim për çdokënd që dëgjon për ndonjë urdhër të të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ose e di atë, t’ia shpjegojë atë ummetit, t’i këshillojë singërisht dhe t’i udhëzojë ata në zbatimin e urdhërit të tij, edhe nëse e kundërshton mendimin e ndokujt zulmëmadh. Ngase autoriteti i të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka më shumë të drejtë të respektohet dhe të pasohet sesa mësimi i kujtdo tjetër zulmëmadh që ka kundërshtuar pa dije urdhërin e të Dërguarit në çfarëdo çështje. Për këtë shkak, shokët e tij (sahabët) dhe ata pas tyre përgënjeshtrojnë çdokënd që e kundërshtonte Sunetin autentik, duke qenë nganjëherë shumë të ashpër në përgënjeshttrimin e tyre,⁴³ jo nga urrejtja ndaj atij personi - edhe pse e donin dhe e

⁴¹ En-Nisa, 4: 65

⁴² En-Nur, 24: 63

⁴³ Madje, edhe kundër etërve të tyre dhe njerëzve të ditur, siç kanë treguar Tahaviu në *Sherh Ma’ani el-Aathaar* (1/372) dhe Ebu Ja’la në *Musned* e tij (3/1317) me një *isnad* të njerëzve të besueshëm nga Salim Ibn Abdull-llah ibn Umeri, i cili ka thënë:

respektonin -, por ngase i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte më i dashur për ta dhe urdhëri i tij ishte më superior se urdhëri i çdo krijese tjetër. Prandaj, kur urdhëri i të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ndeshet me urdhërin e tjetërkujt, urdhëri i të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte më i përshtatshmi për t'u pasuar dhe për t'u zbatuar. Asgjë nga kjo nuk i ndalonte ata që ta madhëronin personin që kishin kundërshtuar, sepse e dinin se atij do t'i falej.⁴⁴ Në fakt, më vonë, këtij të fundit nuk do t'i pengonte që udhëzimet e tij të kundërshtoheshin, kur tregohej qartë se urdhëri i të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte i kundërt."⁴⁵

Vërtet, si do t'u pengonte atyre kjo, kur ata i patën urdhëruar pasuesit e tyre në një gjë të tillë, siç kemi parë, dhe u patën porositur që ta braktisin çdo pikëpamje të tyre që e kundërshton Sunetin. Në fakt, Imam Shafiu (rahimehull-llah) u ka thënë shokëve të vet që t'ia atribuojnë atij Sunetin autentik, edhe nëse nuk e ka përvetësuar, ose ka përvetësuar diçka në kundërshtim me të. Për këtë shkak, kur analisti Ibn Dakik el-'Eidi (rahimehull-llah) përmbledhi në një vëllim të madh çështjet në të cilat njëri ose që të katër medhhebet e Imamëve kanë kundërshtuar hadithin autentik, ai, në fillimin e tij, shkroi:

"Është e ndaluar që këto përgjigje t'u vishen Imamëve Muxhtehidë dhe është obligim i juristëve të cilët i pasojnë mendimet e tyre t'i dinë këto, që të mos i citojnë lidhur me këto dhe kështu të gënjejnë për ta."⁴⁶

"Isha duke ndenjur me Ibn Umerin [radijall-llahu anhu] në xhami njëherë, kur një njeri nga populli i Sirisë erdhi tek ai dhe e pyeti për vazhdimin e Umresë në Haxh (e njohur si *Haxh Temettu*). Ibn Umeri u përgjigj: 'Është një gjë e mirë dhe e bukur'. Njeriu tha: 'Por yt atë (Umer ibn el-Hattabi) e ndalonte këtë!' E ai tha: 'I mjeri ti! Nëse im atë ka ndaluar diçka çka i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka praktikuar dhe urdhëruar, a do të pranoje pikëpamjen e tim atë, apo urdhrin e të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]?' Ai u përgjigj: 'Urdhrin e të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]'. Ai tha: 'Largohu nga unë tash.' Ahmed i (nr.5700) ka transmetim të ngjashëm sikurse Tirmidhiu (2/82), dhe e ka shpallur *sahih*.

Ibn Asakiri (7/51/1), gjithashtu, ka transmetuar nga Ibn Ebi Dhi'bi, i cili ka thënë:

"Sa'd ibn Ibrahim (i biri i Abdurr-Rahman ibn Avfit) solli një vendim rreth një njeriu, duke u bazuar në mendimet e Rebi'ah Ibn Ebu Abdurr-Rahmanit. Atëherë unë e informova për thënien e të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], e cila ishte në kundërshtim me atë vendim. Sa'di i tha Rebi'asë: 'Ne kemi Ibn ebi Dhi'bin, të cilin e konsiderojmë të besueshëm, i cili transmeton nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] të kundërtën e asaj çka unë kam gjykuar.' Rebi'aja i tha atij: 'Ti ke bërë përpjekjet tuaja dhe gjykimi yt është miratuar.' Sa'di tha: 'Sa çudi! Kam zbatuar dekretin e Sa'dit e jo të të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]! Jo, do ta tërheq vendimin e Sa'dit, të birit të nënës së Sa'dit, dhe do të zbatoj vendimin e të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]'. Dhe kështu Sa'di kërkoi që t'i sillet vendimi i shkruar, të cilin e grisi dhe solli një gjykim tjetër".

⁴⁴ Në fakt, ai do të shpërblehet, për shkak të thënies së të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]:

"Nëse një gjykatës jep një gjykim, bën përpjekje (*ixhtihad*) dhe gjykon drejtë, ai do t'i ketë dy shpërblime. Nëse bën përpjekje (*ixhtihad*) dhe gjykon gabimisht, ai do të ketë një shpërblim." (Përmbledhur nga Buhariu, Muslimi dhe të tjerët)

⁴⁵ I cituar në shënimet në *Ikadh el-Himam* (f. 93).

⁴⁶ Fulani (f.99).

Braktisja e pikëpamjeve të imamëve nga ana e pasuesve të tyre, nëse ato janë në kundërshtim me Sunnetin

Për shkak të gjithë asaj që përmendëm, nxënësit e Imamëve,

ثَلَاثَةٌ مِنَ الْأَوَّلِينَ (13) وَقَلِيلٌ مِنَ الْآخِرِينَ (14)

“Shumë nga të mëhershmit dhe pak nga të mëvonshmit”,⁴⁷

nuk i kanë pranuar të gjitha pikëpamjet e Imamëve të tyre; në të vërtetë, ata i kanë shpërfillur shumë prej tyre, kur panë se janë qartazi në kundërshtim me sunnetin. Bile edhe dy imamët, Muhammed ibn El-Hasani dhe Ebu Jusufi (rahimehull-llah) u dalluan në mendime nga shejhu i tyre Ebu Hanifja “përafërsisht, në një të tretën e medhhebit”,⁴⁸ siç dëshmojnë librat e “Mesa’ilit”. Kështu thuhet edhe për Imam El-Muzenun⁴⁹ dhe pasuesit e tjerë të Shafiut dhe të imamëve të tjerë; sikur të fillonim të jepnim shembuj, diskutimi do të bëhej tepër i gjatë dhe do të largoheshim nga ajo që kemi synuar të bëjmë në këtë hyrje, andaj ne do ta kufizojmë veten në dy instanca:

1) Imam Muhammedi thotë në *Muvetta*-në⁵⁰ e tij (f.158):

“Sa i përket Ebu Hanifes, ai nuk ishte i mendimit se ka namaz për shi, por ne mendojmë që imami duhet t’i falë dy rekate dhe pastaj të bëjë dua dhe ta veshë teshën mbështjellëse të tij nga e kundërta...”

2) Kemi Isam ibn Jusuf el-Balhiun, njërin nga shokët e Imam Muhammedit⁵¹ dhe shoqëruesin e imam Ebu Jusufit,⁵² i cili “jepte gjykime në kundërshtim me imamin Ebu Hanife, sepse nuk i dinte argumentet e tij, ndërsa argumentet e tjera do të

⁴⁷ El-Vaki’a 56: 13-14

⁴⁸ Ibn Abidini në “Hashije” (1/62) dhe Laknevi dha burimin e tij në “En-Nafi el-Kebir” (f.93), si Gazali.

⁴⁹ Vetë ai thotë në fillim të “Fikhu konciz i Shafiut” (i shtypur në marginën e “El-Ummi” të Imam Shafiut):
“Ky libër është seleksionim nga njohuritë e Muhammed ibn Idris Esh-Shafiut (rahimehull-llah) dhe nga kuptimet e thënieve të tij për të ndihmuar të kuptuarit e çdokujt që dëshiron, për të ditur për ndalimin e tij që të pasohet mendimi i tij ose i kujtdo tjetër, që ky person të mund të kërkojë me kujdes Dinin e vet.”

⁵⁰ Në të cilën ai ka shpjeguar kundërshtimin e tij ndaj Imamit të vet në më se njëzet *mesaile* (çështje) (42, 44, 103, 120, 158, 169, 172, 228, 230, 240, 244, 275, 284, 314, 331, 338, 355, 356 - nga “Ta’lik El-Mumexhixhid ‘ala Muvetta Muhammed” (Shënime të Rëndësishme mbi *Muvetta*-në e Muhammedit))

⁵¹ Ibn Abidini e ka përmendur atë në mesin e tyre në “Hashije” (1/74) dhe në “Rasm El-Mufti” (1/17).

Kurashi e ka përmendur në “El-Xhevahir el-Medijeh fi Tabekat el-Hanefijeh” (f.347), ku thotë:

“Ai ka qenë transmetues i besueshëm i Hadithit. Ai dhe vëllai i tij Ibrahim asokohe ishin dy dijetarët e Balhit.”

⁵² “El-Fevaid el-Behijeh fil Teraxhum el-Hanefijeh” (f.116)

parashtroheshin para tij, dhe kështu do të binte vendime duke përdorur këtë.”⁵³ Prandaj, “ai i ngrinte duart në ruku dhe në ngritjen prej saj”,⁵⁴ siç është sunneti *mutevatir* i të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. fakti që tre imamët e tij (d.m.th. Ebu Hanifja, Ebu Jusufi dhe Muhammedi) thoshin ndryshe, nuk e pengoi që të praktikonte këtë sunnet. Kjo është qasje të cilën çdo musliman duhet ta zbatojë, siç tashmë kemi parë nga dëshmitë e katër Imamëve dhe të të tjerëve.

Si rezyme mund të themi: Singerisht shpresoj se asnjë pasues i ndonjë Imami nuk do të ngutet që të dënojë parimet e këtij libri dhe kështu të mos përfitojë nga sunnetet e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] të përfshira në të, me argumentin se janë në kundërshti me medhhebin e vet. Shpresoj se një person i tillë, në vend të kësaj, do ta konsiderojë atë çka kemi treguar nga nxitjet e Imamëve për obligimin e pasimit të sunnetit dhe të shpërfilljes së thënieve që kundërshtojnë atë. Po ashtu, shpresoj se do të kuptojë që, nëse dënon qëndrimin e këtij libri, do të dënojë cilindo Imam që pason, ngase ne i kemi marrë këto parime nga këta Imamë, siç edhe kemi shpjeguar. Prandaj, çdokush që refuzon të udhëzohet nga këto parime në këtë rrugë, është në rrezik të madh, sepse një refuzim i tillë kërkon braktisjen e sunnetit, të cilit jemi të urdhëruar t’i referohemi në rast të dallimeve në mendime dhe në të cilin jemi urdhëruar të mbështetemi.

فَلَا وَرَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ حَتَّى يُحَكِّمُوكَ فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ لَا يَجِدُوا فِي أَنْفُسِهِمْ حَرَجًا مِمَّا قَضَيْتَ وَيَسْلُمُوا تَسْلِيمًا
(65)

“Nuk janë besimtarë të vërtetë, përderisa të të bëjnë gjykatës në të gjitha mospajtimet e tyre dhe të mos lënë asnjë kundërshtim në zemrat e tyre ndaj vendimeve tua, por duke i pranuar ato me bindje të plotë.” (En-Nisa: 65)

Lus All-llahun që të na futë në mesin e atyre për të cilët thotë:

⁵³ “El-Bahr ar-Raa’ik” (6/93) dhe “Rasm El-Mufti” (1/28).

⁵⁴ “El-Fevaid...” (f.16); pastaj autori ka shtuar një shënim të dobishëm:

“Nga kjo mund të deduktohet pavërtetësia e transmetimit të Mekhulit nga Ebu Hanifja: “se kush i ngre duart gjatë namazit, namazi i tij është i shkatërruar”, me të cilën Amiri, shkruesi i “Itkanit”, qe mashtruar, siç është cekur në biografinë e tij. Isam ibn Jusufi shok i Ebu Jusufit, i ngrinte duart, kështu që nëse transmetimi i përmendur më sipër ka ndonjë bazë, Ebu Jusufi dhe Isami do ta kishin ditur... Po ashtu, mund të kuptohet, se nëse një Hanefi shpërfill medhhebin e Imami të tij në një çështje për shkak se ka dëshmi të forta kundër saj, kjo nuk do ta largonte nga radhët e pasuesve të Imami, por kjo do të ishte *taklid* me vend në rrugën e lënies së *taklidit*. A nuk e shihni se Isam ibn Jusufi e la medhhebin e Ebu Hanifes në ngritjen e duarve, por ai ende llogaritet si Hanefi!?... I ankohem All-llahut për injorancën e kohës sonë, kur ata fyejnë cilindo që nuk pason Imamin e tij në ndonjë çështje për shkak të dëshmisë së fortë kundër tij, dhe e përjashtojnë nga pala e pasuesve të Imami! Kjo nuk më befason, kur ata shtiren se janë njerëz të ditur, e zvarriten në atë rrugë si gjëri!”

إِنَّمَا كَانَ قَوْلَ الْمُؤْمِنِينَ إِذَا دُعُوا إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ لِيَحْكُمَ بَيْنَهُمْ أَنْ يَقُولُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ
(51) وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَخْشَ اللَّهَ وَيَتَّقِهِ فَأُولَئِكَ هُمُ الْفَائِزُونَ (52)

“Përgjigja e besimtarëve, kur thirren te All-llahu dhe i Dërguari i Tij me qëllim që ai të gjykojë mes tyre, nuk është tjetër pos kësaj: ata thonë: “Kemi dëgjuar dhe nënshtrohemi” - këta janë ata që do të arrijnë sukses. Janë ata që iu nënshtruan All-llahut dhe të Dërguarit të tij dhe i frikësohen All-llahut dhe mbajnë besën e dhënë Atij, ata të cilës do të triumfojnë.”⁵⁵

Damask, Xhemadul-Ahire, 1370.

Përgjigje mëdyshjeve

Hyrja që paraprin është shkruar dhjetë vite më parë, gjatë së cilës kohë na është bërë e qartë se fjala jonë ka pasur efekt pozitiv në rininë muslimane në udhëzimin e tyre drejt obligimit për t’iu kthyer burimeve të pastra islame, Librit dhe Sunnetit, në çështjet e Dinit dhe të adhurimit të tyre. Në mesin e tyre ka pasur rritje në radhët e tyre që praktikojnë Sunnetin dhe janë të devotshëm ndaj tij, - Lavdia i qoftë All-llahut – derisa dhe u bënë të njohur për këtë. Megjithatë, ende gjej në mesin e tyre kokëfortë që nuk praktikojnë Sunnetin; jo për shkak të dyshimit ndaj obligimit të tij pas leximit të ajeteve kur’anore dhe transmetimeve të imamëve në lidhje me kthimin në Sunnet, por për shkak të disa kundërshtimeve dhe keqkuptimeve që i kanë dëgjuar nga dijetarët *mukal-lidë*. Prandaj, vendosa t’i përmend këto nocione dhe t’i përgënjeshtroj ata, se ndoshta kjo do të inkurajonte më shumë njerëz të praktikojnë Sunnetin dhe kështu të jenë në mesin e grupit të shpëtuar, me Dëshirën e All-llahut.

Dilema e parë:

Disa nga ata thonë: “Nuk ka dyshim se është e obligueshme t’i kthehemi udhëzimit të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në çështjet e dinit tonë, posaçërisht në veprat që janë thjeshtë adhurim, siç është namazi, aty ku nuk ka vend për opinione ose *ixhtihad*, për shkak të natyrës së pandryshueshme të tyre. Megjithatë, shumë pak nga dijetarët *mukal-lidë* e urdhërojnë në këtë gjë; në të vërtetë, ne i shohim ata duke i përkrahur dallimet në mendime, duke i trajtuar ato si fleksibilitet për ummetin. Dëshmia e tyre për këtë është hadithi të cilin vazhdimisht e përsërisin në raste të tilla, kur zihen me përkrahësit e Sunnetit: “Dallimet në mendime (*ihtilafi*) në ummetin tim janë mëshirë (*rahmet*) ”. Neve na duket se ky hadith kundërshton parimet në të cilat ju thërritni dhe në bazë të të cilave keni përpiluar këtë libër dhe librat e tjerë. Pra çka thoni për këtë hadith?”

⁵⁵ En-Nur 24: 51-52

Përgjigje: Përgjigja është prej dy këndvështrimeve:

A) Së pari: Ky hadith nuk është autentik; në të vërtetë, është i rremë dhe i pabazë. Al-lameh Subkiu thotë: “Nuk kam hasur në ndonjë zinxhir autentik, të dobët ose të shpikur të transmetimit për të”, d.m.th. nuk ekziston ndonjë zinxhir i transmetuesve për këtë hadith!”

Është transmetuar po ashtu me fjalët “...dallimi në mendime në mesin e shokëve të mi është mëshirë për ju” dhe “shokët e mi janë sikurse yjet, kështu që cilindo që ta pasoni, do të jeni të udhëzuar”.

Të dyja këto transmetime nuk janë autentike: transmetimi i parë është shumë i dobët; kurse i dyti është e shpikur. (Shih shtojcën 1)

B) Së dyti: Ky hadith kundërshton Kur'anin Famëmadh, sepse ajetet që ndalojnë ndasinë në Din dhe urdhërojnë unitetin, janë shumë mirë të njohura që të rikujtohen. Megjithatë, s'do të dëmtonte dhënia e disa prej tyre nëpërmjet shembullit: All-llahu thotë:

(وَلَا تَنَازَعُوا فَيَفْشَلُوا وَتَذْهَبَ رِيحُكُمْ 46)

“...dhe mos u përçani mes vete, e të dobësoheni e ta humbni fuqinë”.⁵⁶

(وَلَا تَكُونُوا مِنَ الْمُشْرِكِينَ (31) مِنَ الَّذِينَ فَرَّقُوا دِينَهُمْ وَكَانُوا شِيعًا كُلُّ حِزْبٍ بِمَا لَدَيْهِمْ فَرِحُونَ (32))

“Dhe mos u bëni prej atyre që i shoqërojnë hyjni All-llahut, që e përçajnë Dinin e tyre dhe ndahen në sekte - secili grup duke u kënaqur me atë që ka!”⁵⁷

(وَلَا يَزَالُونَ مُخْتَلِفِينَ (118) إِلَّا مِنْ رَحِمِ رَبِّكَ)

“Por ata nuk do të ndalen së ndari, përveç atyre të cilët Zoti yt i mëshiron”.⁵⁸

Prandaj, në qoftë së ata mbi të cilët Zoti ka mëshirë nuk përçahen, ndërsa njerëzit gënjeshtarë përçahen (kundërshtohen), si mund të jetë kjo përçarje mëshirë?!

Pra, është konstatuar se ky hadith s'është autentik, as në zinxhirin e transmetimit, as në kuptimin e tij, prandaj është e qartë dhe evidente se nuk mund të përdoret si arsyetim për të refuzuar veprimin sipas Librit dhe Sunnetit, çka përndryshe edhe imamët tanë na kanë urdhëruar.

⁵⁶ El Enfal, 8: 46

⁵⁷ Er-Rum, 30: 31-2

⁵⁸ Hud, 11: 118-9

Dilema e dytë:

Të tjerët thonë: “Nëse dallimet në Din nuk lejohen, çka thoni për dallimet ndërmjet sahabëve dhe ndërmjet imamëve pas tyre? A ka ndonjë diferencë ndërmjet dallimeve të tyre dhe të atyre të gjeneratave të mëvonshme?”

Përgjigje: Po, ekziston një diferencë e madhe ndërmjet këtyre dallimeve, që shfaqet në dy mënyra: së pari, në shkak; së dyti, në pasojë.

A) Sa i përket dallimeve ndërmjet sahabëve, ky ka qenë dallim i pashmangshëm, dallim i natyrës së të kuptuarit të tyre: ata nuk u dalluan me vetëdashje. Faktorë të tjerë të kohës së tyre i kontribuan kësaj duke kushtëzuar dallimin e mendimit, por këto dallime u zhdukën pas epokës së tyre.⁵⁹ Ky lloj i dallimit është e pamundur të shmanget plotësisht dhe njerëzit e këtillë nuk mund të fajësohen, duke marrë parasysh ajetet e përmendura më lart, për shkak të mungesës së kushteve përkatëse, d.m.th. dallimet e qëllimta dhe këmbëngulja në to.

Mirëpo, sa u përket dallimeve që ekzistojnë sot ndërmjet *mukal-lidëve*, nuk ka arsye bindëse për to. Kur njërit prej tyre i tregohet dëshmia nga Libri dhe Sunneti që përkrah medhhebin tjetër e jo të tij, ai lë anash këtë dëshmi pa kurrfarë arsye, përpos asaj se kundërshton medhhebin e tij. Sikur të ishte medhhebi i tij baza ose Dini të cilin Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e solli, derisa medhhebet e tjera janë “dine” të ndara të cilat janë shfuqizuar!

Të tjerët marrin ekstremën e kundërt duke i trajtuar medhhebet - me të gjitha dallimet e tyre - si kode paralele të Ligjit, siç shpjegojnë disa pasues të mëvonshëm të tyre: ⁶⁰ s’ka gjë nëse muslimani merr prej tyre çka do dhe lë atë që do, sepse të gjitha ato janë kode të vlefshme të Ligjit!

Të dyja këto kategori të njerëzve arsyetojnë qëndrimin e tyre të ndarë me këtë hadith të rremë: “Dallimi në ummetin tim është mëshirë” - shumë prej tyre i dëgjojnë duke e përdorur këtë si dëshmi! Disa japin arsyen pas këtij hadithi dhe qëllimin e tij duke thënë se kjo siguron fleksibilitetin për ummetin! Përkundër faktit se kjo arsye është në kundërshtim me ajetet e qarta kur'anore dhe me kuptimet e fjalëve të përmendura të imamëve, ekzistojnë gjithashtu tekste nga disa imamë për ta hedhur poshtë atë.

Ibn El-Kasim thotë:

⁵⁹ “El-Ihkam fi Usul El-Akham” nga Ibn Hazmi, “Huxhxhetull-llah El-Baligah” nga El-Dehlavi dhe eseja e tij që shtjellon posaqërisht këtë çështje, “Ikd El-Xhid fi Ahkam El-Ixhtihad vet-Taklid”.

⁶⁰ Shih në “Faid El-Kadir” nga El-Manavi (1/209) dhe në “Silsileh El-Ehadith Ed-Da’ifeh” (1/76, 77)

“Kam dëgjuar Malikun dhe Lejthin duke thënë për dallimin mes shokëve të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]: “Nuk është siç thonë njerëzit: “Ka fleksibilitet në të”; jo, nuk është ashtu, por është çështje e disave që kanë gabuar dhe e disave që kanë pasur të drejtë”.⁶¹

Eshhebi ka thënë:

“Maliku është pyetur për personin i cili ka pranuar një hadith të transmetuar nga njerëz të sigurt nga autoriteti i shokëve të të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]: “A sheh ndonjë fleksibilitet aty (të veprosh ose të mos veprosh) ?” Ai tha: “Jo, pasha All-llahun, derisa nuk e qëllon mendimin e saktë. E vërteta mund të jetë vetëm një. Dy pikëpamje të kundërta, si mund të jenë të dyja të vërteta?! E vërteta dhe e drejta janë vetëm një.”⁶²

Shoku i Imam Shafiut, imam Muzeni ka thënë:

“Shokët e të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] me të vërtetë dallonin dhe disa prej tyre korrigjonin të tjerët. Disa prej tyre shqyrtonin me hollësi pikëpamjet e të tjerëve dhe i kritikonin ata. Sikur të kishin qenë të gjitha pikëpamjet e tyre të sakta, nuk do të kishin vepruar kështu. Umer ibn El-Hattabi u hidhërua për mosmarrëveshjen ndërmjet Ubejj ibn Ka’bit dhe Ibn Mesudit rreth faljes në vetëm një petk. Ubejji tha: “Falja më një teshë është mirë dhe në rregull”; Ibn Mesudi tha: “Kjo është nëse ndonjëri nuk ka më shumë rroba”. Atëherë, Umeri u hidhërua duke thënë: “Dy burra nga mesi i shokëve të respektuar dhe të ditur të të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] grinden! Ubejji e ka thënë të vërtetën dhe s’ka çarë kokën fare për Ibn Mes’udin. Por, nëse dëgjoj ndonjë duke polemizuar për këtë pas kësaj, unë do t’i bëj kështu e kështu”.⁶³

Imam Muzeni, po ashtu, ka thënë:

“Ka të atillë që lejojnë dallimet dhe mendojnë se, nëse dy dijetarë bëjnë *ixhtihad* për një problem dhe njëri thotë “Hallall” e tjetri thotë “Haram”, atëherë që të dy kanë arritur te e vërteta me *ixhtihadin* e tyre! Mund t’i thuhej një personi të tillë: “A është e bazuar kjo pikëpamje jotja në burime, apo në *kijas* (analogji) ?” Nëse thotë: “Në burime”, mund t’i thuhet: “Si mund të bazohet në burime kur Kur’ani kundërshton dallimin?”, dhe nëse thotë: “Në analogji”, mund t’i thuhet: “Si është e mundur që burimet ta kundërshtojnë dallimin, ndërsa ty të të lejohet të

⁶¹ Ibn Abdul-Berri në Xhami’ Bejan El-’Ilm (2/81-2)

⁶² Ibid. (2/82, 88-9)

⁶³ Ibid. (2/83-4)

arsyetosh me analogji se dallimet lejohen?! Kjo është e papranueshme për këdo inteligjent, e mos të flasim për njeriun e ditur.”⁶⁴

Nëse thuhet më tutje: “Çka keni cituar nga Imam Maliku se e vërteta është vetëm një e jo më shumë, është në kundërshtim me atë që është gjetur në “Al-Madhal Al-Fikhi” nga Shejh Zerka (1/89): “Halifët Ebu Xhafer El-Mensuri dhe më vonë Er-Reshidi propozuan ta zgjedhin medhhebin dhe librin e Imam Malikut “El-Muvetta” kod juridik për dinastinë Abasite, mirëpo Maliku ua ndaloi këtë, duke u thënë: “Vërtet, shokët e të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dalloheshin në çështje jofundamentale dhe ishin të shpërndarë në qytete të ndryshme, mirëpo secili prej tyre kishte të drejtë.”

Unë them: Ky tregim me Imam Malikun (rahimehull-llah) është mirë e njohur, por thënia e tij në fund: “Mirëpo, secili prej tyre kishte të drejtë” është ajo për të cilën - pasha All-llahun - nuk gjej kurrfarë baze në asnjë prej transmetimeve a burimeve të cilat i kam hasur⁶⁵, përveçse në një transmetim të përmbledhur nga Ebu Nuaimi në “Hiljetul-Evlija” (6/332), por me një zinxhir transmetuesish që përfshin “El-Mikdam ibn Davudin”, i cili radhitet në mesin e transmetuesve të dobët nga Dhehebi në “Ed-Du’afa”; jo vetëm kjo, por edhe teksti i tij është: “... mirëpo secili prej tyre kishte të drejtë sipas mendimit të vet.” Prandaj, fraza “sipas mendimit të vet” tregon që transmetimi në “Madkhal” është i ndërshtënë, dhe si mund të jetë ndryshe, kur kjo kundërshton atë çka është transmetuar nga autoritetet e sigurta të Imam Malikut se e vërteta është vetëm një e jo më shumë, siç kemi përmendur, dhe në këtë janë pajtuar të gjithë imamët e sahabëve dhe tabi’inët, si dhe katër Imamët Muxhtehidë dhe të tjerët.

Ibn Abdul-Berri thotë:

“Nëse të dyja pikëpamjet kundërshtuese do të kishin qenë të drejta, selefi nuk do ta kishin korrigjuar *ixhtihadin* e njëri-tjetrit, gjykimet dhe vendimet. Rezonimi i thjeshtë mohon që diçka dhe e kundërta e saj të jenë të dyja të vërteta; siç thotë një fjalë e mirë:

Të dëshmosh dy gjëra të kundërta njëkohësisht është absurditet më i shëmtuar.”⁶⁶

Nëse thuhet më tutje: “Duke qenë se ky transmetim nga Imam Maliku është i rremë, pse ai nuk lejoi “El-Mensurin” t’i bashkonte njerëzit në librin e tij *El-Muvetta* në vend se t’i nënshtrohej dëshirës së Halifit?”

⁶⁴ Ibid. (2/89)

⁶⁵ “El-Intika” nga Ibn Abdul-Berri (41), “Kashf El-Mughatta fi Fadl El-Muvetta” (f.6-7) nga Ibn Aasakiri, dhe “Tadhkirah El-Huffadh” nga Dhehebiu (1/195).

⁶⁶ “Xhami’ Bejan El-’Ilm” (2/88).

Unë them: Përgjigja më e mirë që kam gjetur për këtë është ajo që Hafiz Ibn Kethiri ka përmendur në “Sherh Ihtisar Ulum El-Hadith-in” e tij (f. 31) se Imam Maliku ka thënë:

“Vërtet, njerëzit kanë hasur dhe kanë mësuar gjëra me të cilat ne nuk jemi njoftuar.”

Kjo ka qenë ekselencia e urtësisë dhe paanësisë së tij, siç thotë Ibn Kethiri (rahimehull-llah). Pra, është dëshmuar se të gjitha dallimet janë të këqija e jo mëshirë. Derisa një lloj i dallimit është i qortueshëm, siç është ai i pasuesve ekstrem të medhhebeve, lloji tjetër nuk duhet qortuar, siç është dallimi i sahabëve dhe i imamëve të cilët i trashëguan ata - All-llahu na dhëntë mundësi të ringjallemi në mesin e tyre dhe të pasojmë rrugën e tyre. Prandaj, është e qartë se dallimi i sahabëve nuk është i njëjtë me të *mukal-lidëve*.

Shkurtimisht: Sahabët dallonin vetëm kur ka qenë e pashmangshme, por ata i urrenin polemikat dhe i evitonin sa herë që ishte e mundur, ndërsa sa u përket *mukal-lidëve*, edhe pse në të shumtën e rasteve është e mundur të evitohen kundërshtimet, ata nuk pajtohen e as që përpiqen drejt unitetit; në të vërtetë, ata përkrahin dallimet. Ndërmjet këtyre dy lloje njerëzish në dallimet e tyre në mendime është një hendek i madh.

Kjo ishte nga këndvështrimi i shkakut.

B) Dallimi në efekt është më i dukshëm.

Sahabët [radijall-llahu anhum], pavarësisht dallimeve të tyre mirë të njohura në çështjet joparimore, kanë qenë jashtëzakonisht të kujdesshëm në ruajtjen e unitetit e jashtëm, duke qëndruar larg çdo gjëje që do t'i përçante dhe do t'i ndante radhët e tyre. Për shembull, ka pasur në mesin e tyre të atillë që lejonin të thuhet *bismil-lah* (besmelja) zëshëm (në namaz) dhe të atillë që nuk lejonin. Ka pasur të atillë që konsideronin se ngritja e duarve (gjatë namazit) është e pëlqyer dhe të atillë që nuk mendonin kështu. Ka pasur të atillë që konsideronin se prekja e gruas e prish abdesin dhe të atillë që nuk mendonin kështu. Por, pavarësisht kësaj, ata të gjithë faleshin së bashku pas një imami dhe askush prej tyre nuk përçmonte faljen pas një imami për shkak të dallimit në mendime.

Sa u përket *mukal-lidëve*, dallimi i tyre është plotësisht i kundërt, sepse ka shkakuar që muslimanët të ndahen në shtyllën më madhështore të besimit pas dy dëshmimeve të besimit, e që s'është asgjë tjetër pos namazit. Ata refuzojnë të falen së bashku pas një imami duke pohuar se falja e imami është e pavlerë ose së paku e urryer për dikë të medhhebit tjetër. Ne këtë e kemi dëgjuar dhe e kemi parë ashtu siç kanë parë të tjerët pos nesh;⁶⁷ si mund të mos jetë, kur sot disa libra të famshëm të medhhebeve përmbajnë raste të tilla të zhvlerësimit dhe të të urryerit. Rezultati i kësaj ka qenë ajo që mund të

⁶⁷ Shih Kreun e Tetë të librit “Ma La Jaxhuz min El-khilaf” (f.65-72), ku do të gjeni një numër shembujsh, për të cilët kemi treguar, disa prej tyre përfshijnë dijetarët e El-Ez-herit.

gjesh katër mihrobe (kënde, skuta) në disa xhami të mëdha në të cilat katër imamë në mënyrë të njëpasnjëshme udhëheqin namazin si dhe gjen njerëz duke pritur për imamin e tyre, derisa një imam tashmë është duke qëndruar në namaz!!!

Në të vërtetë, te disa *mukal-lidë* dallimi ndërmjet medhhebeve ka arritur gjendje më të keqe se kjo, siç është ndalimi i martesave mes Hanefive dhe Shafive. Një dijetar i njohur Hanefi, më vonë i njohur si “Mufti Eth-Thekalejn” (Mufti i njerëzve dhe i xhinëve), dha një fetva duke lejuar martesën e Hanefiut me një grua Shafi, sepse pozita e saj është si ajo e Njerëzve të Librit!⁶⁸ Kjo nënkupton se kjo mënyrë e të menduarit është e papranueshme për ta - ndërsa rasti i anasjelltë nuk lejohet, d.m.th. një femër Hanefi s’mund të martohet për një burrë Shafi, ashtu siç femra muslimane nuk mund të martohet me një çifut ose të krishterë?!

Këta dy shembuj, prej të shumtëve, mjaftojnë që t’i ilustrojnë çdokujt inteligjent efektet e këqija të dallimeve të gjeneratave të mëvonshme dhe të insistimit të tyre në të, përkundër dallimeve të gjeneratave të hershme (Selefi), që nuk kanë pasur ndonjë efekt të kundërt në ummet. Për shkak të kësaj, këta të fundit përgënjeshtrohen nga ajetet të cilat ndalojnë ndasinë në Din, gjë që nuk vlen për gjeneratat e mëpastajshme. All-llahu na udhëzoi të gjithëve në rrugë të drejtë.

Sa do të dëshironim që dëmi i shkaktuar nga një dallim i tillë të kufizohej vetëm në mesin e tyre e të mos zgjerohej deri te njerëzit tjerë të cilëve u bëhet da’vet, sepse kjo atëherë nuk do të ishte aq keq, por është aq mjerim kur ata lejojnë që kjo të arrijë deri te jobesimtarët në regjione të ndryshme rreth e qark botës dhe dallimi i tyre pengon hyrjen e shumë njerëzve në numër të madh në fenë e All-llahut! Libri “Dhulamun minel-Garbi” nga Muhammed El-Gazzali (f. 200) shënnon incidentin vijues: “Ndodhi që, gjatë një konference të mbajtur në Universitetin e Prinstonit në Amerikë, njëri nga folësit të bëjë një pyetje e cila është më e dashura te orientalistët dhe te sulmuesit e Islamit: “Cilat mësimet muslimanët i favorizojnë para botës, me qëllim që ta specifikojnë Islamin në të cilin thërrasin? A janë mësimet islamike ashtu siç kuptohen nga sunnitët, apo ashtu siç kuptohen nga shi’itët Imamij apo Zejdij? Për më tepër, të gjithë këta janë të ndarë ndërmjet tyre edhe më tej; disa prej tyre besojnë në përparim të kufizuar të mendimit, derisa të tjerët besojnë me kokëfortësi në ide të fiksuara. Kjo, pra, rezultoi në atë që thirrësit në Islam t’i lënë ata që ftoheshin në konfuzion, ngase edhe vetë ishin tërësisht të hutuar.”⁶⁹

⁶⁸ “El-Bahr Er-Ra’ik.”

⁶⁹ Unë tash them: Shkrimet e kohës së fundit të Muhammed El-Gazzalit, siç është libri i porsabotuar i tij i titulluar *Es-Senneh En-Nebevijeh bejne Ehlil-Hadith ve Ehlif-fikh* (Sunneti profetik mes Njerëzve të Hadithit dhe Njerëzve të Fikhut), kanë konfirmuar se edhe ai vetë është një prej atyre thirrësve në Islam të cilët edhe vetë janë tërësisht të hutuar. Shkrimet e tij një kohë të gjatë kanë treguar konfuzionin e tij, shtrembërimet e tij të Sunnetit dhe përdorimin e intelektit të tij për të shpallur një hadith autentik ose të rremë, duke mos iu kthyer parimeve dhe shkencës së hadithit e as ekspertëve të asaj fushe; në vend të kësaj, çdo gjë që i përshtatet atij, ai e bën autentike, qoftë edhe nëse është e dobët, dhe e shpall të pabesueshme çdo gjë që nuk i pëlqen atij, edhe nëse ekziston pajtimi se është autentike.

Në hyrje të “Hedijje Es-Sultan ila Muslimi Bilad Xhaban” nga Al-lameh Muhammed Sultan El-Masumi (rahimehull-llah), autori thotë:

“Një pyetje m’u shtrua nga muslimanët e Japonisë nga qytetet Tokio dhe Osaka në Lindjen e Largët: “Cili është Dini i vërtetë Islam? Çka është medhhebi? A është e domosdoshme për ndonjë të fisnikëruar me Dinin Islam t’i bashkëngjitet ndonjërit prej katër medhhebeve? Përkatësisht, a duhet të jetë Hanefi, Maliki, Shafi apo Hanbeli, apo kjo nuk është e domosdoshme?” Kjo qe për shkak të një dallimi të madh, një mospajtimi të ndyrë që kishte ngjarë kështu, kur një numër grupesh të intelektualëve japonezë deshën të hynin në Dinin Islam dhe të fisnikëroheshin me bujarinë e Imanit. Kur ata ia propozuan këtë disa muslimanëve të pranishëm në Tokio, disa njerëz nga India thanë: “Është më së miri që ata ta zgjedhin medhhebin e Ebu Hanifes, sepse ai është Kandil i Ummetit”; disa njerëz nga Indonezia (Java) thanë: “Jo, ata duhet të jenë Shafi!” Kur japonezët dëgjuan këto deklarata, ata qenë shumë të hutuar dhe u larguan nga qëllimi i tyre fillestar. Prandaj, çështja e medhhebeve u bë pengesë në rrugën e tyre për pranimin e Islamit!!”

Dilema e tretë:

Të tjerët mendojnë se ajo në çka ne thërrasim, pra, në pasimin e Sunnetit dhe në mospranimin e pikëpamjeve të Imamëve që janë në kundërshtim me të, nënkupton braktisjen e plotë të pikëpamjeve të tyre dhe të përfitimit nga mendimet dhe *ixhtihadi* i tyre.

Përgjigje: Kjo ide është shumë larg së vërtetës, është e rreme dhe qartazi e gjymtë, siç është evidente nga diskutimet tona paraprake, të cilat të gjitha sugjerojnë të kundërtën. Krejt ajo në çka ne thërrasim është që medh-hebi të mos trajtohet si Din, duke e vendosur në pozitën e Kur'anit dhe Sunnetit, ashtu që t’i referohet atij në rast të mospajtimeve ose kur është duke u nxjerrë ndonjë gjykim i ri për rrethana të papritura,

Qasja e tij e mësipërme tregohet qartë në diskutimin e tij për hadithet për librin e tij pararendës “Fikh Es-Sireh”, ku ai shpjegon metodologjinë e tij të pranimin të haditheve të pasigurta dhe flakjen e atyre autentike, duke u bazuar vetëm në tekstin e hadithit, ku lexuesi mund të shohë se kritika objektive e hadithit nuk ka fare vlerë në sytë e tij, nëse kundërshton “analizën e logjikshme”, e cila ndryshon shumë nga personi në person, sepse çka është e vërtetë për njërin, është gënjeshtër për tjetrin! Kështu, i tërë Islami shndërrohet në subjekt të tekave personale, duke mos pasur kurrfarë parime dhe pika referimi, përveç mendimit personal. Kjo është larg nga qëndrimi i hershëm i ulemasë udhëheqëse të Islamit se *isnadi* është pjesë e religjionit; sikur të mos ishte *isnadi*, njerëzit do të thoshin çfarëdo që do të dëshironin.

Libri i tij i fundit i sipërpërmendur ua ka zbuluar njerëzve metodologjinë e tij Mutezilitë, mospërfilljen e paturpshme të imamëve të hadithit dhe të përpjekjeve të tyre ndër shekuj në shërbim të Sunnetit dhe në dallimin e traditave origjinale prej të pasigurtave, dhe mungesën e tij të çmuarjes së përpjekjeve të imamëve të fikhut në vendosjen e tyre të parimeve dhe në zhvillimin e çështjeve në ato baza, por ai merr dhe lë prej tyre atë çka dëshiron vet, pa kurrfarë konsistence drejt asnjëfarë grupi parimesh dhe fundamentesh.

ashtu siç veprojnë të ashtuquajturit juristë të kësaj kohe, kur vendosin ligje të reja për çështjet personale, për martesë, shklorëzim etj., në vend që t'i referohen Kur'anit dhe Sunnetit për të dalluar të drejtën nga e gabuara, të vërtetën nga gënjeshtër - e gjithë këtë në emër të "dallimi është mëshirë" dhe mendimit të tyre për ndjekjen e çdo lehtësimi dhe volie! Sa e bukur ishte thënia e Sulejman Et-Tajmit (rahimehull-llah):

"Po i pranove lehtësimet e çdo dijetari, në ty do të tubohet çdo e keqe".

Treguar nga Ibn Abdul Berr në "Xhaami Bejaan El-Ilm" (2/91-91), i cili ka thënë pas kësaj:

"Ekziston *ixhmaja* (njëzëshmëria e mendimit) rreth kësaj: Nuk di për këtë asnjë pikëpamje të kundërt."

Gjithë kjo ndjekje e lehtësimeve për hir të saj, është refuzuar prej nesh, gjë që është në pajtim edhe me *ixhmanë*, siç e shihni.

Sa i përket referimit në pikëpamjet e imamëve, përfitimit nga ato dhe ndihmës prej tyre në të kuptuarit e së vërtetës, ku ata patën dallime dhe ku s'ka tekst në Kur'an dhe Sunnet, ose kur paraqitet nevoja për sqarime, ne nuk e refuzojmë atë. Në të vërtetë, ne e urdhërojmë dhe e potencojmë atë, ngase do të ketë shumë dobi në këtë për këdo që pason rrugën e të udhëzuarit nga Kur'ani dhe Sunneti.

Al-lameh ibn Abdul-Berri (rahimehull-llah) thotë: (2/182)

"Prandaj, vëllai im, duhet t'i ruash parimet themelore dhe t'u kushtosh vëmendje. Duhet ta dish se ai që kujdeset për mësimin përmendësh e Sunnetit dhe urdhrave të shpallur në Kur'an, i ka parasysh pikëpamjet e juristëve, në mënyrë që t'i ndihmojnë në *ixhtihadin* e tij, t'i bëhen çelës i metodave të analizave dhe shpjegimi i sunneteve që bartin kuptime të ndryshme të mundshme, nuk pason verbazi mendimin e ndonjërit prej tyre, ashtu siç duhet pasuar Sunneti, pa përimitime, e as nuk shpërfill atë që dijetarët vetë kanë arritur në ruajtjen dhe të menduarit rreth Sunnetit, por i pason në diskutime, në të kuptuarit dhe analiza, u është mirënjohës atyre për përpjekjet e tyre, nëpërmjet të cilave ata i kanë sjellë dobi dhe ia kanë tërhequr vërejtjen për çështje të ndryshme, i falënderon ata për përfundimet e tyre të sakta, në të shumtën e rasteve, por nuk i lartëson nga gabimet, ashtu sikurse ata nuk kishin lartësuar vetveten nga kjo gjë. Ky person është ndjekës i diturisë, i cili i është bashkëngjitur rrugës së Paraardhësve të Devotshëm; i cili është fatbardh dhe vërtet i udhëzuar; i tilli është pasues i Sunnetit të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe i udhëzimit të sahabëve [radijall-llahu anhum]. Por ai i cili përmbahet nga analizat, lë anash metodën që kemi përmendur, polemizon rreth sunneteve me mendimin e tij dhe dëshiron t'i përshtatë vetëm aty ku lejon mendimi i tij, i tilli është në lajthitje dhe

është duke i shpënë të tjerët në lajthitje. Më tutje, ai i cili shpërfill tërë atë që kemi përmendur dhe zhytet pa kujdes në dhënien e gjykimeve pa dijeni, i tilli është edhe më i verbër dhe në një rrugë edhe më të humbur”.

Kjo është e vërteta. Në të nuk ka paqartësi. Andaj largohu prej rrugicave.

Dilema e katërt:

Ekziston një tjetër keqkuptim i rëndomtë në mesin e *mukal-lidëve*, që i ndalon ata në zbatimin e një sunneti, për të cilin atyre u është e qartë se medhhebi i tyre është në kundërshtim me të në atë çështje. Ky keqkuptim është mendimi se pasimi i Sunnetit detyrimisht shkakton fajësimin e themeluesit të medhhebit. Për ata, të gjes gabime do të thotë të ofendosh imamin. Nëse nuk është e lejuar për ta fyerja e cilitdo individ musliman, si mund ta ofendojnë ndonjërin prej imamëve të tyre?

Përgjigje: Ky arsyetim është plotësisht i gabueshëm dhe është pjellë e moskuptimit të Sunnetit. Përndryshe, si mund të arsyetohet një musliman inteligjent në këso mënyre?!

I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] vetë ka thënë:

“Kur ai që është duke sjellë një gjykim, përpiqet dhe arrin të përfundimi i saktë, ka dy shpërblime; por nëse ai gjykon duke u përpjekur dhe sjell gjykim të gabuar, ai ka një shpërblim.”⁷⁰

Ky hadith rrëzon argumentin e lartpërmendur dhe shpjegon dukshëm dhe pa asnjë paqartësi se nëse ndokush thotë “ky dhe ky është në gabim”, kuptimi i kësaj në shariat është “ky e ky ka një shpërblim.” Nëse ai është i shpërblyer në shikimin e atij që ka gjetur gabimin, si mund ta akuzosh këtë të fundin për fyerjen e tij?! Nuk dyshohet se ky lloj i akuzimit është i pabazë, dhe kushdo që e bën, duhet ta tërheqë; përndryshe, do të jetë ai që i fyen muslimanët, jo vetëm individët e rëndomtë në mesin e tyre, por imamët e shquar në mesin e sahabëve, të trashëgimtarëve dhe imamëve të mëvonshëm muxhtehidë dhe të tjerët. Kjo ngase ne e dimë me siguri se këto personalitete të famshme qortonin dhe i gjenin gabime njëri-tjetrit⁷¹. A është e arsyeshme të thuhet: “Ata fyenin njëri-tjetrin”? Jo! Në të vërtetë, është transmetuar në mënyrë autentike se i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka përmirësuar Ebu Bekrin [radijall-llahu anhu] në interpretimin e tij të ëndrrës së një njeriu, duke i thënë: “Diku pate të drejtë, diku jo.”⁷² Pra, a e ka fyer ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] Ebu Bekrin me këto fjalë?!

⁷⁰ Buhariu dhe Muslimi.

⁷¹ Shihni fjalët paraprake të imam Muzanit dhe të Hafiz ibn Rexheb el-Hanbelit.

⁷² Buhariu dhe Muslimi; shih Shtojcën Dy për hadithin e plotë.

Një prej efekteve më të habitshme që ky keqkuptim ka në bartësit e vet është se i pengon ata nga ndjekja e Sunnetit, kur është i ndryshëm me medhhebin e tyre, ngaqë për ta zbatimi i tij nënkupton fyerjen e imamit, kurse ndjekja e tij, edhe kur është në kundërshtim me Sunnetin, nënkupton të dashurit dhe të respektuarit e tij! Prandaj, ata ngulmojnë në ndjekjen e mendimit të tij për t'i ikur mosrespektimit të supozuar.

Këta njerëz kanë harruar - të mos them se shtiren se harrojnë – se, për shkak të këtij mendimi, ata janë zhytur në diçka shumë më të keqe se ajo prej së cilës ikin. Atyre duhet t'u thuhet: “Nëse të pasosh dikë do të thotë të respektosh atë ndërsa ta kundërshtosh do të thotë ta ofendosh atë, atëherë pse i lejoni vetes ta kundërshtoni shembullin e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe të mos e pasoni atë duke preferuar të pasoni imamin e medhhebit në një rrugë të ndryshme me atë të Sunnetit, kur imami nuk është i pagabueshëm dhe ofendimi i tij nuk është kufër?! Nëse e interpretoni kundërshtimin e imamit si ofendim të tij, atëherë kundërshtimi i të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është dukshëm më shumë ofendim i tij. Në të vërtetë, është kufër i hapët, nga i cili kërkojmë strehim tek All-llahu! Nëse kjo u thuhet atyre, ata - pasha All-llahun - s'mund t'i përgjigjen kësaj, përpos të japin një replikë të cilën e dëgjojmë shumë herë me radhë nga disa prej këtyre: “Kemi lënë këtë sunnet duke i besuar imamit të medhhebit dhe ai është më i ditur se ne në Sunnet.”

Përgjigja jonë në këtë është nga shumë kënde, gjë që u diskutua gjerësisht në këtë hyrje. Për këtë shkak, do ta kufizoj veten shkurtimisht në një qasje me një përgjigje vendimtare, me lejen e All-llahut. Unë them: “Imami i medhhebit tuaj nuk është i vetmi i cili ishte më i ditur sesa ju në Sunnet. Në të vërtetë, janë duzina, bile qindra, të cilët po ashtu ishin më të ditur se ju në Sunnet. Prandaj, nëse ndodh që një sunnet autentik të ndryshojë nga medhhebi juaj, por është marrë nga njëri prej këtyre imamëve të tjerë, është qartë e domosdoshme për ju që ta pranoni këtë sunnet në këtë rast. Ai që ju kundërshton, do t'ju thotë duke ju kundërshtuar: “Ne vepruam me këtë Sunnet duke i besuar imamit i cili ka vepruar me këtë Sunnet”; në këtë rast, pasimi e imamit të parë është më meritues se pasimi i imamit që ka kundërshtuar këtë Sunnet.

Kjo është e qartë dhe aspak e ngatërruar, me dëshirën e All-llahut. Për shkak të gjithë kësaj që përmendëm, mund të them: Meqë ky libër yni ka përmbledhur sunnetet e vërteta të transmetuara nga i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në lidhje me përshkrimin e namazit të tij, nuk ka arsytim për askënd të mos veprojë me të, pasi nuk ka asgjë të cilën dijetarët e kanë refuzuar njëzëri, dhe nuk do ta bëjnë kurrë. Në të vërtetë, në çdo rast, disa prej tyre kanë përvetësuar Sunnetin e vërtetë; secili prej tyre që nuk ka vepruar kështu, është i falur dhe është shpërblyer një herë, sepse teksti nuk i qe përcjell atij fare, ose i qe përcjell atij në mënyrën që nuk paraqiste dëshmi për të, ose për shkaqe të tjera të njohura mirë në mesin e dijetarëve. Megjithatë, ata pas tij para të cilëve teksti është qartë i parashtruar, nuk kanë arsytim për ndjekjen e mendimit të tij; përkundrazi, është e obligueshme të pasohet teksti i pagabueshëm.

Kjo porosi ka qenë qëllimi i kësaj hyrjeje. All-llahu i Gjithëfuqishëm dhe i Lartësuar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اسْتَجِيبُوا لِلَّهِ وَلِلرَّسُولِ إِذَا دَعَاكُمْ لِمَا يُحْيِيكُمْ وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ يَحُولُ بَيْنَ الْمَرْءِ وَقَلْبِهِ وَأَنَّهُ إِلَيْهِ
تُحْشَرُونَ (24)

“O ju që besuat! Përgjigjuni thirrjes së All-llahut dhe të Dërguarit të Tij kur ju thërret në atë që ju jep jetë dhe ta dini se All-llahu ndërhyr ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij, dhe te ai do të tuboheni të gjithë.”⁷³

All-llahu e thotë të Vërtetën, Ai tregon Rrugën dhe Ai është Ndihmësi dhe Mbrojtësi më i mirë. All-llahu e bekoftë Muhammedin dhe familjen e tij dhe shokët e tij. Lavdërimi i goftë All-llahut, Zotit të botëve.

Muhammed Nasirud-Din El-Albani
Damask 20/5/1381h

⁷³ El-Enfal, 8: 24

FORMA E NAMAZIT E TË DËRGUARIT

[sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]

E PËRSHKRUAR PREJ FILLIMIT DERI NË FUND, SIKUR TË ISHIT DUKE E PARË

Shejh Muhamed Nasirudin el-Albani

“Faluni ashtu siç më keni parë mua duke u falur” (el-Buhari)

Të drejtuarit kah Qabja

Kur i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ngrihej në namaz, ai drejtohej kah qabja, si në namazin e detyrueshëm, ashtu edhe në atë vullnetar⁷⁴, dhe ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] urdhëroi për këtë, duke i thënë “atij që u fal keq”:⁷⁵

“Kur të ngrihesh për t’u falur, merr abdes siç është më së miri, pastaj drejtohu kah kibla dhe thuaje tekbirin.”⁷⁶

“Gjatë udhëtimit, ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i falte namazet vullnetare dhe vitrin hipur mbi kafshën shaluese, në çfarëdo anë që të kthehej ajo duke e bartur atë [kah lindja ose kah perëndimi].”⁷⁷

Andaj, thënia e All-llahut të Lartësuar:

فَإِنَّمَا تَوَلَّوْا فُتْمَ وَجْهِ اللَّهِ

“Kah cila anë që të ktheheni, është fytyra e All-llahut” (el-Bekare, 2: 115), i referohet kësaj.⁷⁸

“[Nganjëherë] kur donte t’i falte namazet e padetyrueshme në devenë e tij, e drejtonte atë kah kibla, thoshte tekbirin dhe falej në cilindo drejtim që të kthehej kafsha e tij.”⁷⁹

⁷⁴Ky është fakt *mutevatir*, prandaj detajet nuk janë të nevojshme. Megjithatë, disa argumente për të do të pasojnë.

⁷⁵ Shih Shtojcën 3.

⁷⁶ Përmbledhur nga Buhariu, Muslimi dhe Siraxhi.

⁷⁷ Përmbledhur nga Buhariu, Muslimi dhe Siraxhi. *Tahrir*hi i tij është dhënë në *Irva el-Galil* (289 dhe 588).

⁷⁸ Muslimi; Tirmidhiu e ka shpallur *sahih*.

⁷⁹ Ebu Davudi, Ibn Hibbani në *eth-Thikat* (1/12), ed-Dija në *el-Muhtarah* me *sened hasan*; Ibn es-Sukni e ka shpallur *sahih* sikurse Ibn el-Mulekkini në *Hulasah el-Bedr el-Munir* (22/1) dhe, para tyre, Abdul-Hakk el-Ishbiliu në *Ahkam*-in e tij (nr.1394 me kontrollimin tim). Ahmed-i e ka shfrytëzuar si dëshmi (argument), siç ka transmetuar Ibn hani prej tij në *Mesail*-in e tij (1/67).

“Ai bënte rukun dhe sexhden në devenë e tij, duke e ulur kokën dhe duke e bërë sexhden më poshtë se rukunë.”⁸⁰

“Kur ai donte t’i falte namazet e detyrueshme, zbriste poshtë dhe drejtohej kah kibla.”⁸¹

Në namazin gjatë frikës së madhe, ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i dha shembull ummetit të tij për t’u falur “duke ecur, duke qëndruar në këmbë ose duke qenë hipur mbi kafshë; duke qenë a duke mos qenë në drejtim të kiblës”⁸². Dhe ai, po ashtu, tha:

“Kur ato (ushtritë) takohen, atëherë ai (d.m.th. namazi) është tekbir dhe lëvizje me kokë”.⁸³

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], po ashtu, thoshte:

“Çka është ndërmjet lindjes dhe perëndimit është kible.”⁸⁴

Xhabiri [radijall-llahu anhu] ka thënë:

“Kur ishim njëherë me të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në një ekspeditë, qielli ishte i vrenjtur, prandaj ne u munduam ta gjenim kiblen, por nuk u pajtuam, kështu që secili prej nesh u fal në vete dhe secili prej nesh vendosi nga një shenjë para vetes, në mënyrë që ta shënonte pozitën e vet. Në mëngjes, ne i shikuam ato dhe pamë se nuk ishim falur kah kibla. Ia përmendëm këtë të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] [por ai nuk na urdhëroi që ta përsërisnim (namazin)], dhe tha: “**Namazi juaj mjafton.**”⁸⁵

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] falej në drejtim të Bejtul-Mukaddesit [duke pasur qaben para tij], para se të shpallej ajeti vijues:

قَدْ نَرَى تَقَلُّبَ وَجْهِكَ فِي السَّمَاءِ فَلَنُوَلِّيَنَّكَ قِبْلَةً تَرْضَاهَا فَوَلِّ وَجْهَكَ شَطْرَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ

“Ne shohim kthimin e fytyrës sate kah qielli...” (el-Bekare, 2: 144)

Kur u shpall kjo, ai u drejtua kah qabja. Ishin duke e falur sabahun njerëzit në Kuba, kur dikush u erdhi atyre dhe u tha:

⁸⁰ Ahmedi dhe Tirmidhiu, të cilët e kanë shpallur *sahih*.

⁸¹ Buhariu dhe Ahmedi.

⁸² Buhariu dhe Muslimi.

⁸³ Bejhekiu me *sened* që përmbush kriteret e Buhariut dhe të Muslimit.

⁸⁴ Tirmidhiu dhe Hakimi e kanë shpallur *sahih*, dhe unë e kam dhënë atë në *Irva el-Galil* (292), botimin e të cilit All-llahu e ka bërë të lehtë.

⁸⁵ Darekutni, Hakimi, Bejhekiu, Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Taberani; është dhënë në *Irva* (296).

“Vërtet, të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i është shpallur mbrëmë diç nga Kur’ani dhe është urdhëruar të drejtohet kah qabja. [Vërtet] pra, kthehuni kah ajo”. Fytyrat e tyre qenë të kthyera kah Shami, por ata u kthyen [edhe imami i tyre u kthye kah kibla së bashku me ta].”⁸⁶

⁸⁶ Buhariu, Muslimi, Ahmedi, Siraxhi, Taberaniu (3/108/2) dhe Ibn Sa’di (1/234). Gjendet po ashtu në *Irrva* (290).

Qëndrimi në këmbë gjatë namazit

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] qëndronte në këmbë si për namazin e detyrueshëm, ashtu edhe për atë vullnetar, duke e zbatuar urdhërin e të Lartësuarit:

وَقُومُوا لِلَّهِ قَانِتِينَ (238)

“Dhe qëndroni para All-llahut me respekt.” (el-Bekare, 2: 238)

Ndërsa, gjatë udhëtimit, ai falte namazet vullnetare në kafshën shaluese.

Ai i dha shembull umetit të tij për t’u falur gjatë frikës së madhe, duke ecur ose hipur në kafshë, siç është përmendur, dhe ky është qëllimi i thënies së All-llahut [subhanehu ve teala]:

حَافِظُوا عَلَى الصَّلَوَاتِ وَالصَّلَاةِ الْوُسْطَى وَقُومُوا لِلَّهِ قَانِتِينَ (238) فَإِنْ خِفْتُمْ فَرَجَلًا أَوْ رُكْبَانًا فَإِذَا أَمِنْتُمْ فَأَدْكُرُوا
اللَّهَ كَمَا عَلَّمَكُمْ مَا لَمْ تَكُونُوا تَعْلَمُونَ (239)

“Të jeni të rregullt në namaz, sidomos në namazin e mesëm⁸⁷ dhe...” (el-Bekare, 2: 238-9)

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] falej ulur gjatë sëmundjes nga e cila ai vdiq.”⁸⁸

Ai, gjithashtu, u fal ulur në një rast tjetër para këtij, kur qe lënduar, ndërsa njerëzit pas tij faleshin duke qëndruar në këmbë. Prandaj, ai u bëri nojmë (u bëri shenjë) atyre të uleshin dhe ata u ulën (dhe u falën). Kur e kreu. tha:

“Gati sa nuk bëtë atë që bëjnë persianët dhe romakët: qëndrojnë në këmbë për mbretin që rri ulur. Prandaj, mos veproni ashtu, sepse imami është që të përcillet: kur ai e bën rukunë, bëni ruku; kur ai ngrihet, ngrihuni dhe, kur ai falet ulur, faluni ulur (të gjithë)”.⁸⁹

Namazi i personit të sëmurë në pozitë të ulur

Imran ibn Husejni [radijall-llahu anhu] ka thënë:

⁸⁷ D.m.th., namazi i Ikindisë, sipas deklaratave të sakta të shumicës së dijetarëve, duke qenë në mesin e tyre edhe ebu Hanifa dhe dy nxënësit e tij. Ekzistojnë hadithe në lidhje me këtë, të cilat Ibn Kethiri i ka dhënë Tefsirin e tij të Kur'anit.

⁸⁸ Tirmidhiu, i cili e ka shpallur *sahih*, dhe Ahmedi.

⁸⁹ Muslimi dhe Buhariu, dhe është dhënë në librin tim *Irva el-Galil*, nën hadithin 394.

“Isha duke lënguar nga hemorroidet (majasëlli), andaj e pyeta të Dërguarin e All-lahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], dhe ai tha: “**Falu në këmbë. Nëse nuk mundesh, atëherë falu ulur; nëse nuk mundesh ashtu, atëherë falu shtrirë**”.⁹⁰

Imran ibn Husajni po ashtu ka thënë:

“E pyeta atë [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] për namazin e njeriut në pozitë të ulur, e ai tha: “**Ai që falet në këmbë, kjo është më mirë. Ai që falet ulur, shpërblimi i tij është përgjysmë më i vogël se i të mëparshmit. Ai që falet shtrirë (në një tjetër transmetim: gjysmë i shtrirë) e ka shpërblimin përgjysmë më të vogël se të atij që falet ulur.**”⁹¹

Kjo i referohet personit të sëmurë, ngase Enesi [radijall-llahu anhu] ka thënë:

“I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] u erdhi njerëzve ndërsa ata ishin duke u falur ulur, për shkak të sëmundjes, dhe tha: “**Vërtet, namazi i atij që ulet është (vlen) sa gjysma e namazit të atij që qëndron në këmbë**”.⁹²

Njëherë ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] vizitoi një person të sëmurë dhe e pa atë duke u falur (mbështetur) në një jastëk të cilin ia mori dhe e largoi anash. Atëherë, ky njeri mori një shkop për t’u falur, duke u mbështetur në të, por ai ia mori edhe atë dhe e largoi anash, dhe i tha:

“**Falu në tokë, nëse mundesh. Përndryshe, bëj lëvizjet me kokën tënde duke e bërë sexhden më poshtë se rukunë.**”⁹³

Namazi në anije

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] u pyet për namazin në anije dhe ai tha:

“**Faluni në të duke qëndruar në këmbë, nëse nuk i frikësoheni fundosjes**”.⁹⁴

Kur ai u plak, merrte diçka për t’u mbështetur në vendin e tij të faljes.⁹⁵

⁹⁰ Buhariu, Ebu Davudi dhe Ahmedi.

⁹¹ Ibid. Hattabiu ka thënë:

“Kuptimi i hadithit të Imranit ka për qëllim njeriun e sëmurë, që është i aftë t’i përballojë mundimet dhe të qëndrojë me vështirësi. Prandaj, shpërblimi i namazit ulur është përgjysmë më i vogël se shpërblimi i namazit në këmbë: duke e inkurajuar të falet në këmbë, por edhe duke e lejuar të ulet.”

Ibn Haxheri thotë në *Fet-h el-Bari* (2/468): “Ky deduksion është i vlefshëm.”

⁹² Ahmedi dhe Ibn Maxhe, me *sened sahih*.

⁹³ Taberaniu, Bezzari, Ibn es-Semaku në librin e tij të hadithit (67/2) dhe Bejhekiu. E ka *senedin sahih*, siç kam shpjeguar në *Silsileh el-Ehadith es-Sahihah* (323).

⁹⁴ Bezzari (68), Darekutniu, Abdul-Gani el-Makdisi në *Sunenin* e tij (82/2) dhe Hakimi e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

Ulja dhe qëndrimi në këmbë në namazin e natës (*Tehexhahud*)

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] falej shumë gjatë natës, duke qëndruar në këmbë dhe duke ndenjur ulur. Nëse këndonte në këmbë, ai e bënte (rukunë) në këmbë; nëse këndonte ulur, ai e bënte rukunë ulur.⁹⁶

Nganjëherë, “Ai falej dhe këndonte ulur, derisa të mbetnin rreth tridhjetë ose katërdhjetë ajete të këndimit të tij, pas çka ai ngrihej që t’i këndonte këto në këmbë, mandej e bënte rukunë dhe sexhden dhe bënte njësoj në rekatin e dytë.”⁹⁷

Në fakt, “ai falte *es-subhan*⁹⁸ ulur kah fundi i jetës së tij, kur u plak, dhe kjo ishte një vit para vdekjes së tij.”⁹⁹

Po ashtu, “ai ulej këmbëkryq.”¹⁰⁰

Namazi me këpucë të mbathura dhe urdhri për të bërë kështu

“Ai nganjëherë qëndronte (në namaz) këmbëzbathur, nganjëherë me këpucë.”¹⁰¹

Dhe ai e lejoi këtë për ummetin e tij duke thënë:

“Kur ndokush nga ju falet, duhet ose t’i mbathë këpucët, ose t’i zbathë ato dhe t’i vendosë midis këmbëve të tij dhe të mos i pengojë të tjerët me to.”¹⁰²

Ai e inkurajonte faljen me këpucë nganjëherë, duke thënë:

“Dallohuni nga hebrenjtë, sepse ata nuk falen me këpucë e as me mestet e tyre (çorapë lëkure) ”.¹⁰³

Ngandonjëherë ai i hiqte ato prej këmbëve duke u falur dhe pastaj e vazhdonte namazin, siç ka thënë Ebu Se’id El-Hudriu:

⁹⁵ Ebu Davudi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, siç ka bërë edhe Dhehebiu. E kam dhënë në *es-Sahihah* (319) dhe në *Irva* (383).

⁹⁶ Muslimi dhe Ebu Davudi

⁹⁷ Buhariu dhe Muslimi.

⁹⁸ D.m.th. namaz vullnetar (natën ose paradite), i emëruar kështu, ngase përmban *tesbih* (glorifikim).

⁹⁹ Muslimi dhe Ahmedi.

¹⁰⁰ Nesaiu, Ibn Huzejme në Sahihun e tij (1/107/2), Abdul-Gani el-Makdisi në *Sunnetin* e tij (80/1) dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

¹⁰¹ Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe. Është hadith *mutevatir*, siç ka cekur Tahaviu.

¹⁰² Ebu Davudi dhe Bezzari (53, *ez-Zeva'id*); Hakimi e ka shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

¹⁰³ Ibid.

“I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] u fal me ne një ditë. Gjersa ishte duke u falur, i zbathi këpucët e tij dhe i vendosi në anën e tij të majtë. Kur njerëzit e panë këtë, i zbathën këpucët e tyre. Kur e kreu namazin, ai tha: **“Pse i zbathët këpucët tuaja?”** Ata thanë: **“Të pamë ty duke i zbathur këpucët e tua, andaj edhe ne i zbathëm tonat.”** Ai tha: **“Vërtet, më erdhi Xhibrili dhe më njoftoi se kishte fëlliqësirë - ose tha: diçka të dëmshme - (në një transmetim tjetër: ndyrësirë) në këpucët e mia, andaj i zbatha ato. Pra, kur dikush nga ju shkon në xhami, duhet t’i shikojë këpucët e veta: nëse sheh në to fëlliqësirë - ose tha: diçka të dëmshme - (në një transmetim tjetër: ndyrësirë), duhet t’i pastrojë (me fërkim) dhe të falet me to.”**¹⁰⁴

“Kur i hiqte ato, ai i vendoste ato në të majtën e tij”¹⁰⁵, dhe, gjithashtu, thoshte:

“Kur ndokush nga ju falet, nuk duhet t’i vendosë këpucët e tij në të djathtën e tij e as në të majtën e tij, ku do të jenë në të djathtën e tjetërkujt, por vetëm nëse nuk është askush në të majtën e tij. Pra, duhet t’i vendosë ato midis këmbëve”.¹⁰⁶

Namazi në Minber

“Njëherë ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] u fal në minber (në një transmetim: “... i cili kishte tri shkallë”)¹⁰⁷. Kështu ai qëndroi në të dhe tha tekbirin dhe njerëzit pas tij e thanë tekbirit ndërsa ai ishte më minder. Pastaj bëri rukunë në minber e më pas u ngrit dhe zbriti prapa për ta bërë sexhden në minber. Pastaj u kthye, [dhe veproi në të ashtu siç veproi në rekatën e parë], derisa e kreu namazin. Pastaj, ai u kthye kah xhemati dhe tha:

“O njerëz! E bëra këtë që ju të më përcillni mua dhe ta mësoni namazin tim”.¹⁰⁸

¹⁰⁴ Ebu Davudi, Ibn Huzejme dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu Neveviu janë pajtuar. I pari është dhënë në *Irva* (284).

¹⁰⁵ Ibid.

¹⁰⁶ Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Huzejme (1/110/2), me *isnad sahih*.

¹⁰⁷ Është ky sunneti për minberin: që duhet t’i ketë vetëm tri shkallë. Të ketë më shumë është risi nga periudha e Beni Umejjes, gjë që shpesh shkakton ndërprerjen e safit. Dhe për t’i ikur kësaj me vendosjen e tij në këndin perëndimor të xhamisë ose në mihrab, është një bidat tjetër sikurse është edhe vendosja e tij në mur në formë ballkoni, në të cilin hipet me ndihmën e shkallëve në mur! Ndërsa, udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Shih *Fet-h el-Bari* (2/331).

¹⁰⁸ Buhariu, Muslimi (i cili mblodhi transmetimin tjetër) dhe Ibn Sa’di (1/253). Është dhënë në *Irva* (545).

Sutra¹⁰⁹ dhe Obligimi për të

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] qëndronte afër sutres, ashtu që ndërmjet tij dhe murit kishte (distancë) tre kut”¹¹⁰ dhe “ndërmjet vendit të sexhdes dhe murit (kishte) hapësirë aq sa për të kaluar një dele.”¹¹¹

Ai thoshte:

“Mos u falni ndryshe pos drejt sutres dhe mos lini askënd të kalojë para jush, por nëse ndokush vazhdon (të provojë për të kaluar), atëherë luftojeni atë, sepse ai e ka një shok (d.m.th. shejtanin) me vet.”¹¹²

Ai po ashtu thoshte:

“Kur të falet ndonjëri nga ju drejt sutres, le t’i afrohet asaj, që të mos e prish shejtani namazin e tij.”¹¹³

Nganjëherë “ai orvatej për t’u falur afër shtyllës, e cila gjendej në xhaminë e tij.”¹¹⁴

“Kur falej [në vend të hapur, ku nuk kishte asgjë për të përdorur si sutra], ai e ngulte një shtizë në tokë para tij dhe falej në drejtimin e saj, me njerëzit pas tij”,¹¹⁵

Nganjëherë “ai vendoste kafshën e tij anash dhe falej në drejtim të saj”,¹¹⁶ por kjo nuk është e njëjtë me faljen në vendpushimin e deveve¹¹⁷, gjë që “ai e ndalonte”¹¹⁸, dhe nganjëherë “ai e merrte shalën e tij, e vendoste për së gjati dhe falej kah fundi i saj.”¹¹⁹

Ai thoshte:

¹⁰⁹ Tekst, “perde, mbulesë”; në kontekstin e namazit, i referohet objektit menjëherë pas vendit të sexhdes, brenda të cilit asgjë nuk duhet të kalojë, siç është përimtuar në këtë pjesë.

¹¹⁰ Buhariu dhe Ahmedi.

¹¹¹ Buhariu dhe Muslimi.

¹¹² Ibn Huzejme në *Sahihun* e tij (1/93/1), me *sened* të fortë.

¹¹³ Ebu Davudi, Bezzari (f.54-Zevaid) dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu dhe Neneviu janë pajtuar.

¹¹⁴ Buhariu. Sutra është e domosdoshme për Imamin ose për personin që falet vetëm, madje edhe në xhami të madhe. Ibn Hani ka thënë në *Mesail*-in e tij nga Imam Ahmedi (1/66): “Ebu Abdull-llahu (d.m.th. Imam Ahmed ibn Hanbeli) më pa një ditë duke u falur pa sutre para meje e unë isha në një xhami të madhe, dhe më tha: “Merr diçka për sutre”, e unë e mora një njeri për sutre.” Kjo tregon se Imam Ahmedi nuk bënte dallim ndërmjet xhamisë së vogël ose të madhe në marrjen e sutres - dhe kjo është pa dyshim e saktë, por kjo është diç që shpërfilllet nga shumica e njerëzve, duke përfshirë edhe imamët e xhamisë, në çdo vend që kam vizituar, duke përfshirë edhe Arabinë Saudite, në të cilën kam bërë një udhëtim në muajin Rexheb të këtij viti (1410), prandaj ulemaja duhen t’u tregojnë njerëzve dhe t’i këshillojë ata rreth kësaj, duke ua shpjeguar vendimin e saj, si dhe obligimin e saj në Dy Xhamitë e Shenjta.

¹¹⁵ Buhariu, Muslimi dhe Ibn Maxhe.

¹¹⁶ Buhariu dhe Ahmedi.

¹¹⁷ D.m.th. vendi i tyre i gjunjëzimit.

¹¹⁸ Buhariu dhe Ahmedi.

¹¹⁹ Muslimi, Ibn Huzejme (92/12) dhe Ahmedi

“Kur ndonjëri nga ju vendos përballë vetes diçka siç është fundi i shalës, le të falet dhe le të mos brengoset nëse ndokush kalon pas saj”.¹²⁰

Njëherë “ai u fal drejt një druri”¹²¹, dhe nganjëherë “ai falej drejt shtratit, në të cilin Aishja [radijall-llahu anhu] ishte e shtrirë [nën mbulojën e saj]”.¹²²

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk linte asgjë të kalojë ndërmjet tij dhe sutres, kështu njëherë “ishte duke u falur, kur një dele erdhi me vrap para tij. Atëherë, ai nxitoi, (eci përpara) saqë e ngjeshi barkun e tij për muri [dhe ajo kaloi prapa tij]”.¹²³

Po ashtu, njëherë “derisa ishte duke e falur një namaz të detyrueshëm, e shtrëngoi grushtin e tij dhe kur e kreu, njerëzit e pyetën: “O i Dërguar i All-llahut, a ndodhi gjë gjatë namazit?” Ai tha: “Jo, përveçse djalli deshi të kalojë para meje e unë ia shtrëngova atij fytyrës, derisa e ndjeva të ftohët e gjuhës së tij në dorën time. Pasha All-llahun! Sikur të mos ma kishte kaluar vëllai im Sulejmani¹²⁴, unë do ta kisha lidhur (djallin) për njërën prej shtyllave të xhamisë, që fëmijët e Medines të mund të silleshin rreth tij. [Pra, kush mund të pengojë që diçka të ndërhyjë midis tij dhe kibles, le të veprojë ashtu]”.¹²⁵

Ai po ashtu thoshte:

“Kur ndokush nga ju falet drejt gjësendi, që është sutr ndërmjet tij dhe njerëzve, dhe dikush dëshiron të kalojë para tij, atëherë ai duhet ta shtyjë atë në fyt [dhe ta zmbarsë sa më shumë që mundet], (në një transmetim: ai duhet ta ndalë atë, dy herë), por nëse ai refuzon, ai duhet ta luftojë, sepse, me të vërtetë, ai është shejtan.”¹²⁶

¹²⁰ Muslimi dhe Ebu Davudi

¹²¹ Nesaiu dhe Ahmedi, me *isnad sahih*.

¹²² Buhariu, Muslimi dhe Ebu Ja'la (3/1107).

¹²³ Ibn Huzejme në *Sahihun* e tij (1/95/1); Taberaniu (3/140/3) dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*; Dhehebiu është pajtuar.

¹²⁴ Duke iu referuar lutjes që vijon të të Dërguarit Sulejman (alejhis-selam), së cilës iu përgjigj All-llahu, siç përshkruhet në Kur'an: “Zoti im! Më fal, dhe më dhuro pushtetin që nuk do t'i japësh askujt pas meje, sepse, vërtet, Ti je Dhuruesi i Begative. Kështu, Ne ia nënshtroam pushtetit të tij erën, e cila fryente lehtë sipas urdhërit të tij, dhe dajtë, çdo lloj ndërtuesi dhe zhytësi, dhe të tjerë të lidhur në pranga” (Sad 38: 35-38)

¹²⁵ Ahmedi, Darekutniu dhe Taberaniu, me *sened sahih*, dhe të ngjashme me kuptimin e këtij hadithi janë gjetur në dy *Sahihët* dhe te të tjerët nën autoritetin e disa Sahabëve. Është një prej shumë haditheve në të cilin grupi Kadijani nuk beson, pasi ata nuk besojnë në botën e xhinëve, e cila përmendet në Kur'an dhe Sunnet. Metoda e tyre e mospërfilljes së tekstit është e njohur mirë: nëse është nga Kur'ani, ata e ndërrojnë kuptimin e tij si p.sh. thënie e të Lartësuarit “Thua: Më është shpallur mua se një grup xhinësh dëgjuan” (72: 1); ata thonë: “d.m.th. një grup njerëzish”! duke e bërë fjalën “xhin” sinonime me “njeri”! Kështu, ata luajnë me gjuhë dhe me fe; nëse është nga Sunneti, atëherë nëse është e mundur për ta ndërruar me interpretim të rrejshëm, ata e bëjnë këtë, përndryshe ata e kanë shumë lehtë për ta shpallur të rrejshëm, edhe nëse të gjithë Imamët e Hadithit dhe i tërë ummeti pas tyre pajtohen në autenticitetin e tij, madje në të qenët e tij *mutevatir*. All-llahu i udhëzoftë.

¹²⁶ Buhariu dhe Muslimi, ndërsa transmetimi shtojcë është nga Ibn Huzejme (1/94/1).

Ai po ashtu thoshte:

“Sikur ta kishte ditur personi që ka kaluar para atij që falej mëkatin e vet, kishte qenë më mirë për të që të presë katërdhjetë, sesa të kalojë përpara”. (Ebu En-Nedri thotë: “Nuk më kujtohet saktësisht se a ka thënë katërdhjetë ditë, muaj, apo vite.”)¹²⁷

Çka e prish namazin

Ai thoshte:

“Namazi i njeriut ndërpritet, kur para tij nuk ka diçka siç është fundi i shalës, nga: gruaaja [me menstruacione]¹²⁸, gomari ose qeni i zi”. Ebu Dherri tha: “Unë i thashë: “O i Dërguar i All-llahut, pse qeni i zi e jo ai i kuq?” Ai tha: “Qeni i zi është shejtan”.¹²⁹

Ndalimi i faljes në drejtim të varrit

Ai ndalonte faljen në drejtim të varrit, duke thënë:

“Mos u falni në drejtim të varreve dhe mos u ulni në to.”¹³⁰

¹²⁷ Ibid.

¹²⁸ D.m.th. e pjekur, ndërsa ajo çka është menduar me “ndërpritet” është “bëhet i pavlefshëm”. Ndërsa sa i përket hadithit: “Asgjë nuk e ndërprejnë namazin”, atëherë është hadith i dobët, siç kam treguar në *Temam El-Minne* (f.306).

¹²⁹ Muslimi, Ebu Davudi dhe Ibn Huzejme (1/95/2).

¹³⁰ Ibid.

Qëllimi (nijeti)¹³¹

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thoshte:

“Të gjitha veprat janë sipas qëllimit dhe çdonjëri do ta ketë atë që ka pasur për qëllim”.¹³²

Tekbiri

Pastaj ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e fillonte namazin duke thënë:

((الله أكبر))

“All-llahu është më i Madhi”¹³³

Ai e urdhëroi “atë që u fal keq” të vepronte kështu, siç është përmendur më parë, dhe i tha atij:

“Me të vërtetë, namazi i personit nuk është i plotë, derisa ai të marrë abdest në të cilin janë përfshirë të gjitha pjesët e domosdoshme të trupit, dhe të thotë: “All-llahu Ekber”.¹³⁴

Ai, po ashtu, thoshte:

“Çelësi i namazit është pastrimi. Në të hyhet me tekbir dhe dilet me teslim.”¹³⁵

¹³¹ Neveviu thotë në *Revdah et-Talibin* (1/224):

“Nijeti është qëllimi. Kështu, personi që do të falet, sjell ndër mend atë namaz dhe atë çka është e rëndësishme nga karakteristikat e tij, si p.sh.: cili namaz është ai, a është i detyrueshëm etj., dhe ai i sjell këto gjëra bashkë në nijetin e tij me tekbirin e parë.”

¹³² Buhariu, Muslimi dhe të tjerët. Është dhënë në *Irvaa* (nr.22).

¹³³ Muslimi dhe Ibn Maxhe. Hadithi na tregon se ai nuk niste namazin me fjalët e disa njerëzve: “kam për qëllim të fal...etj.”, për çka, në të vërtetë, ekziston *ixhmaja* se kjo është risi (bidat). Por, ata nuk pajtohen në është bidat i mirë a i keq, për çka ne i themi: “Vërtet, të gjitha bidatet në adhurim janë lajthitje, nga përgjithësia e deklaratës së tij [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], “...dhe të gjitha risitë janë lajthitje, dhe çdo lajthitje është në zjarr”. Por, ky nuk është vendi për një diskutim më të gjerë të kësaj.

¹³⁴ Taberaniu me *isnad sahih*.

¹³⁵ Ebu Davudi, Tirimidhiu dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar. Është dhënë në *Irvaa* (nr.301).

Tekstualisht, “tekbiri i bën haram”, d.m.th. veprat të cilat All-llahu i ka bërë haram gjatë tij, “ndërsa teslimi i bën hallall” d.m.th. ato që lejohen jashtë namazit. Hadithi ashtu siç dëshmon, se dera e namazit është e mbyllur, duke mos mundur asnjë adhurues ta hapë ndryshe, përveçse me pastrim. Po kështu dëshmon se në namaz nuk mund të hyhet, përveçse me tekbir, dhe prej saj nuk mund të dilet, përveçse me teslim. Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve.

Po ashtu, “ai nginte zërin gjatë tekbirit, ashtu që ata prapa tij të mund ta dëgjonin.”¹³⁶

Por, “kur u sëmur, Ebu Bekri ngriste zërin për t’ua bartur njerëzve tekbirin e të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].”¹³⁷

Ai, po ashtu, thoshte:

“Kur të thotë imami: “All-llahu Ekber”, atëherë edhe ju thoni “All-llahu Ekber”.¹³⁸

¹³⁶ Ahmedi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur sahih, dhe Dhehebiu është pajtuar.

¹³⁷ Muslimi dhe Nesaiu

¹³⁸ Ahmedi dhe Bejhekiu, me isnad sahih.

Ngritja e duarve

Ai i ngrinte duart e tij nganjëherë me tekbir,¹³⁹ nganjëherë pas tekbitit¹⁴⁰ dhe nganjëherë para tij.¹⁴¹

“Ai i ngrinte ato me gishtërinj të ndarë [jo të hapur, as të bashkuar]”,¹⁴² dhe “i vinte në nivel me supet e tij”,¹⁴³ edhe pse herë-herë, “ai i ngrinte ato në nivel me veshët [majet] e tij.”¹⁴⁴

Vendosja e dorës së djathtë mbi dorën e majtë dhe urdhërimi për këtë

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] vendoste dorën e djathtë mbi dorën e tij të majtë”¹⁴⁵, dhe thoshte:

“Ne, shoqëria e të Dërguarve, jemi të urdhëruar ta shpejtojmë iftarin dhe ta vonojmë syfyryn dhe ta vendosim dorën e djathtë mbi të majtën gjatë namazit.”¹⁴⁶

Po ashtu, “ai kaloi pranë një njeriu që po falej dhe që kishte vënë dorën e majtë mbi të djathtën dhe ia ndau duart dhe ia vendosi të djathtën mbi të majtën.”¹⁴⁷

Vendosja e duarve në gjoks

“Ai e vendoste dorën e djathtë mbi shpinën e dorës së majtë, në kyq dhe në bylyzyk”¹⁴⁸, “dhe i urdhëronte shokët e tij të vepronin kësisoj”¹⁴⁹, dhe (nganjëherë) “ai e kapte me grusht dorën e majtë me të djathtën.”¹⁵⁰

¹³⁹ Buhariu dhe Nesaiu

¹⁴⁰ Ibid.

¹⁴¹ Buhariu dhe Ebu Davudi

¹⁴² Ebu Davudi, Ibn Huzejme (1/62/2, 64/1), Temmami dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih* dhe Dhehebiu është pajtuar.

¹⁴³ Buhariu dhe Nesaiu.

¹⁴⁴ Buhariu dhe Ebu Davudi.

¹⁴⁵ Muslimi dhe Ebu Davudi. Është dhënë gjithashtu në *Irva* (352).

¹⁴⁶ Ibn Hibbani dhe Ed-Dija, me *isnad sahih*.

¹⁴⁷ Ahmed i dhe Ebu Davudi, me *isnad sahih*.

¹⁴⁸ Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Huzejme (1/54/2), me *isnad sahih*, dhe Ibn Hibbani e ka shpallur *sahih* (485).

¹⁴⁹ Maliku, Buhariu dhe Ebu Avane.

¹⁵⁰ Nesaiu dhe Darekutni, me *isnad sahih*. Në këtë hadith, ekziston argumenti se shtrëngimi është sunnet, ndërsa në hadithin paraprak se edhe vendosja është gjithashtu e tillë, prandaj që të dyja janë sunnet. Sa i përket kombinimit të vendosjes dhe shtrëngimit, çka disa prej hanefive të mëvonshëm e konsiderojnë në rregull, atëherë ajo është risi; forma e saj, siç ata thonë, është të vendoset dora e djathtë mbi të majtën, duke e

“Ai i vendoste ato në gjoks.”¹⁵¹

Po ashtu, “ai ndalonte vendosjen e duarve në bel gjatë namazit [dhe e vuri dorën e tij në bel (që ta demonstrojë këtë)]”¹⁵². Kjo është “*silb*”, të cilin e ndaloi.¹⁵³

Shikimi në vendin e sexhdes dhe përulësia

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ulte kokën gjatë namazit dhe e përqendronte shikimin e tij në tokë”¹⁵⁴ - “gjersa ishte në Qabe, shikimi i tij nuk largohej nga vendi i sexhdes, derisa të dilte nga ajo”¹⁵⁵, dhe thoshte:

“Nuk është e përshtatshme të ketë diçka në Shtëpi, që do ta shqetësonte personin që falet.”¹⁵⁶

“Ai ndalonte të shikuarit lart në qiell”¹⁵⁷ dhe e theksonte aq shumë këtë ndalesë, sa që ka thënë:

mbajtur një e dorës me gishtin e vogël dhe të madhin, dhe shtrirja e tre gishtave të tjerë, siç shpjegohet në fusnotat e Ibn Abidinit në *Durr El-Muhtar* (1/454). Pra, mos u hutoni me atë çka ata thonë.

¹⁵¹ Ebu Davudi, Ibn Huzejme në *Sahihun* e tij (1/54/2). Ahmedi dhe Ebu Esh-Shejhu në *Tarih Asbehan* (f.125). Tirmidhiu e ka shpallur *hasen* njërin prej *isnadeve* të tij dhe kuptimi i tij është gjetur në *El-Muvatta* dhe në *Sahih El-Buhari*, nëse shikoni me kujdes. I kam shënuar plotësisht *isnadet* e këtij hadithi në librin tim “*Ahkam El-Xhenai*z” (f.118).

SHËNIME: Vendosja e duarve në gjoks është dëshmuar në Sunnet dhe krejt çka është në kundërshtim me të është ose *daife*, ose krejtësisht e pabazë. Në të vërtetë, Imami Is-hak ibn Rahevejhu ka vepruar sipas këtij sunneti, siç ka thënë Merveziu në *El-Mesail* (f.222):

“Is-haku falte vitrin me ne... ai i ngrinte duart në kunut dhe e bënte kunutin para rukusë, dhe i vendoste duart në gjoks ose menjëherë nën gjoks.”

E ngjashme është thënia e El-Kadi ‘ijad El-Malikiut në *Mustahabbat Es-Salah* në librin e tij “*El-I’lam*” (f.15, botimi i tretë, Rabat):

“Dorën e djathtë duhet vendosur në shpinën e së majtës, në pjesën e epërme të gjoksit.”

Afër kësaj është thënia e Abdull-llah ibn Ahmed ibn Hanbelit e transmetuar në *Mesaili*-in e tij (f.62):

“E kam parë se, gjatë namazit, im atë i vendoste duart njërin mbi tjetrën, mbi kërthizë.” Shih Shtojcën 4.

¹⁵² Buhariu dhe Muslimi. Është dhënë në *Irva* (374), sikurse edhe tjetri që vijon.

¹⁵³ Ebu Davudi, Nesaiu dhe të tjerë.

¹⁵⁴ Bejhekiu dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe është ashtu si ka thënë ai. Ka po ashtu një hadith përforcues të transmetuar nga dhjetë sahabë: transmetuar nga Ibn Asakiri (17/202/2). Shih në *El-Irva* (354).

NB: Këto dy hadithe tregojnë se sunnet është të përqendrohet shikimi në vendin e sexhdes në tokë, kështu që veprimi i disa adhuruesve të cilët i mbyllin sytë gjatë namazit, është devotshmëri e gabuar, sepse udhëzimi më i mirë është ai i Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

¹⁵⁵ Ibid.

¹⁵⁶ Ebu Davudi dhe Ahmedi, me *isnad sahih* (*El-Irva*, 1771); “Shtëpia” këtu nënkupton Qaben, siç tregon rasti i këtij hadithi.

¹⁵⁷ Buhariu dhe Ebu Davudi.

“Njerëzit duhen të përmbahen nga shikimi lart në qiell gjatë faljes, ose shikimi i tyre nuk do t’u kthehet (në një transmetim: ...ose shikimi i tyre do t’u cungohet).”¹⁵⁸

Në një hadith tjetër:

“Pra, kur të faleni, mos shikoni aty-këtu, ngase All-llahu vendos Fytyrën e Tij përball fytyrës së robit të Tij në namaz, përderisa ai nuk shikon tjetërkah”¹⁵⁹,

dhe ai gjithashtu ka thënë për shikimin tek-tuk,

“është grabitje të cilën djalli ia bën robit gjatë namazit”¹⁶⁰

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] poashtu ka thënë:

“All-llahu nuk pushon së kthyeri kah robi i Tij në namaz, përderisa ai nuk shikon përreth. Kur ai kthen fytyrën gjatë, All-llahu largohet prej tij”.¹⁶¹

Ai “ndaloi tri gjëra: të çukiturit si pulë, të ndenjurit galiç (*ik’a*) si qen dhe të shikuarit përreth si dhelpër”.¹⁶²

Ai po ashtu thoshte:

“Faleni namazin sikur të ishte i lamtumirës dhe sikur ta shihnit Atë, sepse, edhe nëse nuk e shihni Atë, Ai vërtet ju sheh ju”¹⁶³,

dhe

“Çdo person i cili gjatë namazit të detyrueshëm shquhet në abdesin, përlësinë dhe rukutë e tij, do të jetë kjo falje për mëkatet e vogla të mëparshme, përderisa nuk bën mëkat të madh, dhe kjo (mundësi) vlen për të gjitha kohët.”¹⁶⁴

Njëherë ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] u fal me një *Khamiseh*¹⁶⁵ dhe (gjatë namazit) ai shikoi në shenjat e saj. Kur e kreu, tha: “Merre këtë *khamiseh* timen dhe dërgoja Ebu

¹⁵⁸ Buhariu, Muslimi dhe Siraxhi.

¹⁵⁹ Tirmidhiu dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, *Sahih Et-Tergib* (nr.353).

¹⁶⁰ Buhariu dhe Ebu Davudi

¹⁶¹ Transmetuar nga Ebu Davudi dhe të tjerët. Ibn Huzejme dhe Ibn Hibbani e kanë shpallur *sahih*. Shih *Sahih Et-Tergib* (nr.555).

¹⁶² Ahmedi dhe Ebu Ja’la. Shih *Sahih Et-Tergib* (nr.556).

¹⁶³ Muhlisi në *Ehadith Muntekah*, Teberaniu, Rujaniu, Ed-Dija në *El-Muhtarah*, Ibn Maxhe, Ahmedi dhe Ibn Asakiri. Hejtemiu e ka shpallur *sahih* në *Esna El-Metalib*.

¹⁶⁴ Muslimi.

Xhehmit dhe ma sillni *enbixhanijjen* e tij¹⁶⁶, ngase ma ka larguar vëmendjen nga namazi (në një transmetim: ... sepse i shikova shenjat e saj gjatë namazit dhe për pak më vuri në sprovë).¹⁶⁷

Po ashtu, “Aishja kishte një pëlhurë me vizatime, të shtrira përgjatë *sehves*¹⁶⁸, drejt së cilës i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] u fal dhe pastaj tha: “*Largoje prej meje [sepse vizatimet e saj nuk pushuan së më penguari gjatë namazit]*.”¹⁶⁹

Ai po ashtu thoshte:

“Namazi nuk është i vlefshëm, kur ushqimi është shtruar e as kur vjen koha për t’u liruar prej dy ndyrësirave.”¹⁷⁰

¹⁶⁵ Veshmbathje nga leshi ose e përzier lesh me mëndafsh me shenja.

¹⁶⁶ Manto e vrazhdë pa shenja.

¹⁶⁷ Buhariu, Muslimi 7 Maliku. Është dhënë në *El-Irva* (376).

¹⁶⁸ “Një dhomë e vogël e ngulur pak në tokë, si kthinë e vogël ose dollap” (*Nihajeh*).

¹⁶⁹ Buhariu, Muslimi dhe Ebu Avane. I Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk ka urdhëruar shlyerjen ose grisjen e vizatimeve, por vetëm i ka larguar ato, sepse - All-llahu e di më së miri - ato nuk ishin vizatime të gjësendeve që kanë shpirt. Argument për këtë është se ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i ka grisur vizatimet e tjera, siç është dëshmuar në shumë transmetime në Buhari dhe në Muslim, dhe kushdo që dëshiron të hulumtojë këtë më tej, duhet ta konsultojë *Fet-h El-Bari-n* (10/321) dhe *Gajeh El-Meram fi Tahrixh Ehadiith El-Halal vel-Haram* (131-145).

¹⁷⁰ Buhariu dhe Muslimi.

Lutjet e hapjes (Duatë)

Më tej, ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e fillonte këndimin me shumë lloje duash, në të cilat ai e lavdëronte All-llahun e Lartësuar dhe e madhëronte Atë. Ai, në të vërtetë, e urdhëroi “atë që u fal keq” të vepronte kështu duke i thënë:

“Namazi i askujt nuk është i plotë, derisa ta thotë tekbinin, ta lavdërojë All-llahun e Gjithëfuqishëm dhe të Lartësuar dhe ta madhërojë Atë dhe të këndojë nga Kur'ani atë që i vjen më së lehti ...”¹⁷¹

Ai e thoshte ndonjërin nga duatë vijuese:

1. ((اللَّهُمَّ تَقْنِي مِنَ الْخَطَايَا كَمَا يُقْنِي الثُّوبُ الْأَبْيَضُ مِنَ الدَّنَسِ اللَّهُمَّ اغْسِلْ خَطَايَايَ بِالْمَاءِ وَالْتَجِ وَالْبَرْدِ)).

"O All-llah! Më largo nga mëkatet e mia siç e ke larguar Lindjen nga Perëndimi. O All-llah! Më pastro nga mëkatet e mia ashtu siç pastrohet pëlhuja e bardhë nga ndyrësira. O All-llah! Më pastro nga mëkatet e mia me ujë, akull dhe borë".

Ai e thoshte këtë në namazet e detyrueshme.¹⁷²

2. ((وَجَّهْتُ وَجْهِيَ لِلَّذِي فَطَرَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ حَنِيفًا [مُسْلِمًا] وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ لَا شَرِيكَ لَهُ وَبِذَلِكَ أُمِرْتُ وَأَنَا مِنَ الْمُسْلِمِينَ اللَّهُمَّ أَنْتَ الْمَلِكُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ [سُبْحَانَكَ وَبِحَمْدِكَ] أَنْتَ رَبِّي وَأَنَا عَبْدُكَ ظَلَمْتُ نَفْسِي وَاعْتَرَفْتُ بِذُنُوبِي فَاعْفُرْ لِي ذُنُوبِي جَمِيعًا إِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ وَاهْدِنِي لِأَحْسَنِ الْأَخْلَاقِ لَا يَهْدِي لِأَحْسَنِهَا إِلَّا أَنْتَ وَأَصْرِفْ عَنِّي سَيِّئَهَا لَا يَصْرِفُ عَنِّي سَيِّئَهَا إِلَّا أَنْتَ لِيُيَكِّفَ وَالسَّعْدَ فِي يَدَيْكَ وَالشَّرَّ لَيْسَ إِلَيْكَ [وَالْمَهْدِي مِنْ هَدَيْتِ] أَنَا بِكَ وَالْإِيكَ [لَا مَنجَا وَلَا مَلْجَأَ مِنْكَ إِلَّا إِلَيْكَ] تَبَارَكْتَ وَتَعَالَيْتَ أَسْتَغْفِرُكَ وَأَتُوبُ إِلَيْكَ)).

"Kam kthyer fytyrën drejt Krijuesit të qiejve dhe të tokës singërisht [në Islam] dhe unë nuk jam nga mesi i mushrikëve. Vërtet, namazi im, flija ime, jeta ime dhe vdekja ime janë për All-llahun, Zotin e Botëve: i Cili nuk ka shok. Në këtë jam urdhëruar dhe unë jam i pari prej muslimanëve (që i nënshtrohen Atij) ¹⁷³. O Allah! Ti je Mbreti, askush nuk ka të drejtë të adhurohet pas Teje, [Ti je më i Përsosuri dhe të gjitha Lavdërimet të takojnë Ty] Ti je Zoti im dhe unë jam robi

¹⁷¹ Buhariu, Muslimi dhe Ibn Ebi Shejbe (12/110/2). Është dhënë në *El-Irva* (nr.8).

¹⁷² Ebu Davudi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

¹⁷³ Kështu është në shumicën e transmetimeve; në disa është “*ve ene minel-muslimin*” (Unë jam prej muslimanëve). Kjo është më parë për shkak të gabimit të ndonjë transmetuesi, dhe argumente të tjera tregojnë në këtë, prandaj adhuresi duhet të thotë: *ve ene ev-velul-muslimin* (“Unë jam i pari i muslimanëve”). Nuk ka asgjë të parregullt në këtë, përkundër asaj çka disa njerëz thonë nën përshtypjen se kjo do të thotë “Unë jam njeriu i parë që kam këtë cilësi, ndërsa të tjerët nuk e kanë.” Por nuk është ashtu. Kjo frazë, në të vërtetë, paraqet garën në përmbushjen e urdhrave - e ngjashme me këtë është “**Thuaj: nëse Zoti i mëshirshëm ka fëmijë, unë jam i pari i adhuresve**” (Zuhruf 43: 81), dhe thënia e Musait (alejhis-selam) “dhe unë jam i pari i besimtarëve.” (A ‘raf 7: 143)

Yt.¹⁷⁴ I kam bërë dëm vetes dhe i kam pranuar mëkatet e mia, pra m'i fal të gjitha mëkatet e mia, se askush nuk i fal mëkatet pos Teje. Më udhëzo në karakterin më të mirë, në të cilin nuk mund të udhëzojë kush pos Teje, dhe më ruaj nga karakteri i keq, nga i cili nuk mund të shpëtojë kush pos Teje. Jam këtu dhe i lumtur të shërbej Ty¹⁷⁵. E gjithë e mira është në duart e Tua, ndërsa e keqja nuk është prej Teje¹⁷⁶ [i udhëzuar është ai të cilin e ke udhëzuar Ti]. Ekzistoj me vullnetin Tënd dhe Ty të përkas [Nuk ka ikje dhe strehim nga Ti, përveç se te Ti]. Ti je i bekuar dhe i lartësuar. Kërkoj faljen Tënde dhe Ty të pendohem".

Ai e thoshte këtë në namazet e detyrueshme dhe në ato vullnetare.¹⁷⁷

3. E ngjashme me atë paraprake, por vetëm pa "Ti je Zoti im e unë jam robi Yt..." deri në fund, me shtesat që pasojnë:

"O All-llah! Ti je Mbreti, s'ka zot që meriton të adhurohet pos Teje, i Lavdëruar dhe i Falënderuar qofsh Ti".¹⁷⁸

4. E ngjashme me atë nën 2, deri te "...dhe unë jam i pari nga muslimanët", duke shtuar:

¹⁷⁴ Ez-heriu ka thënë: d.m.th. "Unë nuk adhuroj asgjë tjetër pos Teje."

¹⁷⁵ *Lebbejk*: Dëgjesa ndaj teje është e vazhdueshme dhe e patundur; *sa 'dejk*: jashtëzakonisht i lumtur nën urdhrin Tënd, dhe duke pasuar me devotshmëri dinin të cilin Ti e zgjodhe.

¹⁷⁶ D.m.th. E keqja nuk mund t'i atribuohet All-llahut, sepse nuk ka gjë të keqe në Veprat e Tij, sepse ato janë të gjitha të mira, duke u nisur nga drejtësia, nga mëshira, deri te urtësia, të gjitha këto janë të mira, pa të keqe në to. Por e keqja është e keqe, sepse nuk mund t'i atribuohet All-llahut. Ibn El-Kajjimi (rahimehull-llah) ka thënë:

"Ai është Krijuesi i së mirës dhe i së keqes, por e keqja ekziston në disa prej krijesave të Tij, e jo në aktin e Tij të krijimit, e as në Veprat e Tij. Prandaj i Lartësuari është i pastër prej çdo *dhulmi*, që në thelb do të thotë të vendoset diçka në një vend jo të duhur. Ai nuk vë asgjë përveçse në vendin e tij adekuat; e tërë kjo pra është e mirë. Por e keqja është të vendoset diçka në një vend tjetër, e jo në vendin e tij të duhur: kur të vendoset në vendin e duhur, atëherë nuk është e keqe. Pra, ji i sigurt se e keqja nuk është prej Tij... Por nëse thuhet: Pse Ai ka krijuar diçka që është e keqe? Unë do të thosha: Ai e bëri krijimin dhe vepra e Tij është e mirë, jo e keqe, ngase krijimi dhe vepra janë prej All-llahut dhe është e pamundur që e keqja të jetë me Të, ose t'i atribuohet Atij. Çfarëdo e keqe në të krijuarën, nuk mund t'i vishet All-llahut, por vepra dhe krijimi mund t'i atribuohen Atij, pra ato janë të mira."

Pjesa tjetër e këtij diskutimi të rëndësishëm, si dhe konkluzioni i tij mund të gjendet në librin e tij *Shifa El-'Alil fi Mesail El-Kada vel-Kader vet-Ta'il* (fq. 178-206).

¹⁷⁷ Muslimi, Ebu Avane, Ebu Davudi, Nesaiu, Ibn Hibbani, Ahmed, Shafiu dhe Taberaniu; ata që e kufizojnë vetëm në ndonjë namaz të caktuar gabojnë.

¹⁷⁸ Nesaiu me *isnad sahih*

"O All-llah, më udhëzo në karakterin më të mirë dhe në veprat më të mira, në të cilat nuk mund të udhëzojë kush pos Teje, dhe më ruaj nga karakteri dhe veprat e liga, prej të cilave askush nuk mund të shpëtojë (të tjerët) pos Teje".¹⁷⁹

5. ((سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ وَتَبَارَكَ اسْمُكَ وَتَعَالَى جَدُّكَ وَلَا إِلَهَ غَيْرُكَ))

"I patëmeta je Ti,¹⁸⁰ O All-llah, dhe i Lavdëruar;¹⁸¹ Emri Yt është i bekuar;¹⁸² Madhështia Jote¹⁸³ është e lartësuar dhe askush s'ka të drejtë të adhurohet pos Teje.¹⁸⁴

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] gjithashtu ka thënë:

"Vërtet, fjalët më të dashura tek All-llahu janë kur robi i tij thotë: "I patëmeta je Ti, o All-llah..."¹⁸⁵

6. E ngjashme me atë pararendëse, duke shtuar në namazin e natës:

"Nuk meriton të adhurohet askush tjetër pos All-llahut", tri herë.

7. ((اللَّهُ أَكْبَرُ كَبِيرًا وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا وَسُبْحَانَ اللَّهِ بُكْرَةً وَأَصِيلًا))

"All-llahu është më i Madhi, më Madhështori. Falënderimet i qofshin All-llahut përherë. I Lavdëruar është All-llahu, çdo mëngjes dhe mbrëmje". Njëri nga sahabët filloi me këtë, për të cilën i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: "Për mrekulli! Dyert e qiejve janë hapur për të."¹⁸⁶

8. ((الْحَمْدُ لِلَّهِ حَمْدًا كَثِيرًا طَيِّبًا مُبَارَكًا فِيهِ))

¹⁷⁹ Nesaiu dhe Darekutniu, me *isnad sahih*.

¹⁸⁰ D.m.th. të lartësoj Ty, që do të thotë të konsideroj të patëmetë.

¹⁸¹ D.m.th. jemi të nënshtuar në lavdërimin Tënd.

¹⁸² D.m.th. bekimet e Emrit Tënd janë të mëdha, sepse mirësi e madhe buron nga përkujtimi i Emrit Tënd.

¹⁸³ D.m.th. Fama dhe Madhështia Jote.

¹⁸⁴ Ebu Davudi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar. El-'Ukajli ka thënë (fq.103): "Kjo është transmetuar nëpërmjet disa rrugëve, me *isnade* të mira." Është dhënë në *El-Irva* (nr.341). transmetuar nga Ibn Mende në *et-Tehvid* (123/2) me *sened sahih*, dhe nga Nesaiu në *El-Jevm bel-Lejleh* si *mevkuf* dhe *merfu*, sikur në *Xhami' El-Mesaniid* të Ibn Kefirit (vëll.3 pjesa 2 faqe 235/2).

¹⁸⁵ Ebu Davudi dhe Tahaviu, me *sened hasen*.

¹⁸⁶ Muslimi dhe Ebu Avane; i shpallur *sahih* nga Tirmidhiu. Ebu Nu'jami po ashtu e ka transmetuar në *Ahbar Asbehan* (1/210) nga Xhubejr ibn Mut'ami, i cili e ka dëgjuar të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] duke e thënë në namaze nafile.

"Lavdërimi i qoftë All-llahut, lavdërimi të shumëta, të pastra dhe të bekuara". Një njeri tjetër filloi me këtë, për të cilën ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: "I pashë dymbëdhjetë engjëj që nxitonin se cili prej tyre më parë do ta ngrejë lart."¹⁸⁷

9. ((اللَّهُمَّ لَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ نُورُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ قِيَمُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ مَلِكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ الْحَقُّ وَوَعْدُكَ الْحَقُّ وَقَوْلُكَ الْحَقُّ وَلِقَاؤُكَ حَقٌّ وَالْجَنَّةُ حَقٌّ وَالنَّارُ حَقٌّ وَالسَّاعَةُ حَقٌّ وَالنَّبِيُّونَ حَقٌّ وَ مُحَمَّدٌ حَقٌّ اللَّهُمَّ لَكَ أَسْلَمْتُ وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ وَبِكَ آمَنْتُ وَإِلَيْكَ أُنَبِّتُ وَبِكَ خَاصَمْتُ وَإِلَيْكَ حَاكَمْتُ أَنْتَ رَبُّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ فَاعْفُ عَنِّي مَا قَدَّمْتُ وَمَا أَخَّرْتُ وَمَا أَسْرَرْتُ وَمَا أَعْلَنْتُ وَمَا أَنْتَ أَعْلَمُ بِهِ مِنِّي أَنْتَ الْمَقْدَمُ وَأَنْتَ الْمُؤَخَّرُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِكَ))

"O All-llah, Ty të takojnë të gjitha lavdërimet. Ti je Drita¹⁸⁸ e qiejve dhe e tokës dhe e gjithë asaj çka ka në to. Ty të takojnë të gjitha lavdërimet. Ti je Mbikëqyrësi¹⁸⁹ i qiejve dhe i tokës dhe i gjithë asaj çka ka në to. [Ty të takojnë të gjitha lavdërimet. Ti je Mbreti i qiejve dhe i tokës dhe i gjithë asaj që ka në to]. Ty të takojnë të gjitha lavdërimet. Ti je Hakku.¹⁹⁰ Premtimi Yt është hakk. Fjala Jote është hakk. Takimi me Ty është hakk. Xhenneti është hakk. Zjarri është hakk. O All-llah! Ty të jam nënshtuar. Në Ty jam mbështetur. Në Ty kam besuar. Ty të jam kthyer. Për hir Tëndin kam luftuar. Ty të jam drejtuar për gjykim [Ti je Zoti ynë dhe te Ti është përfundimi i të gjitha udhëtimeve. Pra, m'i fal mëkatet e mëhershme dhe të mëvonshmet; atë që kam fshehur dhe atë që kam shfaqur] [dhe çdo gjë që di për mua më shumë se unë] Ti je Përsheptuesi dhe Ti je Vonuesi; [Ti je Zoti im] dhe askush nuk ka të drejtë të adhurohet pos Teje.¹⁹¹ [dhe nuk ka pushtet e as fuqi pa Ty]".

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e thoshte këtë dua në namazin e natës, sikurse që e thoshte edhe duanë vijuese: ¹⁹²

10. ((اللَّهُمَّ رَبَّ جِبْرَائِيلَ وَمِيكَائِيلَ وَإِسْرَافِيلَ فَاطِرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ عَالِمَ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ أَنْتَ تَحْكُمُ بَيْنَ مَنْ يَخْتَلِفُونَ اهْدِنِي لِمَا اخْتَلَفَ فِيهِ مِنَ الْحَقِّ بِإِذْنِكَ إِنَّكَ تُهْدِي مَنْ تَشَاءُ إِلَى صِرَاطٍ عَبْدِكَ فِيمَا كَانُوا فِيهِ مُسْتَقِيمٍ))

"O All-llah! Zot i Xhebrailit, Mikailit dhe Israfil! Krijues i qiejve dhe i tokës! Njohës i së fshehtës dhe i së dukshmes! Ti je Ai që do të gjykosh mes robërve të Tu në çështjet që ata nuk pajtoheshin. Më udhëzo me Mëshirën Tënde, në të

¹⁸⁷ Muslimi dhe Ebu Avane.

¹⁸⁸ D.m.th. Ti je Dritëdhënësi i tyre, dhe ata në to janë të udhëzuar nga Ti.

¹⁸⁹ D.m.th. Mbrojtës dhe Kujdestar i përhershëm mbi ta

¹⁹⁰ Hakk: e vërtetë, realitet.

¹⁹¹ Buhariu, Muslimi, ebu Avane, Ebu, Ibn Nasri dhe Darimiu.

¹⁹² Edhe pse kjo qartë nuk përjashton mundësinë e përdorimit të tyre në namazet e detyrueshme gjithashtu, përveç për imamin, që ai të mos e zgjasë namazin për ata që e përcjellin.

vërtetën e asaj për çka ata nuk pajtoheshin, sepse, vërtet, Ti e udhëzon këdo që dëshiron në rrugën e drejtë".¹⁹³

11. ((اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي وَاهْدِنِي وَارْزُقْنِي [وَعافني]) (عَشْرًا)
((اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الضَّيْقِ يَوْمَ الْحِسَابِ)) (عَشْرًا)

Ai thoshte tekbinin, tahmidin, tesbihin, tehlilin dhe istigfarin, secilin nga dhjetë herë e pastaj thoshte:

"O All-llah! Më fal dhe më udhëzo dhe më jep mirëmbajtje dhe [mos i shiko mëkatet e mia]" dhjetë herë, pastaj thoshte:

"O All-llah! Kërkoj strehë te Ti nga vështirësia e Ditës së Llogarisë", dhjetë herë.¹⁹⁴

12. ((اللَّهُ أَكْبَرُ ثَلَاثًا) دُوَ الْمَلَكُوتِ وَالْجَبَرُوتِ وَالْكِبْرِيَاءِ وَالْعَظَمَةِ))

"All-llahu është më i Madhi [tri herë], Posedues i Mbretërisë, i Fuqisë, i Madhësisë dhe i Pushtetit."¹⁹⁵

¹⁹³ Muslimi dhe Ebu Avane

¹⁹⁴ Ahmedi, Ibn Ebi Shejbi (12/119/2), Ebu Davudi dhe Taberaniu në *Mu'xhem El-Evsad* (62/2) me një *isnad sahih* dhe një tjetër *hasen*.

¹⁹⁵ Tajalisi dhe Ebu Davudi, me *sened sahih*.

Këndimi

Pastaj, ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] kërkonte strehim tek All-llahu i Lartësuar, duke thënë:

((أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ مِنْ هَمَزِهِ وَنَفْخِهِ وَنَفْثِهِ))

"Kërkoj strehim tek All-llahu nga shejtani i mallkuar, nga çmenduria e tij¹⁹⁶, nga arroganca e tij dhe nga poezia e tij"¹⁹⁷. Nganjëherë i shtonte kësaj, duke thënë: .

((أَعُوذُ بِاللَّهِ السَّمِيعِ الْعَلِيمِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ مِنْ هَمَزِهِ وَنَفْخِهِ وَنَفْثِهِ))

"Kërkoj strehë tek All-llahu, i Gjithëdëgjueshmi, i Gjithëdijshtmi, nga shejtani..."¹⁹⁸

Pastaj këndonte:

((بِاسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ))

Në emër të All-llahut, Mëshirëmadhit, Mëshirëbërësit por jo me zë të lartë.¹⁹⁹

Këndimi i ajeteve një nga një

Pastaj, ai këndonte suren El-Fatiha dhe ndante këndimin e tij, duke i kënduar ajetet një nga një. Ai thoshte:

(1) بِاسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

[këtu pushonte, pastaj thoshte:]

(2) الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

[pastaj pushonte, pastaj thoshte:]

¹⁹⁶ Tri fjalët arabe *hemz*, *nef* dhe *nefth*, u interpretuan kështu nga transmetuesi; të tria këto interpretime po ashtu janë transmetuar nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] me isnad *mursel sahih*. Me "poezi" këtu nënkuptohet poezia e kotë, sepse i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

"Vërtetë disa poezi janë urtësi" (Buhariu).

¹⁹⁷ Ebu Davudi, Ibn Maxhe, Darekutni dhe Hakimi, të cilët së bashku me Ibn Hibbanin dhe Dhehebiun e kanë shpallur *sahih*. Është dhënë në *Irva El-Galil* (342)

¹⁹⁸ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, me isnad *hasen*. Ahmed i ka përkrahur (*Mesa'ili* i Ibn Hanit 1/50)

¹⁹⁹ Buhariu, Muslimi, Ebu Avane, Tahaviu dhe Ahmed i.

(3) الرَّحْمَانُ الرَّحِيمُ

[pastaj pushonte, pastaj thoshte:]

(4) مَالِكِ يَوْمَ الدِّينِ

... dhe kështu me radhë, deri në fund të sures. Pjesa tjetër e këndimit të tij ishte e njëjtë: duke u ndalur në fund të ajetit dhe duke mos e bashkuar atë me ajetin tjetër.²⁰⁰ Nganjëherë ai këndonte:

(4) مَالِكِ يَوْمَ الدِّينِ

(Mbret i Ditës së Gjykimit) në vend të (Mbizotërues i Ditës së Gjykimit).²⁰¹

Domosdoshmëria e El-Fatiha-së dhe rëndësia e saj

Ai fuqishëm theksonte rëndësinë e kësaj sureje duke thënë:

“Nuk është falur ai i cili nuk ka kënduar [në të] Kaptinën Hapëse të Librit [së paku]”,²⁰²

dhe në një thënie tjetër:

“Ai namaz në të cilin nuk këndon Kaptinën Hapëse të Librit,²⁰³ nuk është i mjaftueshëm.”

Ai po ashtu ka thënë:

“Ai i cili fal një namaz në të cilin nuk këndon Kaptinën Hapëse të Librit, atëherë ai (d.m.th. namazi) është i mangët, i paplotë.”²⁰⁴

²⁰⁰ Ebu Davudi dhe Sehmiu (64-65); Hakimi e ka shpallur sahih, ndërsa Dhehebiu është pajtuar. Është dhënë në El-Irva (343). Ebu Amr Ed-Daniu e ka transmetuar në El-Muktefa (5/2), dhe ka thënë: “Ky hadith ka shumë rrugë, dhe kjo është ajo nga çka varet në këtë aspekt, dhe disa nga imamët e mëparshëm dhe nga kënduesit (e Kur'anit) preferenin ndaljen në çdo ajet, edhe nëse janë të lidhura (në kuptim) me njëra-tjetrën. “Unë them: Ky është sunnet, i cili është lënë pas dore nga shumica e kënduesve të kësaj kohe, e mos t'i përmendim të tjerët.

²⁰¹ Temam Er-Raziu në El-Feva'id, Ibn Ebi Davudi në El-Mesahif (7/2), Ebu Nua'jmi në Ahbar Azbehan (1/104) dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur sahih, ndërsa Dhehebiu është pajtuar. Të dyja këto këndime janë mutevatir.

²⁰² Buhariu, Muslimi, Ebu Avane dhe Bejhekiu. Është dhënë në El-Irva (302)

²⁰³ Darekutniu, i cili e ka shpallur sahih, dhe Ibn Hibbani në Sahihun e tij. Poashtu gjendet në El-Irva (302).

²⁰⁴ Muslimi dhe Ebu Avani

Ai po ashtu ka thënë:

“All-llahu i Bekuar dhe i Lartësuar ka thënë: “E kam ndarë namazin²⁰⁵ ndërmjet Meje dhe robit Tim në dy gjysma: gjysma e parë është për Mua, e gjysma tjetër është për robin Tim dhe robi Im do të ketë atë që e ka kërkuar.” Pastaj i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: “Kur robi thotë “Lavdërimi i takon All-llahut, Zotit të botëve”; All-llahu i Lartësuar thotë: “Robi im më ka lavdëruar”, kur robi thotë: “Mëshirëmadh, Përdëllestar”; All-llahu thotë “Robi im më ka lartësuar”. Kur robi thotë: “Sunduesi i Ditës së Gjykimit”; All-llahu i Lartësuar thotë: “Robi im më ka madhëruar.” Kur robi thotë: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë”; [Ai thotë:]: “Kjo është ndërmjet Meje dhe robit Tim, dhe ai do ta ketë atë që e ka kërkuar.” Kur robi thotë: “Na udhëzo në rrugë të drejtë, në rrugën e atyre të cilët i ke bekuar e jo në rrugën e atyre të ndaj të cilëve je i hidhëruar, e as në të atyre që kanë lajthitur.” [Ai thotë]: “Të gjitha këto janë për robin Tim dhe robi Im do ta ketë atë që e ka kërkuar.”²⁰⁶

Ai po ashtu thoshte:

“All-llahu [subhanehu ve teala] nuk ka shpallur në Tevrat e as në Inxhil asgjë të ngjashme me Nënën e Kur'anit. Ajo është Shtatëshja e Shpesh-Përsëritur.²⁰⁷ [dhe Këndimi Madhështor që më është dhënë mua].”²⁰⁸

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e urdhëroi “atë që u fal keq” që ta këndonte atë në namazin e tij,²⁰⁹ por i tha atij që nuk mund ta mbante në mend të thoshte:

(Dëshmoj se All-llahu është i pastër prej të metave; Të gjitha lavdërimet i qofshin All-llahut; askush s’ka të drejtë të adhurohet pos All-llahut; All-llahu është më i Madhi; nuk ka pushtet e as fuqi pa All-llahun).²¹⁰

Ai po ashtu i tha atij “që u fal keq”:

²⁰⁵ D.m.th. suren El-Fatiha. Është shembull i të shprehurit që përfshin tërë namazin, por duke pasur qëllim vetëm një pjesë, si mënyrë e theksimit të asaj pjese.

²⁰⁶ Muslimi, Ebu Avane dhe Maliku, dhe Sehmiu ka një hadith mbështetës të Xhabirit në Tarih Xhurxhan (144)

²⁰⁷ Baxhiu ka thënë:

“Ai është duke iu referuar thënies së të Lartësuarit “**Dhe ne ta kemi thënë Shtatëshen e Shpesh-Përsëritur dhe Këndimi Madhështor**” (Hixhr, 15: 87). Është emëruar “shtatëshja”, sepse ka shtatë ajete dhe “e shpesh-përsëritur”, sepse përsëritet vazhdimisht në namaz. Është quajtur “këndim madhështor” që ta veçojë këtë emër për të edhe pse çdo pjesë e Kur'anit është këndim madhështor; Njësoj me këtë, Kabja është “Shtëpia e All-llahut”, edhe pse të gjitha shtëpitë i përkasin All-llahut; kjo është për shkak të veçimit dhe të theksimit të rëndësisë së saj.”

²⁰⁸ Nesaiu dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

²⁰⁹ Buhariu në artikullin e tij për “Këndimin pas Imamit”, me një sened *sahih*.

²¹⁰ Ebu Davudi, Ibn Huzejme (1/80/2), Hakimi, Taberaniu dhe Ibn Hibbani, të cilët së bashku me Hakimin e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar. Është dhënë në *El-Irva* (303).

“Nëse di gjë nga Kur'ani, atëherë këndoje, përndryshe lavdëroje All-llahun, deklamoje Madhështinë e Tij dhe deklamo se s'ka kush të drejtë të adhurohet pos All-llahut.”²¹¹

Shfuqizimi i këndimit pas imamit në namazet me zë

Ai u pati lejuar atyre që faleshin pas Imamit ta këndojnë Suren El-Fatiha në namazet me zë, mirëpo njëherë: “Ishte duke e falur Sabahun dhe këndimi iu vështirësua. Kur e kreu tha: “**Ndoshta ju këndon pas Imamit**”. Ne i thamë: “Po, duke shpejtuar²¹², o i Dërguar i All-llahut”. Ai tha: “**Mos veproni ashtu, përveçse [çdokush prej jush ta këndojë] Kaptinën Hyrëse të Librit, sepse namazi nuk është i vlefshëm për njeriun i cili nuk e këndon atë.**”²¹³

Më vonë, ai ua ndaloi këndimin në namazet me zë, kur: “Ai kreu namazin, në të cilin ishte duke kënduar me zë (në një transmetim: ishte namazi i sabahut) dhe tha: “**A ishte duke kënduar dikush prej jush bashkë me mua pak më parë?!**” Njëri tha: “Po, unë o i Dërguar i All-llahut.” Ai tha: “**Unë them, pse jam i sfiduar?!**” [Ebu Hurejre tha:] “Kështu, njerëzit e ndërprejnë të kënduarit me të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], kur ai këndonte me zë, pasi e dëgjuan këtë [por këndonin në vete heshtazi, kur imami nuk këndonte me zë].”²¹⁴

Ai po ashtu heshtjen gjatë këndimit të imamit e bëri si pjesë të plotësisë së përcjelljes së imamit, duke thënë: “**Imami është për t'u përcjellë, pra, kur të thotë ai tekbinin, thojeni edhe ju; kur ai këndon, heshtni,**”²¹⁵ ashtu siç e bëri dëgjimin e këndimit të imamit të mjaftueshëm, e duke mos pasur nevojë të këndohet pas tij, duke thënë: “**Ai që ka imam, këndimi i imamit është këndim edhe për të**”²¹⁶ - kjo sa i përket namazeve me zë.

²¹¹ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, të cilët e kanë shpallur *hasen*; senedi i tij është *sahih*. (*Sahih Ebi Davud* nr.807)

²¹² *Hedhden*; duke kënduar shpejt, e që do të thotë duke u ngutur ose duke nxituar.

²¹³ Buhariu në broshurën e tij, Ebu Davudi dhe Ahmedi. Tirmidhiu dhe Darekutni e kanë shpallur *hasen*.

²¹⁴ Maliku, Humejdiu, Buhariu në broshurën e tij, Ebu Davudi dhe Mehameliu (6/139/1). Tirmidhiu e ka shpallur *hasen*; Ebu Hatim Er-Raziu, Ibn Hibbani dhe Ibn Kajjimi e kanë shpallur *sahih*.

²¹⁵ Ibn Ebi Shejbe (1/97/1), Ebu Davudi, Muslimi, Ebu Avane dhe Rujaniu në *Musnedin* e tij (24/119/1). Është dhënë në *El-Irva* (332, 394)

²¹⁶ Ibn Ebi Shejbe (1/97/1), Darekutni, Ibn Maxhe, Tahaviu dhe Ahmedi prej rrugëve të shumta, *musned* dhe *mursel*. Shejhul-Islam Ibn Tejmijje e ka shpallur të fortë, sikurse në “El-Furu” të Ibn Abdul-hadiut (48/2). Busajriu i ka shpallur disa isnade të tij *sahih*. E kam diskutuar atë në detaje dhe i kam hulumtuar rrugët e tij të transmetimit në versionin dorëshkrimor, pastaj në *Irva El-Galil* (nr.500).

Detyrimi për të kënduar në namazet pa zë

Sa u përket namazeve pa zë, ai i nxiste ata për të kënduar fjalët tyre; Xhabri ka thënë: “Ne këndonim pas imamit në Drekë dhe në Ikindi suren El-Fatiha dhe një sure tjetër në dy rekatet e para dhe suren El-Fatiha në dy të fundit.”²¹⁷

Megjithatë, ai ua tërhoqte vërejtjen për të mos e ngatërruar me këndimin e tyre, kur: “Ai e fali Drekën me shokët e tij dhe (pastaj) tha: “Cili prej jush këndoi “Madhërojeni emrin e Zotit tuaj, të Lartësuarit” (surja El-A’la) ?” Dikush tha: “Unë [por vetëm mendova të bëj mirë].” E ai tha: “E dita se dikush po më sfidonte me të.”²¹⁸

Në një hadith tjetër: “Ata këndonin pas të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] [me zë], prandaj ai tha: “Ju ma keni ngatërruar (këndimin) Kur'anin tim.”²¹⁹

Ai gjithashtu ka thënë:

“Vërtet, njeriu që falet, privatisht këshillohet me Zotin e tij, prandaj ai duhet të jetë i kujdesshëm se për çka është duke u këshilluar, dhe nuk duhet ta këndoni Kur'anin duke e ngritur zërin mbi njëri-tjetrin.”²²⁰

Ai po ashtu thoshte:

“Kushdo që këndon një *harf* (shkronjë) nga libri i All-llahut, do t'i numërohet si një vepër e mirë, e vepra e mirë shpërblehet dhjetëfish. Unë s'desha të them se “*elif*, *lam*, *mim*” është *harf*, por “*elif*” është *harf*, “*lam*” është *harf* dhe “*mim*” është *harf*.”²²¹

Amini dhe thënia e tij me zë nga imami

Kur ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] përfundonte këndimin e El-Fatisë, thoshte:

²¹⁷ Ibn Maxhe me sened *sahih*. Është dhënë në *El-Irva* (506).

²¹⁸ Muslimi, Ebu Avane dhe Siraxhi.

²¹⁹ Buhariu në artikullin e tuj, Ahmed i dhe Siraxhi me isnad *hasen*.

²²⁰ Maliku dhe Buhariu në *Efal El-'Ibad*, me isnad *sahih*.

*NB: Pikëpamja e vlefshmërisë së këndimit pas imamit në namazet e pazë, por jo në ato të zëshmet, fillimisht u mor nga Imam Shafiu dhe nga Muhammedi, nxënësi i Ebu Hanifes, në një transmetim prej tij, i cili ishte pëlqyer nga Shejh Ali El-Kariu dhe nga dijetarët e tjerë të medhhebit. Ka qenë po ashtu edhe qëndrim, mes të tjerëve, edhe i Imam Ez-Zuhriut, Malikut, ibn El-Mubarekut, Ahmed ibn Hanbelit, i disa prej muhaddithëve dhe është rekomandim i Shejhul-Islam Ibn Tejmijes.

²²¹ Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe, me isnad *sahih*. Transmetuar po ashtu nga Axhuriu në *Adab Haml El-Kur'an*. Sa i përket hadithit, “Ai që këndon pas imanit, goja e tij është plot zjarr”, është i shpifur (*mevdu*), dhe kjo shpjegohet në *Silsileh El-Ehadith Ed-Da'ifeh* (nr.569) - shih Shtojcën 5.

“amin” me zë, duke e zgjatur zërin.²²²

Ai e urdhëronte edhe xhematin të thoshin amin:

“Kur të thotë imami: “Jo në rrugën e atyre ndaj të cilëve je hidhëruar, e as të atyre që kanë humbur”, atëherë thoni “amin”, ngase melekët thonë: “amin”, dhe Imami thotë: “amin”, (në transmetimin tjetër qëndron: “Kur të thotë Imami: “amin”, thoni edhe ju “amin”) andaj “amini” i kujt përputhet me aminin e melekëve (në transmetimin tjetër qëndron: “Kur ndokush prej jush në namaz thotë “amin”, kurse melekët në qiell thonë “amin”, dhe përputhen njëra me tjetrën”), atëherë i falen mëkatet që i ka bërë më parë”.²²³

Në një hadith tjetër:

“...atëherë thoni amin; All-llahu do t’ju përgjigjet.”²²⁴

Ai po ashtu thoshte:

“Hebrenjtë nuk ju kanë zili për asgjë më shumë se që jua kanë zili për selamin dhe për aminin [pas imamit].”²²⁵

Këndimi pas El-Fatiha-së

Më tutje, ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] këndonte një sure tjetër pas El-Fatiha-së, duke e zgjatur nganjëherë dhe duke e shkurtuar në raste të tjera, për shkak të udhëtimit, të kollës, të sëmundjes se të qarjes së foshnjës.

²²² Buhariu në *Xhuz’ El-Kiraeh* dhe Ebu Davudi, me isnad *sahih*.

²²³ Buhariu, Muslimi, Nesaiu dhe Darimiu. Fjalët shitesë janë kumtuar nga këta dy të fundit, dhe ato dëshmojnë se ky hadith nuk mund të arsyetojë që imami të mos thotë amin, siç është kumtuar nga Maliku; prandaj Ibn Haxheri thotë në *Fet-hul-Bari*:

“Qartë tregon se imami thotë amin.”

Ibn Abdul-Berri thotë në *Tamhid* (7/13):

“Është pikëpamje e shumicës së muslimanëve, duke përfshirë edhe Malikun, siç transmeton populli i Medines nga ai, sepse është autentik nga i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] përmes hadithit të Ebu Hurejres (d.m.th. ky) dhe atij të Va’il Ibn Haxherit (d.m.th. ai paraprak).”

²²⁴ Muslim and Ebu `Avane.

²²⁵ Buhariu në *El-Edeb El-Mufred*, Ibn Maxhe, Ibn Huzejme, Ahmedi dhe Siraxhi me dy isnade *sahih*.

*NB: Amini i xhematit pas imamit duhet të bëhet me zë dhe njëkohësisht me imamin, as para tij, si veprojnë shumica e adhuruesve e as pas tij. Kjo është çka përfundimisht e shoh si më bindësen, siç kam shpjeguar në disa vepra të mia, në mesin e tyre *Silsiletul-Ehadith Ed-Da’ifeh* (nr.952, vëll.2), e cila është shtypur dhe botuar me mëshirën e All-llahut, dhe *Sahih Et-Tergib vet-Terhib* (1/205). Shih Shtojcën 6.

Enes ibn Maliku [radijall-llahu anhu] ka thënë: “Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e shkurtoi atë (d.m.th. këndimin) një ditë në namazin e mëngjesit.” (Në një hadith tjetër: ai e fali namazin e sabahut dhe i këndoi dy suret më të shkurtra të Kur'anit), Prandaj u pyet: “O i Dërguar i All-llahut, pse e shkurtove?” Ai tha: “E dëgjova qarjen e një fëmije dhe ma mori mendja se nëna e tij është duke u falur me ne, prandaj desha ta liroj nënën e tij për të.”²²⁶

Ai po ashtu thoshte:

“Unë filloj namazin duke pasur qëllim që ta zgjas, por e dëgjoj të qarën e fëmijës, prandaj e shkurtoj namazin, sepse e di se sa shumë brengoset nëna për qarjen e saj.”²²⁷

Ai ia niste nga fillimi i sures dhe e përfundonte atë në të shumtën e rasteve.²²⁸

Ai thoshte:

“Jepjani secilës sure hisen e saj të rukusë dhe të sexhdes.”²²⁹

Në një transmetim:

“Çdo sure duhet ta ketë një rekat.”²³⁰

Nganjëherë e ndante suren në dy rekate,²³¹ dhe ndonjëherë e përsëriste tërë suren në rekatën e dytë.²³²

Nganjëherë ai kombinonte dy ose më shumë sure në një rekat.²³³

Njëri nga Ensarët dilte imam në xhaminë e Kubasë dhe sa herë që ua këndonte ndonjë sure²³⁴ atyre, ai fillonte me “**Thuj: All-llahu është Një...**” (Sureja Ihlas: 112) deri në fund, pastaj e këndonte suren tjetër bashkë me të, dhe vepronte kështu në çdo rekat. Për

²²⁶ Ahmedi me sened *sahih*. Hadithi tjetër është transmetuar nga Ibn Davudi në *El-Mesahif* (4/14/2). Ky dhe hadithet e tjera të ngjashme përmbajnë lejimin për fëmijët që të hyjnë në xhami. Sa i përket hadithit “Mos i lini fëmijët e vegjël në xhami...”, është *daif* dhe s’mund të përdoret si dëshmi. Ndër ata që e kanë shpallur *daif* janë Ibn El-Xhevziu, Mundhiri, Hejtemiu, Ibn Haxher El-Askalani dhe Busajriu. Abdul-Hakk El-Ishbili ka thënë: “Është i pabazë.”

²²⁷ Buhari dhe Muslimi.

²²⁸ Janë shumë hadithe të përmendura më pas, në të cilat dëshmohej kjo.

²²⁹ Ibn Ebi Shejbe (1/100/1), Ahmedi dhe Abdul-Gani El-Makdisiu në Sunnetin e tij (9/2), me sened *sahih*.

²³⁰ Ibn Nasri dhe Tahaviu, me sened *sahih*; Kuptimi i hadithit sipas meje është: Bëni çdo rekat të ketë një sure të plotë. Ky urdhër është i preferuar e jo detyrues, nga argumenti që vijon.

²³¹ Ahmedi dhe Ebu Ja’la prej dy rrugëve. Shih gjithashtu në “Këndimi në namazin e Sabahut.”

²³² Siç ka vepruar në Sabah, që do të pasojë.

²³³ Detajet dhe burimet pasojnë së shpejti.

²³⁴ D.m.th. një sure pas El-Fatiha-së.

këtë shkak, njerëzit e tij iu drejtuan duke i thënë: “Ti fillon me një sure, e pastaj nuk të duket e mjaftueshme, derisa e këndon një tjetër: ti ose duhet ta këndosh vetëm atë, ose ta lësh atë dhe ta këndosh një tjetër”. Ai tha: “Nuk do ta lë. Nëse ju dëshironi që t’ju udhëheq me të, do të vazhdoj, por nëse nuk doni, atëherë do t’ju lë.” Ata e dinin se ai ishte njëri nga më të mirët dhe nuk donin që të udhëhiqeshin nga tjetërkush, kështu që, kur u erdhi i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ata ia treguan këtë ndodhi. E ai tha: “O filan, **çka të pengoi ty që të veprosh, ashtu siç kërkon populli yt? Çka të shtyu ta këndosh këtë sure në çdo rekat?**” Ai tha: “E dua këtë sure.” Ai tha: “**Dashuria jote për të do të të fusë në xhennet.**”²³⁵

Kombinimi i sureve të ngjashme dhe i të tjerave në një rekat

Ai i kombinonte dyshtet²³⁶ e sureve *mufessal*²³⁷, kështu që ai këndonte në një rekat njëren prej dysheve të sureve që pasojnë: ²³⁸

- Er-Rahman (55: 78) ²³⁹ dhe En-Nexhm (53: 62);
- El-Kamer (54: 55) dhe El-Hakkah (69: 52);
- Et-Tur (52: 49) dhe Dharijat (51: 60);
- El-Vaki’a (56: 96) dhe El-Kalem (68: 52)
- El-Me'arixh (70: 44) dhe En-Nazi’at (79: 46);
- El-Mutaffifin (83: 36) dhe Abese (80: 42);
- El-Muddeththir (74: 56) dhe El-Muzzemmil (73: 20);
- Ed-Dehr (76: 31) dhe El-Kijameh (75: 40);
- En-Nebe' (78: 40) dhe El-Murselat (77: 50);
- Ed-Duhan (44: 59) dhe Et-Tekvir (81: 29).

Nganjëherë, gjatë namazit të natës, ai kombinonte në një rekat suret nga shtatë *tivalet* (suret e gjata), siç janë: El-Bekare, En-Nisa dhe ali Imran. Ai thoshte: “**Namazi më i përsosur është ai me qëndrim të gjatë.**”²⁴⁰

Kur ai këndonte:

²³⁵ Buhariu si ta’lik dhe Tirmidhiu si mevsul, dhe ai e ka shpallur sahih.

²³⁶ nedha’ir: suret që kanë kuptim të njëjtë, të dyja përmbajnë këshilla, urdhëra ose tregime.

²³⁷ Ekziston pajtimi se mbarojnë në fund të Kur’anit; pikëpamja më e shëndoshë është se ato fillojnë me suren Kaf (nr.50).

²³⁸ Buhariu dhe Muslimi.

²³⁹ Numri i parë është ai i sures, ndërsa i dyti është numri i ajetit në sure. Duke vështuar dy numrat e parë në secilin rast, është lehtë të shihet se në shumicë e këtyre kombinimeve; ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk i është përmbajtur renditjes kuran’ore të sureve, prandaj kjo është dëshmi për lejimin e një gjëje të tillë, eshe pse është më mirë ta përcjellim renditjen e Kur’anit. Rast i ngjashëm do të haset më vonë nën “Namazi i natës”.

²⁴⁰ Muslimi dhe Tahaviu.

أَلَيْسَ ذَلِكَ بِقَادِرٍ عَلَى أَنْ يُحْيِيَ الْمَوْتَى (40)

“A nuk ka Ai fuqi t’u japë jetë të vdekurve?” (Kijameh 75: 40) thoshte:

"Madhështia të takon Ty, gjithsesi!";

Dhe, kur ai këndonte:

سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى (1)

“Madhërojeni emrin e Zotit tuaj, më të Lartësuarit” (A’la 87: 1) thoshte:

"I Madhëruar qoftë Zoti im, më i Lartësuarit)".²⁴¹

Lejimi i këndimit të vetëm El-Fatiha-së

Muadh ibn Xhebeli e falte jacinë me të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], pastaj kthehej dhe udhëhiqte popullin e tij në namaz. Një natë, kur u kthye dhe u fal me ta, një i ri [i quajtur Sulejm, i Beni Selemëve] nga populli i tij, u fal, por, kur u bë tepër gjatë për të, ai [u largua dhe] u fal [në një qosh të xhamisë], pastaj doli, mori frerët e devesë së tij dhe u largua. Kur Muadhi u fal, kjo iu përmend atij, e ai tha: “Sigurisht se ka pak dyfytirësi në të! Unë me siguri do t’i tregoj të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] për atë që ai ka bërë.” E ai i riu tha: “Edhe unë do t’i tregoj të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] për atë që ai ka bërë.” Në mëngjes, ata erdhën te i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe Muadhi i tregoi se ç’ka bërë i riu. I riu tha: “O i Dërguar i All-llahut! Ai qëndron një kohë të gjatë me ty, pastaj kthehet dhe na e zgjatë neve”. I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: “A je ti prej atyre që shkaktojnë trazira, o Muadh?!” dhe i tha të riut:²⁴² “Çka bën ti kur falesh, o i biri i vëllait tim?” Ai tha: “Këndoju Kapitullin e parë të Librit, pastaj e lus All-llahun për Xhenet dhe kërkoj strehim tek Ai nga Xhehennemi. Unë nuk e di *dendene*-në²⁴³ tënde, e as *dende*-në e Muadhit!” I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: “Edhe unë edhe Muadhi rreth kësaj lutemi.”

Transmetuesi tha: I riu tha: “Mirëpo, do ta kuptojë Muadhi kur të shkojë te populli kur ata të kenë qenë të informuar se armiku ka arritur.” Transmetuesi tha: “Dhe armiku

²⁴¹ Ebu Davudi dhe Bejhekiu, me sened *sahih*. Ky hadith është i përgjithshëm, prandaj zbatohet në dy këndimet gjatë namazit, si në atë farz, ashtu edhe në atë sunnet, si dhe jashtë tij. Ibn Ebi Shejbe (2/132/2) ka transmetuar nga Ebu Musa El-Elshariu dhe El-Mugire Ibn Shube se ata e thoshin këtë në namazin farz, dhe nga Umeri dhe Aliu pa specifikime të tilla.

²⁴² Në origjinal, “i riu tha”

²⁴³ *Dendene*: kur dikush thotë disa fjalë, intonacioni i të cilave është i dëgjueshëm, por nuk mund të kuptohen; është pak më shumë se murmuritje (*Nihajeh*).

erdhi dhe i riu arriti të bjerë shehid (dëshmor). Pas kësaj, i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i tha Muadhrit: “Çka ka bërë ai që polemizonte me mua dhe ty?” Ai tha: “O i Dërguar i All-llahut, ai ishte i sinqertë ndaj All-llahut dhe unë kam folur të pavërtetën - ai ra dëshmor.”²⁴⁴

Këndimi më zë dhe në heshtje në pesë namazet dhe në namazet tjera

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] këndonte me zë në namazin e Sabahut dhe në dy rekatet e para të Akshamit dhe të Jacisë, ndërsa pa zë në Drekë, në Ikindi, në rekatën e tretë të Akshamit dhe në dy rekatet e fundit të Jacisë.²⁴⁵

Ata e dinin kur ai këndonte heshtazi nga lëvizjet e mjekrës²⁴⁶ së tij dhe ngase ai ua mundësonte atyre nganjëherë të dëgjonin një ose më shumë ajete.²⁴⁷

Ai po ashtu këndonte me zë në namazin e Xhumasë dhe në dy namazet e Bajramit²⁴⁸, në namazin për shi²⁴⁹ dhe në namazin e errësimit (eklipsit).²⁵⁰

Këndimi me zë dhe në heshtje në namazin e natës (Tehexhjud) ²⁵¹

²⁴⁴ Ibn Huzejme në *Sahihun* e tij (1634) dhe Bejhekiu me isnad të mirë. Ka një transmetim përforcues në Ebi Davud (nr.758, Sahih Ebi Davud), dhe tregimi kryesor është në Buhari dhe në Muslim. Shtojca e parë është në një transmetim të Muslimit, e dyta në Ahmed (5/74), dhe e treta dhe e katërta në Buhari. Po kështu, në këta tre është hadithi nën autoritetin e Ibn Abbasit “Që i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] fali dy rekate, në të cilat këndoi vetëm El-Fatiha-në”, transmetuar nga Ahmedi (1/282), nga Harith bin Ebi Usame në *Musnedin* e tij (fq.38 të *Zevaidit* të tij) dhe nga Bejhekiu (2/62) me sened *daif*. Në veprat e mia të mëparshme, këtë hadith e shpallja *hasen*, derisa e kuptova se kisha gabuar, sepse ky hadith varet nga Handhale Ed-Devsiu, i cili është *daif*, dhe nuk e di se si nuk e kam vërejtur; ndoshta kam menduar se është dikush tjetër. Megjithatë, falënderimi i takon All-llahut, i cili më udhëzoi ta njoh gabimin tim dhe për këtë shkak kam shpejtuar ta përmirësoj në shtyp. Pastaj All-llahu më kompensoi me një hadith më të mirë të Muadhrit, i cili lidhet me atë çka tregon hadithi i Ibn Abbasit. Falënderimi i qoftë All-llahut me mëshirën e të Cilit veprat e mira plotësohen.

²⁴⁵ Ekziston *ixhmaja* (njëzëshmëria e mendimit) e muslimanëve për këtë, me trashëgimtarët duke e përcjellë nga paraardhësit, së bashku me hadithet autentike, të cilat e vërtetojnë këtë, siç ka thënë Neveviu, dhe disa prej tyre pasojnë. Shih po ashtu në *El-Irva* (345).

²⁴⁶ Buhariu dhe Ebu Davudi.

²⁴⁷ Buhariu dhe Muslimi

²⁴⁸ Shih pjesët rreth këndimit të tij në namazin e Xhumasë dhe në dy namazet e Bajramit.

²⁴⁹ Buhariu dhe Ebu Davudi

²⁵⁰ Buhariu dhe Muslimi

²⁵¹ Abdul-Hakku ka thënë në Et-Tehexhjud (90/1):

“Sa i përket namazeve vullnetare gjatë ditës, nuk ekziston asgjë autentike nga ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] lidhur me këndimin me zë ose në heshtje, por siç duket ai këndonte pa zë gjatë tyre. Është transmetuar nga ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] se një herë gjatë dirës, kaloi pranë Abdull-llah bin Hudhafes që falej dhe këndonte me zë, dhe i tha atij: “O Abdull-llah! Lëre All-llahun të të dëgjojë, jo ne”. Por ky hadith nuk është i fortë.”

Në namazin e natës, ai nganjëherë këndonte heshtazi, nganjëherë me zë²⁵² dhe “ai këndonte në shtëpinë e vet, ashtu që do të mund të dëgjohej në oborrin e shtëpisë.”²⁵³ “Herë-herë, ai ngrinte zërin edhe më shumë, derisa dikush i shtrirë në shtrat do të mund ta dëgjonte”²⁵⁴ (d.m.th. jashtë oborrit).

Ai e urdhëroi Ebu Bekrin dhe Umerin [radijall-llahu anhu] të vepronin kështu, kur: “Ai doli një natë dhe e gjeti Ebu Bekrin [radijall-llahu anhu] duke u falur me zë të ulët, pastaj kaloi kah Umer Ibn El-Hattabi [radijall-llahu anhu] i cili falej me zë të lartë. Më vonë, kur u mbledhën te i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ai tha: “O Ebu Bekr, kalova kah ti e ti ishe duke u falur me zë të ulët?” Ai tha: “E lë Atë të Cilit i luteshe me mposhtje të më dëgjojë, o i Dërguar i All-llahut.” Ai i tha Umerit: “Kalova kah ti e ti ishe duke u falur me zë të lartë?” E ai tha: “O i Dërguar i All-llahut, e largoj përgjumësinë dhe zmbrops shejtanin.” I Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: “O Ebu Bekr, ngrite pak zërin”, dhe Umerit: “Ule pak zërin.”²⁵⁵

Ai thoshte:

“Ai që e këndon Kur'anin me zë të lartë, është sikur ai që jep lëmoshë zhurmshëm, ndërsa ai që e këndon Kur'anin me zë të ulët, është sikur ai që jep lëmoshë heshtazi.”²⁵⁶

Çka këndonte ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në namaze të ndryshme

Sa i përket sureve ose ajeteve të cilat i këndonte ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në namaz, kjo ndryshonte varësisht nga namazet. Tash pasojnë detajet, duke filluar me të parin nga pesë namazet:

1- Namazi i Sabahut

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] këndonte suret²⁵⁷ e gjata *mufessel*²⁵⁸, kështu, “ai (nganjëherë) këndonte El-Vaki’a (56: 96) dhe sure të ngjashme në dy rekatet”²⁵⁹.

Ai këndoi suren Et-Tur (52: 49) gjatë Haxhit Lamtumirës.²⁶⁰

²⁵² Muslimi dhe Buhariu në *Ef'al El-'Ibad*.

²⁵³ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu në *Esh-Shemail* me sened *hasen*. Hadithi do të thotë se ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] gjente një mes ndërmjet heshtjes dhe zërit të lartë.

²⁵⁴ Nesaiu, Tirmidhiu në *Esh-Shemail* dhe Bejhekiu në *Ed-Delail*, me sened *hasen*.

²⁵⁵ Ebu Davudi 7 Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

²⁵⁶ Ibid.

²⁵⁷ Nesaiu dhe Ahmedi, me sened *sahih*.

²⁵⁸ Shtatëshja e fundit e Kur'anit, duke filluar me suren Kaf (nr.50), sipas pikëpamjes më të shëndoshë, si më parë.

²⁵⁹ Ahmedi, Ibn Huzejme (1/69/1), Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

Nganjëherë “ai këndonte suren Kaf (50: 45) ose ndonjë sure të ngjashme (në rekatën e parë) ”.²⁶¹

Nganjëherë “ai këndonte suret më të shkurtra *muffeset*, siç është **“Kur dielli të paloset”** (Et-Tekvir 81: 29).²⁶²

Njëherë, ai këndoi: **“Kur toka të dridhet...”** (Zelzele 99: 8) në dy rekatet, kështu që transmetuesi tha: “Nuk e di nëse i Dërguari i All-llahut harroi, apo e këndoi me qëllim.”²⁶³

Njëherë, gjatë udhëtimit, ai këndoi: **“Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit”** (Felek 115: 5) dhe **“Thuaj: I mbështetem Zotit të njerëzve”** (Nas 114: 6).²⁶⁴

Ai po ashtu i ka thënë Ukbeh ibn Amirit [radijall-llahu anhu]:

*“Këndoje *muvedhdhatejn*²⁶⁵ në namazin tënd, ngase asnjë kërkues i strehimit nuk ka kërkuar strehë me diçka të ngjashme me to.”²⁶⁶*

Nganjëherë këndonte më shumë se kjo: “ai këndonte gjashtëdhjetë ose më shumë ajete”²⁶⁷ - njëri nga transmetuesit tha: “Nuk e di se a e bënte këtë në njërin rekat, a në të dyja rekatet.”

Ai këndonte suren Er-Rrum (30: 60)²⁶⁸, e nganjëherë suren Ja Sin (36: 83).²⁶⁹

Njëherë, “ai fali *Subh*-in (d.m.th. Namazin e Sabahut) në Mekë dhe filloi këndimin e sures El-Mu’minun (23: 118), derisa, kur erdhi te përmendja e Musait dhe Harunit ose e Isait²⁷⁰ - njëri prej transmetuesve nuk ishte i sigurt - ai filloi të kollitej, prandaj bëri ruku.”²⁷¹

²⁶⁰ Buhariu dhe Muslimi.

²⁶¹ Muslimi dhe Tirmidhiu. Është dhënë bashkë me tjetrën vijuese në *El-Iroa* (345).

²⁶² Muslimi dhe Ebu Davudi

²⁶³ Ebu Davudi dhe Bejhekiu me sened *sahih*. Dhe siç duket, ai (alejhis-selam) e ka bërë këtë me qëllim për ta vendosur vlefshmërinë e saj.

²⁶⁴ Ebu Davudi, Ibn Huzejme (1/76/1), Ibn Bushrani në *El-Emali* dhe Ibn Ebi Shejbe (12/176/1); Hakimi e ka shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu ëshjtë pajtuar.

²⁶⁵ lit. “Dy mjetet me të cilat kërkohet strehë”, d.m.th. dy suret e fundit të Kur'anit, të dyja duke filluar me **“Thuaj: I mbështetem...”**

²⁶⁶ Ebu Davudi dhe Ahmedi, me sened të mirë.

²⁶⁷ Buhariu dhe Muslimi.

²⁶⁸ Nesaiu, Ahmedi dhe Bezari, me sened të mirë.

²⁶⁹ Ahmedi me sened *sahih*.

²⁷⁰ Musai përmendet në ajetin 45: **“Pastaj ne dërguam Musanë dhe vëllain e tij Harunin me mrekullitë tona dhe me argumente të qarta”**; Isai përmendet menjëherë në ajetin 50: **“Edhe të birin e Mejremes dhe t’ëmën e tij e paraqitëm si argument dhe i vendosëm që të dy në një rrafshnaltë, ku pushonin dhe ishin të sigurt, dhe i furnizuam me burime.”**

²⁷¹ Muslimi dhe Buhariu në formën *talik*. Është dhënë në *El-Iroa* (397).

Nganjëherë, “ai i udhëhiqte në namazin e Sabahut me Es-Saffat” (77: 182).²⁷²

“Në namazin e Sabahut, të Premten, ai këndonte Es-Sexhde-në (32: 30) (në rekatën e parë, ndërsa në të dytin) Ed-Dehr-in” (76: 31).²⁷³

Ai bënte rekatën e parë më të gjatë se të dytin.²⁷⁴

Këndimi në namazin sunnet para sabahut

Këndimi i tij në dy rekatet sunnet të Sabahut ishte tejet i shkurtër,²⁷⁵ saqë Aishja [radijall-llahu anhu] nganjëherë thoshte: “A e këndoi suren Fatiha, apo jo?”²⁷⁶

Nganjëherë, pas El-Fatiha-së, ai këndonte ajetin:

قُولُوا آمَنَّا بِاللَّهِ وَمَا أُنزِلَ إِلَيْنَا وَمَا أُنزِلَ إِلَىٰ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَالْأَسْبَاطِ وَمَا أُوتِيَ
(136)لَهُ مُسْلِمُونَ مُوسَىٰ وَعِيسَىٰ وَمَا أُوتِيَ النَّبِيُّونَ مِنْ رَبِّهِمْ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِنْهُمْ وَنَحْنُ

“Thuaj: Ne besojmë në All-llahu në shpalljen që na është dhënë...” (El-Bekare 2: 136) në rekatën e parë; në të dytin ajetin:

قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ تَعَالَوْا إِلَىٰ كَلِمَةٍ سَوَاءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا اللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِ شَيْئًا وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا
بَعْضًا أَرْبَابًا مِنْ دُونِ اللَّهِ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُولُوا اشْهَدُوا بِأَنَّا مُسْلِمُونَ (64)

“Thuaj: O ithtarët e librit, ejani te një fjalë që është e njëjtë mes nesh dhe jush...” (Ali Imran 3: 64).²⁷⁷

Herë-herë, në vend të kësaj të fundit, ai këndonte,

فَلَمَّا أَحَسَّ عِيسَىٰ مِنْهُمُ الْكُفْرَ قَالَ مَنْ أَنْصَارِي إِلَى اللَّهِ قَالَ الْحَوَارِيُّونَ نَحْنُ أَنْصَارُ اللَّهِ آمَنَّا بِاللَّهِ وَأَشْهَدُ
(52)بِأَنَّا مُسْلِمُونَ

“E kur Isai kuptoi vendosmërinë e tyre në mosbesim...” (Ali Imran 3: 52).²⁷⁸

Nganjëherë këndonte suren El-Kafirun (109: 6) në rekatën e parë dhe suren El-Ihlas (112: 4) në të dytin,²⁷⁹ ai po ashtu thoshte: “Sa çift i shkëlqyeshëm i sureve që janë!”²⁸⁰

²⁷² Ahmedi dhe Ebu Ja’la në *Musnedet* e tyre, dhe Makdisiu në *El-Muhtareh*.

²⁷³ Buhariu dhe Muslimi

²⁷⁴ Ibid.

²⁷⁵ Ahmedi me sened *sahih*

²⁷⁶ Buhariu dhe Muslimi

²⁷⁷ Muslimi, Ibn Huzejme dhe Hakimi.

²⁷⁸ Muslimi dhe Ebu Davudi.

²⁷⁹ Ibid.

Ai dëgjoi një njeri duke kënduar suren e parë (El-Kafirun) në rekatën e parë, pastaj tha: **“Ky është një rob që beson në Zotin e tij”**. Pastaj njeriu këndoi suren tjetër (El-Ihlas) në rekatën e dytë, e ai tha: **“Ky është një rob që e njeh Zotin e tij.”**²⁸¹

2- Namazi i Drekës

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] këndonte El-Fatiha-në dhe dy sure në dy rekatet e para, duke e zgjatur të parin më shumë se të dytin.”²⁸²

Nganjëherë e zgjaste aq shumë, saqë “namazi i Drekës fillonte, dikush mund të shkonte në fushën El-Beki’, t’i përmbushte nevojat e tij, (të kthehej në vendin e tij), të merrte abdest, pastaj të vinte (në xhami), derisa i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte ende në rekatën e parë, aq i gjatë që ishte.”²⁸³

Po ashtu, “ata mendonin se ai e bënte këtë që të mund ta mbërrinin njerëzit rekatën e parë.”²⁸⁴

“Ai këndonte në secilin nga këto dy rekate rreth tridhjetë ajete, si, për shembull, suren Fatiha, të pasuar nga surja Es-Sexhde (32: 30).”²⁸⁵

Nganjëherë ai këndonte **“Pasha qiellin dhe yllin e natës”** (Tarik, 86: 17), **“Pasha qiellin me plot yje”** (Buruxh 85: 22), **“Pasha natën kur errësohet”** (Lejl, 92: 21) dhe sure të ngjashme.²⁸⁶

Herë pas herë, ai këndonte **“Dhe kur qielli të ndahet”** (Inshikak 84: 25) dhe sure të ngjashme.²⁸⁷

“Ata mund të dinin kur ai këndonte në Drekë dhe Ikindi nga lëvizja e mjekrës së tij.”²⁸⁸

Këndimi i ajeteve pas El-Fatiha-së në dy rekatet e fundit

Ai i bënte rekatet e fundit përgjysmë më të shkurtra se dy të parat për një pesëmbëdhjetë ajete,²⁸⁹ e nganjëherë këndonte vetëm El-Fatiha-në në to.”²⁹⁰

²⁸⁰ Ibn Maxhe dhe Ibn Huzejme.

²⁸¹ Tahaviu, Ibn Hibbani në *Sahihun* e tij, dhe Ibn Bushrani; Ibn Haxheri e ka shpallur hasen në *El-Ehadith El-Alijat* (nr.16).

²⁸² Buhariu dhe Muslimi.

²⁸³ Muslimi dhe Buhariu në *Xhuz’ El-Kiraeh* (Artikulli mbi Këndimin).

²⁸⁴ Ebu Davudi me sened *sahih*, dhe Ibn Huzejme (1/165/1).

²⁸⁵ Ahmedi dhe Muslimi

²⁸⁶ Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Huzejme (1/67/2); dy të fundit e kanë shpallur *sahih*.

²⁸⁷ Ibn Huzejme në *Sahihun* e tij (1/67/2).

²⁸⁸ Buhariu dhe Ebu Davudi

Nganjëherë “ai ua mundësonte ta dëgjonin ndonjë ajet.”²⁹¹

“Ata dëgjonin tinguj të këndimit të tij të **“Madhëroje emrin e Zotit tënd, më të Lartësuarit”** (A’la 87: 19) dhe **“A të erdhi ty lajmi për Kaplimin”** (Gashijeh 88: 26).²⁹²

Nganjëherë “ai këndonte **“Pasha qiellin dhe yllin e natës”** (Tarik 86: 17), **“Pasha qiellin me plot yje”** (Buruxh 85: 22) dhe sure të ngjashme”²⁹³

Nganjëherë “ai këndonte **“Pasha natën kur errësohet”** (Lejl 92: 21) dhe sure të ngjashme.”²⁹⁴

Domosdoshmëria e leximit të Fatiha-së në çdo rekat

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka urdhëruar “atë që u fal keq” ta lexonte fatihanë në çdo rekat, pasi që e patë urdhëruar ta lexonte në rekatën e parë, duke i thënë:²⁹⁵ **“Pastaj kështu vepron në namazin tënd”**,²⁹⁶ në një transmetim qëndron: **“Në çdo rekat”**.²⁹⁷

3- Namazi i Ikindisë

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] këndonte El-Fatiha-në dhe dy sure (të tjera) në dy rekatet e para, duke e zgjatur të parin më shumë se të dytin”²⁹⁸ dhe “ata mendonin se ai e bënte këtë që të mund ta mbërrinin njerëzit rekatën.”²⁹⁹

“Ai këndonte rreth pesëmbëdhjetë ajete në secilin prej dy rekateve të para të Drekës dhe i bënte dy rekatet e fundit përgjysmë më të shkurtra se dy të parat.”³⁰⁰

²⁸⁹ Ahmedi dhe Muslimi. Hadithi përmban argument se është sunet të këndohet më shumë se El-Fatiha-ja në të dy rekatet e fundit, dhe shumë sahabë kanë vepruar kështu, e në mesin e tyre Ebu Bekr Es-Siddiku [radijall-llahu anhu]. Ky është gjithashtu edhe mendim i imam Shafiut, qoftë në Drekë, qoftë në të tjerat, dhe i dijetarëve tanë të mëvonshëm, Ebul-Hasenat El-Laknovi e merr këtë qëndrim në Shënime mbi *El-Muvetta*, e Muhammedit (f.102) dhe thotë:

“Disa nga shokët tanë kanë pikëpamje të çuditshme, duke e bërë të obligueshme *sehvi sexhden* (sexhdja e harresës) për këndimin e sures në dy rekatet e fundit, por komentuesit në *El-Menijjeh*, Ibrahim El-Halebiu, Ibn Emir Haxhi dhe të tjerë e kanë përgënjeshtuar këtë për hadithin, dhe po ta kishin ditur, nuk do ta kishin thënë këtë.”

²⁹⁰ Buhariu dhe Muslimi.

²⁹¹ Ibn Huzejme në *Sahihun* e tij (1/67/2) dhe Ed-Dija El-Makdisiu në *El-Muhtarah* me sened *sahih*.

²⁹² Buhariu në Artikull mbi Këndimin, dhe Tirmidhiu, të cilët e kanë shpallur *sahih*.

²⁹³ Muslimi dhe Tajalisi

²⁹⁴ Buhariu dhe Muslimi.

²⁹⁵ Ebu Davudi me sened të fortë.

²⁹⁶ Buhariu dhe Muslimi.

²⁹⁷ Ahmedi me sened të mirë.

²⁹⁸ Ibid.

²⁹⁹ Ebu Davudi me sened *sahih*, dhe Ibn Huzejme.

³⁰⁰ Ahmedi dhe Muslimi

“Ai këndonte El-Fatiha-në në dy të fundit.”³⁰¹

“Ai ua mundësonte të dëgjojnë ndonjë ajet nganjëherë.”³⁰²

Ai këndonte suret, të përmendura më lart në “Namazin e drekës”.

4- Namazi i Akshamit

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] (nganjëherë) këndonte sure të shkurtra *mufessel*”,³⁰³ kështu që “kur e mbaronin namazin me të, ata largoheshin në kohë kur mund ti shihnin pozitën e shigjetave të tyre.”³⁰⁴

Njëherë, “gjatë udhëtimit, ai këndoi **“Pasha fikun dhe ullirin”** (Tin 95: 8) në rekatën e dytë.”³⁰⁵

Por, nganjëherë ai këndonte sure të gjata ose të mesme *mufessel*. Kështu, “ai këndonte **“Ata të cilët vetë nuk besuan dhe penguan të tjerët në rrugën e All-llahut** (Muhammed 47: 48)”³⁰⁶ ose suren Et-Tur (52: 49)³⁰⁷ ose suren El-Murselat (77: 50), të cilën e këndoi në namazin e fundit që ai fali.”³⁰⁸

Nganjëherë “ai këndonte më të gjatën prej dy sureve të gjata³⁰⁹ (Araf 7: 206) (në dy rekate).³¹⁰ Ose këndonte El-Enfal-in (8: 75) në dy rekate³¹¹

Këndimi në namazin sunnet pas Akshamit

Në këtë namaz, “ai këndonte **“Thuaj: O ju që refuzoni besimin”** (Kafirun 109: 6) dhe **“Thuaj: All-llahu është Një”** (Ihlas 112: 4).”³¹²

5- Namazi i Jacisë

³⁰¹ Buhariu dhe Muslimi

³⁰² Ibid.

³⁰³ Ibid. (Buhariu dhe Muslimi).

³⁰⁴ Nesaiu dhe Ahmedi, me sened *sahih*.

³⁰⁵ Tajalisi dhe Ahmedi me sened *sahih*.

³⁰⁶ Ibn Huzejme (1/166/2), Taberaniu dhe Makdisi, me sened *sahih*.

³⁰⁷ Buhariu dhe Muslimi.

³⁰⁸ Ibid.

³⁰⁹ Të quajtura “Et-Tulejejn”: ekziston pajtimi se Araf (7) është njëra; tjetra është En’am (6), sipas shumicës së thëniesve të sakta, sikurse në *Fet-hul-Bari*.

³¹⁰ Buhariu, Ebu Davudi, Ibn Huzejme (1/68/1), Ahmedi, Siraxhi dhe Muhlisi.

³¹¹ Taberaniu në *Mu’xhem El-Kebir*, me sened *sahih*.

³¹² Ahmedi, Makdisi, Nesaiu, Ibn Nasri dhe Taberaniu.

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] këndonte suret e mesme *mufessel* në dy rekatet e para.³¹³ Kështu, “ai këndonte **“Pasha Diellin dhe dritën e tij”** (Shems 91: 15) dhe sure të këtilla.”³¹⁴

Ose “ai këndonte **“Kur qielli të ndahet”** (Inshikak 84: 25) dhe bënte sexhde gjatë saj.”³¹⁵

Po ashtu, “ai njëherë këndoi **“Pasha Fikun dhe Ullirin”** (Tin 95: 8) (në rekati e parë) gjatë udhëtimit.”³¹⁶

Ai ndalonte zgjatjen e këndimit në Jaci, dhe kjo ishte atëherë kur: Muadh ibn Xhebeli udhëhoqi xhematin e tij në namazin e Jacisë dhe e zgjati shumë, atëherë njëri nga ensarët shkoi dhe u fal (vetëm). Kur Muadh iu tregua kjo, ai tha: “Sigurisht, është ndonjë munafik”. Kur njeriu dëgjoi se çka kishte thënë Muadhi për të, vajti te i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe i tregoi se çfarë kishte thënë Muadhi, e i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i tha atij: **“A do të bëhesh prej atyre që bëjnë trazira, o Muadh?!”** Kur të udhëheqësh xhematin, këndo **“Pasha diellin dhe dritën e tij”** (Shems 91: 15) ose **“Madhëroje emrin e Zotit tënd më të Lartësuarit”** (A’la 77: 19) ose **“Lexo në emrin e Zotit tënd”** (Ale 96: 19) ose **“Pasha natën kur errësohet”** (Lejl 92: 21) (për shkak se të vjetërit, të dobët dhe ata që kanë ndonjë nevojë për t’u përmbushur, falen pas teje).³¹⁷

6- Namazi i natës

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nganjëherë këndonte në të me zë, nganjëherë heshtas.³¹⁸ Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nganjëherë shkurtonte këndimin e tij, e nganjëherë e zgjaste, në disa raste duke e zgjatur aq shumë, sa që Abdullah ibn Mes’udi njëherë tha: “U fala më të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] një natë dhe ai vazhdoi së qëndruarit në këmbë aq shumë, sa që më shkoi ndër mend diçka e keqe.” Ai u pyet, “Çfarë të shkoi ndër mend?” Ai tha: “Mendova të ulem e të shkoja e ta lë të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] !”³¹⁹

Po ashtu Hudhejfe ibn El-Jemani ka thënë: “U fala më të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] një natë, kur ai filloi leximin e Sures El-Bekare (2: 286). Dhe unë thashë me vete: “Ai do të bëjë ruku pas njëqind ajetesh.” Por, ai vazhdoi pas këtyre. Atëherë, unë mendova: “Ai do të përfundojë (suren) në dy rekate.” Por, ai vazhdoi. Unë mendova: “Ai do të bëjë ruku, kur ta barojë atë”. Pastaj, ai filloi suren En-Nisa (4: 176) dhe e këndoi

³¹³ Nesaiu dhe Ahmedi, me sened *sahih*.

³¹⁴ Ahmedi 7 Tirmidhiu, të cilët e kanë shpallur *hasen*.

³¹⁵ Buhariu, Muslimi dhe Nesaiu

³¹⁶ Ibid.

³¹⁷ Ibid. Është dhënë gjithashtu në *El-Iroa* (295).

³¹⁸ Nesaiu me sened *sahih*

³¹⁹ Buhariu dhe Muslimi.

të tërën. Pastaj filloi suren Ali Imran (3: 200) ³²⁰ dhe e këndoi të tërën. Ai këndonte ngadalë. Kur vinte te ndonjë ajet në të cilin madhërohej All-llahu, ai e madhëronte All-llahun; në ajetet ku kishte diç për t'u kërkuar, ai e kërkonte atë; ku kërkohej streha, ai e kërkonte (te All-llahu). Pastaj bënte ruku..." deri në fund të hadithit. ³²¹

Po ashtu, "një natë kur ishte i sëmurë, ai këndoi Shtatë suret e Gjata." ³²²

Po kështu, "ai (nganjëherë) këndonte njëren prej këtyre sureve në secilin rekat." ³²³

"Ka qenë (plotësisht) i huaj për të këndimi i plotë i Kur'anit brenda një nate." ³²⁴ Në të vërtetë, ai nuk ia rekomandoi këtë Abdull-llah ibn Amrit [radijall-llahu anhu], kur atij i tha: "Këndoje Kur'anin në tërësi për çdo muaj". Unë i thashë: "Unë kam fuqi (të bëj më shumë se kjo)." Ai tha: "Këndoje për çdo njëzet ditë". Unë i thash: "Unë kam fuqi për më shumë." Ai tha: "Atëherë këndoje për shtatë ditë dhe mos shko përtej kësaj." ³²⁵ Pastaj "ai ia lejoi atij që ta këndonte për pesë ditë." ³²⁶ Pastaj "ai ia lejoi atij ta këndojë për tri ditë." ³²⁷ Më tutje, ai ia ndaloi atij ta këndonte më shpejt se aq, ³²⁸ dhe ai i dha arsye për këtë, duke i thënë: "Kushdo që e këndon Kur'anin për më pak se tri ditë, ai nuk e kupton atë." ³²⁹ Një tjetër version: "Nuk e kupton ai, i cili këndon Kur'anin për më pak se tri ditë." ³³⁰ Po ashtu atij i tha:

"Çdo adhurues ka një (fazë) entuziazmi ³³¹ dhe çdo (fazë) entuziazëm ka një shkarje ³³² ose drejt Sunnetit, ose drejt bidatit (ririsë). Kështu, ai, shkarja e të cilit

³²⁰ Transmetimi është i këtillë, me En-Nisa-në (4) para Ali Imran-it, dhe kjo është argument për (lejimin e) shmangies nga renditja e sureve që gjenden në kopjen Uthmanij të Kur'anit në këndim. Një shembull i kësaj tashmë është parë.

³²¹ Muslimi dhe Nesaiu.

³²² Ebu Ja'la dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar. Ibn El-Ethiri thotë: "...Shtatë suret e Gjata janë: Bekare (2), Ali Imran (3), Nisa (4), Maide (5), En'am (6), A'raf (7) dhe Tevbe (9)."

³²³ Ebu Davudi dhe Nesaiu, me sened *sahih*.

³²⁴ Muslimi dhe Ebu Davudi.

³²⁵ Buhariu dhe Muslimi.

³²⁶ Nesaiu dhe Tirmidhiu, të cilët e kanë shpallur *sahih*.

³²⁷ Buhariu dhe Ahmedi.

³²⁸ Darimiu dhe Se'id bin Mensuri në Sunnetin e tij, me sened *sahih*.

³²⁹ Ahmedi me sened *sahih*.

³³⁰ Darimiu & Tirmidhiu, të cilët e kanë shpallur *sahih*.

³³¹ Ar. *Shirreh*: shqetësim, entuziazëm, energji, eufori. *Shirrahu* i rinisë në fillimin e saj dhe zellin e saj. Imam Tahaviu thotë:

"Ky është zelli i muslimanëve në veprat e tyre, të cilat i afrojnë më shumë te Zoti i tyre. Mirëpo ata, me siguri, do të dështojnë dhe do t'i lënë disa vepra (të cilat i kanë filluar për shkak të zellit që kanë pasur). Prandaj prej veprave të tyre, më të dashurat për të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ishin ato të cilat bëheshin (dhe mbaheshin vazhdimisht), prandaj ai i urdhëronte të kryente vepra të mira, të cilat mund t'i kryenin vazhdimisht dhe t'u përmbaheshin deri në takimin me Zotin e tyre të Gjithëfuqishëm. Është transmetuar nga ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], që të sqarojmë këtë, se ka thënë: 'Veprat më të dashura tek All-llahu janë ato që janë të rregullta, edhe nëse janë të vogla.'"

shpie në sunnet, ka gjetur udhëzimin, ndërsa ai, shkarja e të cilit shpie në diçka tjetër pos kësaj, është shkatërruar.”³³³

Për këtë arsye, “ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk e këndonte tërë Kur'anin për më pak se tri ditë.”³³⁴

Ai thoshte:

“Kushdo që falet natën duke kënduar dyqind ajete, do të shkruhet si një prej të devotshmëve të singertë.”³³⁵

Po ashtu, “ai këndonte suren beni Israil (17: 111) dhe suren Ez-Zumer (39: 75) çdo natë.”³³⁶

Ai gjithashtu thoshte:

“Kushdo që falet natën duke kënduar njëqind ajete, nuk do të shkruhet si një prej të shkujdesurve.”³³⁷

Nganjëherë “ai këndonte rreth pesëdhjetë ajete ose më shumë ajete në secilin rekat”³³⁸, ose ai “këndonte vetëm suren El-Muzzemmil (73: 20).”³³⁹

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk falej gjatë tërë natës³⁴⁰, përveçse rrallëherë. Kështu njëherë: “Abdull-llah ibn Habbab ibn El-Ereti - i cili ishte prezent në Bedr (në

Unë them: ky hadith, të cilit ia shton fjalët “është transmetuar” është sahih, në çka u pajtuan Buhariu dhe Muslimi, nga rrëfimi i Aishes [radijall-llahu anhu].

³³² Ar. fetrah: interval, afat; duke iu referuar këtu fazës së entuziazmit të zvogëluar.

³³³ Ahmedi dhe Ibn Hibbani në Sahihun e tij.

³³⁴ Ibn Sa'di (1/376) dhe Ebu Esh-Shejhu në Ahlak En-Nebijj [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] (281).

³³⁵ Darimiu dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur sahih, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

³³⁶ Ibid.

³³⁷ Ahmedi dhe Ibn Nasri, me sened sahih.

³³⁸ Buhariu dhe Ebu Davudi.

³³⁹ Ahmedi dhe Ebu Davudi, me sened sahih.

³⁴⁰ Muslimi dhe Ebu Davudi. Ky dhe hadithe të tjera e bëjnë të papëlqyeshme (*mekruh*) të ndenjurit zgjuar tërë natën, qoftë rregullisht, qoftë përherë, sepse është në kundërshtim me shembullin e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Po të kishte qenë qëndrimi natën më i mirë, ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] do të kishte vepruar këssoj, e udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhammedit. Pra, mos u mashtroni me atë çka transmetohet nga Ebu Habifja (rahimehull-llah) se ai ka falur sabahun me abdestin e jacisë për dyzet vite me radhë!! Sepse ky transmetim prej tij ai është plotësisht i pabazë. Në të vërtetë, El-Al-lameh El-Fejruzabadiu thotë në *Er-Redd 'ala El-Mu'terid* (44/1):

“Ky transmetim është gënjeshtër e qartë dhe nuk mund t'i vishet Imamit, sepse nuk ka asgjë të dalluar në të. Kurse, në natyrën e imamit është t'i bëjë gjërat që janë të mira. Nuk ka dyshim se përsëritja e abdestit për çdo namaz është më e dalluar, më e plotë dhe më e mirë. Kjo është kështu, edhe në qoftë se është e saktë se ka qëndruar zgjuar pjesën më të madhe të natës për dyzet vite

Betejë) me të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] - qëndroi tërë natën me të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] (në një tjetër version: një natë kur u fal gjatë tërë natës), derisa agoi. Kur e kreu faljen, Habbabi i tha atij: “O i Dërguar i All-llahut, flijofsh im atë dhe ime ëmë për ty! Sonte ke falur një namaz çfarë unë kurrë nuk kam parë?” Ai tha: “Po, ishte namaz i shpresës dhe i frikës. (Vërtet) unë i kërkoja Zotit tim të Gjithëfuqishëm dhe Sublim tri gjëra. Ai m’i pranoi dy, por ma refuzoi një. E luta Zotin që të mos na shkatërrojë siç u shkatërruan popujt para nesh (në një tjetër version: që të mos e shkatërrojë umetin tim me uri), dhe Ai ma pranoi këtë. E luta Zotin tim të Gjithëfuqishëm dhe Sublim që të mos na e imponojë ndonjë armik nga jashtë, dhe Ai ma pranoi këtë. Dhe e luta Zotin që të na mbrojë nga përçarja, por këtë nuk ma pranoi.”³⁴¹

Po ashtu, një natë ai qëndroi (në namaz), duke e përsëritur vetëm një ajet deri në agim:

إِنْ تُعَذِّبُهُمْ فَإِنَّهُمْ عِبَادُكَ وَإِنْ تَغْفِرْ لَهُمْ فَإِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ (118)

“Nëse Ti i dënon ata, ata janë robërit e Tu; nëse i fal ata, Ti me të vërtetë je i Gjithëfuqishmi, i Urti” (Maide 5: 121) [me të bënte ruku, me të binte në sexhde dhe me të bënte dua]

Kështu që, në mëngjes Ebu Dherri [radijall-llahu anhu] i tha atij: “O i Dërguar i All-llahut, e këndove këtë ajet, derisa agoi, dhe ti bëre ruku me të dhe sexhde] [dhe bëre dua me të] [kurse All-llahu ta mësojë tërë Kur'anin;] [sikur ndonjëri prej nesh ta kishte bërë këtë, ne do të kishim qenë të hidhëruar në të”] [Ai tha: “Vërtet, unë e luta Zotin tim të Fuqishëm dhe Sublim të ndërmjetësoj për umetin tim dhe Ai ma pranoi këtë, dhe do të jetë i mundshëm për çdokënd, dashtë All-llahu, që nuk i bën shok All-llahut.”³⁴²

Një njeri i tha atij: “O i Dërguar i All-llahut, unë kam një fqinj i cili qëndron (në namaz) gjatë natës dhe nuk këndon tjetër gjë pos “Thuaj: All-llahu është Një” (Ihlas 112: 4), [duke e përsëritur,] [duke mos i shtuar asgjë], sikur ta konsideronte atë pak. “I Dërguari tha: “Pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, ajo vlen sa një e treta e Kur'anit.”³⁴³

7-Namazi i Vitrit

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] këndonte “Madhëroje emrin e Zotit tënd, më të Lartësuarit” (El-A’la 87: 19) në rekatën e parë, “Thuaj: O ju që nuk besuat” (Kafirun 109: 6) në të dytin, dhe “Thuaj: All-llahu është Një” (Ihlas 112: 4) në të tretin.”³⁴⁴

radhazi! Ky tregim më shumë i përngjan përrallës dhe është shpikje e disa injoranteve fanatikë, të cilët thonë për Ebu Hanifen dhe të tjerët vetëm gënjeshtër.”

³⁴¹ Nesaiu, Ahmedi dhe Taberaniu (1/187/2). Tirmidhiu e ka shpallur *sahih*.

³⁴² Nesaiu, Ibn Huzejme (1.70/1), Ahmedi; Ibn Nasri dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

³⁴³ Ahmedi dhe Buhariu.

³⁴⁴ Nesaiu * Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*.

Nganjëherë ai shtonte në të fundin **“Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit”** (Felek 113: 5) dhe **“Thuaj: I mbështetem Zotit të njerëzve”** (Nas 114: 6).³⁴⁵

Njëherë, “Ai këndoi njëqind ajete nga surja En-Nisa (4: 176) në rekatën e tretë.”³⁴⁶

Për sa i përket dy rekateve pas vitrit³⁴⁷, ai këndonte në to **“Kur toka të dridhet...”** (Zelzele 99: 8) dhe **“Thuaj: O ju që nuk besuat”** (Kafirun 109: 6).³⁴⁸

8- Namazi i xhumasë

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nganjëherë këndonte suren El-Xhumu’ah (62: 11) në rekatën e parë dhe **“Ku hipokritët të erdhën ty”** (Munafikun 63: 11) ³⁴⁹ në të dytin.

Nganjëherë këndonte **“A të erdhi ty lajmi për Kaplimin?”** (Gashijeh 88: 26) në vend të këtij të fundit.³⁵⁰

Ose nganjëherë “ai këndonte **“Madhëroje emrin e Zotit tënd, më të Lartësuarit”** (A’la 87: 19) në rekatën e parë dhe **“A të erdhi ty lajmi...”** (Gashijeh 88: 26) në të dytin.”³⁵¹

9- Namazi i Bajramit

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] (nganjëherë) këndonte **“Madhëroje emrin e Zotit tënd, më të Lartësuarit”** (A’la 87: 19) në rekatën e parë dhe **“A të erdhi ty lajmi...”** (Gashijeh 88: 26) në të dytin.”³⁵²

Ose nganjëherë “ai këndonte në të **“Kaf. Pasha Kur'anin Famëmadh.”** (Kafë 50: 45) dhe **“Momenti është afruar”** (Kamer 54: 55).”³⁵³

³⁴⁵ Tirmidhiu, Ebul-Abbas El-Esammi në *El-Hadith*-in e tij (vëll.2 nr.117) dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur sahih, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

³⁴⁶ Nesaiu dhe Ahmedi, me sened *sahih*.

³⁴⁷ Argumenti për këto dy rekate është gjetur në *Sahih Muslim* dhe te të tjerët si praktikë e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], por këto kundërshtojnë thënien e tij: **“Le të jetë namazi i fundit i natës tek (vitr)”**, transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi. Dijetarët u dalluan në pajtimin e këtyre dy haditheve dhe asnjëri prej tyre nuk ishte i bindshëm për mua, prandaj gjëja më e kujdesshme është që t’i lëmë këto dy rekate në pajtueshmëri me urdhrin e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. All-llahu e di më së miri. Më vonë, hasa në një hadith autentik që përmbante urdhrin për dy rekatet pas vitrit, prandaj urdhri i të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] përputhet me veprat e tij, dhe dy rekatet vlejné për çdokënd; urdhri i parë është rekomandim, duke mos mohuar dy rekatet. Hadithi i fundit është dhënë në *Silsijeh El-Ehadith Es-Sahihah* (1993) - shih Shtojcën 7.

³⁴⁸ Ahmedi dhe Ibn Nasri dhe Tahaviu (1/202) dhe Ibn Huzejme dhe Ibn Hibbani, me sened hasen *sahih*.

³⁴⁹ Muslimi dhe Ebu Davudi. Është dhënë në *El-Irva* (345).

³⁵⁰ Ibid.

³⁵¹ Muslimi dhe Ebu Davudi.

³⁵² Ibid.

³⁵³ Ibid.

10- Namazi i xhenazes

“Është Sunnet të këndohet El-Fatiha-ja³⁵⁴ [dhe një sure tjetër] në të.”³⁵⁵ Po ashtu, “ai heshte pak pas tekbirit fillestar.”³⁵⁶

³⁵⁴ Kjo është thënie e Imam Shafiun, e Ahmedit dhe e Is'hakut, dhe disa nga hanefitë e mëvonshëm a aprovuan këtë pikëpamje pas hulumtimeve. Sa i përket këndimin të sures pas saj, ky është mendim i disa shafive dhe është mendim i saktë.

³⁵⁵ Buhariu, Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn El-Xharudi. Shtojca nuk është *shadhdh* (e çuditshme), siç mendon Tuvejxhiri.

³⁵⁶ Nesaiu dhe Tahaviu, me sened *sahih*.

Tertili (Këndimi me tone të ngadalshme ritmike) dhe Zbukurimi i zërit gjatë këndimit

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] këndonte Kur'anin me tone të ngadalshme, të matura, ritmike, siç e mësoi All-llahu, duke mos u ngutur dhe duke mos nxituar. Në të vërtetë, ishte “këndim në të cilin theksohej qartë çdo shkronjë”³⁵⁷ aq shumë, saqë “ai këndonte ndonjë sure me tone aq të ngadalshme ritmike, saqë do të bëhej më e gjatë se ndonjë sure tjetër që ishte më e gjatë.”³⁵⁸

Ai po ashtu thoshte:

“Do t’i thuhet kënduesit të Kur'anit (në ditën e gjykimit): “Këndo dhe ngrihu. Këndo ngadalë dhe ritmikiqst sikurse që këndoje në botën e mëparshme. Vendi yt do të jetë në ajetin e fundit që do ta këndosh.”³⁵⁹

Ai e “zgjaste këndimin e tij (te shkronja e cila mund të zgjatej), sikurse janë bismil-lah, err-rrahman dhe err-rrahim”,³⁶⁰ dhe “nadiid” (Kaf 50: 100)³⁶¹ dhe të ngjashme me to.

Ai ndalej në fund të ajetit, siç kemi shpjeguar më parë.³⁶²

Nganjëherë “ai këndonte me ton të lëkundshëm dhe tërheqës”³⁶³ sikurse që bëri në Ditën e Pushtimit të Mekës, kur, duke qenë në devenë e tij, ai këndoi suren El-Fet-h (48: 29) [shumë butë]³⁶⁴, dhe Abdull-llah ibn Mugaffeli e ka transmetuar këtë ton atraktiv si: aaa.”³⁶⁵

Ai urdhëronte që të zbukurohet zëri gjatë këndimit të Kur'anit me ton të këndshëm, duke thënë:

³⁵⁷ Ibn El-Mubareku në *Ez-Zuhd* (162/1 nga El-Kevakibi 575), Ebu Davudi dhe Ahmedi, me sened *sahih*.

³⁵⁸ Muslimi dhe Maliku.

³⁵⁹ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, të cilët e kanë shpallur *sahih*.

³⁶⁰ Buhariu dhe Ebu Davudi.

³⁶¹ Buhariu në *Ef'al El-'ibad*, me sened *sahih*.

³⁶² Në pjesën “Këndimi i ajeteve një nga një”.

³⁶³ *Terxhi'* - i shpjeguar si ton lëkundës, nga Ibn Haxheri; Menaviu ka thënë:

“Vjen nga ndjenja e gëzim dhe e lumturisë, që ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] pat ndier ditën e pushtimit të Mekës.”

³⁶⁴ Buhariu dhe Muslimi.

³⁶⁵ Ibid. Ibn Haxheri thotë në komentin e tij të “aaa-së (III) ”:

“Kjo është *hemzeh* me fet'ha, e pasuar nga një *elif* i heshtur, dhe kjo duke u pasuar nga një *hemze* tjetër.”

Shejh Ali El-Kariu ka cituar njësoj nga të tjerët, dhe pastaj ka thënë:

“Është evidente se këto janë tri *elif*e të zgjatura.”

“Zbukurojeni Kur'anin me zërat tuaj [ngase zëri i bukur e shton bukurinë e Kur'anit]³⁶⁶ dhe

“Vërtet, ai i cili ka zërin më të bukur në mesin e njerëzve për këndimin e Kur'anit është ai, për të cilin mendoni se i frikësohet All-llahut, kur dëgjoni duke kënduar.”³⁶⁷

Ai po ashtu urdhëronte këndimin e Kur'anit me ton të këndshëm, duke thënë:

“Këndojeni vazhdimisht, mbajeni në mend dhe këndojeni me ton melodik, se, pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, ikën më shpejt se devetë nga litarët e tyre.”³⁶⁸

Ai po ashtu thoshte:

“Ai i cili nuk e këndon Kur'anin me ton të këndshëm, nuk është prej nesh.”³⁶⁹

Dhe “All-llahu nuk dëgjon asgjë sikurse që dëgjon (në disa versione: sikurse që është duke dëgjuar) të Dërguarin [me zë të mirë, dhe një version: me melodi të mirë], i cili e këndon Kur'anin me ton të këndshëm³⁷⁰ [me zë të lartë].”³⁷¹

Ai i tha Ebu Musa El-Eshariut [radijall-llahu anhu]:

“Sikur të më kishe parë mua duke dëgjuar këndimin tënd dje! Ty me siguri të është dhënë një prej instrumenteve frymore³⁷² të familjes së Davudit!” [Ebu Musa i tha: “Sikur ta kisha ditur se ke qenë aty, do ta kisha bërë zërin edhe më të këndshëm dhe më emocional për ty].”³⁷³

³⁶⁶ Buhariu si *ta'lik*, Ebu Davudi, Darimiu, Hakimi dhe Temam Er-Raziu me dy senede *sahih*.

Shënime: Ky hadith është kthyer mbrapsht nga njëri prej transmetuesve, i cili e ka transmetuar si “zbukuroni zërat tuaj me Kur'an”. Ky është një gabim në transmetim dhe kuptim, dhe kushdo që e shpall *sahih*, është kredhur në gabim, sepse kjo kundërshton transmetimet shpjeguese autentike në këtë pjesë. Në të vërtetë, ky është shembull eklatant i hadithit *maklub*, dhe detajet e këtij shënimi të shkurtër janë në *Silsileh El-Ehadih Ebu Davudi- Da'ifeh* (nr.5328).

³⁶⁷ Hadith *sahih* i transmetuar nga Ibn El-Mubareku në *Ez-Zuhd* (162/1 nga Kevakibi 575), nga Darimiu, Ibn Nasri, Taberaniu, Ebu Nu'ajmi në *Ahbar Asbehan* dhe nga Ed-Dija' në *El-Muhtareh*.

³⁶⁸ Darimiu dhe Ahmedi, me senede *sahih*.

³⁶⁹ Ebu Davudi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur, dhe Dhehebiu është pajtuar.

³⁷⁰ Mundhiriu ka thënë:

“*Taganna* do të thotë këndim me zë të këndshëm. Sufjan bin Ujejne dhe të tjerët kanë aprovuar pikëpamjen se kjo ka të bëjë *istigna*-në (d.m.th. shmangia e njeriut nga kënaqësitë e kësaj bote me anë të Kur'anit, por është refuzuar.”

³⁷¹ Buhariu, Muslimi, tahaviu, dhe Ibn Mende në *Et-Tehvid* (81/1).

³⁷² Dijetarët kanë thënë se instrumentet muzikore këtu nënkuptojnë zërin e bukur dhe se familja e Davudit parakupton vetë Davudin; familja e filanit parakupton vetë filanin; Davudi (alejhisselam) kishte një zë jashtëzakonisht të bukur. Kjo është përmendur nga Neveviu në komentimin e tij mbi *Sahihun* e Muslimit.

³⁷³ Abdurr-Rrezzaku në *El-Emali* (2/44/1), Buhariu, Muslimi, Ibn Nasri dhe Hakimi.

Përmirësimi i Imamit

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] la shembullin për përmirësimin e imamit, kur këndimi i tij ngatërrohet, kur njëherë “ai u fal duke kënduar me zë dhe këndimi iu ngatërrua, kështu, kur e kreu, i tha Ubejjit: “A u fale me ne?” Ai u përgjigj: “Po.” Ai tha: “E çka të ndaloi ty [të më përmirësoje]?”³⁷⁴

Kërkimi i strehimit dhe pështyerja lehtas gjatë namazit me qëllim të sprapsjes së tundimit

Uthman bin Ebi El-Asi [radijall-llahu anhu] i ka thënë atij: “O i Dërguar i All-llahut! Djalli ndërhyr ndërmjet meje dhe namazit tim duke më ngatërruar në këndim!” I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i tha: “Ai është djalli i quajtur Hinzeb, prandaj, kur ta vëshesh këtë, kërko strehim tek All-llahu nga ai dhe pështyjë lehtas³⁷⁵ në anën e majtë tri herë”. Ai tha: “Kur e bëra këtë, All-llahu e detyroi të largohet prej meje.”³⁷⁶

³⁷⁴ Ebu Davudi, Ibn Hibbani, Taberaniu, Ibn Asakiri (2/296/2) dhe Ed-Dija në *El-Muhtarah* me sened *sahih*.

³⁷⁵ Ar. *teff*: nxjerrja e sasisë më të vogël të pështymës - *Nihajeh*.

³⁷⁶ Muslimi dhe Ahmedi. Neveviu (rahimehull-llah) thotë:

“Ky hadith përmban pëlqimin për kërkimin e strehimit nga djalli kur ai tundon, së bashku me pështyrjen në të majtë tri herë.”

Rukuja (përkulja)

Pasi e mbaronte këndimin, ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] pushonte për një çast³⁷⁷, pastaj i ngrinte duart³⁷⁸ në mënyrën që është përshkruar më parë në “Tekbirin fillestar”, thoshte tekbirin³⁷⁹ dhe bënte ruku³⁸⁰.

Ai, po ashtu, e urdhëroi “atë që u fal keq” të vepronte kështu duke i thënë:

“Vërtet, namazi i ndonjërit prej jush nuk është i plotë, derisa të marrë abdest si duhet, ashtu siç e ka urdhëruar All-llahu... pastaj të deklamojë Madhërinë e All-llahut, ta lavdërojë dhe ta madhërojë Atë, pastaj të këndojë Kur'an, aq sa i vjen më së lehti atij nga ajo çka All-llahu e ka mësuar dhe i ka lejuar, pastaj të thotë tekbirin dhe të bëjë ruku [dhe t'i vendosë duart e tij në gjunjë], derisa t'i qetësohen nyjat e tij...”³⁸¹

Përshkrimi i përkuljes

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i vendoste shuplakat në gjunjët e tij”³⁸² dhe “i urdhëronte ata të vepronin kështu”³⁸³, siç e urdhëroi “atë që fal keq” në hadithin teksa të përmendur.

“Ai vendoste duart e tij fort në gjunjë [sikur të ishte duke i kapur ato]”³⁸⁴, dhe “i hapte gishtërinjtë”³⁸⁵, duke e urdhëruar “atë që u fal keq” të vepronte kështu, duke i thënë:

³⁷⁷ Ebu Davudi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

³⁷⁸ Buhariu dhe Muslimi. Kjo ngritje e duarve është transmetuar si *mutevatir* nga ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], si dhe ngritja e duarve pas drejtimit nga rukuja. Ky është medhheb i tre imamëve - Malikut, Shafiut dhe Ahmedit dhe i shumicës së dijetarëve të hadithit dhe të fikhut. Imam Maliku (rahimehull-llah) e ka praktikuar këtë deri në vdekje, siç është kumtuar nga Ibn Asakiri (15/78/2). Disa prej hanefive e bënin këtë, në mesin e tyre Isam bin Jusuf Ebu Asameh El-Belhiu (d.210), nxënës i Imam Ebu Jusufit (rahimehull-llah), siç është shpjeguar në hyrje. Abdull-llah ibn Ahmedi ka transmetuar nga i ati i vet në *Mesail*-in e tij (f.60), (“Është transmetuar nga Ukbeh bin Amir se ai ka thënë për atë që i ngre duart gjatë namazit: “Ai i përfiton nga dhjetë vepra të mira, sa herë që i ngre duart”. Kjo është e mbështetur nga hadithi *kudsij*, “...ai që ka për qëllim një vepër të mirë dhe e kryen atë, All-llahu ia shkruan atij dhjetë deri në shtatëqind vepra të mira”, transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi. Shih *Sahih Et-Tergib*, nr.16.

³⁷⁹ Ibid.

³⁸⁰ Ibid.

³⁸¹ Ebu Davudi dhe Nesai, hakimi e ka shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

³⁸² Buhariu dhe Ebu Davudi.

³⁸³ Buhariu dhe Muslimi.

³⁸⁴ Buhariu dhe Ebu Davudi.

³⁸⁵ Hakimi i cili e ka shpallur atë *sahih*; Dhehebiu dhe Tajalisi janë pajtuar. Është dhënë në *Sahih Ebi Davud* (809).

“Kur të bësh ruku, vendosi shuplakat në gjunjë, pastaj hapi gishtërinjtë, pastaj qëndro (ashtu) derisa çdo gjymtyrë të bjerë në vendin e vet (të duhur).”³⁸⁶

“Ai zgjerohej (d.m.th. nuk përmbledhej, nuk bëhej kruspull) dhe mbante bërrylat anash, larg nga trupi.”³⁸⁷

“Kur ai bënte ruku, e rrafshonte shpinën dhe e drejtonte atë”,³⁸⁸ “saqë, po të derdhej ujë në të, ai (uji) do të mbetej aty (d.m.th. nuk do të derdhej).”³⁸⁹ Ai, po ashtu, i tha “atij që u fal keq”:

“Kur të bësh rukunë, vendosi shuplakat në gjunjë, zgjeroje shpinën dhe përqendrohu në rukunë tënde.”³⁹⁰

“Ai as nuk e linte kokën të bjerë poshtë e as nuk e ngrinte (d.m.th. më lart se shpina e tij)”³⁹¹, por e linte në mes.³⁹²

Obligimi i qetësimit në ruku

Ai rrinte i qetë në ruku dhe urdhëroi “atë që u fal keq” të vepronte kështu, siç është cekur në pjesën e parë të rukusë. Ai thoshte:

“Plotësojeni rukunë dhe sexhden, se pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, unë vërtet ju shoh edhe pas shpinës”³⁹³ sime, kur bëni ruku dhe sexhde.”³⁹⁴

“Ai e pa një njeri duke u falur dhe duke mos e plotësuar rukunë si duhet dhe duke çukitur në sexhden e tij, prandaj tha:

“Sikur ky njeri të vdiste në këtë gjendje, do të vdiste në një besim tjetër e jo në atë të Muhammedit, [duke çukitur në sexhde, sikur sorra që çukit gjakun; ai i cili

³⁸⁶ Ibn Huzejme dhe Ibn Hubbani në *Sahihët* e tyre.

³⁸⁷ Tirmidhiu, i cili e ka shpallur *sahih*.

³⁸⁸ Buhariu dhe Bejhekiu, me *sened sahih*.

³⁸⁹ Taberaniu në *Nu'xhem El-Kebir* dhe *Mu'xhem Es-Sagir*, Abdull-llah bin Ahmedi në *Zevaid El-Musned*, dhe Ibn Maxhe.

³⁹⁰ Ahmedi dhe Ebu Davudi, me *sened sahih*.

³⁹¹ Ebu Davudi dhe Buhariu në *Xhuz El-Kiraeh*, me *sened sahih*.

³⁹² Muslimi dhe Ebu Avane.

³⁹³ Kjo pamje ka qenë fizikisht reale dhe ka qenë një nga mrekullitë e tij; ka qenë e kufizuar gjatë faljes: nuk ka dëshmi se ka qenë e natyrës së përgjithshme.

³⁹⁴ Buhariu dhe Muslimi.

nuk e plotëson rukunë dhe çukit në sexhde është sikur njeriu i uritur që ha një ose dy hurma, të cilat nuk i bëjnë kurrfarë dobie.³⁹⁵"

Ebu Hurejre [radijall-llahu anhu] ka thënë:

"Shoku im i ngushtë [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] më ndaloi që të çukit në namaz si këndes, të shikoj rreth e rrotull si dhelpër dhe të rri galiç si majmun"³⁹⁶

I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] po kështu thoshte:

"Hajduti më i keq në mesin e njerëzve është ai, që vjedh në namazin e tij". Ata thanë: "O i Dërguar i All-llahut, po si vjedh ai nga namazi?" Ai tha: "Ai nuk e plotëson rukunë dhe sexhden e tij."³⁹⁷

Njëherë, "ai ishte duke u falur, kur nga këndi i syrit të tij vështroi një njeri që nuk e drejtonte shpinën në ruku dhe sexhde. Kur e kreu, ai tha:

"O grumbull i muslimanëve! Vërtet, namazi i atij që nuk e drejton kurrizin në ruku dhe sexhde, nuk vlen."³⁹⁸

Ai ka thënë në një hadith tjetër:

"Namazi i njeriut nuk numërohet po që se ai nuk e drejton shpinën në ruku dhe në sexhde."³⁹⁹

Dhikret e rukunë

Ai thoshte përkujtime të ndryshme të All-llahut dhe dua; herë e thoshte njëren, herë tjetren:

1- ((سُبْحَانَ رَبِّيَ الْعَظِيمِ))

³⁹⁵ Ebu Ja'la në *Musnedin* e tij (340/3491/1), Axhuriu në *El-Erbe'in*, Bejhekiu, Taberaniu (1/192/1), Ed-Dija në *El-Munteka* (276/1), Ibn Asakiri (2/226/2, 414/1, 8/14/1, 76/2), me *sened hasen*, dhe Ibn Huzejme e ka shpallur *sahih* (1/82/1). Ibn Battah ka transmetim *mursel* përforcues për pjesën e parë të hadithit, pa shtojcën në *El-Ibaneh* (5/43/1).

³⁹⁶ Tajalisi, Ahmedi dhe Ibn Ebi Shejbe; është *hadith hasen*, siç kam shpjeguar në fusnotat e mia në *El-Ahkam* (1348) nga Abdul-Hakk El-Ishbili.

³⁹⁷ Ibn Ebi Shejbe (1/89/2), Taberaniu dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

³⁹⁸ Ibn Ebi Shejbe (1/89/1), Ibn Maxhe dhe Ahmedi, me *sened sahih*.

³⁹⁹ Ebu Avane, Ebu Davudi dhe Sehmiu (61); Durekutniu e ka shpallur *sahih*.

1-

"Sa i

përsosur është Zoti im, i Madhërishmi!" Tri herë.⁴⁰⁰ Por, nganjëherë e përsëriste më shumë.⁴⁰¹

Njëherë, në namazin e natës, e përsëriti aq shumë, saqë rukuja e tij u zgjat sa qëndrimi para saj, në të cilin kishte kënduar tri nga Suret e Gjata: El-Bekare, En-Nisa dhe Ali Imran. Ky namaz ishte përplot dua dhe kërkim faljeje. Ky hadith është përmendur nën "Këndimi në namazin e natës."

-2 ((سُبْحَانَ رَبِّيَ الْعَظِيمِ وَبِحَمْدِهِ))

2-

"Sa i

përsosur është Zoti im, i Madhërishmi dhe i Lavdëruar qoftë Ai", tri herë.⁴⁰²

-3 ((سُبُّوحٌ قُدُّوسٌ رَبُّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ))

3-

"I

Përsosur, i Bekuar⁴⁰³, Zoti i engjëjve dhe i Shpirtit."⁴⁰⁴

-4 ((سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي))

4-

"Sa i

përsosur je, o All-llah dhe Lavdërimet janë për Ty. O All-llah, më fal". Ai përsëriste këtë shpesh në ruku dhe në sexhde, duke zbatuar (urdhrin) Kur'anin.⁴⁰⁵

⁴⁰⁰ Ahmed, Ebu Davudi, Ibn Maxhe, Derekutniu, Tahaviu, Bezzari dhe Tabariniu në *Mu'xhem El-Kebir*, nën autoritetin e shtatë Sahabëve. Prandaj kjo përgënjeshtrohet ata të cilët nuk e pranuan përkufizimin e lavdërimeve (*tesbih*-ut) në tri herë, siç janë Ibn El-Kajjimi dhe të tjerët.

⁴⁰¹ Kjo mund të kuptohet nga hadithe të cilat e bëjnë të qartë se ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i ka bërë kijamin, rukunë dhe sexhden, të njëjta në gjatësi, siç ceket pas kësaj pjese.

⁴⁰² *Hadith sahih*, i transmetuar nga Ebu Davudi, Darekutniu, Ahmed, Taberaniu dhe Bejhekiu.

⁴⁰³ Ebu Is-haku ka thënë: *subbuh* do të thotë "ai që është i pastër prej çdo të mete", derisa *kuddus* do të thotë "i Bekuar" ose "i Pastër". Ibn Sejde ka thënë:

"I Madhërishëm dhe i Bekuar janë atribute të All-llahut, të Gjithëfuqishëm dhe Sublim, sepse ai madhërohet dhe shenjtërohet nga të tjerët". (*Lisan El-Arab*)

⁴⁰⁴ Muslimi dhe Ebu Avane.

⁴⁰⁵ Buhariu dhe Muslimi. "Zbatimi i Kur'anit i referohet thënies së All-llahut:

"Lartësoje me Lavdërime Zotin tënd, dhe kërko falje nga Ai, se vërtet Ai është Mëshirues i Madh." (Nasr 110: 3)

5- ((اللَّهُمَّ لَكَ رَكَعْتُ وَبِكَ آمَنْتُ وَلَكَ أَسْلَمْتُ [أَنْتَ رَبِّي] خَشَعَ لَكَ سَمْعِي وَبَصَرِي وَمُخِّي وَعَظْمِي وَعَصْبِي [وَمَا اسْتَقَلْتُ بِهِ قَدَمِي اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ]))

5- "O All-llah! Ty të jam përkulur; në Ty kam besuar; Ty t'u kam nënshtruar; [Ti je Zoti im]; Të përlurur për Ty janë të dëgjuarit tim, të parët tim, palca ime, ashti im (në një transmetim: eshtrat e mia), muskujt e mi, [dhe çdo gjë që këmbët e mia bartin⁴⁰⁶, janë të përlurur për All-llahun, Zotin e botëve].⁴⁰⁷

6- ((اللَّهُمَّ لَكَ رَكَعْتُ وَبِكَ آمَنْتُ وَلَكَ أَسْلَمْتُ وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ أَنْتَ رَبِّي خَشَعَ سَمْعِي وَبَصَرِي وَدَمِي وَلَحْمِي وَعَظْمِي وَعَصْبِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ))

6- "O All-llah! Ty të jam përkulur; në ty kam besuar; Ty t'u kam nënshtruar; në Ty unë jam mbështetur; Ti je Zoti im; të dëgjuarit tim, të parët tim, gjaku im, eshtrat e mia dhe muskujt e mi vuajnë për All-llahun, Zotin e botëve].⁴⁰⁸

7- ((سُبْحَانَ ذِي الْجَبَرُوتِ وَالْمَلَكُوتِ وَالْكِبْرِيَاءِ وَالْعَظَمَةِ))

7- "Sa i përsosur është Ai, i Cili ka gjithë Pushtetin, Mbretërinë, Madhësinë dhe Epërsinë', të cilën e thoshte në namazin e natës.

Zgjatja e Rukusë

⁴⁰⁶ Ky është shembull i përdorimit të frazës së përgjithshme pas përmendjes së gjërave individuale.

⁴⁰⁷ Muslimi, Ebu Avane, Tahaviu dhe Darekutniu.

⁴⁰⁸ Nesaiu me *sened sahih*.

Shënim: A ka dëshmi për kombinimin e dy a më shumë dhikre në një ruku, apo jo? Dijetarët janë dalluar në lidhje me këtë. Ibn el-Kajjimi ishte i pasigurt për këtë në *Zad el-Me'ad*. Neveviu zgjodhi mundësinë e parë në *El-Edhkar*, duke thënë:

Është më së miri të kombinohen të gjitha këto dhikre, nëse është e mundur, e po kështu edhe me dhikret në pozitë të tjera."

Ebu el-Tajjib Siddik Hasan Kani nuk u pajtua me të, duke thënë në *Nuzul el-Ebrar*:

"Është transmetuar me njërin këtu, e tjetrin atje, por nuk shoh asnjë dëshmi për kombinim. I

Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk i kombinonte ato në një vend, por herë e thoshte njërin, e herë tjetrin; të pasohet një gjë është më mirë se të niset diçka e re."

Pikëpamja e fundit është e saktë, dashtë All-llahu, por është dëshmuar nga Sunneti zgjatja e kësaj pozite, si edhe e pozitave të tjera, derisa të arrijnë gjatësinë e qëndrimit në këmbë (kijamit): kështu, nëse adhuruesi do të dëshironte të pasonte të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në këtë sunnet, mënyra e vetme do të ishte kombinimi i dhikre, siç ka bërë edhe 'Atau, ose të përsëritet një dhikr për të cilin ekziston teksti për përsëritje, dhe kjo është më afër Sunnetit. All-llahu e di më së miri.

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e bënte rukunë, qëndrimin pas rukusë, sexhden e tij dhe uljen e tij mes dy sexhdeve gati të njëjta në gjatësi.”⁴⁰⁹

Ndalimi i këndimit të Kur'anit në Ruku

“Ai ndalonte këndimin e Kur'anin në ruku dhe në sexhde.⁴¹⁰ Me të vërtetë, më është ndaluar të lexojmë Kur'an në ruku dhe sexhde, prandaj në ruku madhërojeni Sipërinë e Zotit, të Gjithëfuqishëm dhe Sublim; ndërsa në sexhde përpikuni me dua, sepse ka gjasa që do t'ju përgjigjet.”⁴¹¹

Të drejtuarit pas rukusë dhe çka duhet thënë atëherë

Pastaj, “ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] drejtonte shpinën duke u ngritur nga rukuja, duke thënë:

((سَمِعَ اللَّهُ لِمَنْ حَمِدَهُ))

(All-llahu e dëgjon atë që e falënderon/lavdëron Atë).⁴¹²

Ai, po ashtu, e urdhëroi “atë që u fal keq” ta bënte këtë, kur ai i tha atij:

“Namazi i asnjërit nuk është i plotë derisa... ta thotë tekbinin... pastaj ta bëjë rukunë... pastaj të thotë “All-llahu e dëgjon atë që e falënderon/lavdëron Atë” derisa të drejtohet.”⁴¹³

Kur e ngrinte kokën, ai qëndronte drejt derisa çdo rruazë të kthehej në vendin e vet.⁴¹⁴ Pastaj, “ai thoshte duke qëndruar në atë pozitë:

((رَبَّنَا [وَ] لَكَ الْحَمْدُ))

(Zoti ynë, [dhe] Ty të qofshin të gjitha falënderimet/lavdërimet).⁴¹⁵

⁴⁰⁹ Buhariu dhe Muslimi. Është shënë në *Irva El-Galil* (331).

⁴¹⁰ Muslimi dhe Ebu Avane. Ndalesa është e përgjithshme, si për namazet e obligueshme, ashtu edhe për ato vullnetare. Shtojca në Ibn Asakir (17/299/1), “sa i përket namazeve vullnetare, atëherë s’ka gjë” është ose *shadhhdh*, ose *munker* - Ibn Asakiri ka vënë në dukje një defekt në të - prandaj nuk është e lejuar të veprohet me të.

⁴¹¹ Ibid.

⁴¹² Buhariu dhe Muslimi.

⁴¹³ Ebu Davudi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur sahih, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

⁴¹⁴ Buhariu dhe Ebu Davudi; Ar. *fekar*: rruazat, “eshtrat që formojnë kurrizin, nga baza e qafës deri te kocka e bishtit”, sipas *Kamus-it*; shih po ashtu në *Fet-h El-Bari* (2/308).

⁴¹⁵ Buhariu dhe Muslimi.

Ai i ka urdhëruar të gjithë adhuruesit, qenë a nuk qenë pas Imamit, të bëjnë të lartpërmendurën në ngritjen prej rukusë, duke thënë:

((صَلُّوا كَمَا رَأَيْتُمُونِي أُصَلِّي))

“Faluni ashtu siç më keni parë mua duke u falur.”⁴¹⁶

Ai, po ashtu, thoshte:

“Imami është që të përcillet... kur ai të thotë: “All-llahu e dëgjon atë që e falënderon-lavdëron Atë”, atëherë ju thoni: “[O All-llah] Zoti ynë, Ty të qofshin të gjitha falënderimet/lavdërimet”; All-llahu do t’ju dëgjojë, sepse, vërtet All-llahu I Bekuar dhe i Lartësuar ka thënë nëpërmjet gjuhës së të Dërguarit të Tij [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]: “All-llahu e dëgjon atë që e falënderon-lavdëron Atë.”⁴¹⁷

Ai ka treguar edhe arsyen për këtë urdhër në një hadith tjetër, duke thënë:

“...atij të cilit i përputhet thënia me atë të engjëjve, do t’i falen mëkatet e kaluara.”⁴¹⁸

Ai i ngrinte duart kur drejtohej⁴¹⁹, në mënyrën që është përshkruar në Tekbirin Fillestar. Derisa qëndronte ai thoshte, siç u përmend më parë:

1- ((رَبَّنَا [وَ] لَكَ الْحَمْدُ))

1-

"Zoti

ynë, dhe Ty të qofshin të gjitha falënderimet/lavdërimet"⁴²⁰; ose

⁴¹⁶ Ibid.

⁴¹⁷ Muslimi, Ebu Avane, Ahmedi dhe Ebu Davudi.

*NB: Ky hadith nuk dëshmon se ata që falen pas Imamit nuk duhet të thotë bashkë me imamin: All-llahu e dëgjon atë që e falënderon-lavdëron Atë, sikur që nuk dëshnon se imami nuk duhet të thotë bashkë me ata që e përcjellin, në thënien: Zoti ynë, Ty të qofshin të gjitha falënderimet. Për shkak se qëllimi i këtij hadithi nuk është që të tregojë saktësisht se çka duhet të thonë imami dhe përcjellësit e tij në këtë pozitë; para së gjithash hadithi shpjegon se i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e thoshte tahmidin kur ai ishte imam, dhe po ashtu ngase përgjithësia e thënies së tij, “Faluni siç më keni parë mua duke u falur” dikton që përcjellësi duhet të thotë atë që thotë Imami p.sh. tasmi-në, etj. Vëllezërit e respektuar që na u drejtuan neve për këtë çështje duhet të kenë parasysh këtë, dhe ndoshta kjo çka përmendëm është e mjaftueshme. Kushdo që dëshiron të diskutojë më shumë rreth kësaj çështjeje duhet t’i drejtohet artikullit të El-Hafidh Es-Sujutiut në librin e tij El-Havi ili-Fetavi (1/529).

⁴¹⁸ Buhariu dhe Muslimi; Tirmidhiu e ka shpallur sahih.

⁴¹⁹ Buhariu dhe Muslimi. Ngritja e duarve këtu është transmetuar në mënyrë mutevatir nga i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], dhe shumica e dijetarëve e kanë përkrahur këtë, duke përfshirë edhe disa hanefi. Shih fusnotën e mëparshme nën Ruku

⁴²⁰ Ibid.

2- ((رَبَّنَا لَكَ الْحَمْدُ))

2-

"Zoti

ynë, Ty të qofshin të gjitha falënderimet/lavdërimet".⁴²¹

Ndonjëherë ai shtonte në fillim të secilës prej tyre:

3- ((اللَّهُمَّ ...))

3, 4- O All-llah!...⁴²²

Ai i urdhëronte të tjerët ta bënë këtë, duke thënë:

"Kur të thotë imami: All-llahu e dëgjon atë që e falënderon/lavdëron Atë, atëherë thoni: O All-llah! Zoti ynë, Ty të qofshin të gjitha falënderimet/lavdërimet, sepse atij të cilit i përputhet thënia me atë të engjëjve, do t'i falen mëkatet e kaluara."⁴²³

Nganjëherë ai shtonte ose:

5- ((مِلْءُ السَّمَاوَاتِ وَمِلْءُ الْأَرْضِ وَمِلْءُ مَا بَيْنَهُمَا مِنْ شَيْءٍ بَعْدُ))

5- "... duke mbushur qiejt, duke mbushur tokën, dhe duke mbushur çdo gjë që Ti dëshiron"⁴²⁴, ose

6- ((مِلْءُ السَّمَاوَاتِ وَمِلْءُ الْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا وَمِلْءُ مَا شِئْتَ مِنْ شَيْءٍ بَعْدُ))

6- "...duke mbushur qiejt [duke mbushur] tokën, gjithë çka është ndërmjet tyre, dhe duke mbushur çdo gjë që Ti dëshiron".⁴²⁵ Nganjëherë ai shtonte edhe më shumë:

7- ((أَهْلَ التَّوْبَةِ وَالْمَجْدِ لَا مَانِعَ لِمَا أُعْطِيَ وَلَا مُعْطِيَ لِمَا مَنَعْتَ وَلَا يَنْفَعُ ذَا الْجَدِّ مِنْكَ الْجَدُّ))

⁴²¹ Ibid.

⁴²² Buhariu dhe Ahmedi. Ibn El-Kajjimi (rahimehull-llah) ka gabuar në këtë pikë në *Zad El-Me'ad* duke refuzuar kombinimin e "O All-llah!" me "dhe", përkundër faktit se është gjetur në *Sahih El-Buhari*, *Musned Ahmed*, në Nesai dhe prapë në Ahmed përmjet dy rrugëve të transmetimit nga Ebu Hurejre, në Darimi si hadith i Ibn Umerit, në Bejheki nga Ebu Se'id El-Hudriu, dhe prapë në Nesai si hadith i Ebu Musa El-Eshariut.

⁴²³ Buhariu dhe Muslimi; Tirmidhiu e ka shpallur *sahih*.

⁴²⁴ Muslimi dhe Ebu Avane

⁴²⁵ Ibid.

“All-llahu e dëgjon atë që e falënderon/lavdëron Atë”.

Kur i Dërguari i All-llahut e përfundoi namazin e tij, tha: “Kush foli pak më parë?” Burri tha: “Unë, o i Dërguar i All-llahut.” E i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: “I pashë tridhjetë engjëj duke nxituar se kush do të shkruajë i pari.”⁴³⁰

Zgjatja e këtij qëndrimi dhe obligimi për t’u qetësuar në të

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e zgjaste këtë qëndrim gati sa rukunë, siç është cekur; në të vërtetë, “ai qëndronte (aq shumë) nganjëherë, sa që dikush do të thoshte: “Ai ka harruar” [për shkak të qëndrimit të gjatë.]”⁴³¹

Ai i udhëzonte ata që të qetësoheshin në të. Kështu, ai i tha “atij që u fal keq”,

“... Pastaj ngrite kokën derisa të qëndrosh drejt [dhe çdo asht të bjerë në vend të vet]” - në një tjetër transmetim, “Kur të ngrihesh, drejtoje kurrizin dhe ngritje kokën, derisa eshtrat të kthehen në nyjat e tyre.”⁴³²

⁴³⁰ Maliku, Buhariu dhe Ebu Davudi.

⁴³¹ Buhariu, Muslimi dhe Ahmed. Është dhënë në *El-Irva* (nr.307).

⁴³² Buhariu dhe Muslimi (vetëm fjala e parë), Darimiu, Hakimi, Shafiu dhe Ahmed. Me “eshtra” këtu nënkuptohen ato të strukturës kurrizore, rruazat, siç paraprin në tekstin kryesor.

*NB: Kuptimi i këtij hadithi është i qartë dhe evident: të qetësuarit në këtë pozitë. Sa i përket shfrytëzimit të këtij hadithi nga vëllezërit tanë nga Hixhazi dhe vendet e tjera si dëshmi për vendosjen e dorës së djathtë mbi të majtën në këtë pozitë, kjo është shumë larg nga kuptimi i shumë transmetimeve të këtij hadithi. Në fakt, është argument i rremë, pasi vendosja e përmendur nuk i referohet qëndrimit të parë në asnjë transmetim ose tekst të hadithit; prandaj, si është e mundur që “eshtrat të bien në vendin e duhur” e përmendur në hadith të interpretohet si referim për vendosjen e dorës së djathtë mbi të majtën para rukusë?! Kjo do të përshtatej sikur të gjitha versionet e hadithit të konstruktoheshin për të nënkuptuar këtë, e çka pra kur ato aludojnë qartë në një kuptim tjetër? Në fakt, kjo vendosje e tyre nuk mund të nxirret nga ky hadith fare, pasi me atë që nënkuptohet me : eshtra” është eshtrat e kurrizit, siç vërtetohet në Sunnet, “...ai qëndronte drejt derisa çdo vertebër të kthehej në vendin e vet.”

Unë, për një gjë, nuk jam fare në dyshim se vendosja e duarve në gjoks në këtë qëndrim është risi dhe lajthitje, sepse nuk është përmendur në asnjë hadith mbi namazin, përkundër numrit të madh të tyre. Sikur të kishte pasur kjo praktikë ndonjë bazë, do të na kishte ardhur së paku me një transmetim. Pastaj, asnjë nga Selef i nuk e ka praktikuar, e as që është përmendur prej një dijetari të vetëm udhëheqës të hadithit, sa di unë.

Kjo nuk është në kundërshtim me atë çka Shejh Et-Tuvejxhiri ka cituar nga Imam Ahmed (rahimehull-llah) në artikullin e tij,

“Nëse ndokush do, mund t’i lërë duart e veta anash, ose nëse do, mund t’i vendosë në gjoks”, Imam Ahmed nuk ia atribuoi këtë të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], por e ka thënë nga mendimi dhe ixtihadi i tij, ndërsa mendimi mund të jetë i gabuar. Kur argumenti autentik vërteton natyrën novatore të ndonjë praktike siç është kjo, atëherë thënia e një imami në dobi të saj nuk mohon të qenët e saj risi, siç ka shkruar Shejhul-Islam Ibn Tejmijje (rahimehull-llah). Në të vërtetë, unë shoh në fjalët e tij një indikacion se Imam Ahmed nuk e ka konsideruar vendosjen e lartpërmendur si të dëshmuar në sunnet, sepse ai ka lejuar zgjedhjen mes praktikimit të tij dhe lënies së tij! - A ka menduar dijetari i respektuar se Imami, po ashtu, ka lejuar zgjedhje të ngjashme në lidhje me vendosjen e duarve para rukusë? Kështu pra, është dëshmuar se vendosja e duarve në gjoks në qëndrimin pas rukusë nuk është pjesë e Sunnetit. Ky është një diskutim i

Ai, po ashtu, e rikujtoi atë: se namazi i askujt nuk është i plotë derisa ta bëjë këtë, dhe thoshte:

“All-llahu i Madhëruar dhe Sublim nuk shikon në namazin e atij robi që nuk e drejton kurrizin mes rukusë dhe sexhdes.”⁴³³

shkurtër për këtë çështje, që do të mund të ndahej në më shumë detaje dhe analiza, mirëpo për shkak të mungesës së hapësirës këtu, ajo është bërë në Përgënjeshttrimin tim të Shejh Tuvejjiriut.

⁴³³ Ahmedi dhe Taberaniu në *Mu'xhem El-Kebir*, me *sened sahih*.

Sexhdja

Pastaj, “ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thoshte tekbirin dhe binte në sexhde”⁴³⁴ dhe e urdhëroi “atë që u fal keq” të vepronte kështu duke i thënë:

“Namazi i askujt nuk është i plotë derisa... ai të thotë: All-llahu e dëgjon atë që e falënderon-lavdëron Atë, dhe të drejtohet, pastaj të thotë: All-llahu është më i Madhi, dhe të bjerë në sexhde, derisa gjymtyrët e tij të qetësohen.”⁴³⁵

Po ashtu, “kur ai donte të bënte sexhde, thoshte tekbirin [i lëshonte duart anash], dhe pastaj bënte sexhde.”⁴³⁶ Ndonjëherë, “i ngrinte duart, kur binte në sexhde”⁴³⁷

Rënia në sexhde me duar

“Ai vendoste duart e tij në tokë para gjunjëve.”⁴³⁸

Ai edhe urdhëronte kësisoj duke thënë:

“Kur të bëjë ndokush nga ju sexhde, të mos gjunjëzohet si deveja, por le t’i vendosë duart e tij para gjunjëve.”⁴³⁹

⁴³⁴ Buhariu dhe Muslimi.

⁴³⁵ Ebu Davudi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

⁴³⁶ Ebu Ja’la në *Musnedin* e tij (284/2) me *sened* të mirë, dhe Ibn Huzejme (1/79/2) me *sened* tjetër *sahih*.

⁴³⁷ Nesaiu, Darekutniu dhe El-Muhlisi në *El-Fevaid* (1/2/2) me dy *senede* *sahih*. Kjo ngritje e duarve është kumtuar nga dhjetë Sahabë, dhe një numër i Selefit e kanë trajtuar si të saktë, në mesin e tyre Ibn Umer, Ibn Abbasi, El-Hasan El-Basriu, Tavusi, djali i tij Abdull-llahu, Nafiu, robi i liruar i Ibn Umerit, Salimi i biri i Ibn Umerit, El-Kasim bin Muhammedi, Abdull-llah bin Dinari dhe ‘Atau. Po ashtu, Abdurr-rahman bin Mehdiu ka thënë: “Kjo është sunnet”, është praktikuar nga Imami i Sunnetit, Ahmed ibn Hanbeli dhe është cituar nga Maliku dhe Shafiu.

⁴³⁸ Ibn Huzejme (1/76/1), Darekutniu dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar. Të gjitha hadithet që kundërshtojnë këtë, janë joautentike. Kjo rrugë është mbështetur nga Maliku dhe njësoj është transmetuar nga Ahmedi në *El-Tahkik*-un e Ibn El-Xhevziut (108/2). Po ashtu, Merveziu ka cituar me *sened* *sahih* Imam El-Evza’iun në *Mesail*-in e tij (1/147/1), i cili ka thënë: “Kam parë njerëz duke i vendosur duart para gjunjëve.”

⁴³⁹ Ebu Davudi, Temami në *El-Fevaid* dhe Nesaiu në *Sunen Es-Sugra* dhe *Sunen El-Kubra* (47/1), me *sened* *sahih*. Abdul-Hakku e ka shpallur *sahih* në *El-Ahkam* (54/1) dhe pastaj ka vazhduar të thotë në *Kitab Et-Tehexhahud* (56/1): “Ka *isnad* më të shëndoshë se i mëparshmi, ” d.m.th. se hadithi i Va’ilit, i cili është anasjelltas (gjunjët para duarve). Në të vërtetë, hadithi i fundit, i cili është kontradiktor me këtë hadith *sahih* dhe atë paraprak, s’është as autentik në *isnad* e as në kuptim, siç kam shpjeguar në *Silsihet El-Ehadith Ed-Da’ifeh* (nr.929) dhe në *El-Irva* (357).

Duhet ditur se mënyra për t’u dalluar nga deveja është të vendosen duart para gjunjëve, sepse deveja i vendos gjunjët më parë; “gjunjët” e devesë janë këmbët e para, siç definohet në *Lisan El-Arab* dhe në libra të tjerë të gjuhës arabe, dhe siç përmendet nga Tahaviu në *Mushkil El-Athar* dhe *Sherh Meani El-Athar*. Po ashtu, Imam El-Kasim Es-Serakustiu (rahimehull-llah) ka transmetuar në *Garib El-Hadith* (2/70/1-2) me *sened* *sahih*, deklaratën e Ebu Hurejres, “Askush s’duhet të gjunjëzohet si deveja”, pastaj ka shtuar:

Ai, po ashtu, thoshte:

"Vërtet, duart bëjnë sexhde sikurse që fytyra bën sexhde, prandaj, kur ta vendosë ndokush nga ju fytyrën (në tokë), le t'i vendosë edhe duart, dhe, kur ta ngrejë atë, le t'i ngrejë edhe ato."⁴⁴⁰

Përshkrimi i Sexhdes

"Ai mbështetej në duart e tij [dhe i zgjeronte]"⁴⁴¹, "i bashkonte gishtërinjtë"⁴⁴², dhe "i drejtonte kah Kibla."⁴⁴³

Po ashtu, "ai vendoste ato (shuplakat) në nivel me krahët e tij"⁴⁴⁴, dhe nganjëherë "në nivel me veshët e tij".⁴⁴⁵ "Ai i vendoste hundën dhe ballin e tij fort në tokë."⁴⁴⁶

Ai i tha "atij që u fal keq": "Kur të bësh sexhde, përqendrohu në të";⁴⁴⁷ në një transmetim: "Kur të bësh sexhde, vendosi fytyrën dhe duart mirë, derisa eshtrat tua të qetësohen në pozitën e tyre të duhur."⁴⁴⁸

Ai, po ashtu, thoshte:

"Nuk ka namaz ai, hunda e të cilit nuk e ndien tokën aq sa edhe balli i tij."⁴⁴⁹

"Kjo është në sexhde. Ai thotë se nuk bën të lëshohemi poshtë si deveja që ikën, duke shpejtuar dhe pa kujdes, por duhet shkuar poshtë me kujdes dhe qetë, duke vendosur duart përpara, pastaj gjunjët, dhe një hadith *merfu* shpjegues është transmetuar në lidhje me këtë."

Pastaj ai ka përmendur hadithin e mësipërm.

Sa i përket deklaratës së çuditshme të Ibn El-Kajjimit: "Këto fjalë janë të pakuptueshme dhe nuk kuptohen nga ekspertët e gjuhës", kësaj i përgjigjemi me burimet që i kemi përmendur dhe, po ashtu, më shumë se të tjera të cilat mund të konsultohen. Unë, po ashtu, e kam shqyrtuar këtë në Përgënjeshtimin e Shejh Et-Tuvejxhiriut, i cili ndoshta botohet.

⁴⁴⁰ Ibn Huzejme (1/79/2), Ahmedi dhe Siraxhi; Hakimi e ka shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar. Është dhënë në *El-Irva'* (313).

⁴⁴¹ Ebu Davudi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

⁴⁴² Ibn Huzejme, Bejhekiu dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

⁴⁴³ Bejhekiu me *sened sahih*. Ibn Ebi Shejbe (1/82/2) dhe Siraxhi kanë treguar drejtimin e gishtave të këmbës në një transmetim tjetër.

⁴⁴⁴ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, të cilët e kanë shpallur *sahih*, siç ka vepruar edhe Ibn El-Mulekkini (27/2), është dhënë në *El-Irva'* (309).

⁴⁴⁵ Ebu Davudi dhe Ahmedi, me *sened sahih*.

⁴⁴⁶ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, të cilët e kanë shpallur *sahih*, siç ka vepruar edhe Ibn El-Mulekkini (27/2), është dhënë në *El-Irva'* (309).

⁴⁴⁷ Ebu Davudi dhe Ahmedi, me *sened sahih*.

⁴⁴⁸ Ibn Huzejme (1/10/1) me *sened hasen*.

⁴⁴⁹ Darekutniu, Taberaniu (3/140/1), dhe Ebu Nu'ajmi në *Ahbar Asbehan*.

“Ai i vendoste mirë gjunjët dhe gishtat e këmbës”,⁴⁵⁰ “gishtat e këmbëve i drejtonte kah Kibla”,⁴⁵¹ “i bashkonte thembrat”,⁴⁵² “i mbante shputat e këmbëve drejt”⁴⁵³, “urdhëronte kesisoj”⁴⁵⁴ dhe i mblidhte gishtat.

Prandaj, këto janë shtatë gjymtyrë në të cilat ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] bënte sexhde: shuplakat, gjunjët, këmbët, si dhe balli dhe hunda - duke numëruar dy të fundit si një gjymtyrë në sexhde, siç ka thënë:

“Jam urdhëruar të bëj sexhde (në një transmetim: ne jemi urdhëruar të bëjmë sexhde) me shtatë eshtra: me ballë... dhe tregoi duke lëvizur dorën⁴⁵⁵ drejt hundës së tij, ...me duar (në një version: me shuplakë) me gjunjë dhe me gishtërinj të këmbëve, dhe të mos i përvesh⁴⁵⁶ rrobat dhe flokët.”⁴⁵⁷

Ai, po ashtu, thoshte:

“Kur robi bie në sexhde, shtatë gjymtyrë bëjnë sexhde me të: fytyra e tij, shuplakat e tij, gjunjët e tij dhe këmbët e tij.”⁴⁵⁸

Ai tha për njeriun që u fal pas tij me flokë të lidhura:⁴⁵⁹

“Shembulli i tij është si shembulli i atij që falet me duar të lidhura (pas shpine).”⁴⁶⁰

⁴⁵⁰ Bejhekiu me *sened sahih*. Ibn Ebi Shejbe (1/82/2) dhe Siraxhi kanë treguar të drejtuarit e gishtave të këmbës në një transmetim tjetër.

⁴⁵¹ Buhariu dhe Ebu Davudi. Ibn Sa’di (4/157) ka transmetuar nga Ibn Umeri se ai, kur falej, kishte dëshirë t’i orientonte të gjitha pjesët e trupit që mundte kah Kibla, bile edhe gishtat e mëdhenj të duarve.

⁴⁵² Tahaviu, Ibn Huzejme (nr.654) dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

⁴⁵³ Bejhekiu me *sened sahih*.

⁴⁵⁴ Tirmidhiu dhe Siraxhi; Hakimi e ka shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

⁴⁵⁵ Kjo lëvizje e dorës është nxjerrë nga gramatika e tekstit arabik. (*Fet-h El-Bari*).

⁴⁵⁶ D.m.th. të tërhiqen ato dhe të pengohen nga shpërndarja, që nënkupton të mbledhurit e teshave ose të flokëve me duar për ruku dhe sexhde (*Nihajeh*). Ky ndalim nuk vlen vetëm gjatë namazit; shumica e dijetarëve përfshijnë tërheqjen e flokëve dhe të teshave para namazit në këtë ndalim. Kjo edhe më tej përforcohet nga ndalimi që ai ua bëri meshkujve për t’u falur me flokë të lidhura, që pason më vonë.

⁴⁵⁷ Buhariu dhe Muslimi. Është dhënë në *El-Irva* (310).

⁴⁵⁸ Muslimi, Ebu Avane dhe Ibn Hibbani.

⁴⁵⁹ D.m.th. të lidhura ose të gërshetuara.

⁴⁶⁰ Muslimi, Ebu Avane dhe Ibn Hibbani. Ibn El-Ethiri thotë:

“Kuptimi i këtij hadithi është se, sikur të kishin qenë flokët e tij të lëshuara, ato do të kishin rënë në tokë gjatë sexhdes, kështu që njeriu do të shpërblehej për sexhden e flokëve. Ndërsa, nëse flokët janë të lidhura, është sikur të mos bëjnë sexhde, sepse ai e krahasoi atë me dikë duart e të cilit janë të lidhura me pranga, ngase ato atëherë nuk do të mund të lëshoheshin në tokë gjatë sexhdes.”

Me sa duket, kjo këshillë është e kufizuar vetëm për meshkuj dhe nuk aplikohet te femrat, siç ka cituar Shevkaniu nga Ibn El-Arabiu.

Ai, po ashtu, tha: “Ajo është shalë e djallit”, d.m.th. ku djalli ulet, duke iu referuar nyjave në flokë.⁴⁶¹

“Ai nuk i lëshonte parakrahët në tokë”⁴⁶², por “i ngrinte duart mbi tokë dhe i mbante larg nga brinjët, saqë bardhësia e sqetullave mund t’i shihej nga prapa⁴⁶³, dhe po ashtu “në atë mënyrë, saqë, sikur të donte ndonjë qengj apo fëmijë i vogël të kalonte nën duart e tij, do të mund ta kishte bërë këtë.”⁴⁶⁴

Ai e bënte këtë deri në atë masë, saqë njëri prej sahabëve tha: “Na vinte keq për të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] për shkak të mënyrës se si i mbante duart larg brinjëve.”⁴⁶⁵

Ai urdhëronte në këtë duke thënë:

“Kur të bëni sexhde, vendosni shuplakat tuaja (në tokë) dhe ngrini bërrylat⁴⁶⁶ dhe drejtohuni në sexhde, dhe asnjëri të mos i shtrojë parakrahët sikur qeni (në një transmetim: ...sikur që qeni i shtron ato).”⁴⁶⁷

Në një tjetër hadith:

“Asnjëri prej jush të mos i lëshojë duart në tokë sikurse që i lëshon qeni ato.”⁴⁶⁸

Ai, gjithashtu, thoshte:

“Mos i shtroni duart tuaja [sikurse që bën bisha e egër]. Pushoni në shuplakat tuaja dhe mbani pjesët e epërme të duarve ndaras, ngase, kur bëni këtë, çdo gjymtyrë juaja bën sexhde me ju.”⁴⁶⁹

Obligimi për t’u qetësuar në sexhde

⁴⁶¹ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, të cilët e kanë shpallur *hasen’* Ibn Huzejme dhe Ibn Hibbani e kanë shpallur *sahih*. Shihni në *Sahih Ebi Davud* (653).

⁴⁶² Buhariu dhe Ebu Davudi.

⁴⁶³ Buhariu dhe Muslimi. Është dhënë në *El-Irva* (359)

⁴⁶⁴ Muslimi, Ebu Avane dhe Ibn Hibbani.

⁴⁶⁵ Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe, me *sened hasen*.

⁴⁶⁶ Muslimi dhe Ebu Avane.

⁴⁶⁷ Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi dhe Ahmedi.

⁴⁶⁸ Ahmedi dhe Tirmidhiu, të cilët e kanë shpallur *sahih*.

⁴⁶⁹ Ibn Huzejme (1/80/2), Makdisiu në *El-Muhtareh* dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] urdhëronte që të plotësohet rukuja dhe sexhdja, duke e krahasuar atë që nuk e bën këtë me njeriun e uritur që ha një ose dy kafshata të cilat nuk i bëjnë kurrfarë dobie. Po ashtu, tha për të:

“Vërtet, ai është njëri prej hajdutëve më të këqij në mesin e njerëzve”.

Ai, gjithashtu, tha se namazi i atij që nuk e drejton kurrizin plotësisht në ruku dhe në sexhde, është i pavlerë, siç është cekur në “Obligimi i qetësimit në ruku”, dhe urdhëroi “atë që u fal keq” që të qetësohet në sexhde, siç është përmendur më parë.

Dhikret e Sexhdes

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thoshte në këtë pozitë ndonjëherë prej këtyre përkujtimeve të All-llahut dhe duave që pasojnë:

1- ((سُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَى))

1- "Sa i përsosur është Zoti im, më i Lartësuari", tri herë.⁴⁷⁰

Nganjëherë, “ai e përsëriste më shumë herë.”⁴⁷¹

Njëherë, e përsëriti aq shumë, sa që sexhdja u bë e gjatë gati sa qëndrimi i tij, në të cilin kishte kënduar tri Sure të Gjata: El-Bekare, En-Nisa dhe Ali Imran. Ai namaz ishte plot me dua dhe me kërkim faljeje, siç është përmendur më parë nën “Namazi i natës”.

2- ((سُبْحَانَ رَبِّيَ الْعَظِيمِ وَبِحَمْدِهِ))

2- "Sa i përsosur është Zoti im, më i Lartësuari, dhe i Falënderuar qoftë Ai", tri herë.⁴⁷²

3- ((سُبُّوحٌ قُدُّوسٌ رَبُّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ))

3- "I Përsosur, i Bekuar, Zoti i engjëjve dhe i Shpirtit".⁴⁷³

⁴⁷⁰ Ahmedi, Ebu Davudi, Ibn Maxhe, Darekutniu, Tahaviu, Bezzari dhe Taberaniu në *Mu'xhem El-Kebir*, nën autoritetin e shtatë Sahabëve të ndryshëm. Shih shënimin për këtë dhikr nën “Rukuja”.

⁴⁷¹ Shih gjithashtu shënimin paraprak nën “Rukuja”.

⁴⁷² Sahih, transmetuar nga Ebu Davudi, Darekutniu, Ahmedi, Taberaniu dhe Bejhekiu.

⁴⁷³ Muslimi dhe Ebu Avane.

4- ((سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ رَبَّنَا وَبِحَمْدِكَ اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي))

- 4- "Sa i përsosur je, o All-llah, Zoti ynë, dhe i falënderuar qofsh, o All-llah! Më fal", të cilën e thoshte shpesh në ruku dhe në sexhde, duke zbatuar urdhrin e Kur'anit.⁴⁷⁴

5- ((اللَّهُمَّ لَكَ سَجَدْتُ وَبِكَ آمَنْتُ وَلَكَ أَسْلَمْتُ [و أنت ربي] سَجَدَ وَجْهِي لِلَّذِي خَلَقَهُ وَصَوَّرَهُ فَأَحْسَنَ صُورَهُ [وَشَقَّ سَمْعَهُ وَبَصَرَهُ [ف] تَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ))

- 5- "O All-llah! Për Ty kam bërë sexhde; në Ty kam besuar; Ty t'u kam nënshtruar; [Ti je Zoti im] fytira ime ka rënë në sexhde për Atë i Cili e krijoi dhe e trajtësoi [e trajtësoi shkëlqyeshëm], e pastaj nxori të dëgjuarit dhe të parët e saj: [pra] i bekuar goftë All-llahu, Krijuesi më i Mirë!"⁴⁷⁵

6- ((اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذَنْبِي كُلَّهُ دِقَّةً وَجِلَّةً وَأَوَّلَهُ وَآخِرَهُ وَعَلَانِيَتَهُ وَسِرَّهُ))

- 6- "O All-llah! M'i fal të gjitha mëkatet: të voglat dhe të mëdhatë, të parat dhe të fundit, të dukshmet dhe të fshehtat".⁴⁷⁶

7- ((سَجَدَ لَكَ سَوَادِي وَخِيَالِي وَآمَنَ بِكَ فُؤَادِي ، أَبُوءُ بِنِعْمَتِكَ عَلَى هَذِي يَدَيَّ وَمَا جَنَيْتُ عَلَى نَفْسِي))

- 7- "Vetja ime dhe hija ime kanë rënë në sexhde për Ty; zemra ime ka besuar në Ty; Unë i njoh të mirat e Tua ndaj meje: ja ku janë duart e mia dhe çdo gjë që kam bërë kundër vetes".⁴⁷⁷

8- ((سُبْحَانَ ذِي الْجَبَرُوتِ وَالْمَلَكُوتِ وَالْكِبْرِيَاءِ وَالْعَظَمَةِ))

- 8- "Sa i përsosur është Ai që ka gjithë Pushtetin, Mbretërinë, Madhësitinë dhe Sipërinë"⁴⁷⁸, të cilën ai e thoshte në namazin e natës, si dhe këtë që pason:

9- ((سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ))

⁴⁷⁴ Buhariu dhe Muslimi.

⁴⁷⁵ Muslimi, Ebu Avane, Tahaviu dhe Darekutniu.

⁴⁷⁶ Muslimi dhe Ebu Avane.

⁴⁷⁷ Ibn Nasri, Bezzari dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, por Dhehebiu nuk është pajtuar, megjithatë e ka përkrahjen, e cila është përmendur në versionin dorëshkrimor.

⁴⁷⁸ Ebu Davudi dhe Nesaiu, me *sened sahih*.

- 9- "Sa i përsosur je Ti [o All-llah] dhe i Lavdëruar. Askush s'ka të drejtë të adhurohet pos Teje"⁴⁷⁹

10- ((اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي مَا أَسْرَرْتُ وَمَا أَعْلَنْتُ))

- 10- "O All-llah! M'i fal ato (mëkate) që i kam fshehur dhe ato (mëkate) që i kam bërë haptas"⁴⁸⁰

11- ((اللَّهُمَّ اجْعَلْ فِي قَلْبِي نُورًا وَفِي لِسَانِي نُورًا وَاجْعَلْ فِي سَمْعِي نُورًا وَاجْعَلْ فِي بَصَرِي نُورًا وَاجْعَلْ مِنْ تَحْتِي نُورًا وَاجْعَلْ مِنْ فَوْقِي نُورًا وَعَنْ يَمِينِي نُورًا وَعَنْ يَسَارِي نُورًا وَاجْعَلْ أَمَامِي نُورًا وَاجْعَلْ خَلْفِي نُورًا [وجعل في نفسي نورًا] وَأَعْظِمْ لِي نُورًا))

- 11- "O All-llah! Vër dritë në zemrën time; [dhe dritë në gjuhën time;] dhe vër dritë në të dëgjuarit tim; dhe vër dritë në të parët tim; dhe vër dritë nën mua; dhe vër dritë mbi mua; dhe vër dritë në të djathtën time dhe dritë në të majtën time; dhe vër dritë para meje; dhe vër dritë pas meje; [dhe vër dritë në veten time;] dhe bëje dritën më të madhe për mua".⁴⁸¹

12- ((اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِرِضَاكَ مِنْ سَخَطِكَ وَأَعُوذُ بِمُعَافَاتِكَ مِنْ عُقُوبَتِكَ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْكَ لَا أُحْصِي ثَنَاءً عَلَيْكَ أَنْتَ كَمَا أَثْنَيْتَ عَلَى نَفْسِكَ))

- 12- "[O All-llah!] [Vërtet] kërkoj strehë në Kënaqësinë Tënde nga Hidhërimi Yt; [kërkoj strehë] me Faljen Tënde nga Dënimi Yt; kërkoj strehë me Ty prej Teje. Nuk mund t'i numëroj të gjitha Lavdërimet, ashtu siç meriton Ti; Ti je ashtu siç e ke madhëruar Vetën."⁴⁸²

Ndalimi i këndimit të Kur'anit në Sexhde

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ndalonte këndimin e Kur'anit në ruku dhe në sexhde, dhe urdhëronte që të përpiqemi shumë me dua në këtë pozitë, siç është shpjeguar më parë në "Rukuja". Ai, po ashtu, thoshte:

"Robi i afrohet Zotit të vet më së shumti kur bën sexhde, pra shtoni duatë [në të]."⁴⁸³

⁴⁷⁹ Muslimi, Ebu Avane, Nesaïu dhe Ibn Nasri.

⁴⁸⁰ Ibn Ebi Shejbe (62/112/1) dhe Nesaïu; Hakimi e ka shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

⁴⁸¹ Muslimi. Ebu Avane dhe Ibn Ebi Shejbe (12/106/2, 112/1).

⁴⁸² Ibid.

⁴⁸³ Muslimi, Ebu Avane dhe Bejhekiu. Është dhënë në *El-Irva* (456).

Zgjatja e sexhdes

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e zgjaste sexhden e tij gati sa rukunë, dhe nganjëherë ai e bënte tejet të gjatë, për shkak të rrethanave, siç ka thënë njëri prej Sahabëve:

“I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] na erdhi në njërin prej dy namazeve të vonshme [në Drekë ose në Ikindi], duke bartur Hasanin ose Husejnin. I Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] pastaj doli përpara dhe e vendosi poshtë [pranë këmbës së djathtë], dha tekbirin për namaz dhe filloi të falej. Gjatë namazit, ai bëri një sexhde të gjatë, prandaj unë e ngrita kokën [nga mesi i njerëzve] dhe ja aty ishte fëmija në shpinën e të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], i cili ishte në sexhde. Kur i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] mbaroi namazin, njerëzit thanë: 'O i Dërguar i All-llahut! Në mes të (këtij) namazit tënd, ti e bërë një sexhde dhe e zgjate aq shumë, sa që menduam se diçka kishte ndodhur ose ishte duke pranuar shpalljen!' Ai tha: 'Nuk ndodhi asnjëra prej këtyre. Në të vërtetë, djali im më kalëroi e unë nuk desha ta shpejtoja, derisa ta kryente dëshirën e vet.'"⁴⁸⁴

Në një hadith tjetër:

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte duke u falur. Kur ai e bëri sexhden, Hasani dhe Husejni kërcyen mbi shpinën e tij. Kur njerëzit provuan t'i pengonin ata dy, ai ua bëri me shenjë që t'i linin të qetë. Kur mbaroi namazin, i vendosi ata në prehrin e tij dhe tha: “Kushdo që më do mua, duhet t'i dojë edhe këta të dy”.⁴⁸⁵

Rëndësia e sexhdes

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thoshte: “Nuk ka njeri nga ummeti im që nuk do ta njoh në Ditën e Ringjalljes”. Ata thanë: “E si do ta njohësh, o i Dërguar i All-llahut, në mesin e gjithë atyre krijesave?” Ai tha: “Sikur të kishte hyrë ndonjëri nga ju në një vathë ku ndodhen një at i zi sterrë⁴⁸⁶ dhe një kali me ballë e këmbë të bardha,⁴⁸⁷ a nuk do ta kishit dalluar këtë të fundit nga i pari?” Ata thanë: “Natyrisht se po.” Ai tha: “Kështu, në

⁴⁸⁴ Nesaiu, Ibn Asakiri (4/257/1-2) dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

⁴⁸⁵ Ibn Huzejme në *Sahihun* e tij, me *isnad hasen* nga Ibn Mes'udi (887), dhe Bejhekiu në formën *mursel*. Ibn Huzejme e titulloi me “Kapitulli: dëshmia që bërja e ndonjë gjesti gjatë namazit as nuk e zhvlerëson namazin e as nuk e prish” - vepër kjo të cilën Njerëzit e Medhhebeve e kanë ndaluar! Përkitazi me këtë ka edhe hadithe në Buhari, Muslim dhe në të tjerë.

⁴⁸⁶ D.m.th. ngjyra e tij është e pastër e zezë, pa ngjyra të tjera të përziera në të. (*Nihajeh*)

⁴⁸⁷ Bardhësia i referohet pjesës së kalit ku lidhen zinxhirët, duke përfshirë edhe pjesët e poshtme të këmbës, por jo edhe gjunjët.

atë ditë, ummeti im do të ketë fytyra⁴⁸⁸ të bardha, për shkak të sexhdes, dhe duar dhe këmbë të bardha⁴⁸⁹ për shkak të abdestit.”⁴⁹⁰

Ai, po ashtu, thoshte:

“Kur All-llahu do të dëshirojë ta mëshirojë dikë nga banuesit e Zjarrit, Ai do t’i urdhërojë engjëjt ta nxjerrin nga zjarri gjithsecilin që ka adhuruar All-llahun. Atëherë, ata do t’i nxjerrin duke i njohur nga shenjat e sexhdes, sepse All-llahu ia ka ndaluar Zjarrit që t’i gëlltisë vendet e sexhdes. Kështu, ata do të nxirren nga Zjarri, sepse Zjarri gëlltitë gjithë birin e Ademit, përveç vendeve të sexhdes.”⁴⁹¹

Sexhdja në tokë dhe në shtrojë (hasër)⁴⁹²

Ai shpesh bënte sexhde në tokë (pa shtrojë).⁴⁹³

“Shokët e tij faleshin me të në vapë të madhe, kështu që, kur ndonjëri prej tyre nuk mund ta vendoste ballin në tokë, ai e zgjeronte petkun e tij dhe bënte sexhde në të.”⁴⁹⁴

Ai, po ashtu, thoshte:

“... tërë toka më është bërë vend adhurimi (mesxhid) dhe e pastër për mua dhe për ummetin tim. Prandaj, kudo që dikujt i vjen koha për t’u falur, le të falet dhe pastrohet aty. Ata para meje mendonin se kjo ishte tepër; vërtet, ata faleshin vetëm në kisha dhe në sinagoga.”⁴⁹⁵

Nganjëherë, ai bënte sexhde në baltë dhe në ujë, e kjo i ndodhi atij njëherë në agim, në natën e njëzetënjëtë të Ramazanit, kur ra shi, dhe kulmi i xhamisë, që ishte i punuar nga fletët e palmës, e rrodhi ujin. Prandaj, ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] bëri sexhde në ujë dhe në baltë. Ebu Seid El-Hudriu tha:

⁴⁸⁸ D.m.th. shndritja e fytyrës për shkak të sexhdes.

⁴⁸⁹ D.m.th. shndritja e pjesëve të përfshira gjatë abdestit: fytyra, duart dhe këmbët. Shenjat shndritëse të abdestit në fytyrë, në duar dhe në këmbë të njeriut krahasohen me bardhësinë e fytyrës dhe të këmbëve të kalit.

⁴⁹⁰ Ahmedi, me *sened sahih*. Tirmidhiu e ka dhënë një pjesë të saj dhe e ka shpallur *sahih*. Është dhënë në *Silsileh El-Ehadith Es-Sahihah*.

⁴⁹¹ Buhariu dhe Muslimi; hadithi tregon se mëkatarët që janë falur rregullisht, nuk do të mbesin në Zjarr gjithmonë. Në të vërtetë, edhe ata që nuk janë falur rregullisht nga përtacia, nuk do të mbesin në Zjarr gjithmonë. Ky është autentik - shih *Es-Sahihah* (2054).

⁴⁹² Ar. *Hasir*: shtrojë e punuar me fletë palme dhe hurme, ose me kashtë, etj.

⁴⁹³ Kjo ndodhi, sepse xhamia e tij nuk ishte e mbuluar me hasër, etj. Kjo është evidente nga shumë hadithe, siç është ai që pason dhe ai i Ebu Sei’dit më pas.

⁴⁹⁴ Muslimi dhe ebu Avane.

⁴⁹⁵ Ahmedi, Siraxhi dhe Bejhekiu, me *sened sahih*.

“Unë e pashë me sytë e mi të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] me gjurmë balte dhe uji në ballin dhe në hundën e tij.”⁴⁹⁶

Po ashtu, “ai falej në *humrah*”⁴⁹⁷ nganjëherë, ose (hasër) “në shtrojë”⁴⁹⁸ nganjëherë, dhe “ai u fal në të njëherë, derisa ajo u nxi nga përdorimi i gjatë.”⁴⁹⁹

Ngritja nga sexhdja

Pastaj, “ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e ngrinte kokën nga sexhdja duke e thënë tekbirin”,⁵⁰⁰ dhe urdhëroi “atë që u fal keq” ta bënte këtë, duke thënë:

“Namazi i asnjërit nuk është i plotë derisa... të bëjë sexhde, derisa pjesët e trupit të vendosen mirë në vend, pastaj të thotë 'All-llahu ekber' dhe të ngrejë kokën, derisa të ulet drejt.”⁵⁰¹

Po ashtu, nganjëherë “ai i ngrinte duart me tekbir”.⁵⁰²

Ulja muftarishen ndërmjet dy sexhdeve

Më tutje, “ai shtrinte këmbën e majtë në tokë dhe ulej në të [i qetë]”,⁵⁰³ dhe urdhëroi “atë që u fal keq” kështu, duke i thënë:

“Kur të bësh sexhde, përqendrohu mirë në të, pastaj, kur të ngihesh, ulu në kofshën tënde të majtë”⁵⁰⁴.

⁴⁹⁶ Buhariu dhe Muslimi.

⁴⁹⁷ Ibid. *Humrah* është copë hasre prej fijesh palme, ose e ndonjë materiali që është e madhe aq sa për të vendosur në të njeriu kokën për sexhde. Ky term nuk u përgjigjet copave të mëdha.

⁴⁹⁸ Ibid.

⁴⁹⁹ Muslimi dhe Ebu Avane. Ar. *lebise* zakonisht do të thotë “të vishet”, por këtu nënkupton “të ulet”, prandaj “të vishet” përfshin edhe “të ulet”, pra, kjo tregon se është ndaluar (haram) të ulet në mëndafsh, për shkak të ndalesës së veshjes së saj, që është treguar në *Sahihët* e Muslimit dhe Buhariut dhe te të tjerët. Në të vërtetë, në këto është treguar ndalimi i qartë për t’u ulur në mëndafsh, prandaj mos u ngatërroi nga fakti që disa dijetarë udhëheqës e lejojnë këtë.

⁵⁰⁰ Buhariu dhe Muslimi.

⁵⁰¹ Ebu Davudi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

⁵⁰² Buhariu në *Khuz Ref’ul-Jedejn*-in e tij, Ebu Davudi me *sened sahih*, Muslimi dhe Ebu Avaneja. Është dhënë në *El-Irva* (3160.4)

Të ngrihen duart këtu dhe me çdo tekbir ishte mendim i proklamuar nga Ahmedi. Kështu në *El-Bedai’* të Ibn El-Kajjimit (3/89) qëndron: “Ethremi ka cituar prej tij (Imam Ahmedit) se, kur u pyet për ngritjen e duarve, ai tha: “Me çdo lëvizje poshtë dhe lartë”. Ethremi ka thënë: “E pashë Ebu Abdull-llahun (d.m.th. Imam Ahmedin) duke i ngritur duart në namaz në çdo lëvizje poshtë dhe lartë.”

Ky, po ashtu, ishte mendim i Ibn El-Mundhiriut dhe i Ebu Aliut nga shafitë, dhe po ashtu mendim i vetë Malikut dhe Shafiut, sikur në *Tarh Et-Tethrib*. Ngritja e duarve këtu, po ashtu, është transmetuar në mënyrë autentike nga Enes ibn Maliku, Ibn Umeri, Nafiu, Tavusi, El-Hasan El-Basriu, Ibn Sirini dhe Ejjub Es-Sihtijaniu, si në *Musannef ibn Ebi Shejbeh* (1/106) me transmetim *sahih* nga ata.

⁵⁰³ Ahmedi dhe Ebu Davudi, me *sened* të mirë.

⁵⁰⁴ Buhariu dhe Bejhekiu.

“Ai mbante drejt shputën e këmbës së majtë”⁵⁰⁵ dhe “i drejtonte gishtat e saj drejt kibles.”⁵⁰⁶

***Ik'a* ndërmjet dy sexhdeve**

“Ai nganjëherë praktikonte *ik'a* [pushimin në dy thembrat dhe në (të gjithë) gishtat e këmbëve].”⁵⁰⁷

Obligimi për t'u qetësuar ndërmjet dy sexhdeve

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] qetësohej, derisa çdo asht i kthehej në vendin e duhur”⁵⁰⁸ dhe urdhëroi “atë që u fal keq” të vepronte kështu, dhe i tha:

“Namazi i asnjërit nuk është i plotë, derisa ta bëjë këtë.”⁵⁰⁹

Zgjatja e uljes ndërmjet dy sexhdeve

Po ashtu, “ai e zgjaste atë, derisa bëhej e gjatë sa sexhdja”⁵¹⁰, dhe nganjëherë, “ai mbetej (në këtë pozitë), derisa dikush mund të thoshte: Ai ka harruar.”⁵¹¹

Dhikret ndërmjet dy sexhdeve

Në këtë ulje, ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thoshte:

1- ((اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي وَارْحَمْنِي [واجبرني] [وارفعني] وَاهْدِنِي وَعَافِنِي وَارْزُقْنِي))

⁵⁰⁵ Nesaiu me *sened sahih*.

⁵⁰⁶ Muslimi, Ebu Avane, Ebu Esh-Shejhu në *Ma Revahu Ebu Ez-Zubejr'an Xhabir* (104-6) dhe Bejhekiu.

⁵⁰⁷ Ibid. Ibn El-Kajjimi (rahimehull-llah) nuk e vuri re këtë, kështu që, pas përmendjes së *iftirashit* të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] me s dy sexhdeve, ai tha: “Asnjë mënyrë tjetër e të ulurit nuk është ruajtur nga ai”! Si mund të jetë kjo e saktë, kur *ik'a* na ka ardhur përmjet haditheve të Ibn Abbasit në Muslim, të Ebu Davudit dhe të Tirmidhiut, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe të të tjerëve (shih *Silsileh El-Ehadih Es-Sahihah* 383); nëpërmjet hadithit të Ibn Umerit me *sened hasen* në El-Bejheki, i shpallur *sahih* nga Ibn Haxheri. Po kështu, Ebu Is-hak El-Harbiu e ka përmbledhur në *Garib El-Hadith* (5/12/1) nga Tavusi, i cili e ka parë Ibn Umerin dhe Ibn Abbasin duke praktikuar *ik'a*; *senedi* i tij është *sahih*. All-llahu e mëshiroftë Imam Malikun, i cili ka thënë: “Çdonjëri prej nesh mund të përgënjeshtrojë dhe të përgënjeshtrohet, përveç banorit të këtij varri”, dhe tregoi kah varri i të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Ky sunnet praktikohet nga disa Sahabë, tabi'inë dhe të tjerë, dhe e kam shqyrtuar këtë në *El-Asl*. Natyrisht, kjo *ik'a* ndryshon nga ajo që ndalohet, e cila pason nën “Teshehudi”.

⁵⁰⁸ Ebu Davudi dhe Bejhekiu, me *sened sahih*.

⁵⁰⁹ Ebu Davudi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

⁵¹⁰ Buhariu dhe Muslimi.

⁵¹¹ Ibid. Ibn El-Kajjimi ka thënë:

“Ky sunnet u braktis nga njerëzit pas kohës së Sahabëve. Por, sa i përket atij që lidhet për Sunnetin dhe nuk shikon anash në çfarëdo qoftë në kundërshtim me të, atë nuk e brengos asgjë që e kundërshton këtë udhëzim.”

- 1- "O All-llah! (në një version: O Zoti im!) Më fal; më mëshiro; [më forco;] [ma ngre gradën;] më udhëzo; më furnizo".⁵¹²

Ose nganjëherë, ai thoshte:

((رَبِّ اغْفِرْ لِي ، اغْفِرْ لِي)) -2

- 2- "O Zoti im! Më fal, më fal".⁵¹³

Ai thoshte këto dy në namazin e natës⁵¹⁴ gjithashtu.

Sexhdja e dytë

Pastaj, "ai thoshte tekbinin dhe binte në sexhde për të dytën herë."⁵¹⁵ Ai, po ashtu, urdhëroi "atë që u fal keq" të vepronte kështu, duke i thënë, pasi e urdhëroi të jetë i qetë ndërmjet dy sexhdeve: "pastaj thuaj 'All-llahu është më i madhi' dhe bjer në sexhde, derisa gjymtyrët e tua të jenë qetësuar [dhe bëje këtë në gjithë namazin]".⁵¹⁶ Po ashtu, nganjëherë "ai ngrinte duart me këtë tekbin".⁵¹⁷ Në këtë sexhde vepronte sikurse në sexhden e parë.

Pastaj, "ai e ngrinte kokën duke thënë tekbinin"⁵¹⁸, dhe e urdhëroi "atë që u fal keq" të vepronte kështu, duke i thënë, pasi e urdhëroi të bënte sexhde për të dytën herë: "pastaj ngrite kokën dhe thuaje tekbinin".⁵¹⁹ Ai, po ashtu, i tha atij: "[pastaj bëje këtë në të gjitha rukutë dhe sexhdet], sepse, nëse e bën këtë, namazi yt do të jetë i plotë, dhe nëse lë diç

⁵¹² Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

⁵¹³ Ibn Maxhe me *sened hasen*. Imam Ahmedi pat zgjedhur të lutet me këtë dua; Is-hak ibn Rahevejh ka thënë: "Nëse ai do, mund të thotë tri herë, ose mund të thotë: 'O All-llah! Më fal, sepse të dyja janë transmetuar nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] midis dy sexhdeve.'" (*Mesa'lili* i Imam Ahmedit dhe Is-hak ibn Rahavejhut, siç rrëfëhet nga Is-hak El-Merveziu, fq 19).

⁵¹⁴ Kjo nuk mohon vlerën e këtyre shprehjeve në namazet e detyrueshme, për shkak të mungesës së gjësendi për t'i dalluar këto prej namazeve vullnetshme. Ky është mendim i Shafiut, i Ahmedit dhe i Is-hakut, të cilët mendonin se kjo ishte e lejuar në namazet e detyrueshme dhe ato të vullnetshme, siç ka transmetuar Tirmidhiu. Imam Tahaviu, gjithashtu, e ka aprovuar këtë pikëpamje në *Nushkil El-Athar*. Analiza e bërë me vend e përkrah këtë argument, ngase nuk ka pozitë në namaz ku një dhikr nuk vlen, prandaj është e përshtatshme që ky duhet të jetë rasti këtu.

⁵¹⁵ Buhariu dhe Muslimi.

⁵¹⁶ Ebu Davudi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu është pajtuar.

⁵¹⁷ Ebu Avane dhe Ebu Davudi me dy *senede sahih*. Kjo ngritje e duarve është përkrahur nga Ahmedi, Maliku dhe Shafiut në transmetimet prej tyre. Shih shënimin paraprak nën "Sexhdja".

⁵¹⁸ Buhariu dhe Muslimi.

⁵¹⁹ Ebu Davudi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih* dhe Dhehebiu është pajtuar.

nga kjo, namazi do të jetë i mangët.”⁵²⁰ Po ashtu, nganjëherë “ai i ngrinte duart”⁵²¹ me tekbiir.

Ulja e pushimit

Pastaj, “ai ulej drejt [në këmbën e tij të majtë, drejt, derisa çdo asht i kthehej në pozitën e vet].”⁵²²

Mbështetja në duar gjatë ngritjes për në rekatin tjetër

Pastaj, “ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ngrihej për rekatin e dytë, duke u mbështetur në tokë.”⁵²³ Po ashtu, “ai shtrëngonte grushtet⁵²⁴ e tij gjatë namazit, duke u mbështetur me duar gjatë ngritjes.”⁵²⁵

Rekati i dytë

“Kur ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ngrihej në rekatin e dytë, fillonte me **“Të gjitha falënderimet-lavdërimet i qofshin All-llahut”** (Fatiha 1: 1-5), pa bërë pauzë.”⁵²⁶ Ai e bënte këtë rekat njësoj si të parin, përveçse e bënte më të shkurtër se të parin.

Obligimi i këndimit të sures El-Fatiha në çdo rekat

⁵²⁰ Ahmedi dhe Tirmidhiu, të cilët e kanë shpallur *sahih*.

⁵²¹ Shih shënimin e katërt të fundit.

⁵²² Buhariu dhe Ebu Davudi. Nga dijetarët e fikhut kjo ulje njihet si *Xhilsheh el-istirahah* (ulja e pushimit). Shafiu e ka përkrahur, siç ka bërë edhe Ahmedi në *Et-Tahkik* (111/1) dhe e ka pëlqyer edhe më shumë, siç edhe është ditur për të, se ai insistonte në ndjekjen e një sunneti që nuk kishte asgjë në kundërshtim me të. Ibn Hani ka thënë në *Mesa'ilin* e Imam Ahmedit (f.42):

“E kam parë Ebu Abdull-llahun (d.m.th. Imam Ahmedin) nganjëherë duke u mbështetur në duart e tij, kur ngrihej në rekatin tjetër, ndërsa nganjëherë ulej drejt, pastaj ngrihej.”

Kjo ishte, gjithashtu, edhe preferencë e Imam Is'hak ibn Rahevejhut, i cili ka thënë në *Mesa'ili*-in e El-Merveziut (1/147/2):

“Këtë shembull e vendosi i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] për mbështetjen e çdokujt në duar gjatë ngritjes, qoftë ai i ri, qoftë i vjetër.”

Shih, po ashtu, në *El-Irva* (2/83-3).

⁵²³ Buhariu 7 Shafiu.

⁵²⁴ Tekstualisht: sikur ai që ngjesh brumë.

⁵²⁵ Ebu Is'hak El-Harbiu me *sened* të pagabueshëm, dhe kuptimi i tij gjendet në El-Bejheki me *sened sahih*. Sa i përket hadithit, “Ai ngrihej lart si shigjetë, pa u mbështetur në duar”, është *mevdu* (i shpikur), dhe të gjitha transmetimet e ngjashme janë të dobëta, joautentike, dhe këtë e kam shpjeguar në *Silsihet El-Ed-Da'ifeh* (562, 929, 968).

⁵²⁶ Muslimi dhe Ebu Avane. Pushimi që mohohet në këtë hadith mund të jetë pushimi i këndimit të duasë hyrëse dhe nuk përfshin pushimin për këndimin e *istiadhes*, ose mund të jetë më kuptimgjerë se kjo; Mundësia e parë më duket më bindëse. Ekzistojnë dy mendime në mesin e dijetarëve përkitazi me *istiadhen* dhe ne e konsiderojmë të saktë atë që të thuhet në çdo rekat; detajet e kësaj janë dhënë në *El-Asl*.

Ai e urdhëroi "atë që u fal keq" ta këndonte El-Fatiha-në në çdo rekat, kur i tha, pasi që e urdhëroi ta këndonte në rekatën e parë:⁵²⁷ "... pastaj bëje këtë gjatë gjithë namazit⁵²⁸ (në një transmetim: në çdo rekat) "⁵²⁹ Ai, po ashtu, thoshte: "Në çdo rekat ka nga një këndim."⁵³⁰

⁵²⁷ Ebu Davudi dhe Ahmedi, me *sened* të fortë.

⁵²⁸ Buhariu dhe Muslimi.

⁵²⁹ Ahmedi me *sened* të mirë.

⁵³⁰ Ibn Maxhe, Ibn Hibbani në *Sahihun* e tij dhe Ahmedi në *Mesail*-in e Ibn Hanit (1/52). Xhabir ibn Abdull-llahu (rahimehull-llah) ka thënë:

"Ai i cili fal një rekat në të cilin nuk këndon nënën e Kur'anit, nuk është falur, përveçse pas Imamit" - përmbledhur nga Maliku në *El-Muvetta*.

Teshehudi i parë

Pastaj, ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ulej për *teshehhud*, kur përfundonte rekatën e dytë. Në namazin dy-rekatësh, siç është ai i sabahut, “ai ulej *mufterishen*”⁵³¹ sikurse që ulej ndërmjet dy sexhdeve, dhe “ai ulej njësoj në *teshehhudin* e parë”⁵³² në namazin tre ose katër-rekatësh.

Ai, po ashtu, urdhëroi “atë që u fal keq” kështu, duke i thënë:

“Kur të ulesh në mes të namazit, ji i qetë, shtroje kofshën e majtë dhe kryeje *teshehhudin*.”⁵³³

Ebu Hurejre [radijall-llahu anhu] ka thënë: “Shoku im [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] më ndaloi që të rri galiç (*ik’a*) sikur qeni”⁵³⁴; në një tjetër hadith: “ai ndalonte të ndenjurit galiç të djallit.”⁵³⁵

“Kur ai ulej në *teshehhud*, e vendoste pëllëmbën e djathtë në kofshën e djathtë (në një transmetim: në gju) dhe pëllëmbën e majtë në kofshën e majtë (në një transmetim: në gju, duke e zgjeruar mbi të)”;⁵³⁶ dhe “ai vendoste fundin e bërrylit të djathtë në kofshën e djathtë.”⁵³⁷

Po ashtu, “ai ia ndaloi një njeriu që ishte në ulje duke u falur mbështetjen në dorën e majtë, dhe tha: “Vërtet, ajo është falje e hebrenjve”⁵³⁸; në një tekst: “Mos u ulni kështu, se vërtet kjo është mënyrë e uljes së atyre që janë dënuar”⁵³⁹; në një tjetër hadith: “Është pozitë ulëse e atyre që kanë tërhequr mbi vete hidhërimin e All-llahut.”⁵⁴⁰

Lëvizja e gishtit në *teshehhud*

⁵³¹ Nesaiu (1/173) me *sened sahih*.

⁵³² Buhariu dhe Ebu Davudi.

⁵³³ Ebu Davudi dhe Bejhekiu, me *sened* të mirë.

⁵³⁴ Tajalisi, Ahmedi dhe Ibn Ebi Shajbe. Për *ik’a*-në, Ebu Ubejde dhe të tjerët thonë:

“Kjo është kur njeriu i lëshon vithet në tokë, i mban kërcinjtë drejt dhe i mbështet duart në tokë sikur qeni.”

Kjo dallon nga *ik’a* ndërmjet sexhdeve, e cila është miratuar në Sunnet, siç është shpjeguar më parë.

⁵³⁵ Muslimi, Ebu Avane dhe të tjerë. Është dhënë në *El-Irva* (316).

⁵³⁶ Muslimi dhe Ebu Avane.

⁵³⁷ Ebu Davudi dhe Nesaiu, me *sened sahih*. Kjo është sikur të thuhet se nuk i largonte bërrylat anash, siç ka sqaruar Ibn El-Kajjimi në *Zad El-Me’ad*.

⁵³⁸ Bejhekiu dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar. Është dhënë, si edhe tjetra që pason, në *El-Irva* (380).

⁵³⁹ Ahmedi dhe Ebu Davudi, me *sened* të mirë.

⁵⁴⁰ Abdurr-Rrezzaku; Abdul-Hakku e ka shpallur *sahih* në *Ahkam*-in e tij (nr.1284 - me kontrollimin tim).

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e zgjeronte shuplakën e tij të majtë në gjurin e majtë, i mbliidhte gishtat e dorës së djathtë, e drejtonte gishtin tregues kah Kibla dhe fiksonte shikimin në të (d.m.th. në gisht).”⁵⁴¹

Po ashtu, “kur e drejtonte gishtin, e vendoste gishtin e madh mbi gishtin e mesëm”⁵⁴² dhe nganjëherë “ai formonte një rreth me këta dy gishta”.⁵⁴³

“Kur e ngrinte gishtin, e lëvizte atë duke u lutur me të”⁵⁴⁴, dhe thoshte: “Ky, pa dyshim, për djallin ky është më i fortë se hekuri, domethënë gishti tregues.”⁵⁴⁵

Po ashtu, “Shokët e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] përkujtonin njëri-tjetrin, për të drejtuar gishtin gjatë lutjes.”⁵⁴⁶

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e bënte këtë në dy *teshehhudet*.”⁵⁴⁷

⁵⁴¹ Muslimi, Ebu Avane dhe Huzejme. Humejiu (13/1) dhe Ebu Ja’la (275/2) kanë shtuar me *sened sahih* nën autoritetin e Ibn Umerit: “Dhe kjo është guajtje e djallit. Askush s’do ta harrojë kur ta bëjë ai këtë” dhe Humejdju e ngriti gishtin e vet. Humejdju, po ashtu, ka thënë se Muslim bin Ebi Mejremi ka thënë: “Një njeri më tregoi se në një kishë në Siri kishte parë vizatime të Profetëve të pikturuar në këtë mënyrë.” Dhe Humejdju ngriti gishtin. Ky është një shënim shumë i çuditshëm, por *senedi* i tij deri te “personi” është *sahih*.

⁵⁴² Muslimi dhe Ebu Avane.

⁵⁴³ Ebu Avane, Nesaiu, Ibn El-Xharudi në *El-Munteka* (208), Ibn Huzejme (1/86/1-2) dhe Ibn Hibbani në *Sahihun* e tij (485), me *sened sahih*. Ibn El-Mulekkini, po ashtu, e ka shpallur *sahih* (28/2), dhe ka transmetim mbështetës në Ibn ‘Adi (287/1).

⁵⁴⁴ Ibid. Në lidhje me “duke u lutur me të”. Imam Tahaviu ka thënë: “Kjo është dëshmi se ishte në fund të namazit.” Prandaj, në këtë ka dëshmi që në Sunnet të vazhdohet me drejtimin dhe me lëvizjen e gishtit deri në *teslim*, sepse lutja zgjat deri atëherë. Ky është mendim i Malikut dhe i të tjerëve. Imam Ahmed i është pyetur: “A duhet njeriu ta drejtojë gishtin gjatë namazit?” Ai u përgjigj: “Po, fuqishëm.” (Përmendim nga Ibn Hani në *Mesa’ilin* e Imam Ahmedit, 1/80). Nga kjo shihet se lëvizja e gishtit në *teshehhud* është sunnet i dëshmuar i të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe është praktikuar nga Ahmed i dhe imamë të tjerë të Sunnetit. Prandaj, ata që mendojnë se është e pavlerë dhe e kotë dhe s’ka të bëjë me namazin, duhet t’i frikësohen All-llahut, pasi për shkak të kësaj nuk e lëvizin gishtin, ndonëse e dinë se është përcaktuar si sunnet; dhe ata mundohen shumë që ta interpretojnë në atë mënyrë që është në kundërshtim me mënyrën e të shprehurit arab dhe në kundërti me mënyrën e të kuptuarit të imamëve në lidhje me këtë.

Gjëja që habit më së shumti është ajo që disa prej tyre do ta mbrojnë një imam në çështjet e tjera, edhe nëse mendimi i tij kundërshton Sunnetin, me argument se të tregosh gabimet e imamëve, patjetër do të thotë ta fyesh dhe ta nënçmosh atë. Ata pastaj e harrojnë këtë dhe refuzojnë sunnetin e miratuar, njëkohësisht duke i përqeshur ata që e praktikojnë këtë. Qenë të vetëdijshëm në këtë a jo, përqeshja e tyre përfshin ata imamë, të cilët i mbronin gabimisht dhe të cilët kanë të drejtë për Sunnetin kësaj here! Në të vërtetë, ata janë duke përqeshur vetë të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], sepse është ai i cili e vendosi këtë sunnet dhe kështu tallja me të është tallje me të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. “Por çka është shpërblimi për ata që nga mesi juaj sillen kështu, përveçse...”

Sa i përket lëshimit poshtë të gishtit pasi është drejtuar ose kufizimit të lëvizjes në dëshmi (në thënien: la ilahe: “nuk ka Zot...”) dhe mohimit (thënies: il-lall-llah: “... përveç All-llahut”), e gjithë kjo nuk ka bazë në Sunnet; në fakt është kontradiktore me Sunnetin, siç dëshmon hadithi.

Më tej, hadithi se ai nuk e lëvizte gishtin, nuk ka *isnad* autentik, siç kam shpjeguar në *Da’if Ebi Davudi* (175). Bile, edhe nëse është autentik, është mohues, përderisa hadithi i lartpërmendur është pohues: hadithi pohues ka përparësi ndaj atij mohues, siç dihet mirë në mesin e dijetarëve.

⁵⁴⁵ Ahmed i, Bezzari, Ebu Xha’feri, Buhtiriu në *El-Emali* (60/1), Abdul-Gani El-Makdisi në *Sunenin* e tij (12/2), me *sened hasen*, Rujaniu në *Musnedin* e tij (294/2) dhe Bejhekiu.

⁵⁴⁶ Ibn Ebi Shejbe (2/123/2) me *sened hasen*.

Njëherë, “e pa një njeri duke u lutur me dy gishta, prandaj tha: “**Vetëm me një, [vetëm me një]**”, dhe e tregoi gishtin tregues të tij.”⁵⁴⁸

Obligimi i *teshehhudit* të parë dhe vlefshmëria e të luturit gjatë tij

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e këndonte *Tehijjatin* pas çdo dy rekatesh”⁵⁴⁹; “gjëja e parë që thoshte në këtë ulje është: “**Të gjitha falënderimet i qofshin All-llahut.**”⁵⁵⁰

“Kur harronte të bënte *teshehhudin* pas dy rekateve të para, ai bënte sexhde (dy herë) për shkak të harresës.”⁵⁵¹

Ai i urdhëronte ata të bënin *teshehhudin*, duke thënë:

“Kur të uleni pas çdo dy rekatesh, atëherë thoni: *Et-Tehijjatu...* dhe pastaj secili prej jush le të zgjedhë ndonjë dua që i pëlqen më së shumti dhe t’i lutet [me të]⁵⁵² All-llahut, të Madhërishmit, të Lartësuarit”;

në një tjetër version:

“**Thuaj, *Et-Tehijjatu...* në çdo ulje**”⁵⁵³,

dhe ai, po ashtu, urdhëroi “atë që u fal keq” të vepronte kështu, siç është përmendur. “Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ua mësonte *teshehhudin*, ashtu siç ua mësonte suret e Kur'anit,”⁵⁵⁴ dhe “Është sunnet që të thuhet heshtas”.⁵⁵⁵

Llojet e *teshehudeve*

Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] u ka mësuar shokëve të vet lloj-lloj *teshehude*. Prej tyre janë edhe këto:

1- *Teshehhudi* i ibn Mesudit [radijall-llahu anhu]:

⁵⁴⁷ Nesaiu dhe Bejhekiu, me *sened sahih*.

⁵⁴⁸ Ibn Ebi Shajbe (12/40/1, 2/123/2) dhe Nesaiu. Hakimi e ka shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar, ka transmetim mbështetës për të në Ibn Ebi Shejbe.

⁵⁴⁹ Muslimi dhe Ebu Avane.

⁵⁵⁰ Bejhekiu e ka transmetuar këtë si rrëfim nga Aishja, me *isnad* të mirë, siç vërtetohet nga Ibn El-Mulekkini (28/2).

⁵⁵¹ Buhariu dhe Muslimi. Është dhënë në *Irva El-Galili* (338).

⁵⁵² Nesaiu, Ahmedi dhe Taberaniu në *Mu'xhem El-Kebir* (3/25/1), me *sened sahih*. Kuptimi tekstual i hadithit është dëshmi për vlefshmërinë e duasë në çdo *teshehhud*, bile edhe në atë që nuk ndiqet me *teslim*, dhe ky është mendimi i Ibn Hazmit (rahimehull-llah).

⁵⁵³ Nesaiu me *sened sahih*.

⁵⁵⁴ Buhariu dhe Muslimi.

⁵⁵⁵ Ebu Davudi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

Ma mësoi Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] teshehudin, ashtu sikur më patë mësuar sure nga Kur'ani:

1- ((التَّحِيَّاتُ لِلَّهِ وَالصَّلَوَاتُ وَالطَّيِّبَاتُ السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ عَلَيْنا وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ))

“Të gjitha lavdërimet,⁵⁵⁶ duatë⁵⁵⁷ dhe fjalët e dëlira⁵⁵⁸ i takojnë All-llahut. Paqja⁵⁵⁹ qoftë mbi ty, o i Dërguar, dhe po ashtu mëshira dhe bekimi i All-llahut⁵⁶⁰. Paqja qoftë mbi ne dhe në robërit e drejtë të All-llahut. [Kur njeriu e thotë këtë, përfshin çdo rob të drejtë në qiell dhe në tokë.] Dëshmoj se nuk ka të drejtë të adhurohet kush pos All-llahut dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i Dërguar”.

[Kështu thoshim derisa ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte mes nesh, por pasi u mor, në thoshim: Paqja qoftë mbi të Dërguarin].”⁵⁶¹

⁵⁵⁶ Ar. *tehiyyat*, d.m.th. “të gjitha fjalët që nënkuptojnë paqe, pavarësi dhe përjetësi, i takojnë Allahut”. (*Nihajeh*)

⁵⁵⁷ Ar. *Salavat*, d.m.th. “të gjitha duatë që përdoren për lavdërimin e Madhështisë së All-llahut, se Ai meriton këto dhe kush pos Tij nuk është i denjë në to.” (*Nihajeh*).

⁵⁵⁸ Ar. *tajjibat* d.m.th. “të gjitha fjalët e pastra dhe të mira që janë të përshtatshme për lavdërimin e All-llahut, jo ato që janë të papajtueshme me atributet e Tij, me të cilat mbretërit përshëndeten.” (*Fet-hul-Bari*).

⁵⁵⁹ Do të thotë të kërkuarit e strehës tek All-llahu dhe të qenët i forcuar prej Tij, pasi që *Es-Selam* (Paqe), në të vërtetë, është emër i All-llahut. Kështu, përshëndetja do të thotë: “Allahu qoftë me ju”, d.m.th. në kujdestarinë e Tij, ndihmën dhe përkrahjen.

⁵⁶⁰ Term për të gjitha të mirat që vazhdimisht rrjedhin prej All-llahut.

⁵⁶¹ Buhariu, Muslimi, Ibn Ebi Shejbe (1/90/2), Siraxhi dhe Ebu Ja’la në *Musnedin* e tij (258/2). Është dhënë në *El-Irva* (321).

Deklarata e Ibn Mes’udit, “Ne thoshim: Paqja qoftë mbi të Dërguarin” sqaron se Sahabët [radijall-llahu anhu] thoshin, “Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguar” në *teshehud* ndërsa i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte gjallë, por, kur vdiq, ata nuk thoshin më kështu, por thoshin, “Paqja qoftë mbi të Dërguarin.” Pa dyshim, kjo qe me miratimin e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]; kjo përkrahet nga fakti që Aishja [radijall-llahu anhu] e thoshte kështu *teshehudin* në namaz me “Paqja qoftë mbi të Dërguarin”, siç transmetohet nga Siraxhi në *Musnedin* e tij (9/1/2) dhe nga Muhlisi në *El-Fevaid* (11/54/1) me dy *senede sahih* nga ajo.

Ibn Haxheri thotë:

“Kjo shtojcë tregon qartë se ata thoshin “Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguar”, duke iu drejtuar drejtpërsëdrejti gjatë jetës së tij, por, kur i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] vdiq, ata nuk i drejtoheshin atij më, por e përmendnin në vetën e tretë, duke thënë “Paqja qoftë mbi të Dërguarin”.

Ai, po ashtu, thotë në një vend tjetër:

“Subkiu ka thënë në *Sherh El-Ninhaxh*, pasi që ka përmendur këtë transmetim vetëm prej Ebu Avanes: “Nëse kjo është transmetuar në mënyrë autentike nga Sahabët, dëshmon se, pas jetës së tij, nuk është e detyrueshme t’i drejtohem drejtpërsëdrejti të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] me përshëndetjen e paqes, kështu që thuhet: ‘Paqja qoftë mbi të Dërguarin’”. (Ibn Haxheri vazhdon:) Kjo padyshim është autentike (d.m.th. sepse gjendet në *Sahih El-Buhari*) dhe, po ashtu, kam gjetur përkrahje të fortë për të: -Abdurr-Rrezzaku ka thënë: “Ibn Xhurejxhi më informoi: ‘Atau më informoi se Sahabët thoshin: ‘Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguar’ ndërsa i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte gjallë, por, pasi vdiq, ata thoshin: ‘Paqja qoftë mbi të Dërguarin’, dhe ky është *isnad sahih*. Sa i përket transmetimit të Se’id bin Mensurit nga Ebu Ubejdeh bin Abdull-llah bin Mes’udi i cili ka transmetuar nga i ati i vet se i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ua kishte mësuar *teshehudin* dhe pastaj ai (Abdull-llah bin Mes’udi) e kishte thënë atë (*Teshehudin*);

2- ((التَّحِيَّاتُ الْمُبَارَكَاتُ الصَّلَوَاتُ الطَّيِّبَاتُ لِلَّهِ السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ عَلَيْنا وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ))

2- *Teshehhudi* i Ibn Abbasit: “I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] na e mësonte *teshehhudin*, siç na e mësonte [suret] Kur'anin; ai thoshte:

“Të gjitha lavdërimet, fjalët e bekuara, lutjet, fjalët e dëlira i takojnë All-llahut. Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguar, e po ashtu mëshira e All-llahut dhe bekimi i Tij. Paqja qoftë mbi ne dhe mbi robërit e drejtë të All-llahut. Dëshmoj se askush s’ka të drejtë të adhurohet përpos All-llahut dhe [dëshmoj] që Muhammedi është i Dërguar i All-llahut (në një transmetim: ... është robi dhe i Dërguari i Tij).”⁵⁶²

3- ((التَّحِيَّاتُ لِلَّهِ وَالصَّلَوَاتُ وَالطَّيِّبَاتُ السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ عَلَيْنا وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ))

3- *Teshehhudi* i Ibn Umerit, i cili ka kumtuar se i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thoshte në *teshehhud*:

“Të gjitha lavdërimet, lutjet dhe fjalët e mira i takojnë All-llahut, Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguar, dhe mëshira e All-llahut” - Ibn Umeri tha: “Unë shtoj: ⁵⁶³... dhe bekimet e Tij. - Paqja qoftë mbi ne dhe mbi robërit e drejtë të All-llahut. Dëshmoj se askush s’ka të drejtë të adhurohet pos All-llahut” - Ibn Umeri tha: “Unë shtoj: ⁵⁶⁴... Një, i Cili nuk ka shok”, - dhe dëshmoj se Muhammedi është robi dhe i Dërguari i Tij.⁵⁶⁵

4- ((التَّحِيَّاتُ الطَّيِّبَاتُ الصَّلَوَاتُ لِلَّهِ السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ عَلَيْنا وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ))

Ibn Abbasi ka thënë: 'Ne thoshim 'Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguar' vetëm derisa ishte gjallë, për të cilën ibn Mes'udi u përgjigj: 'Kështu jemi mësuar dhe kështu mësojmë', me sa duket, Ibn Abbasi e tha këtë si çështje për diskutim, por Ibn Mes'udi nuk e pranoi. Sidoqoftë, transmetimi i Ebu Ma'merit (d.m.th. transmetim i Buhariut) është më autentik, pasi Ebu Ubejde nuk ka dëgjuar (hadithe) nga i ati, dhe, përveç kësaj, *isnadi* deri te Ebu Ubejde është i dobët.” (Fund i citatit nga Ibn Haxheri).

Këto fjalë të Ibn Haxherit janë cituar nga disa dijetarë në *isnadet* e tyre, si Kastalani, Zerkani, Lakanoviu, etj. Ata të gjithë zgjedhën të japin fjalët e tij pa e komentuar më tej.

⁵⁶² Muslimi. Ebu Avane, Shafiu dhe Nesaiu.

⁵⁶³ Shih shënimin që vijon.

⁵⁶⁴ Këto dy shtesa janë dëshmuar të jenë pjesë e *teshehhudit* nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Ibn Umeri nuk i ka shtuar ato vetë (larg është ai nga një gjë e tillë!). Në të vërtetë, ai i ka mësuar ato nga Sahabët, të cilët i transmetuan ato nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], dhe atëherë ia shtoi ato *teshehhudit* të cilin e dëgjoi nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] drejtpërsëdrejti.

⁵⁶⁵ Ebu Davudi dhe Darekutni, të cilët e kanë shpallur *sahih*.

4- *Teshehhudi* i Ebu Musa El-Eshariut, i cili ka thënë se i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“... kur të uleni, gjëja e parë që duhet të thoni është:

Të gjitha lavdërimet, fjalët e mira dhe lutjet i takojnë All-llahut. Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguar, e po ashtu mëshira e All-llahut dhe bekimet e Tij. Paqja qoftë mbi ne dhe mbi robërit e drejtë të All-llahut. Dëshmoj se askush s’ka të drejtë të adhurohet pos All-llahut [Një, i Cili nuk ka shok] dhe dëshmoj se Muhammedi është rob i Dërguari - shtatë fjalitë, e ato janë përshëndetjet në namaz.”⁵⁶⁶

5- ((التَّحِيَّاتُ لِلَّهِ ، الزَّكَايَاتُ لِلَّهِ ، الطَّيِّبَاتُ لِلَّهِ [الله] ، السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ))

5- *Teshehhudi* i Umer Ibn El-Hattabit, i cili ua mësonte *teshehhudin* njerëzve derisa qëndronte në minber, duke thënë,

“Thuaj: Të gjitha lavdërimet i takojnë All-llahut; të gjithë titujt e pastër i takojnë All-llahut; të gjitha fjalët e mira [i takojnë All-llahut]; të gjitha falënderimet i takojnë All-llahut. Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguar, e po ashtu mëshira e All-llahut dhe bekimet e Tij. Paqja qoftë mbi ne dhe mbi robërit e drejtë të All-llahut. Dëshmoj se s’ka të drejtë të adhurohet pos All-llahut dhe dëshmoj se Muhammedi është rob i Dërguari i tij”⁵⁶⁷.

6- ((التَّحِيَّاتُ الطَّيِّبَاتُ الصَّلَوَاتُ الزَّكَايَاتُ لِلَّهِ السَّلَامُ عَلَى النَّبِيِّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ))

6- *Teshehudi* i Aishes radijall-llahu anha:

⁵⁶⁶ Muslimi, Ebu Avane, Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe.

⁵⁶⁷ Maliku dhe Bejhekiu, me senede sahih. Ndonëse, ky hadith është *mevkuf*, efektivisht është *merfu*, sepse është e ditur se një gjë e tillë nuk thuhet nga mendimi personal, sepse, po të ishte kështu, s’do të ishte më e mirë se çfarëdo thënie tjetër e dhikrit, siç ka thënë Ibn Abdul-Berri.

*NB: Në asnjë *teshehhud* nuk ekziston shtesa: *ve magfiretuhu* (... “dhe falja e Tij”), prandaj askush nuk duhet ta përdorë. Prandaj, disa nga Selefë kanë tërhequr vërejtjen në këtë, siç tregon transmetimi që pason: Taberaniu (3/56/1) ka transmetuar me sened sahih nga Talhah bin Musarrifi, i cili ka thënë: “Rebi’ bin hejthemi shtonte gjatë *teshehhudit*. “... dhe bekimet e Tij dhe falja e Tij”! Atëherë, Alkame tha: “Ne ndalemi aty ku jemi mësuar: ‘Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguar, dhe po ashtu mëshira e All-llahut dhe bekimet e Tij’”; Alkame, në të vërtetë, pasonte shembullin e mësuesit të tij, Abdull-llah bin Mes’udit [radijall-llahu anhu], nga i cili transmetohet në formë autentike se ishte duke ia mësuar një njeriu *teshehhudin*, dhe, kur erdhi te “Dëshmoj se nuk ka Zot (të vërtetë) përpos All-llahut...”, ai njeri tha: “Një, i Cili nuk ka shok”, në çka Abdull-llahu tha: “Ashtu është, por ne ndalemi aty ku jemi mësuar.” (Transmetuar nga Taberaniu ne *Mu’xhem El-Evsat*, nr.2848 me *senes sahih*).

"Të gjitha lavdërimet, fjalët e mira, lutjet dhe të gjithë titujt e pastër i takojnë All-llahut. Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguar, e po ashtu mëshira e All-llahut dhe bekimet e Tij. Paqja qoftë mbi ne dhe mbi robërit e drejtë të All-llahut. Dëshmoj se askush s'ka të drejtë të adhurohet pos All-llahut [Një, i Cili nuk ka shok] dhe dëshmoj se Muhammedi është robi dhe i Dërguari".

Es-Salah 'ala En-nebii (Dërgimi i Salavateve mbi të Dërguarin) - Vendi dhe mënyra e dërgimit

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dërgonte *salavate* mbi vetveten në *teshehhudin* e parë, si dhe në të dytin.⁵⁶⁸ Ai përcaktoi këtë, gjithashtu, edhe për ummetin e tij, duke i urdhëruar ata të dërgojnë *salavate* mbi të, pasi të dërgojnë paqe mbi të⁵⁶⁹, dhe ai ua mësoi atyre disa mënyra të dërgimit:

1- ((اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى أَهْلِ بَيْتِهِ وَأَزْوَاجِهِ وَذُرِّيَّتِهِ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ وَبَارَكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَأَزْوَاجِهِ وَذُرِّيَّتِهِ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ))

1- "O All-llah! Dërgo *salavate* mbi Muhammedin⁵⁷⁰ dhe mbi familjen e tij dhe mbi gratë dhe mbi pasardhësit e tij, siç ke dërguar *salavate* mbi familjen e Ibrahimit; Ti, me të vërtetë, je i Denjë për Lavdërim, përplot madhështi. Dhe

⁵⁶⁸ Ebu Avane në Sahihun e tij (2/324), dhe Nesaiu.

⁵⁶⁹ Ata kanë thënë: "O i Dërguar i All-llahut, ne jemi mësuar si të dërgojmë paqe mbi ty (d.m.th. në *teshehhud*), por na trego si të dërgojmë *salavate* mbi ty? Ai tha: "Thuaj: O All-llah! Dërgo *salavate* mbi të Dërguarin..." etj. Kështu që ai nuk e veçoi një *teshehhud* prej tjetrit. Pra, kjo është dëshmi për dërgimin e *salavateve* në *teshehhudin* e parë, gjithashtu. Kjo është pikëpamje e Imam Shafiut, që paraqitet në tekstin e librit të tij *El-Umm*, dhe mbahet si e saktë nga shokët e tij, siç shpjegon Neveviu në *El-Mexhmu* (3/460) dhe duke e mbështetur në *Revdah Et-Talibin* (1/263). Është, gjithashtu, pikëpamje e El-Vezir ibn Hubejreh El-Hanbeliut në *El-Ifsah*, siç ka cituar Ibn Rexhepi dhe fuqimisht ka mbështetur në *Dhejl Et-Tabekat* (1/280). Shumë hadithe ekzistojnë për dërgimin e *salavateve* mbi të [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në *teshehhud*; dhe në asnjërin prej tyre nuk përmendet një specifikim i tillë. Në të vërtetë, këto hadithe janë të përgjithshme, duke përfshirë kështu çdo *teshehhud*, dhe unë i kam thënë ato në *El-Asl* si *ta'lik*, por jo në tekstin kryesor, sepse ato nuk përmbushin kushtet tona për autenticitet. Megjithatë, ato mbështesin njëra-tjetrën në kuptim, dhe ata që refuzojnë dhe kundërshtojnë këtë, nuk kanë ndonjë dokument autentik që ta përdorin si dëshmi, siç e kam shkoqitur këtë në *El-Asl*. Njëlloj me këtë, të thuash se të shtosh diçka në "O All-llah! Dërgo *salavate* mbi të Dërguarin" është *mekruh*, nuk ka baza në Sunnet, e as që ekziston ndonjë argument bindës. Në të vërtetë, shohim se kushdo që thotë këtë, nuk zbaton këshillën e mëparshme të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], "Thuaj: O All-llah! Dërgo *salavate* mbi Muhammedin dhe familjen e Muhammedit ..."; përkitazi me këtë diskutim ka ende në *El-Asl*.

⁵⁷⁰ Një prej mendimeve më të hershme për kuptimin e "dërgimit të *salavateve* mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]" është ai i Ebu El-Alijes (duke iu referuar sures El-Ahzab 33: 56). "Dërgimi i *salavateve* të All-llahut mbi të Dërguarin e Tij do të thotë lartësimi i tij dhe ngritja e shkallës së tij; dërgimi i *salavateve* të engjëjve dhe të të tjerëve do të thotë kërkimi i kësaj prej All-llahut, dhe këtu nënkupton kërkesën për shtimin e *salavateve*, duke mos kërkuar vetë duanë origjinale." Ibn Haxheri ka cituar këtë në *Fet-h El-Bari* dhe ka vazhduar të përgënjeshtrojë nocionin e përhapur që *salavatet* e Zotit mbi ndokënd janë mëshira e Tij. Ibn El-Kajjimi, po ashtu, e ka sqaruar këtë në *Xhela El-Efham*, duke lënë pak vend të lirë për koment të mëtutjeshëm.

bekoje Muhammedin⁵⁷¹ dhe familjen e tij dhe mbi gratë dhe mbi pasardhësit e tij, siç e ke bekuar familjen e Ibrahimit; Ti, me të vërtetë, je i Denjë për Lavdërim, përplot Madhështi".

Këtë dua e bënte edhe vet.⁵⁷²

-2 ((اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ اللَّهُمَّ بَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ))

- 2- "O All-llah! Dërgo *salavate* mbi Muhammedin dhe mbi familjen e Muhammedit siç ke dërguar *salavate* [mbi Ibrahimin dhe]⁵⁷³ mbi familjen e Ibrahimit; Ti, me të vërtetë, je i denjë për Lavdërim, përplot Madhështi. O All-llah! Bekoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit, siç ke bekuar [Ibrahimin dhe]⁵⁷⁴ familjen e Ibrahimit; Ti, me të vërtetë, je i denjë për Lavdërim, përplot Madhështi."⁵⁷⁵

-3 ((اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ وَبَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ))

- 3- "O All-llah! Dërgo *salavate* mbi të Dërguarin dhe mbi familjen e Muhammedit, siç ke dërguar *salavate* mbi Ibrahimin [dhe mbi familjen e Ibrahimit]; Ti, me të vërtetë, je i denjë për Lavdërim, përplot Madhështi, dhe bekoje Muhammedin dhe familjen e tij, siç e ke bekuar Ibrahimin [dhe familjen e Ibrahimit]; Ti, me të vërtetë, je i denjë për Lavdërim, përplot Madhështi."⁵⁷⁶

-4 ((اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ [النبي الأمي] وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَبَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ [النبي الأمي] وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ فِي الْعَالَمِينَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ))

⁵⁷¹ Nga *berekeh*: rritje, shtim. Kështu, kjo dua siguron për Muhammedin të mirën të cilën All-llahu ia dha familjes së Ibrahimit, të mirën e vazhdueshme, si dhe shumëfishimin dhe shtimin e saj.

⁵⁷² Ahmedi dhe Tahaviu, me *sened sahih*.

⁵⁷³ Shih shënimin e ardhshëm.

⁵⁷⁴ Këto dy shtesa përfundimisht janë gjetur në Buhari, Tahavi, Bejheki, Ahmed dhe Nesai. Këto, po ashtu, ekzistojnë përmes rrugëve të ndryshme të transmetimit në lloje të tjera të kësaj duaje, andaj mos u ngatërrohi nga pikëpamja e Ibn El-Kajjimit në *Xhela El-Efham* (f.198), duke pasuar hapat e mësuesit të tij të madh Ibn Tejmijes në *El-Fetava* (1/16): "Nuk ekziston ndonjë hadith autentik me frazat "Ibrahim" dhe "familja e Ibrahimit" së bashku". Këtu ne ju kemi paraqitur një hadith të tillë. Gabimi i Ibn El-Kajjimit vërtetohet më tej nga fakti se ai vetë e ka shpallur *sahih* nr.7, që përmban atë çka ai ka mohuar më lart!

⁵⁷⁵ Buhariu, Muslimi, Humejdiu (138/1) dhe Ibn Mende (68/2), i cili ka thënë:

"Për autenticitetin e këtij hadithi ekziston njëzëshmëria."

⁵⁷⁶ Ahmedi, Nesaiu dhe Ebu Ja'la në *Musnedin* e tij (44/2), me *sened sahih*.

- 4- "O All-llah! Dërgo *salavate* mbi Muhammedin [të Dërguarin e Pamësuar] dhe mbi familjen e Muhammedit, siç ke dërguar *salavate* [mbi familjen e] Ibrahimit; dhe bekoje Muhammedin [të Dërguarin e Panxënë dhe familjen e Muhammedit siç e ke bekuar [familjen e] Ibrahimit në mesin popujve; Ti, me të vërtetë, je i denjë për Lavdërim, përplot Madhështi."⁵⁷⁷

5- ((اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ عَبْدِكَ وَرَسُولِكَ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ وَبَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ عَبْدِكَ وَرَسُولِكَ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ))

- 5- "O All-llah! Dërgo *salavate* mbi Muhammedin, robin dhe të Dërguarin Tënd, siç ke dërguar *salavate* mbi [familjen e] Ibrahimit. Dhe bekoje Muhammedin [robin dhe të Dërguarin Tënd], [dhe familjen e Muhammedit], siç e ke bekuar Ibrahimin [dhe familjen e Ibrahimit]".⁵⁷⁸

6- ((اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى أَزْوَاجِهِ وَذُرِّيَّتِهِ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ وَبَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى أَزْوَاجِهِ وَذُرِّيَّتِهِ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ))

- 6- "O All-llah! Dërgo *salavate* mbi Muhammedin dhe [mbi] gratë dhe pasardhësit e tij, siç ke dërguar *salavate* mbi [familjen e Ibrahimit]. Dhe bekoje Muhammedin dhe gratë e pasardhësit e tij, siç i ke bekuar [familjen] Ibrahimin; Ti vërtet je i denjë për Lavdërim, përplot madhështi".⁵⁷⁹

7- ((اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ وَبَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ وَبَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ))

- 7- "O All-llah! Dërgo *salavate* mbi Muhammedin dhe mbi familjen e Muhammedit, dhe bekoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit, siç ke dërguar *salavate* dhe bekime mbi Ibrahimin dhe familjen e tij; Ti, vërtet, je i denjë për Lavdërim, përplot Madhështi".⁵⁸⁰

Dobi të rëndësishme lidhur me dërgimin e *salavateve* mbi të Dërguarin e ummetit

⁵⁷⁷ Muslimi, Ebu Avane, Ibn Ebi Shejbe (2/132/1) dhe Ebu Davudi, Hakimi e ka shpallur *sahih*.

⁵⁷⁸ Buhariu, Nesaiu, Tahaviu, Ahmedi dhe Ismail El-Kadiu në *Faḍl Es-Salah 'ala En-Nebijj sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem* (f.28 botimi i parë, p.62 botimi i dytë me kontrollimin tim).

⁵⁷⁹ Buhariu, Muslimi dhe Nesaiu.

⁵⁸⁰ Nesaiu, Tahaviu, Ebu Se'id ibn El-Arabiu në *El-Mu'xhem* (79/2), me *sened sahih*. Ibn El-Kajjimi e ka dhënë burimin e tij, sikurse Muhammed bin Is-hak Es-Siraxhi në *Xhela El-Efham* (f.14-15), dhe pastaj e ka shpallur *sahih*. Kjo fjali përfshin të dy, edhe "Ibrahimin" edhe "familjen e Ibrahimit", diç që nuk është vënë re nga Ibn El-Kajjimi dhe mësuesi i tij Ibn Tejmiije, siç është sqaruar më lart.

1) Mund të shihet se në shumicën e këtyre mënyrave të dërgimit të *salavateve* mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], nuk përmendet Ibrahimimi ndaras nga familja e tij, siç është shprehja, “... siç ke dërguar *salavate* mbi familjen e Ibrahimit.” Arsyeja për këtë është se në arabishte familja e burrit përfshin burrin si dhe anëtarët e tjerë, p.sh. në fjalët e All-llahut të Lartësuar:

إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَىٰ آدَمَ وَنُوحًا وَآلَ إِبْرَاهِيمَ وَآلَ عِمْرَانَ عَلَى الْعَالَمِينَ (33)

“All-llahu zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi të gjithë njerëzit” (Ali Imran 3: 33);

إِلَّا آلَ لُوطٍ نَجَّيْنَاهُمْ بِسَحَرٍ (34)

“Ne dërguam kundër tyre një erë të fortë me të reshura gurësh, përveç familjes së Lutit - Ne i shpëtuam ata herët në agim” (Kamer 54: 34);

E ngjashme është thënia e tij [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]:

“O All-llah! Dërgo *salavate* mbi familjen e Ebu Evfasë”.

Shprehja *Ehlul-Bejti* (njerëzit e shtëpisë) është e këtillë, po ashtu, p.sh.:

رَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ عَلَيْكُمْ أَهْلَ الْبَيْتِ إِنَّهُ حَمِيدٌ مَجِيدٌ (73)

“Mëshira dhe bekimet e All-llahut qofshin me ju, o njerëzit e shtëpisë” (Hud 11: 73).

Kështu, Ibrahimimi përfshihet në “familjen e Ibrahimit”.

Shejhul-Islam Ibn Tejmijje thotë:

“Shumica e versioneve kanë; 'siç ke dërguar *salavate* mbi familjen e Ibrahimit' dhe 'siç e ke bekuar familjen e Ibrahimit'; disa kanë vetëm 'Ibrahimin'. Kjo ngase ai është shkaku i të gjitha *salavateve* dhe i pastrimeve që dërgohen përmbi të; të tjerët në familjen e tij janë pranues sekondarë të tërë asaj. Që të tregohen këto dy pika, të dyja shprehjet janë vendosur ndaras.”

Më tutje, në mesin e dijetarëve ekziston një pyetje e njohur mirë: për natyrën e krahasimit në deklaratën e tij, “siç ke dërguar *salavate* mbi...”, sepse është e vërtetë se i krahasuari nuk është më superior se ai me të cilin krahasohet; këtu është rast i kundërt, pasi Muhammedi (i krahasuar) [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është më i vlefshëm se Ibrahimimi, kështu që superioriteti i tij dikton që *salavatet* e kërkuara të jenë më të dalluara se cilado lutje të pranuar ose që do të pranohen nga dikush tjetër. Dijetarët kanë dhënë

shumë përgjigje në këtë, që mund të gjenden në “Fet-h El-Bari” dhe “Xhela El-Ifham”. Ato përfshijnë rreth dhjetë pikëpamje dhe të gjitha prej tyre janë të paprovuara, disa më të dobëta se të tjerat, përveç njëres, e cila është pikëpamje mirë e mbështetur dhe e përvetësuar nga Shejhul-Islam Ibn Tejmijje dhe Ibn El-Kajjimi. Kjo pikëpamje është:

“Familja e Ibrahimit përfshin shumë të Dërguar; asnjë sikur ata nuk gjendet në familjen e Muhammedit. Prandaj, kur kërkohen *salavate* mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe mbi familjen e tij të njëjta me ato që u janë dhënë Ibrahimit dhe familjes së tij që përfshin edhe të Dërguar, familja e Muhammedit pranon nga kjo atë çka i përket. Pasi familja e Muhammedit nuk mbërrin shkallën e të Dërguarve, atëherë bekimet dhe dobitë e dërguara përmbi të Dërguarve që teprojnë, duke përfshirë edhe Ibrahimin, mbesin për Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Kështu, ai fiton një pozitë të dalluar, që të tjerët nuk mund ta mbërrijnë.”

Ibn Kajjimi thotë:

“Kjo është pikëpamja më e mirë deri më tash: që Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është njëri nga familja e Ibrahimit; në të vërtetë, ai është më i miri nga familja e Ibrahimit, siç na transmeton Ali bin Talha nga Ibn Abbasi [radijall-llahu anhu] rreth thënies së të Lartësuarit:

إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَىٰ آدَمَ وَنُوحًا وَآلَ إِبْرَاهِيمَ وَآلَ عِمْرَانَ عَلَى الْعَالَمِينَ (33)

“All-llahu zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi të gjithë njerëzit” (Ali Imran 3: 33);

Ibn Abbasi ka thënë: 'Muhammedi është nga mesi i familjes së Ibrahimit.' Ky transmetim është provë e prerë për këtë rast, sepse, nëse të Dërguarit e tjerë të dalë nga Ibrahim përfshihen në familjen e tij, atëherë përfshirja e të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është më e përshtatshme. Prandaj thënia jonë, 'siç ke dërguar *salavate* mbi familjen e Ibrahimit', përfshin *salavatet* e dërguara mbi të dhe mbi të Dërguarit e tjerë të zbritur nga Ibrahim. All-llahu atëherë na ka urdhëruar ne që të dërgojmë *salavate* enkas mbi Muhammedin dhe mbi familjen e tij aq sa dërgojmë *salavate* mbi të, bashkë me pjesën tjetër të familjes së Ibrahimit në përgjithësi. Prandaj, familja e të Dërguarit pranon atë çka u përket, duke e lënë tërë atë që ka mbetur për të [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

Nuk ka dyshim se sasia e përgjithshme e *salavateve* e pranuar nga familja e Ibrahimit, me të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në mesin e tyre, është më e madhe se ajo e pranuar nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] veçmas. Prandaj, ajo çka kërkohet për të është begati e madhe, padyshim më superiore se ajo që është kërkuar për Ibrahimin.

Kështu, natyra e këtij krahasimi dhe lidhja logjike e saj bëhen të qarta. *Salavatet* e kërkuara për të me këto fjalë, janë më të mëdha se ato të kërkuara në çfarëdo mënyre tjetër, pasi ajo çka kërkohet me duanë është që të jetë aq sa edhe modeli i krahasimit, dhe që i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] të pranojë një sasi të madhe: krahasimi dikton që ajo çka kërkohet është më e madhe se ajo që i është dhënë Ibrahimit dhe të tjerëve.

Kështu, epërsia dhe fisnikëria e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], mbi Ibrahimin dhe familjen e tij, e cila përfshin shumë të Dërguar, është evidente dhe është ashtu siç ai e meriton. Ky dërgim i *salavateve* mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] bëhet dëshmi për këtë epërsi të tij, dhe kjo nuk është më shumë se që ai meriton. Kështu, pra, All-llahu dërgoftë *salavate* mbi të dhe familjen e tij dhe dërgoftë paqe mbi ta, shumë përsëritje të paqes, dhe e shpërbleftë nga duatë tona më mirë se që e ka shpërblyer cilindo të Dërguar nga populli i tij. O All-llah! Dërgo *salavate* mbi Muhammedin dhe familjen e Muhammedit, siç ke dërguar *salavate* mbi familjen e Ibrahimit; Ti, vërtet, je i denjë për Lavdërim, përplot Madhështi. Dhe bekoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit, siç e ke bekuar familjen e Ibrahimit; ti me të vërtetë je i Denjë, përplot Madhështi.”

2) Lexuesi do të vërejë se kjo pjesë e *salavateve*, me të gjitha llojet e ndryshme të saj, gjithnjë është dërgimi i *salavateve* mbi familjen e të Dërguarit, mbi gratë e tij dhe mbi fëmijët e tij, si dhe mbi vetë atë. Prandaj, nuk është sunnet e as zbatim i urdhrave të të Dërguarit që të lihet vetëm me “O All-llah! Dërgo *salavate* mbi Muhammedin”, por duhet të përdoret një nga këto lloje të plota të duase, si në *teshehhudin* e parë, ashtu edhe në të fundit, siç transmetohet nga veprimi i tij [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Imam Shafiu, në lidhje me këtë tekst, në librin e tij “El-Umm” thotë:

“*Teshehhudi* në rastin e parë dhe në të dytin është e njëjta gjë; me “*teshehhud*” unë kuptoj dëshmimin dhe dërgimin e *salavateve* mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]: asnjëri nuk do të mjaftojë pa tjetrin.”⁵⁸¹

Sa i përket hadithit: “Në *teshehhudin* e parë nuk shtonte asgjë, përveç *tehjatit*”, ky hadith është *bunker*, siç kam sqaruar më gjerësisht në “Zinxhiri i haditheve të dobëta” nr. 5816. Në të vërtetë, një prej gjërave më të çuditshme të lindura në këtë kohë dhe nga anarkia intelektuale të saj është se një person, Muhammed Is’af En-Neshashibiu, në librin e tij “El-Islam Es-Sahih” (“Islami i Vërtetë”), ka guxim të refuzojë dërgimin e *salavateve* mbi familjen e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] me rastin e dërgimit të *salavateve* mbi të, pavarësisht përcaktimit të tij të fuqishëm në *Sahihun* e Buhariut dhe të Muslimit dhe në vendet e tjera, në autoritetin e disa sahabëve, p.sh. të Ka’b bin Uxhres, Ebu Humejd Es-Sa’idiut, Ebu Se’id El-Hudriut, Ebu Mes’ud El-Ensariut, Ebu Hurerjes dhe

⁵⁸¹ Shiko: “El-Ummu”, 1/102

Talha bin Ubejdull-llahu! Në hadithet e tyre qëndron se ata e kanë pyetur të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]: “Si të dërgojmë *salavate* mbi ty?”, dhe ai ua mësoi këtë mënyrë. Argumenti i En-Neshashibut për pikëpamjen e tij është se i Lartësuarit nuk ka përmendur askënd bashkë me të Dërguarin e Tij në thënien e Tij:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا (56)

“O ju që besoni! Dërgoni salavate mbi të dhe përshëndeteni me respekt.” (Ahzab 33: 56).

Ai pastaj vazhdon më tej në refuzimin e tij duke thënë se Sahabët nuk ia shtruan atij [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] këtë pyetje, për shkak se fjalën “salah” tek ata ka qenë e ditur si “dua”, kështu që ata nuk kanë pasur nevojë për një pyetje të tillë! Ky është mashtrim i qartë, ngase pyetja e tyre nuk kishte të bënte me kuptimin e “salah” mbi të, sikur që haset në transmetimet të cilave ne iu referuam. Kështu e tërë kjo përputhet, sepse ata e kanë pyetur atë për mënyrën e dërgimit sipas sheriatit, diçka që nuk mund të kenë ditur, përveçse nga udhëzimi i të Gjithëdijshtit, të Urtit dhe Dorëzuesit të Sheriatit. Kësisoj, sikurse që kanë mundur ta pyesin për mënyrën e faljes së Salahut (namazit), që u bë i detyrueshëm nga fjalët e të Lartësuarit siç janë: **“Kryejeni Salahun (Namazin)”**, sepse njohja e tyre e kuptimit tekstual të “Salahut” nuk mund ta ketë larguar nevojën e tyre që të pyesin për mënyrën e saj sipas Sheriatit, dhe kjo është e qartë si loti.

Sa i përket argumentit të cilit En-Neshashibiu i referohet, ai është i parëndësishëm, sepse dihet mirë në mesin e muslimanëve se i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është sqarues i fjalëve të Zotit të Botëve, si thotë Ai:

وَأَنزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ (44)

“Dhe Ne ta kemi dërguar ty shpalljen, që ti t’ua shpjegosh qartë njerëzve se çka u është dërguar” (Nahl 16: 44).

Prandaj, i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] shpjegoi mënyrën e dërgimit të *salavateve* mbi të, që përfshin përmendjen e familjes së tij, prandaj është e detyrueshme të pranohet kjo prej tij, për shkak të thënies së All-llahu [subhanehu ve teala]:

“Atë çka t’ju japë i Dërguari, merreni” (Hashr 59: 7)

dhe hadithin e njohur mirë:

“Vërtet, mua më është dhënë Kur’ani dhe diçka e ngjashme me të”.⁵⁸²

⁵⁸² Ebu Davudi dhe Ahmed, me *isnad sahih*.

Me të vërtetë, pyes veten, se çka do të thoshte En-Neshashibiu dhe ata që u gënjyen nga fjalët pompoze të tij, nëse dikush do ta refuzonte tërësisht *teshehhudin* në namaz, ose do ta refuzonte ndalesën e gruas me menstruacione për t'u falur dhe për të agjëruar, të gjitha këto me argumentin se All-llahu i Lartësuar nuk e ka përmendur *teshehhudin* në Kur'an; Ai ka përmendur vetëm rukunë dhe sexhden, dhe Ai në Kur'an nuk e ka përjashtuar nga falja dhe agjërimi gruan me menstruacione!! Pra, a pajtohen ata me këso argumente që janë në një radhë me argumentet e tij origjinale të tij, apo jo? Nëse po, e ne shpresojmë se jo, atëherë ata kanë devijuar larg, larg nga udhëzimi dhe kanë lëshuar rrjedhën e muslimanëve; nëse jo, atëherë ata kanë të drejtë që janë pajtuar me ne, dhe arsyet e tyre për refuzimin e këtyre argumenteve janë pikërisht të njëjta me arsyet tona për refuzimin e deklaratës origjinale të En-Neshashibiut, të cilën e kemi shpjeguar qartë.

Prandaj, kini kujdes, o muslimanë, nga përpjekja për ta kuptuar Kur'anin pa iu rikthyer Sunnetit, sepse kurrë nuk do të mund ta bëni këtë, edhe nëse do të ishit Sibevejh⁵⁸³ i kohës suaj, ekspert i kohës suaj në gjuhën arabe. Këtu kemi një shembull para jush, pasi Nesheshibiu është njëri prej dijetarëve udhëheqës të kësaj periudhe në gjuhën arabe. Ju keni parë se si ka lajthitur, duke u mashtruar nga njohuritë e tij të gjuhës, duke mos kërkuar ndihmë nga Sunneti në kuptimin e Kur'anit; në të vërtetë, ai refuzoi këtë ndihmë, siç kuptuat. Ka shumë shembuj të tjerë të këtillë - këtu nuk ka hapësirë të mjaftueshme që t'i përmendim, por ajo çka kemi përmendur do të mjaftojë, dhe All-llahu është Dhuruesi i të gjitha mundësive.

3) Lexuesi, po ashtu, do të shohë se në asnjërin prej këtyre llojeve të *salavateve* mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk ekziston fjala *sejjid* (udhëheqës, prijës). Dijetarët e mëvonshëm janë dalluar në lidhje me vlefshmërinë e përfshirjes së saj në *salavateve* mbi Ibrahimin. Për shkak të mungesës së hapësirës, nuk do të hyjmë në detaje e as nuk do t'i përmendim ata që refuzuan vlefshmërinë e saj, duke iu përmbajtur kështu mësimëve të plota të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] që ia drejtoi ummetit të tij, kur ai udhëzoi, "Thuaj: O All-llah! Dërgo salavate mbi Muhammedin...", kur u pyet për mënyrën e dërgimit të *salahut* mbi të, por do të citojmë El-Hafidh Ibn Haxher El-Askalanin rreth kësaj, duke pasur parasysh pozitën e tij si njëri nga dijetarët e mëdhenj Shafiit të hadithit dhe të fikhut, sepse kundërshtimet ndaj këtij mësimi të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] janë përhapur shumë në mesin e dijetarëve Shafi. El-Hafidh Muhammed bin Muhammed bin Muhammed El-Gurabiliu (790-835 p.H.), bashkëmendimtar i Ibn Haxherit, ka thënë, dhe unë po citoj nga dorëshkrimi i tij⁵⁸⁴:

"Ai (d.m.th. Ibn Haxheri), All-llahu e bëftë jetën e tij të dobishme për ne, u pyet për veçoritë e *salavateve* mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] gjatë namazit ose jashtë tij, pa marrë parasysh se a themi se dërgimi i *salavateve* është vaxhib ose themi se është sunnet: "A është njëri nga kushtet e tij që i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] të cilësohet me *sejjidena*/Zotëriun tonë

⁵⁸³ Gramatikan i njohur dhe dijetar i gjuhës arabe i shekullit të dytë p.H.

⁵⁸⁴ Që ruhet në Librarinë "Edh-Dhahirijeh" në Damask.

(udhëheqësi)?, p.sh. 'O All-llah! Dërgo *salavate* mbi Muhammedin, ose Zotëriun e krijesave, ose mbi Zotëriun e bijve të Ademit, apo mjafton të thotë: 'O All-llah! Dërgo *salavate* mbi Muhammedin'. Cila nga këto është qasje më e mirë: përfshirja e fjalës *sejjid*, për shkak të të qenët e saj cilësi e vërtetuar e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], apo lënia e saj për shkak të mungesës së saj në transmetime?'

Ai (Ibn Haxheri), All-llahu qoftë i kënaqur me të, u përgjigj:

'Po, të pasosh shprehjet e transmetuara është më mirë. Nuk mund të thuhet: 'Ndoshta vetë i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk e thoshte nga modestia, sikur që nuk e thoshte [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] gjatë përmendjes së emrit të tij, ndonëse ummeti i tij është nxitur të veprojë kështu', sepse ne themi që, nëse ajo do të ishte më mirë, do të ishte cituar nga Sahabët, pastaj nga Tabi'inët, por ne nuk e gjejmë në asnjë transmetim nga asnjë Sahab ose Tabi'inë. Kjo është përkundër sasisë së madhe të transmetimeve nga ata. Kemi Imam Shafiun, All-llahu e lartësoftë, njërin nga njerëzit më të dalluar në respektimin e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], duke thënë në hyrje të librit të tij, i cili është bazë për njerëzit e medhhebit të tij: 'O All-llah! Dërgo *salavate* mbi të Dërguarin...' etj., deri në fund të asaj që gjykimi i tij diktonte, "... sa herë që ndonjëri nga përkujtuesit e përkujton atë, dhe sa herë që ndonjëri nga të shkujdesurit harron ta përkujtojë", çka ai, siç duket, e ka nxjerrë nga hadithi autentik, në të cilin tregohet se i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e pa Nënë e Besimtarëve duke bërë dhikr të shumtë dhe të gjatë, dhe i tha asaj: **'Ti ke thënë fjalë të cilat, po të mateshin me këto që pasojnë, do të balancoheshin: I madhëruar qoftë All-llahu aq herë sa është numri i krijesave të Tij'**; atij [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i pëlqenin duatë të cilat ishin koncize, por të thella në kuptim.

El-Kadi 'Ijadi ka përpiluar një kaptinë në lidhje me *salavatet* mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në librin e tij "Esh-Shifa" (Libri i Shërimit), duke cituar në të transmetime nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nën autoritetin e disa Sahabëve dhe Tabi'inëve; në asnjërin prej tyre nuk transmetohet fjala *sejjid*:

- a) Hadithi i Aliut; se ai ua mësonte mënyrën e *salavateve* mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], duke thënë: "O All-llah, Shpërndarës i fushave, Shpikës i kodrave, dërgo *salavatet* më të mira, bekimet më të frytshme dhe të gjitha nderimet e tjera mbi Muhammedin, robin Tënd dhe të Dërguarin, hapësin e asaj çka është e mbyllur.
- b) Prapë nga Aliu, se thoshte: "*Salavatet* e All-llahut, Përdëllestarit, Mëshiruesit, e engjëjve më të afërt (me All-llahun), e të Dërguarve, e të Singertëve, e

Dëshmitarëve, e të Drejtëve dhe e çdo gjëje që të madhëron Ty, o Zot i botëve, qofshin mbi Muhammedin të birin e Abdull-llahut, Vulën e të Dërguarve, Imamin e atyre që i frikësohen Zotit, ...etj.”

- c) Nën autoritetin e Abdull-llah bin Mesudit, se ai thoshte: “O All-llah! Dërgo *Salavatet* Tua, Bekimet dhe Mëshirën Tënde mbi Muhammedin, robin dhe të Dërguarin Tënd, imamin e mirësisë, të Dërguarin e mëshirës, ...etj”.
- d) Nga El-Hasan El-Basriu, që ai thoshte: “Kushdo që dëshiron të pijë nga gota që shuan etjen, nga burimi i Mustafasë, duhet të thotë: 'O All-llah! Dërgo *salavate* mbi Muhammedin dhe mbi familjen e tij, mbi shokët e tij, gratë e tij, fëmijët e tij, pasardhësit e tij, dhëndurët e tij, kushërinjtë e tij, ndihmuesit e tij, pasuesit e tij dhe mbi të gjithë ata që e duan.”

Pra, kjo është ajo çka (Kadi'Ijadi) ka shkruar në “Esh-Shifa” lidhur me mënyrën e *salavateve* mbi të Dërguarin, nën autoritetin e Sahabëve dhe të atyre që i trashëguan ata, duke përmendur edhe gjëra të tjera në të.

Po, është transmetuar në hadithin e Ibn Mes'udit se në *salavatet* e tij mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thoshte: “All-llah! Dërgo *salavatet* më të mira, mëshirën dhe bekimet mbi (*sejjidin*) udhëheqësin e të Dërguarve...” etj., transmetuar nga Ibn Maxhe, por *isnadin* e ka të dobët, prandaj hadithi i Aliut, i transmetuar nga Taberaniu me *isnad* të pranueshëm ka përparësi. Ky hadith ka fjalë të paqarta, të cilat i kam paraqitur dhe i kam shpjeguar në librin “Fadul En-Nebijj” (Shkëlqesia e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]) të Ebul-hasen bin El-Faris-it. Disa Shafi thonë, se nëse ndokush do të përbetohej për të dërguar *salavatet* më të mira mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], mënyra për ta përmbushur betimin e tij do të ishte: “O All-llah! Dërgo *salavate* mbi të Dërguarin sa herë që përkujtuesit e përkujtojnë ose të shkujdesurit e harrojnë”. En-Neveviu ka thënë:

'Më e përshtatshmja të caktohet si e saktë është që njëri të thotë: 'O All-llah! Dërgo *salavatet* mbi Muhammedin dhe mbi familjen e Muhammedit, siç ke dërguar *salavate* mbi Ibrahimin...'

Disa nga dijetarët e mëvonshëm i janë përgjigjur kësaj duke thënë se në asnjërën prej këtyre dy mënyrave të përmendura më lart nuk gjendet ndonjë gjë për të dëshmuar se cila është më superiore, por sa i përket kuptimit, atëherë e para është qartë më superiore. Kjo çështje është mirë e njohur në librat e fikhut, dhe nga të gjithë dijetarët e fikhut të cilët e shtruan këtë çështje, pa përjashtime, askund në fjalët e tyre nuk paraqitet fjala *sejjid*. Sikur të kishte qenë kjo fjalë shtesë e rekomandueshme, nuk do t'u kishte shpëtuar atyre të gjithëve, duke i

lënë të paditur për të. Të gjitha të mirat janë në ndjekjen e asaj që është transmetuar, dhe All-llahu e di më së miri.”

Pikëpamja e Ibn Haxherit për mospranimin e përshkrimit të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] si *sejjid* gjatë *salavateve* mbi të, është në përputhje me urdhrin kur'anor, dhe, po ashtu, është edhe mendimi i dijetarëve hanefi. Është ky mendim të cilit duhet t'i përmbahemi, sepse është shprehje e vërtetë e dashurisë ndaj tij [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]:

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ (31)

“Thuaj: Nëse doni All-llahun, atëherë më pasoni dhe All-llahu do t’ju dojë.” (Ali Imran 3: 31)

Për shkak të kësaj, Imam En-Neveviu në “Revdah Et-Talibin” (1/265) ka thënë: “*Salavati* më i plotë mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është: 'O All-llah! Dërgo *salavatet* e Tua mbi Muhammedin...'” etj., në përputhje me mënyrën nr.3, në të cilën nuk përmendet fjala *sejjid*!

4) Do ditur se mënyrat 1 dhe 4 janë ato të cilat i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ua mësoi Sahabëve, kur e pyetën për mënyrën e dërgimit të *salavateve* mbi të, kështu që kjo është përdorur si dëshmi se këto janë mënyrat më të mira të dërgimit të *salavateve* mbi të, sepse ai nuk zgjidhte asgjë për ta ose për vete, përveçse më të mirën dhe më fisniken. Imam En-Neveviu, siç është cekur më parë, pohonte (në *Revdah Et-Talibin*) që, sikur dikush do të betohej për ta bërë *salavat* më të mirë mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], këtë nuk do të mund ta përmbushte, përveçse me këto mënyra.

Es-Subkiu ka dhënë një arsye tjetër: kushdo që dërgon *salavate* me këto mënyra, le të jetë i sigurt se ka bërë *salavate* mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], e kushdo që e bën atë me fjalë të tjera, është i dyshimtë se a i ka bërë *salavatet* ashtu siç është kërkuar, apo jo. Kjo është për shkak se ata kanë thënë: “Si të dërgojmë *salavate* mbi ty?” dhe ai është përgjigjur: “Thuaj: ...”, duke e definuar kështu *salavatet* e tyre mbi të. Këtë e ka përmendur Hejtemiu në “Ed-derr El-Mendudi” (25/2) e pastaj thotë (27/1) se qëllimi është arritur me të gjitha mënyrat të cilat janë paraqitur në hadithet autentike.

5) Do ditur se nuk vlen kombinimi i të gjitha këtyre mënyrave në një mënyrë të *salavateve*, dhe e njëjta vlen për *teshehhudet* e ndryshme të dhëna më parë. Në të vërtetë, ajo do të ishte risi në fe; Sunnet është të thuhet mënyra të ndryshme në kohë të ndryshme, siç shpjegon Shejhul-Islam Ibn Tejmijje në diskutimin e tij për tekbinin e dy Bajrameve (*Mexhmu' El-Fetava* 29/253/1).

6) El-Al-lameh Siddik Hasen Kani thotë në librin e tij “Nuzul El-Ebrar bil-”Ilm El-Me’thur min El-Ed’ijeh vel-Edhkar”, pasi që jep shumë hadithe përkitazi me rëndësinë e *salavateve* mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] (f. 161) thotë:

“Nuk ka dyshim se më të dalluarit në mesin e muslimanëve në dërgimin e *salavateve* mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] janë dijetarët e Hadithit dhe transmetuesit e Sunnetit të pastër, sepse është një prej detyrave të tyre në këtë degë bujare të dijes dërgimi i *salavateve* mbi të para çdo hadithi dhe kështu gjuhët e tyre janë të zëna gjithmonë me përmendjen e tij, All-llahu i dhëntë atij mëshirë dhe paqe. Nuk ka ndonjë libër të Sunnetit a koleksion të hadithit, qoftë ai *xhami’*, *musned*, *mu’xhem*, *xhuz*, etj., që nuk përfshin mija hadithe, bile një nga më të paktët në vëllim, *El-Xhami’ Es-Sagir* i Es-Sujutiut përmban dhjetë mijë hadithe, e mos të flasim për tjerat. Prandaj, ky është Grup i Shpëtuar: Ithtarët e Hadithit, të cilët do të jenë më të afërmit nga njerëzit me të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në Ditën e Ringjalljes dhe me gjasat më të mëdha për t’u shpërblyer me ndërmjetësimin e tij [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], u flijofshin im atë dhe ime ëmë për të! Kjo madhështi e Ithtarëve të Hadithit nuk mund të kalohet nga askush, përpos nëse dikush do të bënte më shumë se ajo çka ata bëjnë, gjë që është gati e pamundur. Prandaj, o dëshirues i së mirës, kërkues i shpëtimit, gjithsesi duhet të jesh ose *muhaddith*, ose të rrish afër *muhaddithëve*; mos ji ndryshe..., sepse, veç kësaj, nuk ekziston asgjë që do të të bënte dobi.”⁵⁸⁵

E lus All-llahun e Bekuar dhe të Lartësuar të më bëjë njërin prej këtyre Ithtarëve të Hadithit, të cilët janë më të afërmit nga njerëzit me të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Ndoshta ky libër do të jetë dëshmi për këtë. All-llahu e mëshiroftë Imam Ahmedin, i cili recitonte:

Feja e Muhammedit është në transmetime,
Sepse mbështetja më e mirë për një të ri është tradita;
Mos ia kthe shpinën Hadithit dhe njerëzve të tij,
Meqë opinionin është natë, kurse Hadithi është ditë.
I riu mund të jetë injorant ndaj udhëzimit...
Megjithëse dielli shndrit me gjithë shkëlqimin e tij!

Dua ja në *teshehhudin* e parë

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka lënë gjithashtu edhe udhëzimin për duanë në këtë *teshehhud*, duke thënë:

⁵⁸⁵ Kjo është porosi e artë nga ky imam, andaj kapu për te me dhëmballë, nëse shpreson shpëtim në dunja dhe ahiret.

“Kur të uleni pas çdo dy rekatesh, atëherë thoni: 'Të gjitha lavdërimet i qofshin All-llahut... (deri në fund të kësaj duaje, pastaj tha:)... pastaj zgjidhni një dua që ju pëlqen më së shumti.'”⁵⁸⁶

⁵⁸⁶ Nesaiu, Ahmedi dhe Taberaniu, me isnade të ndryshme nga Ibn Mes'udi - detajet - detajet janë dhënë në “Es-Sahihah” (878) - dhe është hadithi i Ibn Ez-Zubejrit që e mbështet këtë, në Mexhma' Ez-Zeva'id (2/142)

Ngritja në rekatën e tretë e pastaj në të katërtin

Më tutje, ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ngrihej në rekatën e tretë me tekbir⁵⁸⁷ dhe e urdhëroi "atë që u fal keq" të vepronte kështu:

"Pastaj bëje atë në çdo rekat dhe çdo sexhde si më parë".

"Kur ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ngrihej nga ulja, e thoshte tekbirin, pastaj ngrihej në këmbë"⁵⁸⁸; dhe "ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ngrinte duart"⁵⁸⁹ nganjëherë në këtë tekbir.

"Kur donte të ngrihej në rekatën e katërt, ai thoshte: "All-llahu Ekber"⁵⁹⁰, dhe e urdhëroi "atë që u fal keq" të vepronte kështu si më parë dhe "ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ngrinte duart"⁵⁹¹ nganjëherë në këtë tekbir.

"Ai ulej drejt në këmbën e majtë, qetë, derisa çdo asht të kthehej në vendin e vet të duhur, pastaj ngrihej duke u mbështetur në tokë; dhe i mblidhte grushtet⁵⁹²; duke u mbështetur në duar, kur ngrihej."⁵⁹³

Ai këndonte "El-Fatiha-në" në të dyja rekatet, dhe e urdhëroi "atë që u fal keq" ta bënte këtë. Në namazin e Drekës, ai nganjëherë i shtonte disa ajete kësaj, siç është shpjeguar nën "Këndimi në Namazin e Drekës".

⁵⁸⁷ Buhariu dhe Muslimi.

⁵⁸⁸ Ebu Ja'la në *Musnedin* e tij (284/2) me *isnad* të mirë. Është dhënë në *Silsileh El-Ehadith Es-Sahihah* (604).

⁵⁸⁹ Buhariu dhe Ebu Davudi.

⁵⁹⁰ Ibid.

⁵⁹¹ Ebu Avane dhe Nesaiu, me *sened sahih*.

⁵⁹² Tekstualisht, "si ai që ngjesh brumë."

⁵⁹³ Harbiu në "Garib El-Hadith," kuptimi i tij është në Buhari dhe Ebu Davud. Sa i përket hadithit, "Ai ndaloi të mbështeturit në duar gjatë ngritjes në namaz", është *munker* dhe joautentik, siç kam shpjeguar në *Silsileh El-Ehadith Ed-Da'ifeh* (967).

Kunuti në pesë namazet për shkak të ndonjë fatkeqësie

“Kur ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] donte të lutej kundër ndokujt ose të lutej për dikë, ai e bënte *kunutin*⁵⁹⁴ në rekatin e fundit, pas rukusë, pasi thoshte: “*Semi'all-llahu limen hamideh All-llahumme rabbena lekel-hamd*”.⁵⁹⁵ “Ai lutej me zë të ngritur”⁵⁹⁶, “ngrinte duart”⁵⁹⁷, dhe “ata pas tij thoshin: amin”⁵⁹⁸.

“Dihej për të se e bënte *kunutin* në pesë namazet”⁵⁹⁹, ndonëse “ai bënte *kunutin* në to vetëm kur lutej për njerëzit ose kur lutej kundër tyre”⁶⁰⁰. Për shembull, ai njëherë tha:

“O All-llah! Shpëtoje El-Velid bin El-Velidin, Selemeh bin Hishamin, Ijash bin Ebi Rebiun. O All-llah! Shtojë dënimin tënd mbi (fisën) Mudar dhe bëji për ta vitet si vitet e Jusufit. [O All-llah! Mallkoje Lahjanin, Ru'lin, Dhekvanin dhe Usajin, të cilët nuk dëgjuan All-llahun dhe të Dërguarin e Tij!]

Pastaj, “ai thoshte: All-llahu Ekber, kur kryente *kunutin*, dhe bënte sexhde.”⁶⁰²

Kunuti në namazin e vitrit

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e bënte *kunutin* në rekatin (tek) të namazit të Vitrit”⁶⁰³ nganjëherë⁶⁰⁴, dhe “ai e bënte atë para rukusë.”⁶⁰⁵

⁵⁹⁴ *El-Kunut* bart disa kuptime, p.sh. përlësi, devocion. Këtu kemi të bëjmë me një dua të veçantë me rastin e qëndrimit në këmbë gjatë namazit.

⁵⁹⁵ Buhariu dhe Ahmedi.

⁵⁹⁶ *Ibid*.

⁵⁹⁷ Ahmedi dhe Taberaniu, me *sened sahih*. Ngrija e duarve në *kunut* është qëndrim i Ahmedit, si dhe i Is'hak ibn Rahevejhut, cf. *El-Mesail*-i i Merveziut (f.23). Sa i përket fërkimit të fytyrës me duar në këtë pozitë, nuk është transmetuar në këtë pozitë, prandaj është një risi; ndërsa sa i përket jashtë namazit, nuk transmetohet në mënyrë autentike: çdo gjë që është transmetuar përkitazi me këtë është e dobët, siç kemi treguar në *Da'if Ebi Davud* (262) dhe *Silsileh El-Ehadith Es-Sahihah* (597). Për këtë shkak El-'Izz bin 'Abd Es-Selam thotë në njërin prej fetvave të tij:

“Vetëm personi injorant e bën këtë.”

Shih Shtojcën 8.

⁵⁹⁸ Ebu Davudi dhe Siraxhi; Hakimi e ka shpallur *sahih*, ndërsa Dhehebiu dhe të tjerët janë pajtuar.

⁵⁹⁹ Ebu Davudi, Siraxhi dhe Darekutniu, me dy *senede hasen*.

⁶⁰⁰ Ibn Huzejme në *Sahihun* e tij (1/78/2) dhe Ebu Ja'la në *Musnedin* e tij, me *sened sahih*.

⁶⁰¹ Ahmedi dhe Buhariu; shtesa është në Muslim.

⁶⁰² Nesaiu, Ahmedi, Siraxhi (109/1) dhe Ebu Ja'la në *Musnedin* e tij, me *sened* të mirë.

⁶⁰³ Ibn Nasri dhe Darekutniu, me *sened sahih*.

⁶⁰⁴ Ne kemi thënë, “...nganjëherë”, sepse Sahabët që e kanë transmetuar namazin e Vitrit, nuk kanë përmendur *kunutin* në të, ndërsa, sikur ta kishte bërë i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] këtë gjithnjë, ata të gjithë do ta kishin përmendur. Derisa vetëm Ubejj bin Ka'bi transmeton *kunutin* në Vitrit, pra, kjo tregon se ai e bënte atë nganjëherë. Prandaj, kjo është dëshmi se *kunuti* në Vitrit nuk është i detyrueshëm (*vaxhib*), dhe ky është mendim i shumicës së dijetarëve. Për këtë arsye, dijetari hulumtues Hanefi, Ibn El-Humami, ka pranuar në *Thet'h El-Kadir* (1/306, 359, 360) se mendimi për detyrimin e tij është i dobët, dhe

Ai mësoi El-Hasan bin Aliun [radijall-llahu anhu] të thotë [pasi të përfundojë këndimin në Vitr]:

((اللَّهُمَّ اهْدِنِي فِيمَنْ هَدَيْتَ وَعَافِنِي فِيمَنْ عَافَيْتَ وَتَوَلَّنِي فِيمَنْ تَوَلَّيْتَ وَبَارِكْ لِي فِيمَا أَعْطَيْتَ وَقِنِي شَرَّ مَا قَضَيْتَ فَإِنَّكَ تَقْضِي وَلَا يُقْضَى عَلَيْكَ وَإِنَّهُ لَا يَذِلُّ مَنْ وَالَيْتَ [وَلَا يَعْزُ مَنْ عَادَيْتَ] تَبَارَكْتَ رَبَّنَا وَتَعَالَيْتَ [لَا مُنْجَا مِنْكَ إِلَّا إِلَيْكَ]))

“O All-llah! Më udhëzo në mesin e atyre që i ke udhëzuar; më fal në mesin e atyre që i ke falur; më shoqëro mua me ata të cilët i ke shoqëruar; më beko në atë çka Ti ke dhuruar; më shpëto nga e keqja e asaj që Ti ke përcaktuar; [se] vërtet, Ti përcakton dhe askush s’mund të ndikojë në Ty; [dhe] nuk është poshtëruar ai të cilin Ti e ke miqësuar; [e as që është nderuar ai që është armiku Yt.] I bekuar qofsh, o Zot dhe i Lartësuar. [Nuk ka shpëtim prej Teje, përpos në drejtimin Tënd.]”⁶⁰⁶

nuk është i përforcuar me argument. Kjo tregon sinqeritetin e tij dhe mungesën e konformizmit, sepse ky mendim që e ka përkrahur është në kundërshtim me medhhebin e tij!

⁶⁰⁵ Ibn Ebi Shejbe (12/41/1), Ebu Davudi, Nesaiu, në *Sunen El-Kubra* (218/1-2), Ahmed, Taberaniu, Bejhekiu dhe Ibn Asakiri (4/244/2) e kanë transmetuar këtë, së bashku me duanë pas saj me *sened sahih*. Ibn Mende e ka transmetuar këtë dua vetëm në *Tevhid* (70/2) me *sened hasen* të ndryshëm. *Tahrir* i saj, po ashtu, është dhënë në *El-Irva* (426).

⁶⁰⁶ Ibn Huzejme (1/119/2) dhe, po ashtu, Ibn Ebi Shejbe, etj; sikur për hadithin e fundit.

Shënime: Nesaiu shton në fund të *kunutit*: dhe *sal-lall-llahu ‘ala-n-Nebijj El-Ummij* (“All-llahu dërgoftë salavate mbi të Dërguarin e Pashkolluar”), i transmetuar me *isnad* të dobët. Në mesin e atyre që e shpallën *daif* janë Ibn Haxher El-’Askalani dhe Ez-Zurkaniu. Prandaj, ne nuk e kemi përfshirë në sistemin tonë të kombinimeve të transmetimeve të pranueshme. El-’Izz bin ‘Abd Es-Selam tha në *El-Fetava* (66/1, 1962):

“Dërgimi i salavateve mbi të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në *kunut* nuk është autentik dhe as që është e përshtatshme t’i shtohet namazit të të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në çfarëdo mënyre.”

Ky mendim i tij tregon se ai e ka zgjeruar argumentin duke përfshirë idenë e bidatit *hasen* (ririsë së “mirë”), siç kanë prirje të bëjnë disa dijetarë të vonshëm! Megjithatë, është dëshmuar në hadithin për Ubejj bin Ka’bin se, gjatë udhëheqjes në namazet e netëve të Ramazanit, ai dërgonte salavate mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në fund të *kunutit*, dhe kjo ka qenë gjatë sundimit të Umerit [radijall-llahu anhu] - transmetuar nga Isma’il El-Kadiu (nr. 107) dhe të tjerët, prandaj kjo shtesë është përligjur nga praktika e Selef, dhe nuk mund të pohohet kategorikisht se kjo shtesë është një risi. All-llahu e di më së miri.

Obligimi i këtij *teshehudi*

Mbasandaj, pas plotësimit të rekatit të katërt, ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ulej në *teshehudin* e fundit. Ai udhëzonte lidhur me të dhe vepronte në të ashtu siç vepronte në *teshehudin* e parë, përveçse “ulej *muteverriken*”⁶⁰⁷, “me kofshën e epërme të majtë në tokë dhe dy këmbët e tij të nxjerra në një anë (d.m.th. të djathtë).”⁶⁰⁸ “Shputën e këmbës së tij të majtë e vendoste nën kofshën dhe kërcirin e djathtë”⁶⁰⁹, “shputën e djathtë të këmbës e mbante drejt”⁶¹⁰ ose nganjëherë “ai e shtrinte atë për toke.”⁶¹¹ “Shuplaka e tij e majtë mbulonte gjurin e tij të majtë, duke u mbështetur fort në të.”⁶¹²

Ai la shembullin e dërgimit të salavateve mbi të [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në këtë *teshehud* sikurse në *teshehudin* e parë; mënyrat e dërgimit të salavateve mbi të janë dhënë të transmetuara në atë pjesë.

Obligimi i dërgimit të salavateve mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në këtë *teshehud*

Njëherë, “ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dëgjoi një njeri duke u lutur në namazin e tij pa lavdëruar madhështinë e All-llahut të Lartësuar dhe pa dërguar salavate mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], prandaj tha: “Ky njeri u ngut.” Pastaj e thirri tek ai dhe i tha atij dhe të tjerëve:

“Kur të falet ndokush nga ju, duhet të fillojë me lavdërimin e Zotit të tij Sublim dhe të Gjithëfuqishëm dhe me lartësimin e Tij, dhe pastaj të dërgojë salavate (në një transmetim: ai duhet të dërgojë salavate) mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe pastaj të lutet si të dojë.”⁶¹³

⁶⁰⁷ Buhariu

⁶⁰⁸ Ibid. Sa i përket namazit dyrekatësh, siç është Sabahu, është Sunnet të ulet *mufterishen*. Ky dallim në detaje është dokumentuar nga Imam Ahmedi; *Mesail*-in e Imam Ahmedit nga Ibn Hani (f.79).

⁶⁰⁹ Ebu Davudi dhe Bejhekiu, me *sened sahih*.

⁶¹⁰ Muslimi dhe Ebu Avane.

⁶¹¹ Ibid.

⁶¹² Ibid.

⁶¹³ Ahmedi, Ebu Davidi, Ibn Huzejme (1/83/2) dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

Do ditur se ky hadith dëshmon që *selah*-u (dërgimi i salavateve) mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në këtë *teshehud* është i detyrueshëm, për shkak të urdhrit për të. Ky mendim është përfaqësuar nga Imam Shafiu dhe nga Imam Ahmedi në transmetimin e fundit nga dy transmetimet prej tij, dhe para tyre nga disa Sahabë, si dhe nga dijetarë të tjerë. Për shkak të kësaj, El-Axhuriu ka thënë në *Sheri'ah* (f.415):

“Ai i cili nuk dërgon salavate mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në *teshehudin* e fundit, duhet ta përsëritë namazin.”

Prandaj, ata që e etiketojnë Imam Shafiun se është i vetëm dhe i çuditshëm në mendimin e vet mbi këtë, nuk kanë të drejtë, siç ka shpjeguar fakihu El-Hejtemiu në *Ed-Derr El-Menduh* (pjesa 13-16).

Po ashtu, “ai e dëgjoi një njeri duke lavdëruar dhe duke madhëruar All-llahun, dhe pastaj duke dërguar salavate mbi të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në namaz, atëherë i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i tha:

“Lutu dhe do të të pranohet, kërko dhe do të të jepet.”⁶¹⁴

Obligimi për të kërkuar strehim nga katër gjëra para bërjes së duasë

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thoshte:

“Kur dikush nga ju e kryen *teshehudin* [e fundit], duhet të kërkojë strehim tek All-llahu nga katër gjëra, [duke thënë:

O All-llah! Vërtet, kërkoj strehim te Ti] nga dënimi i Zjarrit të Xhehennemit dhe nga dënimi i varrit dhe nga sprova e jetës dhe e vdekjes dhe nga e keqja [sprovat] e Dexhxhallit (antikrishtit). [Pastaj duhet të bëjë dua për vete me atë që i bie ndërmend.]”⁶¹⁵

((اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ جَهَنَّمَ وَمِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ وَمِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا وَالْمَمَاتِ وَمِنْ شَرِّ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ
الدَّجَالِ))

“Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] bënte dua me të në *teshehudin* e tij.”⁶¹⁶

Po ashtu, “ai ua mësonte Sahabëve [radijall-llahu anhuma] këtë, ashtu siç ua mësonte suret e Kur'anit.”⁶¹⁷

⁶¹⁴ Nesaiu me *sened sahih*.

⁶¹⁵ Muslimi, Ebu Avane, Nesaiu dhe Ibn El-Xharudi në *El-Munteka* (27). Është dhënë në *El-Irva* (350).

⁶¹⁶ Ebu Davudi dhe Ahmedi, me *sened sahih*.

⁶¹⁷ Muslimi dhe Ebu Avane.

Duaja para Selamit dhe llojet e ndryshme të saj

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] përdorte dua të ndryshme në namazin e tij⁶¹⁸, duke u lutur me dua të ndryshme; ai ka konfirmuar edhe dua të tjera, dhe “urdhëronte adhuruesin që të zgjedhë prej tyre atë që do.”⁶¹⁹ Ato janë:

1- ((اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا وَفِتْنَةِ الْمَمَاتِ اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْمَأْتَمِ وَالْمُغْرَمِ))

1 - “O All-llah! Vërtet, kërkoj strehim nga dënimi i varrit dhe kërkoj strehë te Ti nga sprovat e Dexhxhallit dhe kërkoj strehë te Ti nga sprova e jetës dhe e vdekjes. O All-llah! Vërtet, kërkoj strehë te Ti nga mëkati⁶²⁰ dhe barra^{621,622}

2- ((اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا عَمِلْتُ وَمِنْ شَرِّ مَا لَمْ أَعْمَلْ بَعْدُ))

2 - “O All-llah! Vërtet, kërkoj strehë te Ti nga e keqja e asaj që kam bërë dhe nga e keqja e asaj që nuk kam bërë⁶²³ [ende].”⁶²⁴

3- ((اللَّهُمَّ حَاسِبْنِي حِسَابًا يَسِيرًا))

3 - “O All-llah! Më llogarit me një llogari të lehtë.”⁶²⁵

⁶¹⁸ Ne s’kemi thënë, “...në teshehudin e tij”, sepse teksti është “... në namazin e tij”, pa veçuar *teshehudin* ose diç tjetër, prandaj përfshin të gjitha pozitat të përshtatshme për lutje, p.sh. sexhden dhe *teshehudin*; udhëzimi për duanë në këto dy pozita është përmendur.

⁶¹⁹ Buhariu dhe Muslimi. Ethremi ka thënë: “E pyeta Ahmedin: “Me çfarë (fjalë) duhet të lutem pas *teshehudit*?” Ai tha: “Ashtu siç është transmetuar.” Unë e përsërita pyetjen e ai tha: “Prej asaj çka është transmetuar”. “Kjo është cituar nga Ibn Tejmijje (*Mexhmu’ El-Fetava* 69/218/1), i cili e ka përkrahur këtë, duke shtuar: “Prandaj, “cilëndo dua” i referohet duasë që All-llahu e do, jo çfarëdo duaje...”; më vonë thotë: “Prandaj, më së miri është të thuhet: (duhet bërë dua) me dua të vërtetuar dhe të miratuar, dhe këto janë çka është transmetuar dhe ato të cilat janë të dobishme.” Kjo është kështu, por të dihet se cila dua është me të vërtetë e dobishme varet nga dituria autentike dhe kjo haset rrallë në mesin e njerëzve, prandaj është më mirë që t’i përmbahemi duave të cituara, posaçërisht kur ato përshijnë atë që adhuruesi do të kërkojë. All-llahu e di më së miri.

⁶²⁰ me ‘them: ajo çka shkakton njeriun të mëkatojë ose mëkati vetë.

⁶²¹ magrem: barrë; këtu nënkuptohet borxhi, siç dëshmohet nga pjesa tjetër e hadithit, në të cilën Aishja ka thënë: “Dikush i tha atij: “Pse po kërkon strehim nga borxhi aq shpesh, o i Dërguar i Allllahut?” Ai u përgjigj: “Vërtet, kur njeriu hyn në borxh, ai flet dhe gënjen, dhe ai premtion dhe thyen premtimin.”

⁶²² Buhariu dhe Muslimi.

⁶²³ D.m.th. nga e keqja e veprave të këqija që kam bërë dhe nga e keqja e të mos bërit të veprave të mira.

⁶²⁴ Nesaiu me sened sahih dhe Ibn Ebi Asimi në Es-Sunneh-un e tij (nr. 370 me kontrollimin tim); shtojca është prej të dytit.

⁶²⁵ Ahmedi dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur sahih, dhe Dhehebiu është pajtuar.

4- ((اللَّهُمَّ بِعِلْمِكَ الْغَيْبِ وَقُدْرَتِكَ عَلَى الْخَلْقِ أَحْيِنِي مَا عَلِمْتَ الْحَيَاةَ خَيْرًا لِي وَتَوَقَّيْ إِذَا كَانَتْ الْوَفَاةَ خَيْرًا لِي اللَّهُمَّ وَأَسْأَلُكَ خَشْيَتَكَ فِي الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ وَأَسْأَلُكَ كَلِمَةَ الْحَقِّ وَالْعَدْلِ فِي الْغَضَبِ وَالرِّضَا وَأَسْأَلُكَ الْقَصْدَ فِي الْفَقْرِ وَالْغِنَى وَأَسْأَلُكَ نَعِيمًا لَا يَبِيدُ وَأَسْأَلُكَ فُرَّةَ عَيْنٍ [لا تنفد و] لا تَنقُطُ وَأَسْأَلُكَ الرِّضَاءَ بَعْدَ الْقَضَاءِ وَأَسْأَلُكَ بَرْدَ الْعَيْشِ بَعْدَ الْمَوْتِ وَأَسْأَلُكَ لَذَّةَ النَّظَرِ إِلَى وَجْهِكَ وَ [أَسْأَلُكَ] الشَّوْقَ إِلَى لِقَائِكَ فِي غَيْرِ ضَرَاءٍ مُضِرٍّ وَلَا فِتْنَةٍ مُضِلَّةٍ اللَّهُمَّ زَيِّنَا بِزِينَةِ الْإِيمَانِ وَاجْعَلْنَا هَذَاهُ مُهْتَدِينَ))

4 - “O All-llah!, pashë diturinë Tënde mbi të fshehtën dhe pushtetin që ke mbi krijimin, më jep jetë derisa Ti e di se është e mirë për mua, dhe le të më marrë vdekja, nëse është më e mirë për mua. O All-llah! Po ashtu kërkoj prej Teje frikën ndaj Teje, kur jam vetëm dhe në mesin e njerëzve. Kërkoj prej Teje fjalën e vërtetë (në një transmetim: urtësi) dhe drejtësinë në hidhërim dhe në kënaqësi. Kërkoj prej Teje maturi në skamje dhe pasuri.

Kërkoj prej Teje gëzim që nuk shuhet. Kërkoj prej Teje kënaqësi [e cila nuk kalon, e as atë] që ndërpritet. Kërkoj prej Teje të jem i kënaqur me përcaktimin Tënd. Kërkoj prej Teje jetë të qetë pas vdekjes. Kërkoj prej Teje gëzimin e shikimit të fytyrës Sate, dhe [kërkoj prej Teje] etje për takimin me Ty, jo në vështirësi dhe sprovime. O All-llah! Na stolis me zbukurimin e Imanit dhe na bëj prej atyre që sëmbarin dhe që janë të përudhur.”⁶²⁶

5- ((اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي ظُلْمًا كَثِيرًا وَلَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ فَاعْفِرْ لِي مَغْفِرَةً مِنْ عِنْدِكَ وَارْحَمْنِي إِنَّكَ أَنْتَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ))

5 - Ai mësoi Ebu Bekr Es-Siddikun [radijall-llahu anhu] të thotë:

“O All-llah! Vërtet, i kam bërë shumë dëm vetes dhe askush nuk mund të falë mëkatet pos Teje. Pra, më fal dhe më mëshiro. Vërtet, Ti je Falësi, Mëshiruesi.”⁶²⁷

6- ((اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنَ الْخَيْرِ كُلِّهِ [عَاجِلِهِ وَآجِلِهِ] مَا عَلِمْتُ مِنْهُ وَمَا لَمْ أَعْلَمْ وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الشَّرِّ كُلِّهِ [عَاجِلِهِ وَآجِلِهِ] مَا عَلِمْتُ مِنْهُ وَمَا لَمْ أَعْلَمْ وَأَسْأَلُكَ [و في رواية: اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ] الْجَنَّةَ وَمَا قَرَّبَ إِلَيْهَا مِنْ قَوْلٍ أَوْ عَمَلٍ وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ النَّارِ وَمَا قَرَّبَ إِلَيْهَا مِنْ قَوْلٍ أَوْ عَمَلٍ وَأَسْأَلُكَ [و في رواية: اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ] مِنَ الْخَيْرِ مَا سَأَلَكَ عَبْدُكَ وَرَسُولُكَ [مُحَمَّدٌ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا اسْتَعَاذَكَ مِنْهُ عَبْدُكَ وَرَسُولُكَ] مُحَمَّدٌ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ [وَأَسْأَلُكَ] مَا قَضَيْتَ لِي مِنْ أَمْرٍ أَنْ تَجْعَلَ عَاقِبَتَهُ [لِي] رَشَدًا))

6 - Ai e udhëzonte Aishen [radijall-llahu anhu] të thotë:

“O All-llah! Vërtet, kërkoj prej Teje të gjitha të mirat [të hershmet dhe të vonshmet], atë prej asaj që e di dhe atë që nuk e di. Kërkoj strehim te Ti nga të gjitha të këqijat, [të hershmet dhe të vonshmet], atë prej asaj që e di dhe që nuk e

⁶²⁶ Nesaiu dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

⁶²⁷ Buhariu dhe Muslimi.

di. Kërkoj prej teje (në një transmetim: O All-llah! Vërtet, kërkoj prej Teje) xhennetin (kopshtin) dhe çfarëdo fjalë a vepër që afron drejt tij; kërkoj strehë te Ti nga zjarri dhe (nga) çdo fjalë a vepër që afron drejt tij. Kërkoj prej teje (në një transmetim: O All-llah! Vërtet, kërkoj prej Teje) të mirën që është kërkuar prej Teje nga robi dhe i Dërguari Yt [Muhammedi; dhe kërkoj strehë te Ti prej së keqes nga e cila robi dhe i Dërguari Yt Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] kërkonte strehim te Ti]. [Kërkoj prej Teje] që atë që ke përcaktuar për mua, të jetë [për mua] e dobishme.”⁶²⁸

7- ((اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْجَنَّةَ وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ النَّارِ))

7 - Ai i tha një njeriu: “Çka thua gjatë namazit?” Ai u përgjigj: “Dëshmoj (d.m.th. e bëj *teshehudin*), pastaj kërkoj prej All-llahut xhennetin dhe kërkoj strehë tek Ai nga zjarri. Mirëpo, pasha All-llahun, nuk e di murmuritjen⁶²⁹ tënde dhe të Muadhit.” Atëherë ai tha: “Rreth kësaj edhe ne Murmurisim”⁶³⁰

8- ((اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ يَا اللَّهُ [و في رواية: بالله] بِأَنَّكَ الْوَاحِدُ الْأَحَدُ الصَّمَدُ الَّذِي لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ أَنْ تَعْفِرَ لِي ذُنُوبِي إِنَّكَ أَنْتَ الْعَفْوُ الرَّحِيمُ))

8 - Ai dëgjoi një njeri duke thënë në *teshehud*:

“O All-llah! Vërtet, kërkoj prej Teje, o All-llah (në një transmetim: Pasha All-llahun), Një, i Vetmi, Absoluti, i Cili nuk është lindur dhe as që ka lindur kë dhe askush s’është si Ai, që të m’i falësh mëkatet. Vërtet, Ti je Falës, më i Mëshirshmi. Atëherë Pejgamberi tha: “I është falur!, i është falur!”⁶³¹

9- ((اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ بِأَنَّ لَكَ الْحَمْدَ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ [وحدك لا شريك لك] الْمَنَّانُ يَا بَدِيعَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ يَا حَيُّ يَا قَيُّوْمُ إِنِّي أَسْأَلُكَ [الجنة و أعوذ بك من النار])

9 - Ai dëgjoi një tjetër njeri duke thënë në *teshehudin* e tij: “O All-llah! Vërtet, kërkoj prej Teje nga fakti që Ty të takon i gjithë falënderimi; nuk ka Zot (të vërtetë) tjetër pos Teje, [je i vetëm, Ti nuk ke shok]; Dhurues i së mirave; [o] Shpikës i qiejve dhe i tokës; o Ti që je plot Madhështi dhe Nder; o i Gjallë, o i Përvetshëm; [Vërtet kërkoj prej Teje] [Xhennetin, dhe kërkoj strehë te Ti nga zjarri]. [Atëherë, i Dërguari [sal-

⁶²⁸ Ahmedi, Tajalisi, Buhariu në *El-Edeb El-Mufred*, Ibn Maxhe dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar. E kamë dhënë *Tahrirhin* e tij në *Silsileh El-Ehadith Es-Sahihah* (1542).

⁶²⁹ *Dendeneh*: të flitet aq sa intonacioni të jetë i dëgjueshëm, por fjalët të jenë të pakuptueshme - në këtë rast, fjalët e qeta të lutjes. Deklarata e fundit do të thotë “Fjalët tona janë si të tuat.”

⁶³⁰ Ebu Davudi, Ibn Maxhe dhe Ibn Huzejme (1/87/1) me *isnad sahih*.

⁶³¹ Ebu Davudi, Nesaiu, Ahmedi dhe Ibn Huzejme; Hakimi e ka shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar.

lall-llahu alejhi ve sel-lem] u tha Sahabëve: “A e dini se me çka bëri dua?” Ata thanë: “All-llahu dhe i Dërguari e dinë më së miri.” Ai tha: [“Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im] ai bëri dua me emrin⁶³² e Tij të madh (në një transmetim: më të madhin), me të cilin nëse i lutet Atij, Ai përgjigjet dhe me të cilin nëse prej Tij kërkohet, Ai jep.”⁶³³

10- ((اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي مَا قَدَّمْتُ وَمَا أَخَّرْتُ وَمَا أَسْرَرْتُ وَمَا أَعْلَنْتُ وَمَا أَسْرَفْتُ وَمَا أَنْتَ أَعْلَمُ بِهِ مِنِّي أَنْتَ الْمُقَدِّمُ وَأَنْتَ الْمُؤَخِّرُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ))

10 - Një prej gjërave të fundit që ai thoshte ndërmjet *teshhudit* dhe *teslimit* ishte:

“O All-llah! Më fal atë që kam bërë në të kaluarën dhe atë që do ta bëj në të ardhmen, atë që kam fshehur dhe atë që kam bërë haptas, dhe atë që e kam tepruar dhe çfarëdo që Ti di më mirë se unë. Ti je Shpëtuesi dhe Ti je Vonuesi dhe nuk ka Zot (të vërtetë) përpos Teje.”⁶³⁴

⁶³² Ky është *tevessul* (kërkim afrimi) tek All-llahu përmjet të Tij më të mirë dhe cilësive, dhe kjo është ajo çka i Lartësuar i urdhëron: “**All-llahut i përkasin emrat më të mirë, pra thirreni me ta.**” (El-A’raf 7: 180). Sa i përket afimit tek All-llahu me gjëra të tjera, p.sh. për hatër të kësaj e asaj, ose pasha të drejtën, pozitën, dinjitetin e filanit, etj. ekziston teksti nga Imam Ebu Hanifja (rahimehull-llah) dhe shokët e tij se një praktikë e tillë nuk pëlqehet (*mekruh*); në përgjithësi është e ndaluar (haram). Prandaj, është gjë e mjerueshme kur sheh shumicën e njerëzve, në mesin e tyre shumë dijetarë, duke shpërfillur plotësisht *tevessulin* e miratuar, - kurrë nuk do t’i dëgjosh duke iu afruar All-llahut në këtë mënyrë - por janë mirë të mësuar në forma të reja të *tevessulit*, të cilat nuk diskutohen fare, thuajse në asnjë mënyrë tjetër nuk është e lejuar! Shejhul-Islam Ibn Tejmije ka kompozuar një ese jashtëzakonisht të mirë në këtë temë, e titulluar *Et-Tevessul ve El-Vesileh* (“Të afuarit tek All-llahu dhe kuptimi i këtij veprimi”), i cili duhet të konsultohet, sepse është shumë i rëndësishëm dhe pak çka mund të krahasohet me të në përfshirjen e saj. Është, po ashtu, artikulli im “*Tevessul* - llojet dhe rregullat e tij”, i cili, po ashtu, është i rëndësishëm në përmbajtjen dhe formatin e vet, dhe gjithashtu përgënjeshtroon disa nga keqkuptimet e vonshme, të përkrahura nga doktorët bashkëkohorë të fesë. All-llahu na udhëzoftë ne dhe ata.

⁶³³ Ebu Davudi, Nesaiu, Ahmedi, Buhariu në *El-Edeb El Mufred*, Taberaniu dhe Ibn Menede në *Tehvid* (44/2, 67.1, 70/1-2), me *isnade sahih*.

⁶³⁴ Muslimi dhe Ebu Avane.

Teslimi (përshtëndetja e paqes)

Pastaj, "ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] përshtëndeste në të djathtën e tij:

((السلام عليكم ورحمة الله))

"Paqja dhe mëshira e All-llahut qofshin mbi ju" [derisa të dukej bardhësia e faqes së djathtë të tij] dhe në të majtë e tij:

((السلام عليكم ورحمة الله))

"Paqja dhe mëshira e All-llahut qofshin mbi ju" [derisa të dukej bardhësia e faqes së majtë të tij]."⁶³⁵

Nganjëherë, ai ia shtonte përshtëndetjes në të djathtë:

((السلام عليكم ورحمة الله وبركاته))

"...dhe bekimet e Tij (qofshin me ju)".⁶³⁶

"Kur ai thoshte:

"Paqja dhe mëshira e All-llahut qofshin me ju", në të djathtën e tij, nganjëherë e shkurtonte përshtëndetjen në të majtë në:

((السلام عليكم))

"Paqja qoftë mbi ju".⁶³⁷

Nganjëherë, "ai përshtëndeste vetëm njëherë, [Paqja qoftë me ju] [para fytyrës së tij, duke u kthyer pak në të djathtë]."⁶³⁸

"Ata bënë gjeste me duar ndersa përshtëndetnin në të djathtë dhe në të majtë. Kur i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i pa, tha:

⁶³⁵ Ebu Davudi, Nesaiu dhe Tirmidhiu, të cilët e kanë shpallur *sahih*.

⁶³⁶ Ebu Davudi dhe Ibn Huzejme (1/87/2), me *sened sahih*. Abdul-Hakku po ashtu e ka shpallur *sahih* në *Ahkam-in* e tij (56/2), sikundër Neveviut dhe Ibn Haxheri. Po ashtu, është transmetuar nëpërmjet një rruge tjetër nga Abdurrr-Rezzaku në *Musennefin* e tij (2/2/219), dhe nga *Mu'xhem El-Evsat* (nr.4476-numërimi im) dhe nga Darekutniu.

⁶³⁷ Nesaiu, Ahmedi dhe Siraxhi, me *sened sahih*.

⁶³⁸ Ibn Huzejme, Bejhekiu, Ed-Dija në *El-Muhtareh* dhe Abdul-Gani El-Makdisi në *Sunenin* e tij El-Mulekkini (29/1) dhe Hakimi, të cilët e kanë shpallur *sahih*, dhe Dhehebiu është pajtuar. *Tahririxhi* i tij është dhënë në *Iroa El-Galil*, nën hadithin nr.327.

“Ç’është me ju? Pse bëni gjeste me duar sikur ato të ishin bishta kuajsh?! Kur të japë selam ndokush nga ju, duhet të shikojë drejt shokut të tij dhe të mos bëjë ndonjë shenjë me duar.”

[Kështu, kur ata faleshin më të, ata nuk vepronin më kështu] (në një transmetim:

“Mjafton për secilin prej jush të vendosë dorën e tij mbi kofshën e tij dhe pastaj t’i përshëndesë vëllezërit që janë në të djathtën dhe në të majtën e tij”).⁶³⁹

Obligimi i *teslimit*

Ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thoshte:

“...nga ai (namazi) dilet me *teslim*.”⁶⁴⁰

Është kjo e fundit nga ajo çka ka qenë e mundur të kompilohet lidhur me përshkrimin e namazit të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nga *tekbiri* deri te *teslimi*. Shpresoj se All-llahu do ta bëjë singlerisht për Fytyrën e Tij plot Nder si dhe udhëzim në Sunnetin të Dërguarit të Tij të mëshirshëm dhe fisnik.

Qoftë i Lavdëruar dhe i Falënderuar All-llahu. I Lavdëruar qofsh, o All-llah, dhe i Falënderuar. Dëshmoj se nuk meriton të adhurohet kush, përveç Teje. Kërkoj falje nga Ti dhe Ty të pendohem.

O All-llah! Dërgo salavate mbi Muhammedin dhe mbi familjen e Muhammedit dhe bekoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit, siç ke dërguar salavate mbi Ibrahimin dhe mbi familjen e Ibrahimit. Ti, vërtet, je i Denjë për Lavdërim, Përplot Madhësi.⁶⁴¹

⁶³⁹ Muslimi, Ebu Avane, Siraxhi, Ibn Huzejme dhe Taberaniu.

Shënime: *Ibadijjetë* kanë shtrembëruar këtë hadith. Dijetari i tyre Rabi e ka përmbledhur këtë në *Musnedin* e tij të pabesueshëm me tekste të tjera, për të arsyetuar pikëpamjen e tyre se ngritja e duarve me tekbir zhvleftëson namazin! Këto fjalë janë të rreme, siç kam shpjeguar në *Ed-Da’ifeh* (6044).

⁶⁴⁰ Hakimi dhe Dhehebiu e kanë shpallur *sahih*; tashmë është dhënë e plotë nën “Tekbiri fillestar”

⁶⁴¹ Duaja e parë është më e plotë nga duatë e njohura si *keffareh el-mexhlis* (shlyerje për tubimin):

“Ai që e thotë këtë në një tubim të Përkujtimit (të All-llahut), do të jetë sikur vulë për të vulosur me të, dhe ai i cili e thotë në një tubim të kotë, do të ketë shpërblim për të” - në formë autentike e transmetuar nga Hakimi nga Hakimi dhe Taberaniu.

Duaja e dytë është natyrisht nga Sunneti i dërgimit të paqes dhe mëshirës mbi të Dërguarin. Këto dy dua janë mënyrat më të mirat për zbatimin e udhëzimit islam që pason:

“Nuk ka njerëz që ulen në një tubim në të cilin nuk e përmendin All-llahun e as që dërgojnë salavate mbi të Dërguarin, e të mos jetë ai burim i hidhërimit për ta; nëse All-llahu do, ai do t’i dënojë, ose nëse ai do, do t’i falë” - në formë autentike i transmetuar nga Tirmidhiu, Hakimi dhe Ahmedi. Shih në *Silsileh El-Ehadith Es-Sahihah* të Shejh Albanit (74-84) për detaje.

SHTOJCË

Krejt ajo çka është përmbledhur nga përshkrimi i namazit të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] vlen njësoj si për meshkuj, ashtu edhe për femra, sepse në Sunnet nuk gjendet asgjë që kërkon veçimin e femrës në ndonjërin prej këtyre përshkrimeve. Në të vërtetë, përgjithësia e deklaratës së tij [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], “**Faluni ashtu siç më keni parë mua duke u falur**”, përfshin edhe femrën.

Ky është mendimi i Ibrahim En-Neh’iut, i cili ka thënë:

“Veprimet e femrës në namaz janë të njëjta me të mashkullit” - transmetuar nga Ibn Ebi Shejbe (1/75/2), me *sened sahih* nga ai.

Hadithi në lidhje me *indimam*-in (palosjen) e femrës në sexhde dhe se ajo nuk është e njëjtë në këtë rast me mashkullin, është *mursel* dhe joautentik. Ebu Davudi e ka transmetuar këtë në “*El-Merasil*” nën autoritetin e Jezid Ibn Ebi Habibit.

Sa i përket asaj çka Imam Ahmedi ka transmetuar, sikur në “*Mesail*-in” e të birit të tij Abdull-llahut, nga Ibn Umeri, se ai udhëzonte gratë e tij të uleshin këmbëkryq në namaz, *senedi* i tij s’është autentik, sepse përmban Abdull-llah Ibn Umer El-Amrin, i cili është transmetues *daif* (i dobët).

Po ashtu, Buhariu transmeton në “*Et-Tarih Es-Saghir*” (f.95) me *sened sahih* nga Umm Ed-Derda’, “se ajo ulej në namazin e saj, sikurse që ulet mashkulli, dhe ajo ishte grua e dijshme - fekihe”

SHTOJCA 1

Dobësia e haditheve që mbështesin *ihtilafin* (mospajtimin, dallimin) nga *Silsileh El-Ehadith Ed-Da'ifeh vel-Mevdu'ah* (58-62) nga Shejh El-Albani

1. “Mospajtimi në ummetin tim është mëshirë.”

La Asle Lehu (I pabazë). Muhaddithët janë munduar të gjejnë ndonjë *isnad* për të, por nuk kanë gjetur asnjë, dhe Sujutiu në *El-Xhami' Es-Sagir*-in e tij ka thënë: “Ndoshta është përmbledhur në njërin nga librat e *huffadhit*, i cili nuk ka aritur te ne”!

Ky pohim është shumë i ekzazgjeruar, meqë do të nënkuptonte se disa nga thëniet e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] janë humbur për ummetin përgjithmonë, gjë që nuk i lejohet muslimanit të besojë.

Menaviu ka cituar Subhiun duke thënë: “Ajo (d.m.th. thënia) nuk është e njohur për muhaddithët dhe unë s'mund të gjej *isnad* për të, *sahih, daif a mevdu*”, dhe kjo është e mbështetur nga Shejh Zekerijeh El-Ensariu në shënimet e tij mbi *Tefsir El-Bejdevi* [92/2].

Më tutje, kuptimi i këtij hadithi është gjithashtu i gabuar, siç është treguar prej dijetarëve të vërtetuar, prandaj Ibn Hazmi thotë në *El-Ihkam fi Usul El-Ahkam* [5/64], pas të bërit me dije se ky nuk është hadith:

“Kjo është një ndër thëniet më të gabuara, pasi, nëse *ihtilafi* është mëshirë, atëherë pajtimi do të ishte dënim, gjë që asnjë musliman nuk do ta thoshte, sepse mund të ketë vetëm pajtim ose mospajtim, dhe mund të ketë vetëm mëshirë ose dënim.”

Edhe disa fjalë të Ibn Hazmit janë cituar më poshtë.

Kundërshton Kur'anin, i cili ka dënuar *ihtilafin* në shumë vende.

2. “Sahabët e mi janë si yjet: cilindo që ta pasoni, do të jeni drejt të udhëzuar”.

Mevdu (i shpifur). Transmetuar nga Ibn Abdul-Berri në *Xhami' Bejan El-'Ilm* [2/91] dhe nga Ibn Hazmi në *El-Ihkam* [6/82] përmes rrugës: Sellam ibn Sulejm, i cili ka thënë: “El-Harith ibn Gissini na e ka transmetuar nga El-A'meshi, ky nga Ebu Sufjani, ky nga Xhabiri, e ky nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ”.

Ibn Abdul-Berri ka thënë:

“Dëshmia nuk mund të vendoset më këtë *isnad*, sepse El-Harith Ibn Gissini është *mexhhul* (i panjohur)”;

Ibn Hazmi ka thënë:

“Ky është transmetim i dështuar. Ebu Sufjani është i dobët; El-Harith Ibn Gissini është Ebu Vehb Eth-Thekafiu; Sellam Ibn Sulejmani ka transmetuar hadithe të shpifura - ky është pa dtshim njëri prej tyre.”

Të gjykohej ky hadith sipas Sellam Ibn Sulejmit - po ashtu i njohur si Sellam Ibn Sulejman - është më mirë, sepse ekziston pajtimi se ai është *daif*; në të vërtetë, Ibn Kirashi ka thënë për të: “Një gënjeshtar i vërtetë”, dhe Ibn Hibbani ka thënë: “Ai transmetoi hadithe të shpifura.”

Sa i përket Ebu Sufjanit, ky nuk është i dobët, siç ka thënë Ibn Hazmi, por më parë ai është i besueshëm, siç ka thënë Ibn Haxheri në *Et-Takrib* dhe Muslimi transmeton prej tij në Sahihun e tij.

El-Harith ibn Gissini është i panjohur, siç ka thënë Ibn Hazmim sikurse që ka thënë Ibn Abdul-Berri, edhe pse Ibn Hibbani e ka përmendur atë në *Eth-Thikat* (Transmetuesit e besueshëm)

Prandaj, Ahmed i thotë: “Ky hadith nuk është autentik”, siç citohet në *El-Muntehab*-in [10/199/2] e Ibn Kudames.

Sa i përket thënies së Sha’ranit në *El-Mizan* [1/28]: “Ky hadith, ndonëse është diskutabil në sytë e muhaddithinëve, prapëseprapë është autentik në sytë e njerëzve të *Keshfit*”, është plotësisht e gabuar dhe e trilluar dhe s’duhet t’i kushtohet ndonjë rëndësi! Sepse shpallja e një hadithi *sahih* me anën e *Keshfit* (“zbulimi” në gjendje transi) është risi djallëzore e sufive, dhe mbështetja në të shpie gjer te shpallja *sahih* e haditheve të rreme dhe të pabaza siç është ky. Sepse edhe në rrethanat më të mira, *Keshfi* është mendimi, i cili nganjëherë është i drejtë, nganjëherë i gabuar - dhe kjo në qoftë se nuk përzihet me ndonjë dëshirë personale! Lusim All-llahun të na shpëtojë nga kjo dhe nga çdo gjë me të cilën Ai nuk është i kënaqur.

Të ngjashme me transmetimin e sipërpërmendur janë edhe këto që pasojnë:

“Shembulli i Sahabëve të mi është sikur ai i yjeve: ai që pason cilindo prej tyre do të jetë drejt i udhëzuar.”

Mevdu (i shpifur). Transmetuar nga Kuda’iu (109/2) përmjet: Xha’fer ibn Abdul-Vahidit, i cili ka thënë: “Vehb ibn Xherir ibn Hazimi na informoi nga i ati i tij, ky

nga El-A'meshi, ky nga Ebu Salihi, ky nga Ebu Hurejre, e ky nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]."

Njëri nga muhaddithët, ose Ibn El-Muhibbi, ose Dhehebiu ka shkruar në margjinë: "Ky hadith nuk është fare autentik", d.m.th. është i shpifur: e meta në të është Xhaferi, për të cilin Derkutniu ka thënë: "Ai kishte zakon të shpifte hadithe"; Ebu Zur'ah ka thënë: "Ai transmetoi hadithe të pathemelta"; Dhehebiu ka dhënë disa hadithe, për shkak të të cilave ai ka zhvlerësuar atë, duke qenë në mesin e tyre edhe ky, dhe pastaj ka thënë: "Kjo është një prej fatkeqësive të tij!"

3. **"Çfarëdo që ju jepet nga Libri i All-llahut duhet të veproni me të; s'ka kurrfarë arsytimi për lënien e tij. Nëse nuk ndodhet në Libër, atëherë (veproni) sipas shembullit tim të mëparshëm (Sunnetit). Nëse nuk ekziston asnjë shembull i mëparshëm (sunnet), atëherë (veproni) sipas asaj çka kanë thënë sahabët e mi: me të vërtetë, sahabët e mi janë sikur vendqëndrimet e yjeve në qiell, prandaj cilindo që ta merrni, do të udhëzoheni, dhe mospajtimet në mesin e sahabëve të mi janë mëshirë për ju."**

Mevdu (i shpifur). I përmbledhur nga Hatibi në *el-Kifajeh fi Ilm er-Rivajeh* (f.48) dhe gjithashtu nga Abul-Abas el-Asami në *Hadith* (nr.142), dhe nga Ibn Asakiri (7/3/15/2) përmes: Sulejman ibn Ebi Karime nga Xhuvjbiri, ky nga ed-Dahaku, ky nga Ibn Abasi, e ky nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Ky *isnad* është *daif xhidden* (shumë i dobët).

Për Sulejman ibn Ebi Karimenë, Ibn Ebi Hatimi ka treguar nga i ati i tij se "Ai është i dobët në hadith". Xhuvjbiri është Ibn Said el-Azadiu, dhe ai është *metruk* (i braktisur), siç kanë thënë Darekutniu, Nesaiu dhe të tjerët, dhe Ibn el-Medini e ka shpallur atë shumë të dobët.

Dahaku është Ibn Muzahim el-Hilali, dhe ai nuk e ka takuar Ibn Abasin. Iraku ka cituar pjesën e fundit të hadithit në *Tahrirhin* e tij të librit të Gazalit "Ihja Ulum ed-Din" (1/25), dhe pastaj ka thënë: "Isnadi i tij është *daif*". Isnadi është në të vërtetë shumë i dobët, për shkak të asaj që kemi përmendur për Xhuvjbirin, siç ka thënë Sahavi në *el-Mekasid*. Në kuptim, megjithatë, hadithi është i shpifur, siç shihet qartë nga ajo që ka kaluar dhe nga ajo që do të pasojë.

Sujuti e ka cituar hadithin në tërësi në fillim të broshurës së tij *Xhezil el-Mehevib fi Ihtolaf el-Medhehib* nga transmetimi i Bejhekiut në *el-Med-hal*, dhe Dejlemiu e ka treguar nga kjo rrugë, siç paraqitet në *el-Mevdu'at* të Ali el-Kariut (f.19). Duke ditur këtë, atëherë thënia e Sujutiut në broshurën e tij të sipërpërmendur është shumë e çuditshme: "... dhe ky hadith përmban disa pika për t'u përmendur; ndër to është kallëzimi i tij [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] për mospajtimet ndërmjet medhhebeve në çështjet jofundamentale, dhe kjo është një nga mrekullitë e tij,

duke qenë se është kallëzim për të Fshehtën; po ashtu, pëlqimi dhe pranimi tij i kësaj, pasi ai e përshkroi atë si mëshirë, dhe se personi i ngarkuar mund të zgjedhë cilindo prej tyre.”

Atij mund t'i thuhet: vendose fronin së pari, e pastaj ulu. Çka ka përmendur ai për zgjedhjen është e pasaktë: nuk është e mundur që një musliman t'i mbështetet atij dhe të punojë në bazë të përgjithësisë së tij, pasi shpie deri te thyerja e ndalimeve të Sheriatit, dhe kjo nuk është vështirë të shihet. Shih po ashtu diskutimin nën 4 më poshtë.

4. **“E pyeta Zotin tim në lidhje me atë çka për Sahabët e mi do të përçahen, kështu që All-llahu më frymëzoi: O Muhammed! Sahabët e tu janë për mua sikur vendqëndrime yjesh në qiell - disa janë më të ndritshëm se të tjerët; kështu që, kushdo që merr prej cilitdo prej tyre në ato çështje ku janë përçarë, atëherë për mua, ai është i udhëzuar.”**

Mevdu (i shpifur). Transmetuar nga Ibn Bette, në *El-Ibaneh* [4/11/2], nga Hatibi, Nizam El-Maliku në *El-Amali* [13/2], Di'ja' në *El-Munteka 'an Mesmu'atihi bimar* [116/2] dhe nga Ibn Asakiri [6/303/1] përmes:

Nua'jm ibn Hammadit, i cili ka thënë: “Adurr-Rahim ibn Zejdi na e transmetoi nga i ati i tij, ky nga Se'id ibn El-Musejjibi, ky nga Umer ibn El-Hattabi, e ky nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ”.

Ky isnad është *mevdu*.

Nuajm ibn Hammadi është i dobët: Ibn Haxheri ka thënë: “Ai bën shumë gabime”.

Për Abdurr-Rahim ibn Zejd- El-Aminin, El-Buhariu thotë: “Ai qe braktisur”; Ebu Hatimi ka thënë: “Hadithet e tij janë braktisur”: ai është i papranueshëm në hadith - ai e shkatërronte të atin e tij, duke transmetuar katastrofa nga ai”; Ibn Me'ini ka thënë: “Ai ishte një gënjeshtar i vërtetë, i ndytë”.

Për të atin e tij, Zejd El-'Ami ibn El-Havariun, Ibn Sa'di ka thënë: “Ai ishte i dobët në hadith.” Sujutiu ka regjistruar këtë hadith në *El-Xhami' Es-Sagir* përmes transmetimeve të Sixhizzit në *El-Ibaneh*, dhe Ibn Asakiri nga Umeri; Menaviu ka thënë në komentin e tij mbi *El-Xhami' Es-Safir*: Ibn El-Xhevziu ka thënë në *El-'Ilal*-in e tij: “Ky nuk është autentik. Nuajmi është shpërfillur; Ibn Me'ini e ka përshkruar Abdurr-Rahimin si një gënjeshtar i vërtetë; thotë në *El-Mizan*: “Ky hadith është i rremë.”

5. **“Vërtet Sahabët e mi janë sikur yjet: prandaj, cilëndo thënie të tyre që ta pranoni, do të jeni të udhëzua.”**

Mevdu (i shpifur). Ibn Abdul-Berri e transmeton në formën *mual-lek* (të pezulluar, d.m.th. një zinxhir i pakompletuar i transmetuesve në fundin e përmbledhësit), dhe Ibn Hazmi e ka transmetuar prej tij; zinxhiri komplet u soll nga Abd ibn Humejdi në *El-Muntehab min El-Musned* (86/1):

Ahmed ibn Junusi më informoi: Ebu Shihab El-Hanati na e ka transmetuar nga Hamzeh El-Xhezriu, ky nga Nafiu, ky nga Ibn Umeri, e ky nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

Po ashtu, Ibn Bette e ka transmetuar në *El-Ibaneh* [4/11/2 nga një tjetër zinxhir nga Ebu Shihabi.

Ibn Abdul-Berri ka thënë: “Ky *isnad* nuk është autentik; askush i pranueshëm si dëshmi nuk e ka transmetuar nga Nafiu.”

Ky Hamze është Ibn Ebi Hamzeja; Darekutniu ka thënë për të: “*Metruk* (i braktisur)”; Ibn Adi k’athënë: “Shumica e transmetimeve të tij janë të shpifura”; Ibn Hibbani ka thënë: “Ai mbetej i vetmuar në transmetimin e gjërave të shpifura nga transmetuesit e besueshëm, deri në atë masë, sikur ta kishte bërë me qëllim - nuk është e lejuar të transmetohet prej tij”; Dhehebiu ka cituar disa nga hadithet e shpifura të tij në *El-Mizan*, kjo që njëra prej tyre.

Ibn Hazmi ka thënë *El-Ihkam* (6/83), pasi ka deklaruar se ky hadith (nr.2, me të gjitha versionet e tij) pa dyshim është gënjeshtër, meqë kundërshton gjithashtu disa ajete të Kur'anit, p.sh. Nexhm (53: 3-4), Nisa (4: 82), Enfal (8: 86), këtë që pason:

“...prandaj është absurd që i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] të na urdhëronte të pasojmë çdo mendim të shprehur nga Sahabët, All-llahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata, sepse kishte në mesin e tyre asi që lejonin diçka, derisa të tjerët e ndalonin atë: nëse ky do të ishte rasti, tregtia me alkool do të ishte e lejuar për atë që do të pasonte Semurah ibn Xhundubin; do të ishte e lejuar për atë që pason Ebu Talhanë të hajë borë gjatë agjërimit, por e ndaluar nëse pason të tjerët pos tij; Nëse do të pasojë Aliu, Uthmani, Talha, Ebu Ejjubi dhe Ubejj ibn Ka’bi larja nuk do të ishte e detyruar për shkak të marrëdhënieve të paplota, por do të ishte e detyruar nëse do të pasojë Aishja dhe ibn Umeri; të gjithë këta shembuj na janë transmetuar me zinxhirë autentikë të transmetimit.”

Ai pastaj vazhdon të shpjegojë gjerësisht disa mendime të shprehura nga Sahabët, në të cilat ata kishin gabuar në lidhje me Sunnetin, si gjatë jetës së të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ashtu dhe pas vdekjes së tij. Ai pastaj thotë (6/86):

“Pra si mund të jetë e lejueshme që verbërisht të pasohen mendimet e njerëzve, të cilët sikur që bëjnë gabime, ashtu edhe ia qëllojnë?!”

Para kësaj, ai ka shpjeguar, nën titullin Dallimi i Dënuar (5/64), gabimin e atyre që thonë “Mospajtimi është mëshirë”, duke përdorur si dëshmi hadithin “Sahabët e mi janë si yjet: cilindo që ya pasoni, do të jeni të udhëzuar drejt”, duke sqaruar se hadithi është gënjeshtër, për disa arsye:

- (I) Nuk është autentik sa i përket zinxhirit të transmetimit
- (II) Më tutje, i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk do të mund të na urdhëronte diçka që ai vetë e ka shpallur të gabuar nganjëherë; p.sh. ai ia tërhoqi vërejtjen Ebu Bekrit në interpretimin e gabuar të ëndrrës së Ebu Bekrit, dhe Umerit në një interpretim tjetër të gabuar dhe Ebu Senabilit për shqiptimin e gabuar të një vendimi, prandaj nuk është e mundur për të të na urdhërojë në pasimin e dikujt që gabon;
- (III) I Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] asnjëherë nuk foli të pavërtetën; fjalët e tij gjithnjë ishin të vërteta: krahasimi me yjet është qartazi i gjymtë, pasi që, për shembull, nëse dikush ka për qëllim të udhëtojë në ndonjë rrugë të udhëzuar nga ylli i Bricjapit, por, në vend të kësaj, përcjell yjet në Akrep, ai nuk do të jetë drejt i udhëzuar, por do të devijojë nga rruga e duhur dhe do të gabojë pa masë, prandaj është qartazi e gabuar të thuhet se pasimi i cilitdo yll do të udhëzojë dikë si duhet.

Ibn El-Mulekkini ka dhënë një version të shkurtër të fjalëve të Ibn Hazmit në *El-Hulasah*-in e tij [2/175], e ka mbështetur dhe e ka përfunduar diskutimin e hadithit duke thënë: “Ky është një transmetim i trilluar, i shpifur, transmetim i rremë dhe nuk është fare i saktë.”

SHTOJCA 2

Hadithi autentik: *“Diku ia ke qëlluar, diku jo.”*

Nga: *Sahih El-Buhari*, Libri i Ëndrrave

E ka transmetuar Ibn Abbasi (All-llahu qoftë i kënaqur me të): Një njeri erdhi tek i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe tha:

“Pashë në ëndërr një re e cila bënte hije. Prej saj binte gjalpë dhe mjaltë, dhe pashë njerëzit duke i mbledhur me duart e tyre; disa mblidhnin më shumë e disa më pak. Një litar zgjatej nga toka dhe mbërrinte deri në qiell, dhe pashë që ti u kape dhe shkove lart; pastaj, një tjetër njeri u kap dhe shkoi lart dhe (pas kësaj) një tjetër (i treti) njeri u kap dhe shkoi lart, pastaj një tjetër (i katërti) u kap, por u këput dhe prapë u lidh.”

Ebu Bekri tha: “O i Dërguar i All-llahut! U flijoftë im atë për ty! Pashë All-llahun, më lejo ta interpretoj këtë ëndërr.” I Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i tha: *Interpretoje*”. Ebu Bekri tha: “Reja me hije simbolizon Islamin, ndërsa gjalpi dhe mjalti simbolizojnë Kur'anin, ëmbëlsinë e tij dhe disa njerëz që mësojnë shumë nga Kur'ani e disa më pak. Litari i zgjatur nga qielli deri në tokë është e vërteta të cilën ti (i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]) je duke pasuar. Ti e pason atë dhe All-llahu do të të ngrejë lart me të, pastaj një tjetër person do të të pasojë dhe do të ngrihet, pastaj një tjetër njeri do të të pasojë, por do të këputet, pastaj do të lidhet prapë për të dhe ai do të ngritet lart me të. O i Dërguar i All-llahut! U flijoftë im atë për ty! A kam të drejtë, apo jo?” I Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] u përgjigj: *“Diku ia ke qëlluar, diku jo”*. Ebu Bekri tha: “O i Dërguar i All-llahut! Pashë All-llahun më trego se ku gabova.” I Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Mos përbej”*.

(Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi dhe, po ashtu, nga Ebu Davudi, Tirmidhiu, Darimiu, Ibn Maxhe, Ibn Ebi Shejbe dhe Ahmed).

SHTOJCA 3

“Ai i cili u fal keq” [radijall-llahu anhu]

Në literaturën e Hadithit dhe të Fikhut, ky term i referohet Sahabit të përmendur në hadithin që pason të *Sahih El-Buhariu* (Libri i duave); shumë transmetime të tjera të këtij incidenti janë ndeshur në koleksione të ndryshme të hadithit dhe ofrojnë një burim të rëndësishëm nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] për mënyrën e duhur të faljes: Transmetuar nga Ebu Hurejre [radijall-llahu anhu]: I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] hyri në xhami dhe një njeri hyri pas tij. Ky u fal mandej vajti tek i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe e përshëndeti; ai ia ktheu përshëndetjen dhe i tha: “Kthehu dhe falu, sepse nuk je falur.” Ky njeri u kthye dhe u fal si më parë, pastaj u kthye dhe e përshëndeti të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], i cili tha: “Kthehu dhe falu, sepse nuk je falur”, tri herë. Njeriu tha: “Pasha Atë që të dërgojë ty me të Vërtetën, nuk mund të bëj më mirë se kjo, pra, të lutem më mëso.” Ai tha: “Kur të ngrihesh për t’u falur, thuaje tekbinin pastaj këndo çka është më lehtë për ty nga Kur’ani (atë çka e di përmendësh); pastaj bëj ruku derisa të qetësohesh në të; pastaj ngrije kokën dhe qëndro drejt, pastaj bëj sexhde, derisa të qetësohesh në të; pastaj ulu me kujdes derisa të qetësohesh, dhe vepro kështu në të gjitha namazet e tua”.

[Transmetime të mëtejshme të këtij hadithi të gjetura në vepra të tjera të Hadithit, siç është Sunen Ebi Davud, etj. Përmbajnë detaje të tjera.]

SHTOJCA 4

Dobësia e hadithit në lidhje me vendosjen e duarve nën kërthizë.

Nga *Irva El-Galil* (353) dhe *El-Xhenaiz* (f.118), nga Shejh El-Albani.

Ebu Davudi (756), Darekutniu (107), Bejhekiu (2/310), Ahmedi në *Mesail*-in e të birit (62/2) dhe, po ashtu, në *Zevaid El-Musned* (1/110) dhe Ibn Ebi Shejbe (1/156/1), transmetuar:

- 1) nga Abd Er-Rahman ibn Is-haku, ky nga Zijad ibn Zejd Es-Sivai, ku nga Ebu Xhuhejfeja, e ky nga Aliu [radijall-llahu anhu], i cili la thënë: “Është nga sunneti që të vendosen gjatë namazit shuplakat njëra mbi tjetrën nën kërthizë.”

Ky është *sened daif* (i dobët), për shkak të Abd Er-Rahman ibn Is-hakut (El-Vasiti El-Kufi), i cili është i dobët (shih më poshtë). Përveç kësaj, ka *idtirab*, sepse e ka transmetuar: ky nga Ebu Xhuhejfe, e ky nga Aliu (si më lart);

- 2) një herë nga Numan ibn Sadi, ky nga Aliu (transmetuar nga Darekutni dhe Bejhekiu); dhe
- 3) njëherë nga Sijas Ebul-hakamim ky nga Ebu Vaili, i cili ka thënë: “Ebu Hurejre ka thënë: “Është Sunneti...” (Transmetuar nga Ebu Davudi [758] dhe Darekutniu).

Dobësia e Abd Er-Rahman ibn Is-hak El-Kufit në sytë e Imamëve të Hadithit

- 1) Ebu Davudi ka thënë: “Kam dëgjuar Ahmed ibn Hanbelin duke shpallur Abd Er-Rahman ibn Is-hak El-Kufin *daif* (të dobët).” [Për këtë arsye Imam Ahmedi nuk e ka pranuar këtë hadith të tij, sepse i biri i tij Abdull-llahu ka thënë: “E pashë se gjatë namazit im atë i vendoste duart e tij, njërën mbi tjetrën, mbi kërthizë.”]
- 2) Neveviu ka thënë në *Mexhmu* (3/313) dhe, po ashtu, në *Sherh Sahih Muslim* dhe në vende të tjera: “Ata (dijetarët e hadithit) pajtohen në shpalljen e këtij hadithi të dobët, sepse është transmetim i Abd Er-Rahman ibn Is-hak El-Vasitit, i cili është transmetues *daif* (i dobët), siç pajtohen edhe Imamët e *Xherhit* dhe *Tadilit* (Vërtetimi dhe Zhvleftësimi i transmetuesve).”
- 3) Zejla’i ka thënë në *Nesb Er-Rajeh* (1/314): “Bejhekiu ka thënë në *El-Ma’rifeh*: “*Isnadi* i tij nuk është i sigurt, sepse është transmetim unikat i Abd Er-Rahman ibn Is-hak El-Vasitit, i cili është *metruk* (i braktisur) ”.”
- 4) Ibn Haxheri ka thënë në *Fet-h El-Bari* (2/186): “Është hadith i dobët.” Ajo çka tregon më tej në dobësinë e tij është ajo se në kundërti me të është transmetuar nën autoritetin e Aliut me *isnad* më të mirë: hadithi i Ibn Xherir El-Dabbiut nga i ati i vet, i cili ka thënë: “Kam parë Aliun [radijall-llahu anhu] duke

mbajtur dorën e majtë me të djathtën në nyje mbi kërthizë” - ky *isnad* është kandidat për shkallën *hasen*; Bejhekiu (1/301) fuqishëm e ka specifikuar si *hasen*, dhe Buhariu (1/301) e ka emëruar me siguri duke thënë në formë të shkurtuar, *ta'lik*.

Ajo çka është autentike nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] lidhur me pozitën e duarve është ajo se ato duhet të jënë në gjoks. Janë shumë hadithe në lidhje me këtë, njëri prej tyre është edhe ai nën autoritetin e Tavusit, i cili ka thënë: “I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] vendoste dorën e djathtë mbi të majtën dhe i mbështeste fort në gjoks gjatë namazit” - transmetuar nga Ebu Davudi (759) me *isnad sahih*.

Ndonëse ky është *mursel*, mjafton si dëshmi për të gjithë dijetarët, me gjithë mendimet e tyre të llojlojshme rreth hadithit *mursel*, meqë është *sahih*, si *isnad mursel* dhe, po ashtu, është transmetuar si *mevsul* me shumë transmetime; andaj vlen si dëshmi për të gjithë. Disa nga transmetimet që mbështesin këtë janë si pasojnë:

- a) nga Va'il ibn Huxhri: “Se ai e ka parë të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] duke e vendosur dorën e djathtë mbi të majtën dhe duke i vendosur ato në gjoks.” Transmetuar nga Ibn Huzejme në *Sahihun* e tij (*Nesb Er-Rajeh*, 1/314) dhe nga Bejhekiu në *Sunenin* e tij (2/30) me zinxhirë të transmetimit që mbështesin njëri tjetrin.
- b) nga Kabiseh ibn Hulbi, nga i ati i tij i cili ka thënë: “E kam parë të Dërguarin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] duke u larguar [pasi që kryente faljen] nga e djathta dhe e majta e tij dhe pashë duke i vendosur në gjoks - Jahja (Ibn Se'id) e ka përshkruar të djathtën (dorën) mbi të majtën, mbi nyje.” Transmetuar nga Ahmedi (5/226) me zinxhirë të transmetuesve që janë të standardit të vendosur nga Muslimi, përveç Kabises, por ky është shpallur i besueshëm nga Ixhli dhe Ibn Hibbani; sidoqoftë, askush nuk ka transmetuar prej tij, përpos Simak ibn Harbit, për të cilin Ibn El-Mediniu dhe Nesaiu thonë: “I panjohur” dhe Ibn Haxheri thotë në Takrib: “Ai është “Makbul” [dmt i pranueshëm vetëm nëse përkrahet].” Hadithet e ndonjërit si ky, janë *hasen* sikur transmetime mbështetëse, dhe prandaj Tirmidhiu ka thënë, pasi që ka cituar pjesën e këtij hadithi në lidhje me marrjen e dorës së majtë me të djathtën: “Është *hadith hasen*.”

Pra, këto janë tri hadithe që tregojnë se është sunnet të vendosen duart në gjoks, dhe ai që has në to nuk do të dyshojë se së bashku këto janë të mjaftueshme të dëshmojnë këtë.

SHTOJCA 5

Dobësia e Hadithit që dënon (qorton) këndimin pas Imamit.

Nga: *Silsileh El-Ehadith Ed-Daifeh vel-Mevdu'a* (568-570) nga Shejh El-Albani.

1. "Ai që këndon pas imamit, e ka gojën përplot zjarr."

Mevdu (i shpikur). Ibn Tahiri e ka cituar në *Tedhkirah El-Mevdu'at* (f.93), dhe ka thënë: "Isnadi përmban Ma'mun ibn Ahmed El-Haraviun, një gënjeshtarë i vërtetë që transmetonte shpifje."

Përshkrimi i mëtejshëm i tij është dhënë në hadithin 2 më poshtë. Ibn Hibbani e ka përmendur këtë hadith nën emrin e tij në *Ed-Du'afa* (Transmetuesit e Dobët), dhe dhehebiu e ka konsideruar si njërin prej fatkeqësive të tij!

Disa Hanefij janë mashtruar nga ky hadith, duke argumentuar mbi bazat e tij se çdo këndim pas imamit është absolutisht haram! Ebul-Hasenat El-Laknoviu ka thënë në *Et-Ta'lik El-Mumexhhid 'ala Muvetta' Muhammed* (f.99): "Është përmendur nga autori i *Nihaje-së* dhe nga të tjerët si *merfu*, me shprehjen, "...në gojën e tij është qymyri i ndezur" dhe është plotësisht i pabazë."

Ai ka thënë para kësaj: "Në asnjë hadith *merfu sahih* nuk gjendet ndalesa e këndimit pas imamit. Tërë ajo që citohet si *merfu* në lidhje me këtë ose është e pabazë, ose joautentike", dhe pastaj ka përmendur këtë hadith me dy tekstet, si shembull.

Dijetarët e kaluar dhe të tashmit janë dalluar në lidhje me këndimin pas imamit, duke marrë njërin prej këtyre tri qëndrimeve:

1. Që këndimi në namazet me zë dhe pa zë është i obligueshëm
2. Që heshtja në namazet me zë dhe pa zë është e obligueshme
3. Që të ketë këndim në namazet pa zë, por jo edhe në ato me zë.

Qëndrimi i fundit është më i peshuari dhe më i afërt me të vërtetën, sepse në të mund të përshtaten të gjitha dëshmitë, ashtu që asnjëra prej tyre të mos refuzohet plotësisht. Është qëndrim i Malikut dhe i Ahmedit, dhe pas analizës është preferuar edhe nga disa Hanefij, duke përfshirë Abdul-Hasenat El-Laknoviun, në librin e tij të përmendur.

Një shembull tjetër i shpifjeve të Ma'mun El-Haraviut është ky që pason:

2. "Nuk ka namaz ai që i ka ngritur duart gjatë namazit"

Mevdu (i shpikur). Ibn Tahiri e ka cituar këtë në *Tedhkirah El-Mevdu'at* (f.87) dhe ka thënë: “*Isnadi* përmban Ma'mun ibn Ahmed El-Heraviun, një gënjeshtar të vërtetë, i cili shpifte hadithe.”

Dhehebiu ka thënë për të: “Ai solli fatkeqësi dhe transmetime të turpshme. Ai shpiku hadithe, duke qenë ky njëri prej tyre, dhe i transmetoi ato haptazi nën autoritetin e transmetuesve të besueshëm.”

Mua më është e qartë nga hadithet që Ma'mun El-Heraviu i ka shpikur, se ai është një fanatik i medhhebit Hanefi, sepse të gjitha hadithet e përmendura nën përshkrimet e tij (në librat e transmetuesve) sillen rreth përkrahjes së Ebu Hanifes dhe fyerjes së Imam Shafiut; në mesin e tyre është kjo: fyerje e qartë ndaj pikëpamjes së Shafiut, i cili ka miratuar ngritjen e duarve gjatë shkuarjes në ruku dhe gjatë ngritjes prej rukusë (e cila është pa dyshim e vërtetë), ndërsa evidentisht duke përkrahur pikëpamjen hanefite, e cila thotë që kjo është *mekruh*. Ky njeri neveritës bile nuk ishte i kënaqur as me qëndrimin e medhhebit të tij që ngritja e duarve ishte *mekruh*: ai shkoi aq larg, sa që shpiku këtë hadith, me qëllim që të propagandojë në mesin e njerëzve se ngritja e duarve, në të vërtetë, e zhvlerëson namazin!

Ndoshta ai, po ashtu, kishte për qëllim të përkrahte transmetimin e Mehulit nga Ebu Hanifja, që tha: “Ai që i nge duart fjatë namazit, namazi i tij është i shkatërruar”, transmetim i cili mashtroi Amir Katib El-Itkanin, i cili kompiloj një hartim duke u bazuar në të që të argumentojë zhvlerësimin e namazit me ngritjen e duarve!

Njësoj është mashtruar edhe ai i cili ka përcjellur rrugën e tij dhe që ka vendosur se nuk është e lejuar për Hanefitë që të falen pas Shafive, sepse këtë i ngritin duart! Gjatë gjithë kohës ky transmetim nga Ebu Hanifja është plotësisht i rrejshëm, siç e ka vërtetuar Al-lameh Ebul-Hasenat El-Lakneviu në *El-Fefaid El-Behijjeh fi Teraxhum El-Hanefijjeh* (f.116, 216-7).

Shejh Ali El-Kariu e ka cituar këtë hadith në *El-Mevdu'at* dhe pastaj ka thënë (f.81): “Ky hadith është shpifur nga Muhammed b. Ukasheh El-Kurmaniu, All-llahu e poshtëroftë.” Më vonë (f.129) ai citon Ibn El-Kajimin: “Është një hadith i shpikur.”

Kjo është kontradiktore me atë çka është treguar (më lart) se shpikësi ishte Heraviu; nëse kjo është dëshmuar, atëherë ndoshta njëri prej tyre e vodhi nga tjetri!

Mund të shohim se çka mund të bëjë mospërfillja e Sunnetit dhe braktisja e vërtetimeve të transmetuesve nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe nga Imamët!

SHËNIM: Në lidhje me ngritjen e duarve gjatë shkuarjes në ruku dhe gjatë ngritjes prej saj, janë transmetuar shumë hadithe nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]: Ato, në të vërtetë, janë *mutevatir* në shikimin e dijetarëve; në fakt, ngritja e duarve me çdo

tekbir është dëshmuar nën autoritetin e tij në shumë hadithe, kurse mosngritja e duarve nuk është transmetuar në formë autentike prej tij, përveçse njëherë përmes Abdull-llah Ibn Mesudit [radijall-llahu anhu], por kjo nuk është e përshtatshme të praktikohet, sepse është *naʿf* (mohues). Është qëndrim i prerë i Hanefive dhe i të tjerëve, se *muthbit-i* (pohues) ka përparësi mbi *naʿf*-in (mohues); kjo është edhe kur pohuesja është vetëm, duke lënë mënjane rastin kur ekzistojnë shumësi hadithesh sikurse në këtë çështje! Mbi bazat e këtij principi dhe në mungesë të gjësdi që e kundërshton këtë, kjo i detyron në përvetësimin e ngritjes së duarve dhe që të mos qëndrojnë me këmbëngulje në medhheb, pasi është vendosur argumenti. Megjithatë, është dëm që vetëm një grusht personash nga të mëvonshmit dhe të mëhershmit e kanë përvetësuar këtë, sa që mosngritja e duarve është bërë shenjë dalluese për ta!

Edhe një prej shpikjeve të këtij gënjeshtari të poshtër, kësaj here fyerje personale ndaj Imam Shafiut (Muhammed bin Idris), është kjo që pason:

3. “Do jetë njeri në ummetin tim i njohur si Muhammed bin Idris, i cili do të jetë më i dëmshëm për ummetin tim sesa Iblisi. Dhe do të jetë një njeri në ummetin tim i njohur si Ebu Hanife, i cili do të sjellë kandil për ummetin tim.”

Mevdu (i shpifur). Ibn El-Xhevziu e ka cituar këtë në *El-Mevdu'at* (1/457) përmes: Ma'mun ibn Ahmed Es-Selmit, i cili ka thënë: “Ahmed ibn Abdull-llah El-Xhujbariu na e ka transmetuar neve: Abdull-llah ibn Mi'dan El-Azadi na ka informuar prej Enesit, si *merfu*; dhe pastaj ka thënë: “I shpikur; nga Ma'muni ose nga Xhujbariu. Hakimi e ka përmendur në *Medhkel* se i është dhënë Ma'munit: “A nuk e shikon Shafiun dhe pasuesit e tij?” Kështu që ai tha: “Ahmed ibn Abdull-llah El-Xhujbariu na e ka transmetuar neve...” etj., prandaj është më se evidente se ai ishte shpikës i tij.”

Shtojca që pason paraqitet në *Lisan*: “Hakimi pastaj ka thënë: “Çdokush të cilit All-llahu i ka dhënë sasinë më të vogël të inteligjencës do të dëshmonte se hadithi siç është ky është shpikje që i vishet të Dërguarit të All-llahu [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]”.

Hadithi ka edhe rrugë të tjera transmetimi, por këto varen në gënjeshtarë dhe transmetues të panjohur. Prandaj, është jashtëzakonisht e çuditshme që Al-lameh Ajniu anon kah përforcimi i hadithit me ato rrugë të tjera dhe që Shejh Kevtheri e mbështet! Megjithatë, nuk është befasi për të fundit, sepse ai ishte famëkeq për kredhjen e tij në fanatizëm ndaj Imam Ebu Hanifes (rahimehull-llah), edhe nëse kjo kërkonte fyerjen e Imamëve të tjerë. Por, befason Ajniu, sepse për të, në përgjithësi, ishte e ditur se nuk shkonte deri në ekstremizëm të tillë. Mendimi i të dyve është zhvërtetuar me analizimin e rrugëve të tjera të transmetimeve, të cilave iu kam referuar në mënyrë unike në librin e çmueshëm të Al-lameh Jemaniut *Et-Tenkil bima fi Ta'nib El-Kevtheri min El-Ebatil* (1/20, 446-9).

SHTOJCA 6

Analiza e haditheve në lidhje me thënien e “amin”-it nga Imami dhe Xhemati
Nga: *Silsileh El-Ehadith Ed-Da’ifeh* (951-2) nga Shejh El-Albani.

1. “Kur ai thoshte amin, ata pas tij thoshin amin, saqë bëhej shumë zhurmë në xhami.”

Nuk ka bazë për këtë hadith me këtë tekst, me sa dimë ne. Ibn Haxheri ka thënë në *Talhis El-Habir* (f.90): “Nuk mund ta gjej më këtë tekst, por kuptimi i tij është transmetuar nga Ibn Maxhe në hadithin e Bishr ibn Rafiut”.

2. “Kur ai këndonte: “Jo në të atyre që tërhoqën hidhërimin Tënd, e as në të atyre të cilët kanë humbur”, ai thoshte “amin”, saqë ata afër tij në safin e parë mund ta dëgjonin [dhe xhamia dridhej gjatë tij].”

Daif (i dobët). Transmetuar nga Ibn Maxhe (1/281) dhe Ebu Davudi, pa shtojcë (1/148), të dyja përmes: Bishr Ibn Rafiut nga Ebu Abdull-llahu, kushëriri i Ebu Hurejres, nga Ebu Hurejre, e ky nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

Ibn Haxheri ka thënë në *Tahlis* (f.90): “Bishr ibn Rafiu është i dobët. Kushëriri i Ebu Hurejres thuhet të ketë qenë i panjohur, por Ibn Hibbani e ka shpallur të besueshëm.”

Busejri ka thënë në *Zevaid* (56/1): “Ky është *isnad* i dobët. Gjendja e Ebu Abdull-llahut nuk dihet. Bishri është shpallur i dobët nga Ahmedi, dhe Ibn Hibbani ka thënë: “Ai transmetoi shpifje.””

Hadithi 2 vetëm jep një pjesë të kuptimit të nr.1, d.m.th. thënia e aminit vetëm nga imami. Sa i përket aminit të atyre pas, kjo mund të jetë arsyeja për shprehjen “xhamia dridhej prej tij (zërit)”, por hadithi, në të vërtetë, nënkupton që amini i të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte arsyeja për këtë.

3. “Kur ai përfundonte këndimin e Nënës së Kur'anit, ai ngrinte zërin dhe thoshte “amin”.

Daif (i dobët). Transmetuar nga Darekutni, Hakimi dhe Bejhekiu.

Të gjitha burimet e lartpërmendura përmbajnë Is’hak Ibn Ibrahim ibn El-Ala’ Ez-Zubejdin, po ashtu i njohur si Ibn Zibiriku, i cili është i dobët: Ebu Hatimi ka thënë: “Njeri plak, nuk ka të keqe në të”. Ibn Meini e ka përshkruar me fjalë të mira. Nesaiu ka thënë: “Nuk është i besueshëm”. Muhammed ibn Avfi ka thënë: “Nuk dyshoj se Is’hak Ibn Zibiriku kishte zakon të gënjente”. Mirëpo, ky tekst është i drejtë në kuptim, sepse ka hadith mbështetës të Vail ibn Haxherit me *sened sahih*.

(Pasi teksti i këtij hadithi nuk nënkupton fare aminin e xhematit, nuk është e drejtë që ta konsiderojmë si një version tjetër të hadithit nr.2, siç ka vepruar Shevkaniu).

Mbështetja e vetme për nr.1 është çka Shafiu ka transmetuar në *Musnedin* e tij (1/76) përmes Muslim Ibn Halidit nga Ibn Xhurejxhi, e ky nga Atau, i cili ka thënë:

4. “I dëgjoja imamët: Ibn Ez-Zubejrin dhe të tjerët pas tij, kur thoshin “amin”, dhe ata pas thoshin “amin”, derisa xhamia ushtonte.”

Kjo ka dy mangësi:

- Dobësitë e Muslim ibn Halid Ez-Zenxhiut. Ibn Haxheri ka thënë: “Ai ishte i besueshëm, por bëri shumë gabime”;
- An’ane-ja e Ibn Xhurixhit, i cili ishte *mudelis*. Ndoshta ai njëmend e ka marrë nga Halid ibn Ebi Enufi, i cili e ka transmetuar nga Atau siç pason:

4.1. “Hasa në dyqind sahabë të të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në xhami (d.m.th. Mesxhid El-Haram, Mekë) dhe, kur imami e tha: “e as në të atyre të cilët kanë humbur”, ata ngrenë zërin në amin (në një version: E dëgjova tingullin gjëmues të aminit të tyre).”

Transmetuar nga Bejhekiu (2/59) dhe Ibn Hibbani në *Thikat* (2/74); transmetimi tjetër është nga ky i fundit.

Ky Halid është përshkruar nga Ibn Ebi Hatimi (1/2/355-60), por ai nuk ka përfshirë ndonjë vërtetim ose zhvlerësim. Ibn Hibbani e ka përfshirë atë në mesin e transmetuesve të besueshëm, por Ibn Hibbani është i mirënjohur të mos ketë qenë rigoroz në raste të tilla, prandaj nuk jam i kënaqur që ky transmetim të jetë autentik. Për shkak se, nëse Ibn Xhurejxhi vërtet e mori prej tij, kjo formon vetëm një rrugë të diskutueshme; nëse jo, ne nuk dimë se prej kujt e mori Ibn Xhurejxhi. Me sa duket, as vetë Imam Shafiu nuk qe i kënaqur me autenticitetin e këtij transmetimi, sepse qëndrimi i tij është i kundërt me të: ai thotë në *El-Umm* (1/95): “Kur imami mbaron këndimin e Nënës së Librit, ai thotë “amin” duke e ngritur zërin, që ata pas tij të mund ta përcjellin. Kur ai e thotë atë, ata e thonë në vete, por nuk e pëlqej të thuhet me zë”.

Sikur transmetimi i lartpërmendur i Sahabëve të kishte qenë autentik sipas mendimit të Shafiut, ai nuk do të kundërshtonte veprimin e tyre. Prandaj, mendimi më i qëlluar në këtë çështje del se është medhhebi i Shafiut: që imami, por jo ata që përcjellin, duhet të thotë “amin” me zë të lartë. All-llahu e di më së miri.

Por atëherë, e pashë se Buhariu e ka përmendur tekstin (vetëm) e transmetimit në lidhje me Ibn Ez-Zubejrin në *Sahihun* e tij (d.m.th. formën *mual-lek*), duke e shënuar si të sigurt. Ibn Haxheri ka thënë në *Fet'h El-Bari* (2/208): "*Isnadi* lidhës është siguruar nga Abd Er-Rezzaku, ky nga Ibn Xhureixhi, e ky nga Atau. Ai (d.m.th. Ibn Xhurejxhi) ka thënë: "Unë i thashë atij: "A thoshte Ibn Ez-Zubejri amin në fund të Nënës së Kur'anit?" Ai tha: "Po, dhe ata pas tij thoshin amin gjithashtu, derisa xhamia ushtonte." Ai pastaj tha: "Vërtet, amini është dua". Kjo është gjetur në *Musennefin* e Abd Er-Rezzakut (2640/2), dhe nga kjo rrugë në *Muhal-la*-në e Ibn Hazmit (3/364).

Në këtë transmetim, Ibn Xhurejxhi ka sqaruar se e ka marrë këtë transmetim drejtpërdrejt nga Atau, prandaj jemi të sigurt se nuk ka *tedlis*, dhe transmetimi i Ibn Ez-Zubejrit është mirë i vërtetuar. Njëlloj është dëshmuar nga Ebu Hurejre; Ebu Rafiu ka thënë:

5. "Ebu Hurejre thërriste në namaz për Mervan ibn El-Hakemin, duke e ditur se ky i fundit nuk do të shkonte deri te "e as në të atyre që kanë humbur", përveç nëse e dinte se Ebu Hurejre gjendet në saf. Kështu që, kur Mervani tha "e as në të atyre që kanë humbur", Ebu Hurejre tha "amin", duke e zgjatur. Ai, po ashtu, tha: "Kur amini i atyre në tokë përputhet me aminin e atyre në qiell, ata që janë të falur"."

Transmetuar nga Bejhekiu (2/59); *isnadi* i saj është *sahih*.

Pra, pasi që asgjë nuk është vërtetuar nga Sahabët e tjerë krahas Ebu Hurejres dhe Ibn ez-Zubejrit në kundërshtim me aminin e tyre me zë të lartë, kjo duhet të pranohet. Tash për tash, nuk di për asnjë transmetim që kundërshton këtë. All-llahu e di më së miri.

SHTOJCA 7

Dy rekatet pas Vitrit.

Nga: *Silsileh El-Ehadith Es-Sahihah* (1993) nga Shejh El-Albani

1. I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Le të jetë namazi juaj i fundit i natës tek (vitr)”.

Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

2. Ebu Seleme e pyeti Aishen për namazin e të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Ajo tha: “Ai i falte 13 rekate (në namazin e natës): ai falte tetë rekate dhe pastaj falte vitrin dhe i falte dy rekate ulur, kur donte të bënte rukunë, ngrihej dhe pastaj bënte ruku dhe pastaj falte dy rekate mes ezanit dhe ikametit të namazit të Sabahut.”

Transmetuar nga Muslimi.

3. Thevbani ka thënë: “Ishim në një udhëtim me të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], kur ai tha: “Vërtet, ky udhëtim është një përpjekje dhe barrë e madhe, prandaj kur secili nga ju ta falë Vitrin, le t’i falë dy rekate; nëse zgjohet (atëherë është mirë), përndryshe këto të dyja do të jenë (namazi i natës) për të”.

Transmetuar nga Darimiu (1/374), nga Ibn Huzejme në *Sahihun* e tij (2/159/1103) dhe nga Ibn Hibbani (683) me rrugë të ndryshme, duke u kthyer deri te Ibn Vehbi, i cili ka thënë:

“Mu’aviye ibn Salihu ma transmetoi mua nga Shurejh Ibn Ubejdi, ky nga Abd Er-Rahman ibn Xhubejr ibn Nufejri, ky nga i ati i tij, e ky nga Tedhbani, i cili ka thënë...”.

Ibn Vehbi është përkrahur nga Abdull-llah ibn Salihu, i cili ka thënë: “Mu’aviye ibn Salihu na e transmetoi... etj., transmetuar nga Darekutniu (f.177) dhe Taberaniu në *El-Mu’xhem El-Kebir* (1410). Abdull-llah ibn Salihu është shejh i Buhariut, kështu që ai mund të përdoret si dëshmi në dëshmi në përkrahjen e transmetimeve të tjera.

Prandaj, është e qartë nga ky hadith (për shkak të urdhrit të përgjithshëm ndaj Ummetit të tij) që dy rekatet pas Vitrit nuk ishin ekskluzivisht për të. Dhe, me sa duket, qëllimi i urdhrit të tij që të bëhet tek namazi i fundit natën ishte që të parandalojë mospërfilljen e rekatit tek. Kështu, objektivi këtu nuk kundërshtohet nga dy rekatet pas tij sikurse është vërtetuar në praktikën dhe urdhrin e tij. All-llahu e dimë së miri.

SHTOJCA 8

Dobësia e Haditheve që përmendim fërkimin e fytyrës me duar pas duasë (lutjes).
Nga *Irvā El-Galil* (2/178-182) nga Shejh El-Albani.

1. “I Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], kur i ngrinte duart në dua, ai nuk i lëshonte poshtë derisa ta fërkonte fytyrën me to.”

Da’if (i dobët). Transmetuar nga Tirmidhiu (2/244) dhe Ibn Asakiri (7/12/2) përmjet: Hemmad ibn ‘Isa El-Xhuhani nga Henzele ibn Ebi Sufjan El-Xhemhi, ky nga Salim ibn Abdull-llahu, ky nga i ati i vet, ky nga Umer ibn Abdull-llahu, ky nga i ati i vet, ky nga Umer ibn El-Hattabi, i cili ka thënë: ...

Tirmidhiu ka thënë pas kësaj: “Ky është hadith *sahib garib*. Ne e njohim vetëm si hadith të Hammad ibn Isas, meqë vetëm ai e transmeton këtë. Ai ka pak hadithe, por njerëzit kanë transmetuar prej tij”.

Mirëpo, ky transmetim është i dobët, si në Tekrib të Ibn Haxher, i cili lidhur me të thotë në *Tehdhib*: “Ibn Ma’in ka thënë: “Shejh i mirë⁶⁴²”. Ebu Hatim ka thënë: “I dobët në Hadith”. Ebu Daud ka thënë: “I dobët. Ai transmeton hadithe *munker*”. El-Hakim dhe Nekkash ka thënë: “Ai transmeton hadithe të shpikura nga Ibn Xhurejxh dhe Xha’fer es-Sadik”. Ai është shpallur si i dobët nga ed-Darekutni. Ibn Hibban ka thënë: “Ai transmeton gjëra të radhitura gabimisht nga Ibn Xhurejxh dhe nga AbdulAziz bin Umer bin AbdulAziz, në mënyrën që zotëruesve të kësaj fushe u duket si e qëllimtë. Nuk lejohet ta përdorësh atë si dëshmi”. Ibn Makula ka thënë: “Ata i konsiderojnë të dobëta hadithet e tij”.

Prej këtui, të ngjashmit më këtë transmetues, janë të dobët, kështu që këto hadithe s’mund të ngrihen në shkallën *hasan*, e lerë më në atë të *sahisë*!

Një hadith i ngjashëm është:

“Kur peygamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] bënte dua dhe i ngrinte duart, ai fshinte fytyrën me to”.

Daif (i dobët). Ebu Daud (1492) nga Ibn Lehi’eh nga Hafs ibn Hisham ibn Utbeh ibn Ebi Uekas nga Sa’ib ibn Jezid nga babai i tij. Ky është *sened* i dobët, për shkak se Hafs ibn Hisham është i panjohur si dhe për shkak të dobësisë së Ibn Lehi’eh (*Tekrib et-Tehdhib*).

⁶⁴²Nëse Ibn Ma’in fliste mirë për një transmetues ndërsa pjesa tjetër e dijetarëve e shpallin atë të dobët, atëherë deklarata e Ibn Ma’in nuk merret në konsideratë, për shkak se ai ishte i njohur për ashpërsi në kritikë. Transmetuesit e dobët kishin tepër kujdes të mos shfaqnin dobësitë e tyre para tij. Kjo shpjegon faktin përse ai ishte i vetëm në vërtetimin e një transmetuesi.

Ky hadith s'mund të forcohet nga dy rrugët e transmetimit, për shkak të seriozitetit në dobësinë e të parës, të cilën dhe e patë.

2. "Kut t'i luteni Allahut, luteni me shuplakat e duarve tuaja e mos lutni me pjesën e prapme të tyre; kur ta kryeni (lutjen), fshini fytyrën me to".

Daif (i dobët). Transmetuar nga Ibn Maxheh (1181, 3866), Ibn Nasr në *Kijam el-Lejl* (f.137), et-Taberani në *el-Mu'xehm el-Kebir* (3/98/1) dhe el-Hakim (1/536), nga Salih ibn Hasan nga Muhamed ibn Ka'b nga Ibn Abas (radi Allahu anhu) si *merfu*.

Ky është një *sened* i dobët, për shkak të Ibn Hasan, i cili është *munker* në Hadith, siç ka thënë el-Buhari dhe en-Nesa'i: "Nuk merret hadithi prej tij". Ibn Hibban ka thënë: "Ai kishte këngëtare dhe dëgjonte muzikë, dhe kishte zakon të transmetonte hadithe të shpikura nga transmetues të besueshëm". Ibn ebi Hatim ka thënë në *Kitab el-Ilel* (2/351): "Pyeta babanë tim (dmth Ebu Hatim er-Razi) rreth këtij hadithi dhe ai tha: "Munker"". Ibn Hasan u mbështet nga Isa ibn Mejmun, i cili, po ashtu, e transmetoi nga Muhamed ibn Ka'b, siç transmetohet nga Ibn Nasr. Mirëpo, kjo nuk ndryshon gjë, meqë Ibn Mejmun, po ashtu, është i dobët". Ibn Hibban ka thënë: "Ai transmeton hadithe dhe të gjitha janë të shpikura". En-Nesa'i ka thënë: "S'është i besueshëm".

Ky hadith i Ibn Abas, po ashtu, transmetohet nga Ebu Daud (1485) dhe prej tij Bejhekiu (2/212), përmes Abdul-Melik ibn Muhammed Ejmenit nga Abdull-llah ibn Kabi, tekstin i cili është:

"Mos i mbuloni muret. Ai i cili shikon në shënimet e vëllait të vet pa lejen e tij, shikon në zjarr. Luteni All-llahun me shuplakat e duarve tuaja, dhe mos e lutni me shpinën e tyre, dhe, kur të përfundoni, fërkoni fytyrën tuaj me to."

Ky është *sened* i dobët. Abdul-Meliku është shpallur i dobët nga Ebu Davudi. Përmban, po ashtu, Shejh Abdull-llah ibn Jakupin, i cili është i panjohur - është e mundur që ky të jetë Ibn Hasani ose Ibn Mejmuni, të cilët u përmendën më lart.

Hadithi njashtu transmetohet nga Hakimi (4/270) përmes Muhammed ibn Muavijes, i cili ka thënë se Mesadif ibn Zijad El-Medini ia ka transmetuar këtij atë që kishte dëgjuar nga Muhammed ibn Kab El-Kurazi. Dhehebiu e ka pasuar këtë, duke cekur se Ibn Muavije ishte shpallur gënjeshtar nga Darekutniu; pra, hadithi është i falsifikuar.

Ebu Davudi ka thënë për këtë hadith: "Ky hadith është transmetuar nëpërmjet më shumë se një rruge nën autoritetin e Muhammed ibn Kabit; të gjitha ato janë të dobëta."

Ngritja e duarve gjatë Kunutit për Fatkeqësi është vërtetuar nga i Dërguari i Allahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në duanë e tij kundër politeistëve, të cilët i mbytn shtatëdhjetë recitues (recitues të Kur'anit) - transmetuar nga Imam Ahmedi (3/137) dhe

Taberaniu në *El-Muxhem Es-Sagir* (f.111), si hadith i Enesit me *sened sahih*. Njësoj është dëshmuar nga Umeri dhe të tjerët në Kunutin e Namazit të Vitrit. Megjithëkëtë, pasi fërkimi i fytyrës pas Duasë El-Kunut nuk është cituar fare nga i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], e as nga asnjë Sahab, padyshim që është risi.

Sa i përket fërkimit të fytyrës pas duasë jashtë namazit, janë vetëm këto dy hadithe. Dhe nuk mund të thuhet se ato përforcojnë njëra-tjetrën deri në shkallën *hasan* sikurse që ka vepruar Menaviu, për shkak të dobësisë serioze që gjendet në rrugët e transmetimit të tyre. Për këtë Imam Neveviu ka thënë në *Mexhmu*: “Nuk është e preferuar”, duke mbështetur Ibn Abd Es-Selamin, i cili ka thënë “Vetëm një injorant e bën këtë.”

Qëndrimi se fërkimi i fytyrës pas duasë nuk është i përcaktuar, përforcohet me faktin se ka shumë hadithe autentike për ngritjen e duarve në dua dhe në asnjërën prej tyre nuk përmendet fërkimi i fytyrës. Kjo tregon, nëse do All-llahu, se kjo është e papranueshme dhe e papërcaktuar.